



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

BESIMI

BAZAT – ESENCA - NEGACIONI

Dr. Muhamed Naim Jasin

Botuar nga: Gjurma Botime

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

PARATHËNIE.....	9
HYRJE.....	10
KAPITULLI I PARË.....	13
BAZAT E IMANIT.....	13
PJESA E PARË.....	15
BESIMI NË ALL-LLAHUN XH.SH.	15
1 TEVHIDUR-RUBUBIJJE.....	16
2 - TEVHIDUL-ULUHIJJE.....	22
3- TEVHIDUL-ESMA'I VES-SIFAT.....	29
EMRAT E BUKUR TË ALL-LLAHUT XH.SH.....	37
ARGUMENTET PËR TEVHIDUL-ESMA'I VES-SIFAT.....	41
PJESA E DYTË.....	50
BESIMI NË ENGJËJ.....	50
VEÇORITË E ENGJËJVE.....	52
ROBËRIT FISNIKË.....	55
QËNDRIMI I ENGJËJVE NDAJ GJITHËSISË DHE NJERIUT.....	56
NUMRI I ENGJËJVE.....	64

BESIMI NË ENGJËJ INDIVIDUALISHT DHE PËRGJITHËSISHT	66
ROLI DHE RËNDËSIA E BESIMIT NË ENGJËJ NË JETËN E NJERIUT	70
PJESA E TRETË	72
BESIMI NË PEJGAMBERËT DHE LAJMËTARËT E ALL-LLAHUT XH.SH.....	72
PEJGAMBERËT DHE LAJMËTARËT	73
PEJGAMBERËT MË TË ZGJEDHUR (ULUL`AZM)	76
PËRMBAJTJA E SHPALLJES.....	76
BESIMI NË MUHAMMEDIN A. S.....	84
PJESA E KATËRT	95
BESIMI NË LIBRAT E ALL-LLAHUT XH.SH.....	95
PJESA E PESTË	105
BESIMI NË BOTËN E ARDHSHME.....	105
AKCENI I KUR`ANIT NË KËTË BAZË TË BESIMIT DHE SHKAKU I KËSAJ	106
ARGUMENTET E BESIMIT NË BOTËN E ARDHSHME DHE PËRGJIGJJA NË DYSHIMIN E JOBESIMTARËVE	111
DETAJET E BESIMIT NË BOTËN E ARDHSHME	123
1 - SPROVIMI DHE PROVIMI NË VARR NGA ANA E DY ENGJËJVE.....	123
2 - VUAJTJET DHE KËNAQËSITË NË KABUR.....	125

3 - PARASHENJAT E DITËS SË GJYKIMIT	130
A - LINDJA E DIELLIT NGA PERËNDIMI	136
B - DALJA E KAFSHËS NGA TOKA	138
C - PARAQITJA E DEXHXHALIT	139
D - ZBRITJA E ISAIT A.S.	145
D - PARAQITJA E JE`XHUXHIT DH ME`XHUXHIT	148
4 - FILLIMI I DITËS SË GJYKIMIT	151
5 - RINGJALLJA	153
6 - (EL-HASHËR) TUBIMI I TË GJITHË NJERËZVE NË NJË VEND PËR DHËNIEN E LLOGARISË	154
7 - SHPËRBLIMI - NDËSHKIMI PËR VEPRAT E BËRA	157
8 - PARASHTRIMI I VEPRAVE NJERËZORE DHE GJYKIMI	158
9 - HAVDI (BURIMI) I RESULLULL-LLAHUT S.A.V.S.	165
10 - PESHORJA (PESHIMI I VEPRAVE)	168
11 - URA SIRAT	170
12- XHENNETI DHE XHEHENNEMI	174
PJESA E GJASHTË	178
BESIMI NË PËRCAKTIMIN E ALL-LLAHUT XH.SH.	178

DEFINICIONI I KADAASË DHE KADERIT.....	178
DOMETHËNIA E IMANIT NË KADER.....	181
SHKALLA E PARË:.....	181
SHKALLA E DYTË:.....	182
ARSYETIMI I JOBESIMTARËVE ME KADER.....	187
FSHEHTËSIA E PËRCAKTIMIT TË ALL-LLAHUT XH.SH. DHE NDALIMI I POLEMIZIMIT RRETH TIJ	192
NDIKIMI I BESIMIT NË KADER NË JETËN E MYSLIMANIT	194
BESIMI NË KADER PRODHON REZULTATE KOLOSALE NË JETËN TOKËSOR TË NJERIUT	204
BESIMI NË KADER NUK BIE NË KUNDËRSHTIM ME PUNËN E BAZUAR NË SHIKAQET DHE PASOJAT	204
KAPITULLI I DYTË.....	208
ESENCA E IMANIT.....	208
ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I IMANIT	215
KAPITULLI I TRETË	222
FJALËT DHE VEPRAT TË CILAT NXJERRIN NGA IMANI.....	222
PJESA E PARË.....	223
KUR JOBESIMTARI BËHET BESIMTAR	223
ARGUMENTET PËR KONFIRMIMIN E PARASHTRUAR.....	225

SHEMBUJT NGA PRAKTIKA E RESULULL-LLAHUT S.A.V.S. DHE NGA NDODHITË NGA SIREJA.....	227
PJESA E DYTË	235
KUR BESIMTARI BËHET JOBESIMTAR	235
RREGULLA	236
SQARIMI I KËSAJ RREGULLE	236
LLOJET E GJËRAVE QË NXJERRIN NGA IMANI.....	238
LLOJI I PARË.....	239
LLOJI I DYTË:.....	240
LLOJI I TRETË.....	242
LLOJI I KATËRT	248
TË KËNAQURIT ME KUFËR DHE PAKËNAQËSIA ME ISLAM	251
1 - KONSIDERIMI SE JOBESIMTARËT - ATEISTËT, RENEGATËT DHE MUSHRIKËT - NUK JANË JOBESIMTARË, OSE DYSHIMI NË MOSBESIMIN E TYRE, OSE TË PRANUARIT PËR TË VËRTETË CILINDO DREJTIM TË TYRE JOBESIMTAR	252
2 - MIQËSIMI ME JOBESIMTARËT DHE SHPREHJA E PAJTUESHMËRISË ME BESIMIN E TYRE.....	254
ÇKA DO TË THOTË MIQËSIMI ME JOBESIMTARËT?	261
ÇKA PRANOHET, E ÇKA NUK PRANOHET NGA ARSYETIMI NË KËTË SITUATË	264
KUFIJTË E DHUNËS QË MIRREN PARASYSH	266

DISA SHEMBUJ TË MOSKËNAQËSISË ME ISLAM.....	272
FJALËT E DISA ALIMËVE PËRKITAZI ME ATË SE ÇKA SHKAKTON RENEGIMIN NGA FEJA	274
KUJDESI PËRKITAZI ME SHPALLJEN E DISA PERSONAVE PËR KAFIR.....	287
FJALA PËRFUNDIMTARE.....	293
QËNDRIMI ISLAM NDAJ MËKATARËVE	293
VETË MËKATI NUK NXJERRË NGA FEJA E ALL-LLAHUT XH.SH.	293
PJESËTARËT E EHLI SUNNETIT PRANOJNË NDËSHKIMET QË JANË PËRMENDUR PËR MËKATE TË CAKTUARA.....	305
MËKATET E MËDHA	307
DEFINICIONI I MËKATIT TË MADH DHE KRITERI I TIJ	311
DISA SHEMBUJ TË MËKATEVE TË MËDHA	313
SHKAQET E LIRIMIT NGA NDËSHKIMI PËR MËKATE	316
SHËNIM PËR AUTORIN.....	323

PARATHËNIE

Bismilahir-Rrahmanir-Rrahim

Falënderim i qoftë All-llahut, Zotit të të gjitha botëve, bekimi i All-llahut dhe paqja qofshin mbi Pejgamberin, mbi familjen e tij të ndershme, mbi shokët e tij besnik dhe mbi të gjithë pasuesit e tij gjer në ditën e gjykimit.

Akideja-tevhidi është shkencë themelore islame, në bazë të së cilës ndërtohen të gjitha shkencat e tjera të Islamit. Misioni i çdo Pejgamberi ka qenë i përmbajtur në maksimën La ilahe ilAll-llah - nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, dhe detyrë e çdonjërit prej tyre ka qenë ta mbarështojë këtë ide në zemrat e ithtarëve të tyre. Mjerisht, kohëve të fundit në mjedisin tonë assesit nuk është punuar në shkrimin dhe në përgatitjen e librave, apo teksteve shkollore nga kjo fushë, të cilat do t'i përgjigjeshin nevojave të myslimanit tonë mesatar në Bosnjë apo nxënësit mesatar të medresës. Rrekja jonë në këtë fushë është kufizuar në teoritizimet filozofike apo gjysmëfilozofike - debatime ilmul kelame rreth cilësive të All-llahut xh.sh. dhe rreth çështjeve të gajbit. Mirëpo, vëllezërit tanë në botën islame kanë shkruar me dhjeta vepra dhe libra shkollore bashkëkohore nga kjo fushë, të cilat kanë zënë vendin e tyre në fakultete dhe në universitete të famshme islamike. Njëra nga veprat bashkëkohore akaide gjithëpranuese nga profesorët dhe studentët gati të të gjitha universiteteve është edhe kjo vepër e cila, me vullnetin e All-llahut xh.sh., ka gjetur vendin e vet edhe në gjuhën boshnjakishte (tani edhe në gjuhën shqipe MD). Pranueshmëria e saj

nga ana e numrit të madhë të botës islame ka qenë motiv kryesor gjatë vendosjes për përkthimin e saj. Autori i kësaj vepre është profesori i famshëm i Universitetit të Jordanisë i cili edhe sot vepron dhe punon. Shpresoj se me këtë vepër do të plotësojmë zbrazësirën e madhe e cila është e pranishme në këtë fushë në gjuhën tonë.

Ë lus All-llahun xh.sh. që kjo vepër të hasë në mirëpranim nga ana e myslimanëve tanë, siç është rasti tek vëllezërit tonë në botën arabe, dhe e lus Atë të më shpërblejë në Ditën e gjykimit për mundin tim që e kam bërë duke përkthyer këtë vepër.

Përkthyesi në boshnjakishte:

Mr. Zuhdi Adilović

HYRJJE

Falëndeimi i përket All-llahut, nga Ai kërkojmë ndihmë dhe Atë e lusim për ndjesë. Mbështetemi në All-llahun nga të këqijat e vetës sonë dhe nga veprat tona të këqija. Atë që All-llahu e drejton në rrugë të drejtë, për atë nuk ka lajthitje, e atë të cilin e shpie në lajthitje, për të nuk ka udhëzim. Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi a.s. është robi dhe i Dërguari i Tij.

Baza e çdo çrregullimi është kundërshtimi i të së vërtetës dhe shmangia nga rruga e saj, ndërsa çdo e mirë prehet në pasimin e së vërtetës dhe në të përmbajturit e udhëzimeve të saj. E vërteta-

hakk është gjendje më e përsosur dhe më e volitshme në të cilën All-llahu xh.sh. i ka krijuar të gjitha krijesat, andaj prej tyre kërkon që edhe ato të jenë të tilla. Çdo gjë në këtë botë e ka krijuar vetëm All-llahu xh.sh. dhe në këtë askush nuk ka bashkëpunuar me Të. All-llahu xh.sh. e ka formuar çdo krijesë në këtë botë në mënyrë të caktuar dhe për të kujdeset në mënyrë adekuate. Ndërsa All-llahu xh.sh. është i përkryer dhe larg çdo të mete, dhe në krijimtarinë dhe në përcaktimin e Tij prehet vetëm drejtësia dhe korrektësia. Për këtë shkak çdo gjë që shmanget nga Ligji hyjnor dhe urdhri i Tij, shkatërrohet në mënyrë të pashmagshme. Qiejt dhe Tokën All-llahu xh.sh. i ka krijuar sipas së vërtetës dhe i ka rregulluar sipas urtësisë së Vet, andaj edhe janë në përsosmëri dhe në harmoni të plotë.

“Sikur të kishte në to (qiejt dhe Tokën) zota, përveç All-llahut, në të dyja do të mbretëronte çrregullimi.” (El-Enbija: 22).

Gjithashtu edhe njeriu është një nga krijesat e All-llahut xh.sh. dhe korrektësia e jetës së tij varet nga konceptimi i të vërtetës dhe të pasuarit e saj, ndërsa prapësira është rezultat i pashmagshëm i mosnjohjes të së vërtetës, apo flakja e saj pasi që njëherë është konceptuar ajo. Shkaku i jetesës jokorrekte i mbarë njerëzimit është mosbesimi në Krijuesin dhe mospërfillja e urdhreve e udhëzimeve të Tij dhe të së vërtetës të cilën e ka shpallur Ai. Ndërsa shkaku i mbarë jetesës korrekte në këtë botë është besimi në All-llahun xh.sh. dhe në atë që ka shpallur Ai dhe të vepruarit sipas udhëzimit të Tij në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore. Prandaj All-llahu xh.sh. ka thënë:

“Me të vërtetë, do t’ju arrijë juve udhëzim nga ana Ime, e kush pason udhëzimin Tim, nuk do të humbë (në këtë botë), as që do të jetë fatkeq (në botën tjetër). E, ai që shmanget nga Libri Im, ai

do të ketë jetë të vështirë dhe, Na, në Ditën e Kiametit do ta ringjallim atë të verbër. (Ta-ha: 123-124).

Udhëzimin e All-llahut xh.sh. e pason vetëm ai që e beson Atë, e përkujton Atë, e ndien praninë e Tij, cilësitë e Tij dhe madhështinë e Tij. E, kush e harron All-llahun xh.sh., ai në realitet ia kthen shpinën udhëzimit të Tij.

Pra, njeriu në këtë botë është vënë në sprovim ndërmjet këtyre dy gjërave: ta përkujtojë All-llahun xh.sh. dhe ta ndjekë rrugën Tij, ose ta harrojë All-llahun dhe të jetë në lajthitje. Ai është në udhëkryqin e këtyre dy udhëzimeve, e i treti nuk ekziston. Para tij është rruga e imanit, e udhëzimit dhe e lumturisë në këtë dhe në botën tjetër, dhe rruga e kufrit, lajthitjes dhe fatkeqësisë në të dy botët.

Prandaj, gjëja më e rëndësishme dhe më e lartësuar që mund të mësojë njeriu dhe t'i mësojë edhe të tjerët për këtë, është çështja e imanit, bazave të tij dhe obligimeve të cilat nënkuptohen me të. E, njëkohësisht gjëja më esenciale me çka do të mbrohet dhe të armatohet është konceptimi i simptomeve të kufrit, shkaqeve të tij dhe pasojave të tij. Nëse njeriut i bëhen të qarta këto dy gjëra të rëndësishme, atëherë e ka konceptuar rrugën e lumturisë së vet dhe do ta ndjekë atë me siguri dhe nuk do të shmanget nga ajo, dhe e ka konceptuar rrugën e fatkeqësisë, të cilës do t'i shmanget me siguri.

Shpresojmë se në këtë libër do të sqarojmë - duke shpresuar që All-llahu xh.sh. do t'na pajisë me dituri dhe me të vërtetën - çështjen e imanit dhe baza e tij, simptomat e kufrit, shkaqet e tij dhe rrugët e tij. E, vetëm All-llahu xh.sh. është Ai i Cili mundëson suksesin. Prandaj, e tërë ajo që ia qëllojmë nga e vërteta është nga All-llahu xh.sh. i Vërtetë, ndërsa e tërë ajo që gabojmë është nga

ana e jonë dhe nga shejtani. E lusim All-llahun xh.sh. të na falë dhe ta obligojë ndonjërin prej robërve të Vet që t'i përmirësojë gabimet në këtë libër dhe ta sqarojë të vërtetën.

Në mënyrë që më lehtë të përdoret ky libër, temat e saj do t'i prezentojmë në tre kapituj:

1. - Bazat e imanit;
2. - Esenca e imanit dhe
3. - Gjërat të cilat nxjerrin nga imani.

KAPITULLI I PARË BAZAT E IMANIT

Në emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Allahu xh.sh. thotë:

“Pejgamberi beson në atë që i është shpallur nga Zoti i tij, dhe besimtarët; - të gjithë ata besojnë All-llahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij dhe Pejgamberët e Tij: “Na nuk dallojmë asnjërin nga Pejgamberët e Tij”. Ata thonë: “Ne dëgjuam dhe përulemi; falna neve o Zoti Ynë dhe te Ti do të kthehemi! (El-Bekare: 285)

“O besimtarë! Besoni All-llahun, Pejgamberin e Tij, Librin që ia ka dërguar Pejgamberit të Vet dhe Librat që i ka dërguar më parë. E ai që nuk beson All-llahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, Pejgamberët e Tij dhe Ditën e Kiametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë.” (En-Nisa’: 136)

“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj kah lindja dhe perëndimi, por, mirësia është kur (njeriu) beson All-llahun, Ditën e Kiametit, engjëjt, Librat, Pejgamberët.” (El-Bekare: 177)

Në hadithin e njohur mbi Xhibrilin, i cili i ka ardhur Pejgamberit s.a.v.s. në figurën e bedunit dhe ka filluar të pyeste për Islamin, imanin dhe ihsanin, qëndron se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë se imani është: “Të besosh All-llahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, Pejgamberët e Tij, botën e ardhshme dhe se çdo gjë që ndodh (e mirë a e keqe), ndodh sipas përcaktimit të All-llahut.”¹

Këto gjashtë elemente janë bazat e besimit, dhe këto janë parimet themelore me të cilat kanë ardhur të gjithë Pejgamberët a.s. dhe për të cilat flitet në të gjitha Librat e shpallura. Prandaj imani i askujt nuk është i plotë dhe i pranuar përderisa nuk beson në të gjashtë bazat e përmendura të imanit, në mënyrë çfarë e ka caktuar Kur’ani dhe Sunneti i Pejgamberit të All-llahut. E, ai i cili mohon çkado qoftë prej tyre, ai ka dalur nga imani dhe është bërë jobesimtar.

Në kaptinat vijuese, insh-All-llah, do t’i trajtojmë këto gjashtë bazat.

1 Transmeton imam Muslimi nga Umeri r.a. Shih Sahih Muslim me komentin e Neveviut, 1: 175. Këtë hadith e transmeton edhe Buhariu nga Ebu Hurejre r.a. Shih Fet’hul Bari, 1: 96-97.

PJESA E PARË

BESIMI NË ALL-LLAHUN XH.SH.

Besimi në All-llahun xh.sh. do të thotë të bindurit e fuqishëm se All-llahu është Zot, Sundues, Sundues dhe Krijues i çdo gjëje. Se vetëm Ai meriton t'i bëhet ibadet me anë të: namazit, agjërimit, duasë, shpresës, frikës, përruljes dhe dëgjesës. Se ai posedon të gjitha cilësitë e përsosmërisë, dhe se Ai është larg çdo të metë.

Imani - besimi në All-llahun xh.sh. përfshinë tri gjëra:

1. Të besuarit se vetëm All-llahu është Krijues dhe Sundues i të gjithave (tevhidur-rububijje);
2. Të besuarit se vetëm Atij mund t'i bëhet ibadet (tevhidul-uluhijje); dhe
3. Të besuarit se vetëm Atij i takojnë emrat dhe cilësitë e përsosmërisë (tevhidul esma'i ves-sifat).

Prandaj njeriu nuk mund të jetë besimtar në All-llahun xh.sh. përderisa nuk beson se All-llahu është Sundues i të gjithave dhe se sundues tjetër nuk ekziston, se vetëm Ai është Zot dhe se vetëm Ai mund të adhurohet, dhe se Ai është plotësisht i përsosur me cilësitë dhe emrat e Vet dhe se askush tjetër nuk është i përsosur dhe i përkryer.

Këta janë tre lloj të tevhidit që i ngërthen domethënia e imanit ndaj All-llahut xh.sh.² e me sa vijon detajisht do të sqarojmë çdonjërin prej tyre.

2 Sherhul 'akidetit-Tahavijje, f. 76. Tejsirul 'Azizil Hamid, f. 17. Er-revdatun nedijje, f. 9, duke transmetuar nga Midaridus salikin. Një pjesë e ulemasë islame këta tre lloj të tevhidit I reduktojnë në dy lloj: tevhidin

1 TEVHIDUR-RUBUBIJJJE

Tevhidur-rububijje shkurtimisht do të thotë:

Bindshmëria e fuqishme se All-llahu xh.sh. është Krijues dhe Sundues i të gjithave dhe se tjetër Sundues nuk ekziston.

Fjala Rabb në gjuhën arabe do të thotë pronar - udhëheqës³ E, rububijjeti i All-llahut mbi krijesat e Veta do të thotë se vetëm Ai dhe i Vetmi Ai i ka krijuar ato, se vetëm Ai është pronar dhe se vetëm Ai i mirëmbanë ato dhe udhëheqë me to. Prandaj tevhidur-rububijje do të thotë pranimi se All-llahu xh.sh. është i Vetmi Krijues i të gjitha krijesave dhe i Vetmi Pronar i tyre, se vetëm Ai i ngjallë dhe i vdesë ato, se Vetëm Ai u sjellë dobi apo dëm dhe se Vetëm Ai i pranon lutjet e krijesave, po qe se gjenden në situatë pa shtegdalje. Se vetëm Ai mund të bëjë me ta çka të dojë Vet, se vetëm Ai me të vërtetë jep dhe merr, se vetëm Ai krijon dhe se në duart e Tij janë të gjitha. Përkritazi me këtë All-llahu xh. Na thotë:

“Vetëm Ai krijon dhe sundon! I Lartësuar është All-llahu, Sundues i botëve!” (El-A’raf: 54).

e diturisë dhe të besimit ku benë pjesë tevhidur-rububijje dhe tevhidul esma’i ves-sifat dhe tevhidul iradeti vel kasd - tevhidi i dëshirave dhe aspiratave ku benë pjesë tevhidul-uluhijje. Shih: Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 88; Sherhu kasideti, Ibnul Kajjim, 2: 259 dhe Tathirul i’tikad, f. 3.

3 El-Misabahul munir.

Në këtë lloj të tevhidit bënë pjesë edhe besimi në përcaktimin e All-llahut xh.sh. - besimi se çdo gjë që ndodh, ndodh me dijeninë, vullnetin dhe fuqinë e All-llahut xh.sh.⁴ Me fjalë të tjera ky lloj i tevhidit do të thoshte: të kuptuarit dhe të pranuarit se iniciator i njëmendtë që me të vërtetë vepron në këtë Gjithësi është vetëm All-llahu xh.sh. me krijimin, udhëheqjen, ndryshimin, drejtimin (e lëvizjes), rritjen dhe zvogëlimin, ringjalljen dhe vdekjen dhe me veprime të tjera, dhe se në tërë këtë askush nuk i shoqërohet Atij.

Kur'anit tejet qartë flet për këtë lloj të tevhidit. Gati se asnjë kaptinë e Kur'anit nuk e lë pa përmendur atë, apo bile pa treguar atë në të një mënyrë të zhdrejtë. Ky është themel i llojeve të tjera të tevhidit, ngase vetëm Ai është Krijues i njëmendtë, Sundues dhe Udhëheqës, i Cili meriton t'i bëhet ibadet (çdo formë e adhurimit), që T'i shprehet dhe T'i drejtohet përuļja dhe bindja. Dhe vetëm Ai është merituar që T'i drejtohet falënderimi, dhikri, duaja, shpresa, droja e të ngjashme. Pra, çka do qoftë nga ibadeti mund t'i kushtohet vetëm Atij i Cili posedon pushtet absolut dhe udhëheqë me të gjitha.⁵

Nga ana tjetër, vetëm Ai është Krijues i njëmendtë, Sundues dhe Udhëheqës, që i meriton cilësitë madhështore, të bukura dhe të përsosura. Për shkak se këto cilësi mund t'i posedon vetëm Sunduesi i të gjitha botëve, sepse, është e pamundur t'i përshkruhet pronësia dhe sundimi dikujt që nuk është i gjallë, që nuk dëgjon, nuk sheh, që është i pafuqishëm, memec, që nuk është në

4 Sherhul 'Akaidetit-Tahavijje, f. 76-77; Tejsirul 'Azizil Hamid, f. 17-18.

5 Tefsirul Kurtubi, 5: 395; Sherh Mulla 'Ali el-Kari 'alel fikhil ekber, f. 9.

gjendje të bëjë atë që dëshiron vet dhe që nuk është i përkryer në të folmen e vet dhe në veprat e veta.⁶

Andaj gjejmë se Kur’ani e përmend këtë lloj të tevhidit në kontekst të hamdit (falënderimit), të ibadetit, të nënshtimit, të përkushtimit All-llahut xh.sh. dhe në kontekst të shpjegimit të cilësive të lartësuara dhe emrave të bukur të Tij.

Në kontekstin e hamdit (falënderimit) çdo myslimanë në çdo rekatë këndon:

“Falënderimi i përket vetëm All-llahut, Zotit të botëve!” (El-Fatiha: 1).

All-llahu xh.sh. thotë: “Pra, falënderimi i përket vetëm All-llahut, Zotit të qiejve dhe Zotit të Tokës - Zotit të Gjithësisë!” (El-Xhathije: 36).

Në kontekstin e nënshtimit dhe përkushtimit (devocionit) Atij, All-llahu xh.sh. thotë:

“Thuaj: “Rruga e All-llahut - është e vetmja rrugë e drejtë, dhe neve jemi të udhëruar t’i bindemi Zotit të Gjithësisë”. (El-En’am: 71)

Në kontekstin e të drejtuarit dhe mbështetjes vetëm Atij, All-llahu xh.sh. thotë: “Thuaj: “Me të vërtetë, namazi im dhe adhurimi im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm All-llahut, Zotit të Gjithësisë”. (El-En’am: 162)

Në kontekstin e sqarimit se vetëm All-llahu xh.sh. mirret për mbrojtës e askush tjetër, Kur’ani thotë:

6 Fet’hul Mexhid, f. 13; El es’iletu vel exhvibe, f. 29-30.

“Thuaj: “A të marr për mbrojtës dikë tjetër përveç All-llahut, Krijuesit të qiejve dhe të Tokës! Ai ushqen (botën), e Atë askush nuk e ushqen!” Thuaj: “Mua më është urdhëruar që të jem i pari nga ata që përulen”, - dhe: kurrsesi mos u bënë nga ata që i bëjnë shok Atij!” (El-En’am: 14).

Në kontekstin e duave, All-llahu xh.sh. thotë:

“Vetëm Ai krijon dhe sundon! I lartësuar është All-llahu, Zoti i Gjithësisë! Lutjuni Zotit tuaj përulshëm dhe ngadalë (në vete)! Ai, me të vërtetë, nuk i do ata që luten me zë të lartë.” (El-A’raf: 54-55)

Në kontekstin e ibadetit, All-llahu xh.sh. thotë:

“Përse të mos e adhuroj Atë, i cili më ka krijuar. E, te Ai do të ktheheni ju?” (Ja Sin: 22).

“O njerëz! Adhuroni Zotin tuaj, i Cili u ka krijuar juve dhe ata para jush, që të ruheni nga ndëshkimi. Zoti është Ai, që për ju Tokën e ka bërë shtrat dhe qiellin ndërtesë; i Cili prej qielli lëshon shira dhe bënë që të rriten frutet, ushqim për ju. Prandaj mos i bëni me vetëdije shok All-llahut, sepse ju e dini (që Ai nuk ka shok)!” (El-Bekare: 21-24).

Me të vërtetë, vetëm Krijuesi i qiejve, i Tokës dhe i çdo gjëje që gjendet në to, është i Vetmi i Cili meriton që njeriu ta pranojë për Zot dhe për mbrojtës, dhe tërësisht t’i dorëzohet Atij, që duatë e veta t’ia drejtojë Atij dhe të mbështet tek Ai.

Nga ana tjetër vërejmë se Kur’ani ndërlihdë rububijjetin e All-llahut xh.sh. - i cili pasqyrohet në sundimin e Tij me qiejt e me Tokën dhe me çdo gjë që ekziston në to - me konservimin e tyre me

emrat e Tij të bukur dhe me cilësitë e Tij të lartësuara. Soditi fjalët e All-llahut xh.sh. në ajetul-Kursijj:

“All-llahu është - s’ka tjetër zot përveç Tij - i Gjalli dhe i Përjetshmi! Atë nuk e kaplon as kotja as gjumi! Të Atij janë të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë. Kush mund të angazhohet për ndokend pa lejen e Tij?! Ai di çdo gjë që ka ndodhë përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë në të ardhmen. Por, njerëzit, nuk dinë asgjë nga dijenia e Tij, përveç që Ai ka dashur t’ua tregojë. Froni (Madhëria) i Tij përfshinë qiejt dhe Tokën dhe Atij nuk i vie rëndë t’i ruajë ato. Ai është shumë i Larti, i Madhëruari!” (El-Bekare: 255).

Me të vërtetë, Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën është i Vetmi që jeton përgjithmonë dhe kurrë nuk vdes, i Cili i mirëmbanë të gjitha, di çdo gjë, kujdeset për çdo gjë, i Cili është më i Lartësuari, më Madhështori.

Pastaj përqëndrohu në këto fjalë të All-llahut xh.sh.:

“Ne e krijojmë njeriun dhe Na dimë çka pëshpëriti shpirti i tij, sepse Ne jemi më afër se damari i qafës së tij.” (Kaf: 16).

“E si mos të dinte Ai, i Cili ka krijuar çdo gjë dhe është i informuar hollësisht.” (El-Mulk: 14).

Pra, nuk ka kurrfarë dyshimi se Ai i Cili i ka krijuar të gjitha krijesat, i mbikëqyrë ato dhe se Ai di çdo gjë ç’veprojnë ato.

E, për sa i përket atyre, të cilët pranojnë se All-llahu xh.sh. është Sundues dhe Krijues i të gjithave, por nuk e veçojnë nga hyjnitë e tjerë, por së bashku me Të adhurojnë edhe të tjerët, dhe

që nuk e veçojnë sipas emrave dhe cilësive të Tij, duke i mohuar ato apo duke i krahasuar ato me cilësitë e krijesave të tjera, apo duke i komentuar ato në kuptimin figurativ që nuk ka bazë, atyre tevhidi i këtij lloji nuk do t'u shërbejë dhe assesi nuk do t'i nxjerrë ata nga rrethi i mosbesimit në rrethin e imanit. All-llahu xh.sh. na tregon në Kur'an se jobesimtarët (mushrikët) kanë pranuar se All-llahu është i Vetmi Krijues, por përkundër kësaj kanë mbetur mushrikë,⁷ ngase nuk e kanë veçuar All-llahun xh.sh. në uluhijjetin (hyjninë) e Tij, por i kanë adhuruar edhe të tjerët përveç Tij. Dhe për shkak se ata nuk i kanë bërë tevhid All-llahut xh.sh. në emrat dhe cilësitë e Tij, ashtu që disa i mohonin dhe nuk i besonin atyre. Prandaj All-llahu xh.sh. Thotë për ta:

“Shumica e tyre nuk i besojnë All-llahut, por i bëjnë shok Atij.” (Jusuf: 106).

Mufessiri i njohur El-Muxhahidi, gjatë komentimit të këtij ajeti thotë: “Imani i tyre në All-llahun është pranimi se ne na ka krijuar All-llahu dhe se Ai na furnizon që të gjithëve, por ata krahas këtij pranimi i bëjnë ibadet edhe të tjerëve përveç Atij.”⁸

Një pjesë e ulemasë nga gjeneratat e para ka thënë: “Ku t'i pyesish: “Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?” Ata përgjigjen: “All-llahu”, por megjithëkëtë e adhurojnë tjetër kë.”⁹

All-llahu xh.sh. na thotë në Kur'an se edhe mushrikët kanë besuar se All-llahu është Krijues, Furnizues dhe Sundues:

7 Sherhul”Akaidetit-Tahavijje, f. 79; Fet’hul Mexhid, f. 17; Tejsilu Azizil-Hamid, f. 17; Tathirul i’tikaf, f. 5.

8 Tefsirut-Taberi, 16: 28.

9 Këtë e përmend Ibnü Kethiri prej Ibnü Abbasit, Muxhahidit, ‘Ata’as, ‘Ikrimes, Esh-Sha’biut, Katades, Dahhakut dhe Abdurrahman b. Zejd b. Eslemit. Shih: Tefsiru Ibnü Kethir, 2: 494; Tefsiru Taberi, f. 78.

“E, nëse i pyet kush i ka krijuar, ata, me siguri, do të thonë: “All-llahu!” E, nga po ia mbajnë atëherë?” (Ez-Zuhruf: 87).

“Thuaj: “Kush ju ushqen juve nga qielli dhe nga Toka? Ose, kush mund të krijojë të dëgjuarit dhe të pamurit? Dhe kush mund të nxjerrë të gjallin nga i vdekuri dhe të vdekurin nga i gjalli? Dhe kush i drejton gjërat? Ata do të thonë: “All-llahu!” E ti (o Muhammed!) Thuaj: “E, përse atëherë nuk i frikësoheni Atij?” (Junus: 31).

Nga ajetet e cituara shihet qartë se, gjithsecili që pranon se All-llahu është Zot i të gjithave, njëherit nuk është edhe ai që e ka besuar All-llahun si të Vetmin Zot, të Cilit i bëhet ibadet dhe i Vetmi të Cilit i përkasin të gjitha emrat e bukur dhe cilësitë e përsosmërisë.¹⁰ Shumica e njerëzve nuk mohojnë Krijuesin dhe udhëheqjen e Tij me krijesat, por shumë mosbesime të tyre rrjedhin nga adhurimi i tjetërkujt përveç All-llahut xh.sh.¹¹

2 - TEVHIDUL-ULUHIJJE

Tevhidul-uluhijje shkurtimisht do të thotë: bindshmëria e fuqishme se vetëm All-llahu xh.sh. është Zot i vërtetë dhe se tjetër zot nuk ekziston, dhe se të gjitha llojet e ibadetit (adhurimit) duhet t'i kushtohen vetëm Atij.

10 Fet'hul Mexhid, f. 18; Sherhul Mulla 'Ali el-Kari 'alel fikhil ekber, f. 9.

11 Ihjau 'ulumid din, 1: 182; Sherhul 'akidetit-tahavijje, f. 78.

Fjala Ilah (Zot) në gjuhën arabe përdoret në domethënien e fjalës Me'luh (ai i cili adhurohet - atij të cilit i bëhet ibadet)¹² E, ibadet në gjuhën arabe do të thotë të qenët i dëgjueshëm, i përlshëm, i përvuajtshëm. Disa alimë ibadetin e kanë definuar si dashuri e sinqertë me përvuajtëri të plotë. Ibadeti i cili na është urdhëruar në vete ngërthen domethënien e përvuajtërisë, e njëkohësisht edhe domethënien e dashurisë, andaj kjo është përlësia e plotë ndaj All-llahut xh.sh. me dashuri jashtëzakonisht të madhe ndaj Tij. Prandaj ibadeti ndaj All-llahut xh.sh. nuk është i rregullt nëse aty nuk përfshihen që të dy domethëniet e përmendura, dhe vetëm njëra prej tyre nuk është e mjaftueshme për korrektësinë e tij. All-llahu xh.sh. për ne duhet të jetë më i dashur se çdo gjë tjetër që ekziston, e njëkohësisht më i lartësuar prej të gjithëve.¹³

Tevhidul-uluhije, pra, bazohet, të besosh vetëm All-llahun xh.sh. sinqertë edhe esencialisht edhe formalisht (në batin dhe në zahir), kështu që asgjë prej tij (besimi) nuk guxon t'i kushtohet dikujt tjetër përveç All-llahut xh.sh. Prandaj, besimtari adhuron (i bënë ibadet) vetëm All-llahun e askë tjetër, pastaj vetëm Atë e don me të vërtetë, frikësohet vetëm prej Tij, shpreson vetëm prej Tij, duanë ia drejton vetëm Atij, mbështetet vetëm në Të, vetëm ndaj Tij shprehë përvuajtërinë, përlësinë, pendesën dhe të gjitha llojet e tjera të ibadetit.

Kjo pjesë e tevhidit në esencën e vet ngërthen të gjitha pjesët e tjera të besimit në All-llahun xh.sh. si Krijues dhe besimin në atë se Ai është i Vetmi që posedon emra të bukur dhe cilësi të

12 Fjala ilah në trajtën fe'al e në kuptimin e trajtës me'ful, siç është fjala kitab në kuptimin e fjalës mektub.

Shih: El-Meshahul munirdhe Tarilul vusul 'ilet 'ilmil me'mul, f. 12.

13 Sherh kasideti Ibnul Kajjim, 2: 259; Igasetul lehfan, 2: 128-129; El-'Ubudijje li-Ihni Tejmijje, f. 9.

përsosmërisë, që nuk është rast i kundërt. Sepse, të besuarit dhe të pranuarit e All-llahut xh.sh., si Krijues dhe Sundues nuk do të thotë se i njëjti e pranon si të vetmin të cilin e adhuron.¹⁴

Njeriu mund ta pranojë All-llahun xh.sh. si të Vetmin Krijues, por assesi mos ta adhurojë Atë (nuk i bënë ibadet Atij). Gjithashtu, edhe besimi në All-llahun xh.sh. si të Vetmit që i përkasin emrat e bukur dhe cilësitë e përsosmërisë (tevhidul-esma’i’ ves-sifat) nuk i përfshinë llojet e tjera të tevhidit.

Por, njeriu, i cili i bënë All-llahut xh.sh. tevhidul-uluhijje, duke u bindur dhe duke e pranuar Atë si të Vetmin i Cili meriton të adhurohet (që T’i bëhet ibadet) dhe se këtë askush tjetër përveç Tij nuk e meriton nga kurrnjë aspekt, ai me këtë pranon All-llahun xh.sh. për Krijues dhe Sundues të të gjithave dhe se vetëm Atij i përkasin të gjitha emrat dhe të gjitha cilësitë e përsosmërisë, sepse ibadeti i njëmendtë mund T’i bëhet vetëm Zotit të Përsosur, e jo dikujt tjetër që nuk është Zot.¹⁵ Sepse, si mund të adhurohet dikush, që nuk është krijues i cili nuk udhëheq me të, dhe si mund të adhurohet dikush, që nuk është i përsosur dhe i përkryer?

14 Me gjithë vërejtjen se të pranuarit e All-llahut xh.sh. si të vetmin Krijues është argument se vetëm Ai meriton të adhurohet, siç kemi thënë më parë kur folëm për tevhidur-rububijje, një numër i madh njerëzish assesi nuk e përfillin këtë të vërtetë nga inati dhe mosbesimi. Ata e pranojnë All-llahun si Krijues, por nuk e pranojnë si të vetmin i Cili adhurohet, duke mohuar kështu atë që i udhëzon vetë pranimit të tyre.

15 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 79.

Me sa parashtruam më sipër, shihet qartë se kelimei shehadeti (La ilahe ilAll-llah) në vete ngërthen të gjitha llojet e tevhidit, sepse domethënia e tij e drejtpërdrejtë është të besuarit në tevhidul-uluhijje i cili në vete ngërthen edhe tevhidur-rububijje edhe tevhidul-esma'i ves-sifat.

Prandaj, me këtë lloj të tevhidit (tevhidul-uluhijje) ka filluar feja dhe me të ka përfunduar, kjo është forma (zahir) dhe esenca (batin) e fesë dhe për shkak të tij janë krijuar të gjitha krijesat. All-llahu xh.sh. thotë:

“Xhinnët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.” (Edh-Dharijat: 56).

Ibni Tejmiiu thotë: “Sipas këtij lloji të tevhidit dallohen muvehhidët dhe mushrikët - ata të cilët sinqerisht adhurojnë All-llahun xh.sh. dhe ata të cilët, krahas Tij adhurojnë edhe diç tjetër - dhe për shkak të këtij do të realizohet shpërblimi apo ndëshkimi edhe në këtë botë edhe në botën tjetër, e kush nuk pranon këtë, do të mbetet ndër mushrikët.”¹⁶

Për shkak të këtij lloji të tevhidit janë dërguar edhe Pejgamberët dhe janë shpallur Librat. Nuk ka ekzistuar kurrnjë Pejgamber që i është dërguar njerëzve, e që tevhidul-uluhijje të mos i jetë bazë dhe esencë e misionit të tij. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ne çdo popull i kemi dërguar nga një Pejgamber. Të gjithë ata thonin: “Adhuroni vetëm All-llahun, e shmajiuni idhujve.” (En-Nahël: 36).

16 Risaletul-haseneti ves-sejjiu, në koleksionin e njohur të Ibni Tejmijje nën titullin Mexhm'u'atur resail, f. 261.

“Ne nuk kemi dërguar asnjë Pejgamber para teje e që të mos ia kemi shpallur: “S’ka zot tjetër përveç Meje, andaj adhuromëni vetëm Mua!” (El-Enbija: 25).

All-llahu xh.sh. na informon se Pejgamberët e Tij janë: Nuhi, Hudi, Salihu, dhe Shu'ajbi, dhe çdo njëri prej tyre i ka thënë popullit të vet:

“O populli im, adhurojeni vetëm All-llahun! Ju nuk keni zot tjetër përveç Tij!” (El-Mu’minun: 23; Hud: 61; El-A’raf: 65).

All-llahu xh.sh. gjithashtu na informon se Ibrahim i a.s. i ka thënë popullit të vet:

“Unë e kthej fytyrën time kah Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga ata që i bëjnë shok All-llahut!” (El-En’am: 79).

Pra, Ky lloj i tevhidit është thelbi i fesë islame, andaj sharti i parë i Islamit është kelime shahadet. Pejgamberi i All-llahut thotë: “Islami bazohet në pesë gjëra: dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe Muhammedi është Pejgamber i All-llahut, kryerja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i muajit Ramazan dhe kryerja e haxhxit.”¹⁷

Të pranuarit e All-llahut xh.sh. si të Vetmin i Cili adhurohet, nga ne kërkon që vetëm Atij T’i drejtohem me çdo trajtë adhurimi dhe që zemrat tona gjatë kësaj të jenë tërësisht të pastra nga çdo drejtim tjetër. Në këtë formulim hyjnë edhe shumë gjëra të tjera. Ja disa prej tyre:

1 - Domosdoshmëria e dashurisë së sinqertë ndaj All-llahut xh.sh. Njeriu nuk guxon që edhe në dashurinë e vetë të ketë dikë të barabartë apo përmbi All-llahun xh.sh. Prandaj, nëse dikush e do

17 Transmeton Buhariu dhe Muslimi. Shih Zadul Muslim fima ittefeka ‘alejhi Buhari ve Muslim, 1: 139.

dikë sikur që e do All-llahun xh.sh., apo më tepër se Atë, atëherë ky ka bërë shirk. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ka njerëz që në vend të All-llahut marrin disa gjëra të tjera për hyjni dhe i duan ato si All-llahun; ndërsa ata që besojnë, e duan shumë më tepër All-llahun.” (El-Bekare: 165).

Në shirkun e madh, të cilin All-llahu xh.sh. nuk do ta falë, pos me pendesë për të, bën pjesë edhe ajo që njeriu ta dojë dikë tjetër përveç All-llahut siç duhet All-llahu xh.sh.¹⁸ Njeriu, sipas natyrës së vet, është i prirur për ta dashur vetvetën, prindërit, fëmijët, atdheun, pasurinë e të ngjashme, andaj përshpirtëria (devotshmëria) e tij e sinqertë ndaj All-llahut xh.sh. nuk do të thotë asgjësim apo pengesë të kësaj ndjenje natyrore, por nga besimtari kërkohet që dashuria e tij ndaj çkado qoftë tjetër në këtë botë, të jetë pas dashurisë ndaj All-llahut xh.sh., që dashuria ndaj All-llahut xh.sh. tek ai të jetë përmbi dashuritë e tjera, kështu që të jetë i gatshëm që tërë atë që dashuron, nëse vjen gjer tek kontradikta mes asaj që kërkon nga ai dashuria ndaj All-llahut xh.sh. dhe çkado qoftë tjetër që dashuron, duhet ta sakrifikojë në emër të All-llahut xh.sh. All-llahu xh.sh. i kërcënohet atyre të cilët i japin përparësi vlerave të kësaj bote, të cilat i duanë më shumë sesa All-llahun xh.sh., e thotë:

“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj, që e keni fituar, tregtia - për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë - në të cilat e ndieni veten rehat, u janë më të dashura se sa All-llahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë

18 Sherh kasidet, Ibni Kajjim, 2: 268.

pritni derisa ta sjellë vendimin All-llahu. E, All-llahu, nuk do t'i udhëzojë mëkatarët në rrugën e drejtë.” (Et-Tevbe: 24).

2 - Domosdoshmëria e veçimit të All-llahut në dua, në tevekkul (mbështetje) dhe në shpresë, nga aspekti se askush përveç All-llahut xh.sh. nuk është në gjendje ta plotësojë atë. All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe, përveç All-llahut mos iu lut tjetërkujt, të cilët nuk të sjellin as dobi as dëm, e nëse e bën këtë, ti atëherë, me të vërtetë, je nga pabesimtarët.” (Junus: 106).

“...Dhe, nëse jeni besimtarë (të vërtetë), mbështetuni në All-llahun!” (El-Maide: 23).

“Ata të cilët besojnë dhe të cilët emigrojnë dhe luftojnë në udhën e All-llahut, ata mund të shpresojnë mëshirën e All-llahut. Se All-llahu është mëshirues dhe falë.” (El-Bekare: 218).

3 - Domosdoshmëria e veçimit të All-llahut xh.sh. përkritazi me frikën. Ai i cili konsideron se disa nga krijesat mund t'i sjellin dëm me vullnetin dhe fuqinë e tyre personale,¹⁹ e nga ky shkak i frikësohen atyre, atëherë ky i ka bërë shirk All-llahut xh.sh. All-llahu xh.sh. thotë:

19 Ky kusht jipet për shkak të sqarimit të dallimit mes frikës si ibadet dhe frikës natyrore: e para nuk është e lejuar, por vetëm nga All-llahu xh.sh. Që do të thotë se njeriu duhet të jetë i bindur se vetëm All-llahu xh.sh. është Ai, i Cili me vullnetin dhe me fuqinë e Vet mund të dëmtojë, e kushdo qoftë tjetër nuk mund të sjellë dëm apo dobi, përveç nëse All-llahu e bënë shkak të dëmit apo të dobisë. E, për sa i përket frikës natyrore, siç është frika nga bishat, apo frika që paraqitet kur të drejtohet arma e të ngjashme, kjo frikë nuk e trazon tevhidin, për shkak se ky është në vetë natyrën e njeriut, sipas së cilës e ka krijuar All-llahu xh.sh.

“... Dhe, druajuni vetëm prej Meje!” (En-Nahël: 51)

“Nëse All-llahu të sjellë ndonjë dëm, askush nuk mund të ta largojë, përveç Tij, e nëse Ai don të ta bëjë ndonjë të mirë, s’ka kush të ta pengojë mirësinë e Tij. Ai ia jep atë mirësi kujt të dojë nga robërit e Tij; dhe Ai është falës dhe mëshirues.” (Junus: 107).

4 - Domosdoshmëria e veçimit të All-llahut xh.sh. në të gjitha llojet e ibadetit trupor, siç është namazi, ruku’a, sexhdeja, agjërimi, therja (e kurbanit), tavafî dhe të gjitha format e ibadetit gjuhësor, siç është betimi, kërkim ndjese etj.

Ky dhe çdo lloj tjetër i ibadeteve duhet t’i kushtohen vetëm e vetëm All-llahut xh.sh., e ai i cili çkado qoftë prej tyre i kushton dikujt tjetër, përveç All-llahut xh.sh., ai i ka bërë shirk. All-llahu xh.sh. thotë:

“All-llahu, me të vërtetë, nuk e falë atë që i bën shok Atij, por ia falë tjerat mëkate kujt të dojë (përveç këtij). Kushdo që t’i bëjë shok All-llahut, ai me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë.” (En-Nisa: 116).

3- TEVHIDUL-ESMA’I VES-SIFAT

Tevhidul-esma’i ves-sifat shkurtimisht do të thotë bindshmëria e fuqishme se All-llahut xh.sh. i përkasin të gjithë emrat e bukur dhe cilësitë e përsosmërisë, se Ai është larg atributëve të mangëta dhe se Ai me cilësitë e Tij shquhet mbi të gjitha krijesat. Cilësitë dhe emrat të cilat na janë të

njohura vetëm nga fjalët e Tij dhe nga fjalët e Pejgamberit të Tij, pa kurrfarë ndryshimesh të fjalëve të tyre, pa mohimin e tyre parcial apo të tërësishëm, pa tentim që tërësisht të kuptohen ato dhe të shpjegohen thelbësisht apo komparacionet me cilësitë e krijesave.

Nga ky formulim jipet të kuptohet se tevhidul-esma'i ves-sifati, bazohet në tri parime, e, kush largohet prej tyre, ai nuk do të jetë besimtar në këtë lloj të tevhidit.²⁰

- a) - Të besuarit se All-llahu xh.sh. nuk i gjason krijesave dhe se është larg çdo të mete;
 - b) - Të besuarit në emrat dhe në cilësitë e All-llahut xh.sh. që janë përmendur në Kur'an dhe në Sunnet, pa kurrfarë mungese apo shtimi dhe pa kurrfarë shtrembërimesh apo mohimesh; dhe
 - c) - Shuarja e çdo dëshire për të kuptuar domethënien e vërtetë të këtyre cilësive;
- a) - Me parimin e parë nënkuptohet mohimi i çdo ngjashmërie ndërmjet cilësive të All-llahut xh.sh. dhe cilësve të krijesave. Argument për këtë janë fjalët e All-llahut xh.sh.:

“Dhe askush nuk i gjason Atij!” (El-Ihlas: 4).

“All-llahun mos e krahasoni me kurrjë!” (En-Nahël:).

Imam Kurtubi, duke komentuar ajetin “Dhe askush nuk i gjason Atij!” thotë: “Këtu flitet se All-llahut xh.sh., me lartësinë e Tij, në madhësinë e Tij, me pushtetin e Tij, me emrat e bukur dhe me cilësitë e përsosura të Tij, nuk i gjason askush nga krijesat e Tij, e as që mund krahasohet ndokush të me Të. Gjithashtu edhe cilësitë e All-llahut xh.sh., të cilat janë përmendur në Kur'an

20 Menhexh ve dirasat li ajatil esma'i ves-sifat, faqe 3 dhe 25, lish-shejh Muhammed el-Emin esh-Shenkiki.

dhe në Sunnet, e ato janë të përbashkëta sipas shqiptimit në raport me All-llahun xh.sh. dhe krijesat e tjera, assesi nuk i gjasojnë domethënies së vërtetë të tyre, ngase cilësitë e Atij që gjithmonë ekziston nuk janë të njëjta sikurse cilësitë e atyre të cilët janë krijuar nga Ai.”²¹

Kurse El-Vasiti - rahimehullahu te’ala - thotë: “Nuk ekziston ndonjë qenie siç është qenia e Tij, as ndonjë emër siç është emri i Tij, as ndonjë vepër siç është vepra e Tij, përveçse nga pikëpamja gjuhësore (shqiptimit). Qenia, që nuk është e krijuar, është larg asaj që të ketë cilësi çfarë posedon e krijuara. Siç është e pamundur që qenia e krijuar të ketë cilësitë e Atij që nuk është i krijuar. E tërë kjo është drejtim i pasuesve të së vërtetës, udhës (Sunnes) së Pejgamberit a.s. dhe xhema’atit të gjeneratave të para të myslimanëve.”²²

Sejjid Kutbi në tefsirin e vet, duke komentuar këtë ajet, thotë: “Natyra e njeriut në tërë këtë beson vetvetiu, ngase gjërat e krijuara, të cilat i ka krijuar ai vetë, njëherit nuk mund t’i përngjajnë krijuesit.”²³

Në këtë parim bënë pjesë edhe mohimi i çdo gjëje që i kundërvihet asaj me çka All-llahu xh.sh. e ka përshkruar Vetveten, ose me çka e ka përshkruar Pejgamberi i Tij. Prandaj besimi në All-llahun xh.sh., si të Vetmit që i përkasin emrat dhe cilësitë e përsosmërisë, kërkon prej nesh të mohojmë dhe të dëbojmë mundësinë se Ai mund të ketë grua, shok, partner (ortak), ndihmës, ndërmjetsues (përveç me lejen e All-llahut) dhe mbrojtës nga poshtërimi. Siç kërkon edhe

21 Tefsirul Kurtubi, 16: 8, në botimin Mektebetul kutubil masrijje.

22 Tefsirul Kurtubi, 16: 9, darul kutubil masrijje.

23 Fi zilzilil Kur’an, 7: 272.

mohimin se Atë mund ta kaplojë kotja dhe gjumi, lodhja, kapitja, vdekja, padrejtësia, shkujdesja, harresa, pagjumësia, transformimi dhe cilësi të tjera mangësie.

b) - Parimi i dytë kërkon obligueshmërinë e kufizimit të çdo gjëje që i përshkruhet All-llahut xh.sh. vetëm në atë që është përmendur në Kur'an dhe në hadithet e Pejgamberit a.s. Sepse, cilësitë dhe emrat e All-llahut xh.sh. kuptohen me anë të të thënave, e jo me anë të përsiatjes personale. All-llahu xh.sh. assesi nuk mund të përshkruhet, përveçse me atë që e ka përshkruar Vetveten apo me çka e ka përshkruar Pejgamberi Tij.

Gjithashtu edhe nuk emërohet, përveçse me emrat me të cilat e ka quajtur Vetveten apo me të cilat e ka quajtur Pejgamberi i Tij. Për shkak se All-llahu xh.sh. i di më së miri emrat dhe cilësitë e Vet. All-llahu xh.sh. thotë:

“... Thuaj: “A e dini më mirë ju apo All-llahu?” (El-Bekare: 140).

Duke qenë se All-llahu xh.sh. e di më së miri për Vetveten, dhe pasi që Pejgamberët e Tij e kanë folur vetëm të vërtetën, sepse ata kanë transmetuar vetëm atë që u ka shpallur All-llahu xh.sh., atëherë, në sferën e emrave dhe të cilësive të All-llahut xh.sh. - duke i pranuar ato - jemi të obliguar t'i përmbahemi asaj që na ka informuar All-llahu xh.sh. dhe Pejgamberi i Tij. Imam Hambeli thotë: “All-llahu xh.sh. nuk përshkruhet, përveçse me atë që e ka përshkruar Vetveten, apo me çka e ka përshkruar Pejgamberi i Tij, duke mos e tejkualuar aspak Kur'anin dhe Hadithin.”²⁴

24 Er-Revdatun nedijje, f. 22; Sherhul 'akidetil vasitijje li Muhammed Halil Herras, f. 21

Nu'Aj'm bin Hammad - mësuesi i Buhariut - ka thënë: “Ai i cili e krahason All-llahun xh.sh. me krijesat e Tij, ai ka bërë kufër, kush mohon çkado qoftë nga ajo me çka All-llahu xh.sh. e ka përshkruar Vetveten apo me çka e ka përshkruar Pejgamberi i Tij, ai ka bërë kufër, dhe ajo me çka All-llahu xh.sh. e ka përshkruar Vetveten dhe me çka e ka përshkruar Pejgamberi i Tij nuk mund të barazohet me asgjë dhe nuk mund të krahasohet me asgjë.”²⁵

Ky parim kërkon nga çdo njeri i moshës madhore - moshës ligjore sipas Sheriatit - që të besojë tërë atë që transmetohet nga emrat dhe cilësitë e All-llahut xh.sh. në Kur'an dhe në Sunnetin e Pejgamberit a.s. Dhe t'i pranojë ato sipas domethënieve të tyre të qarta dhe parimore në gjuhën arabe, duke mos mohuar diç prej tyre dhe duke mos shtrembëruar diç gjatë komentimit duke u larguar nga domethënia e tyre.

c) - Parimi i tretë kërkon nga njeriu që t'i besojë të gjitha cilësive të përmendura në Kur'an dhe në Sunnet, pa pyetje për esencën e tyre dhe për domethënien e tyre të vërtetë (lidhur me All-llahun xh.sh.). Sepse, të konceptuarit e cilësive bazohet në të konceptuarit e qenies, sepse, cilësitë dallohen në ujdë me dallimin e bartësve të tyre. Sikurse që assesi nuk pyesim për qenien e All-llahut xh.sh. dhe kualitetin e Tij, po ashtu assesi nuk është korrekte të pyesim për cilësitë e Tij.²⁶ Prandaj transmetohet nga një numër i madh i gjeneratave të para (selef) se, kur i patën pyetur për ngritjen (el-istiva) e All-llahut xh.sh., ishin përgjegjur: “Ngritja është e njohur, ndërsa mënyra e saj është e panjohur, të besuarit në të është vaxhib e pyetja për mënyrën e saj është bid'at.”²⁷

25 Dy veprat e sipërcituara; Ithaful kainat, f. 6; Sherhul Mulla 'Ali el-Kari, f. 15.

26 Menhexh ve dirasat li ajatil esma'i ves-sifat, f. 25; Er-Revdatun nedijje, f. 23 dhe 28.

27 Er-Revdatun-nedijje, f. 29.

Pra, selefët janë pajtuar se mënyra (e ngritjes së All-llahut xh.sh.) është e panjohur për ne dhe se pyetja për të është bid'at. Andaj sikur të na pyeste dikush: “Në ç’mënyrë Zoti ynë zbret në qiellin botëror?” Ne do ti thoshim: “Si duket Ai?” E, nëse thotë se nuk e di se si duket Ai, ne do t’i thoshim: “Ne nuk dimë se si zbret Ai, sepse dituria për atributin kërkon dituri mbi bartësin e atij atributi. E, si mund të kërkosh prej nesh të të shpjegojmë në ç’mënyrë All-llahu xh.sh. dëgjon, sheh, flet, si ngritet dhe si zbret, e ti nuk e di se si duket Ai? Nëse ti pranon se All-llahu xh.sh. dhe eksistenca e tij është me të gjitha cilësitë e përsosmërisë dhe se askush nuk i gjason Atij, ngjashëm me këtë është edhe të dëgjuarit dhe të pamurit e Tij, zbritja dhe ngritja e Tij, është fakt i vërtetë, e që njëkohësisht nuk i gjason shqisës të të dëgjuarit të krijesave, të të pamurit, të folurit, zbritjes dhe ngritjes së tyre.”²⁸

Me sa ekspozuar më lartë, rezulton se këtë lloj të tevhidit e trazojnë disa gjëra, të cilat myslimani nuk do të guxonte t’i lejojë vetes:

1 - Et-teshbih - krahasimi i cilësive të All-llahut xh.sh. me cilësitë e krijesave (antropomorfizmi), siç e krahasojnë të krishterët Isain a.s. (të birin e Merjemës), hebrejntë Uzejrin, e mushrikët idhujt e tyre me All-llahun xh.sh. Apo, sikurse që disa sekte e krahasojnë fytyrën e All-llahut xh.sh. me fytyrën e krijesave, dorën e Tij me dorën e krijesave, të dëgjuarit e Tij me të dëgjuarit e tyre e të ngjashme.²⁹

28 Er-Revdatun-nedijje, f. 34.

29 El-Esiletu vel-exhviбетul usulijje, f. 35; Li ‘Abdul Aziz el-Muhammed es-Selman, Er-Revdatun nedijje, f. 35.

2 - Shtrembërimi i domethënies së cilësive të All-llahut xh.sh. me komentime, dhe çfarëdo ndërrimi dhe zëvendësimi në to (et-tahrif bit te'vil), siç është shtrembërimi i fjalëve, emrave dhe cilësive duke shtuar, duke munguar apo duke ndërruar herektet (konsonantet) në fjalë, siç kanë vepruar disa me fjalët e All-llahut xh.sh.: "... E, All-llahu, me siguri, ka biseduar me Musain." (En-Nisa: 164) - kështu që ne vend të damme-s në fjalën All-llah e kanë vënë fet'h-in, në mënyrë që domethënia të jetë se All-llahu nuk ka folur me Musain, por Musai ka folur me All-llahun.

Rruga më e drejtë përkitazi me cilësitë e All-llahut xh.sh. është drejtimi i gjeneratave të para myslimane (selef), të cilët i kanë përshkruar All-llahut xh.sh. atë që Ai i ka përshkruar Vetes dhe atë që ia ka përshkruar Pejgamberi i Tij, pa alegori, me të cilat mohohen cilësitë dhe pa komparacione të cilat nuk i përshtaten Madhërisë dhe Unitetit (vahdaniijeit) të All-llahut xh.sh.

Prandaj e tërë ajo që përmendet në Kur'an dhe në hadithe autentike, siç është dora, fytyra, ngritja, zbritja, hidhërimi, kënaqësia dhe cilësitë e tjera, ne ia përshkruajmë All-llahut xh.sh., pa krahasime me cilësitë njerëzore dhe pa komentime alegorike të cilat shpiejnë në mohimin e tyre.³⁰ Dhe themi ashtu siç ka thënë imam Shafiu: "E besoi All-llahun dhe tërë atë çka ka ardhur nga All-llahu ashtu siç dëshiron Vetë Ai dhe e besoj Pejgamberin e All-llahut dhe tërë atë që ka ardhur prej tij ashtu siç ka menduar dhe siç ka dëshiruar ai."³¹

3 - Et-ta'til - Të kuptuarit se All-llahu është i privuar nga të gjitha atributet, mohimi i cilësive të All-llahut xh. sh dhe kundërshtimin e lidhshmërisë së tyre me qenien e All-llahut xh.sh. Siç është

30 El-Fikhul ekber, f. 15.

31 El-Esiletu vel-exhvibetul usulijje, f. 50.

mohimi i përsosmërisë së plotë të All-llahut xh.sh. me anë të kundërshtimit të emrave dhe të cilësive të Tij. Apo mohimi i ndërsjelljes me All-llahun xh.sh. duke lënë ibadetin, ose mohimi i lidhjes mes krijesave dhe Krijuesit të tyre, ose, siç konfirmojnë disa, që materia ka ekzistuar gjithnjë (nuk është krijuar) dhe se All-llahu xh.sh. nuk e ka krijuar atë.³²

4 - Et-tekjif - shqyrtimi mbi kualitetin; caktimi i kualitetit të cilësive të Zotit xh.sh. dhe të konstatuarit e esencës së tyre.

Pranimi i vërtetë i cilësive dhe i emrave të All-llahut xh.sh., të cilat janë përmendur në Kur'an dhe në Sunnet, në domethënien e tyre origjinare, pa bërë krahasime, shtrembërime, mohime dhe polemizime mbi kualitetin e tyre, ka qenë drejtimi (medhhebi) i selefëve - as'habëve, tabi'inëve, dhe tabi tabi'inëve. Esh-Shevkani thotë: “Drejtimi i selefëve nga as'habët, tabi'inët dhe tabi tabi'inët është pranimi dhe transmetimi i argumenteve (teksteve) mbi cilësitë e All-llahut xh.sh. në domethënien e tyre rrënjësore, pa kurrfarë shtrembërimesh, alegorishë tejet të theksuara, komparacionesh dhe mohimesh kah shpie pjesa më e madhe e te'vilit (komentimit figurativ). Ata, nëse i pyeste dikush për diçka lidhur me cilësitë e All-llahut xh.sh., i citonin argumentet dhe përmbaheshin nga thashethemet, duke thënë: “All-llahu xh.sh. ka thënë kështu, dhe ne asgjë më tepër nuk dimë lidhur me këtë, dhe nuk tentojmë të flasim për atë që nuk dimë, e as që na ka dhënë të drejtë All-llahu xh.sh. ta tejkalojmë këtë.” E, nëse pyetsi megjithatë përpiquej të kuptojë diç më tepër përkitazi me këtë, ata e qortonin duke ia ndaluar të interesohet për atë që nuk i përket atij dhe të kërkojë diç që është e pamundur të arrihet, përveçse duke hyrë në bid'at i cili është jashtë asaj në çka bazoheshin ata, e që e kanë mbajtur mend nga Pejgamberi i All-llahut

32 Er-Revdatun nedijje, f. 25; El-Esiletu vel-exhvibe, f. 32-33.

xh.sh., e tabi'inët nga as'habët dhe tabi tabi'inët nga tabi'inët. Në këta shekuj të famshëm ka mbretëruar qëndrimi unanim përkitazi me cilësitë e All-llahut xh.sh. Ata kujdeseshin për atë që u ka urdhëruar All-llahu xh.sh. dhe bëni atë që u ka urdhëruar ta bëjnë, duke filluar nga emrat e All-llahut xh.sh. e gjer tek namazi, dhënia e zekatit, agjërimi, haxhxi, xhihadi, ndarja (dhënia) e pasurisë për qëllime bamirësie, që është garancë e fitimit të Xhennetit dhe shpëtimit nga zjarri i Xhehennemit. Pastaj, kujdeseshin për të udhëzuar në të mirë dhe për të ndaluar nga e keqja, e pengonin përdhunuesin nga trazirat me të gjitha mjetet që i kishin në disponim, dhe nuk interesoheshin për asgjë tjetër që All-llahu xh.sh. nuk ka kërkuar prej tyre, e as që i ka obliguar të kuptojnë esencën e tij. Prandaj atëbotë feja ka qenë e pastër nga miksturat e risirave (bid'ateve).³³

EMRAT E BUKUR TË ALL-LLAHUT XH.SH.

Emrat e bukur të All-llahut xh.sh. janë emra të përveçëm të Tij për të cilët Ai na ka njoftuar në Kur'an dhe Pejgamberi i Tij në hadithe. Çdonjëri prej tyre tregon një apo më shumë cilësi të All-llahut xh.sh. Çdo emër është derivat i foljes përkatëse, si p.sh. el-'Alim - i Gjithdijshmi është derivat i foljes 'alime - di, ditur. Rasti i njëjtë është edhe me emrat el-Kadir - i Plotfuqishmi (që i cakton të gjitha), es-Semi' - që i dëgjon të gjitha, el-Besir - që i sheh të gjitha, dhe me të gjithë emrat e tjerë.

³³ Et-Tiuhaf fiu mezahibis selef, f. 8, Lish-Shevكاني.

Ndërsa, emri që në vete përmban domethëniet e të gjitha emrave dhe të gjitha cilësive është All-llah. Dijetarët islam ndahen në mendime rreth rrënjës së kësaj fjale. Disa mendojnë se është nxjerrë nga fjala el-ilah, e të tjerët mendojnë se ky assesi nuk është derivat.³⁴

Këta emra njëkohësisht janë edhe cilësitë e All-llahut xh.sh. dhe këtu nuk ka kurrfarë kontradiktash. Err-Rrahman është njëkohësisht edhe emër edhe cilësi e All-llahut xh.sh. Të gjithë emrat e All-llahut xh.sh. kanë domethënie të caktuar të cilët pa përjashtim janë attribute lavdërimi.³⁵

Emrat e All-llahut xh.sh. janë quajtur të bukur ngase se me to quhet dhe përshkruhet më i Bukuri dhe se kanë domethënie më fisnike.

Tevhidul-esma'i kërkon prej nesh që t'i besojmë çdo emri me të cilin All-llahu xh.sh. e ka quajtur Vetën, t'i besojmë kuptimit që shënon emri përkatës, si dhe refleksionit të tij në vetë ne.

Në Kur'an bie fjala përmendet emri Err-Rrahim, dhe ne besojmë se ai është emri i All-llahut xh.sh., se ai tregon se All-llahu xh.sh. është i mëshirshëm dhe se Ai do ta mëshirojë kë të dojë. Rasti i njëjtë është edhe me emrat e tjerë që janë përmendur në Kur'an dhe në Sunnet.³⁶

34 Fet'hul Mexhid, f. 11; Imam Taberi përkritazi me domethënien e kësaj fjale thotë: "All-llah do të thotë Ai i Cili posedon të gjitha cilësitë e hyjnisë dhe vetëm Ai meriton që të gjitha krijesat T'i bëjnë ibadet.", Tefsirut Taberi, 1: 123.

35 Fet'hul Mexhid, f. 14; El-Esiletu vel-exhvibetul-usulijje, f. 44.

36 El-Esiletu vel-exhvibetul-usulijje.

Për sa i përket numrit të emrave të bukur të All-llahut xh.sh., në hadith përmenden 99; Buhariu dhe Muslimi transmetojnë hadithin nga Ebu Hurejre r.a., ku ka thënë: “I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: “All-llahu xh.sh. i ka 99 emra, një më pak se njëqind, dhe vepron sipas tyre, do të hyshë në Xhennet. All-llahu është Vitër (tek) dhe e do vitrin.”³⁷ Ulemaja islame janë të një mendimi se me fjalët e Pejgamberit s.a.v.s “nëntëdhjetë e nëntë emra” nuk janë përfshirë të gjitha emërat me këtë numër, porse në këtë hadith janë përmendur 99 emra dhe se kush i mëson përmendsh dhe vepron sipas tyre, do të hujë në Xhennet. E me këtë hadith nuk mohohen emrat e tjerë të All-llahut xh.sh. Pra, me këtë hadith informohet se do të hyjë në Xhennet ai i cili i përfshinë këta 99 emra, e jo se All-llahu xh.sh. i ka vetëm 99 emra.³⁸

Argument se All-llahu xh.sh. posedon edhe emra për të cilët nuk na ka informuar, por i ka mbajtur tek Ai në gajb, është hadithi i Pejgamberit s.a.v.s., ku qëndron: “Kurrnjë mysliman nuk do ta godasë ndonjë mynxyrë apo pikëllim, kur ai thotë: “All-llahu im i dashur, unë jam robi Yt, i biri i robit Tënd dhe i robëreshës Tënde, jeta ime është në dorën Tënde, mbi mua realizohet vendimi (sentenca) Yt, përcaktimi Yt ndaj meje është i drejtë, unë Të lus me çdo emër Tënd me të cilin e ke quajtur Vetën, që e Ke shpallur në Librin Tënd, apo ia Ke zbuluar ndokujt prej robërve të Tu, apo e ke mbajtur tek Ti në gajb, që Kur’anin Ta bëshë pranverë të zemrës sime, zhdukje të pikëllimit tim dhe largim të mynxyrave dhe vështirësive të mia”, e që All-llahu xh.sh. të

37 Këtë hadith e transmeton Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibni Maxhe. Shih: Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 5: 372; Hidajetu-l-Bari, 1: 135; dhe Sahih Muslim bi Sherhin Nevevi, 17: 5.

38 El-Esmâu ves-sifatu lil-Bejheki, f. 6; Isarul Hakk ‘alel halk lil-Murteda el-Jemani, f. 169; Fet’hul-Bari, 11: 183; Tefsirul Kasimi, 7: 2911; Sherhul ‘akidetit-tahavijje, f. 110; dhe Sahih Muslim bi Shehrin Nevevi, 17: 5.

mos i largojë prej tij mynxyrat dhe pikëllimet e tij e të mos i zëvendësojë me lumturi.” Atëherë as’habët thanë: “O i Dërguari i All-llahut, a do t’i mësojmë këto fjalë përmendsh?” “Gjithsesi”, - u përgjigj ai, “secili që i dëgjon këto, do të duhej t’i mësonte përmendsh.”³⁹

Për sa i përket përfshirjes së emrave të All-llahut xh.sh. në hadithin e lartëcituar, me këtë nënkuptohet se ata duhet t’i mbajmë mend, t’u besojmë, t’i kuptojmë, të përpiqemi që t’u përgjigjemi, të veprojmë sipas kuptimit të tyre në marrëdhënien tonë ndaj All-llahut xh.sh. dhe me ta t’i lutemi All-llahut xh.sh. Andaj domethënia e hadithit do të ishte: Ai i cili i mëson përmendsh, emërat e All-llahut duke menduar për domethënien e tyre, duke vepruar sipas asaj që ata kërkojnë prej tij dhe duke pranuar shenjtërinë e Atij i cili quhet me ta, ai do të hyjë në Xhennet.⁴⁰

39 Këtë hadith e transmeton imam Ahmedi dhe Ebu ‘Avane në Sahihun e vet, e për këtë imam Huthejmi në”Mexhme’udh dhevaid” thotë: ”Këtë e transmeton Ahmedi, Ebu Ja’la dhe el-Bezzari, e transmetuesit e Ahmedit janë transmetues, të cilët i përmend Buhariu në”Sahih”, përveç Ebu Seleme el-Xhuhejni, të cilin Ibni Hibbani e konsideron të besueshëm. Shih: Isarul Hakk ‘alel halk, f. 180; El-Esmau ves-sifat, f. 6-7; dhe Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 110.

40 El-Esmau ves-sifatu, f. 6; El-Esiletu vel-exhvibe, f. 45; Fet’hul Bari, 13: 322; dhe Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 17: 5-6.

ARGUMENTET PËR TEVHIDUL-ESMA'I VES-SIFAT

Argumentet nga Kur'ani dhe Sunneti për këtë lloj të tevhidit janë të shumënumërt. Në çdo kapitënë të Kur'anit përmenden emrat dhe cilësitë e All-llahut xh.sh., madje edhe në çdo faqe të Kur'anit. Kur'ani i përmend emrat dhe cilësitë e All-llahut xh.sh., dhe në to terheq vëmendjen në shumë tema mbi të cilat flet. Kur flet për tevhidin, ibadetin, legjislacionin, kontekstin e urdhrin dhe ndalesës, premtimit dhe kërcënimit, rrëfimit dhe parashtrimit të shembujve. Në këtë rast do të përmendim suren (kapitinën) e cila përmbanë të gjitha fushat e këtij lloji të tevhidit dhe ajetin më të rëndësishëm të Kur'anit.

Për sa i përket sures, ajo është suretul Ihlas, e cila, sipas vlerës së saj, i përgjigjet një të tretës të Kur'anit, siç theksohet në hadith.⁴¹

All-llahu xh.sh. thotë:

41 Buhariu në "Sahihun" e vet transmeton nga Ebu Se'id el-Hudrije r.a., se një njeri e kishte dëgjuar njërin i cili gjithnjë (në çdo rekatë) përsëriste "kul huv All-llahu ehad", andaj pasi që agon, shkon te i Dërguari i All-llahut dhe i tregon për këtë, duke konsideruar se kjo është pak (e vogël). Në këtë Pejgamberi s.a.v.s. tha: "Pasha All-llahun, ajo vlenë sa një e treta e Kur'anit?" Ebu Se'idi transmeton se Pejgamberi i All-llahut ka thënë: "A mos ka nga mesi i juaj të atillë që nuk mund ta lexojnë një të tretën e Kur'anit për çdo netë?" Kjo u erdhë vështirë as'habëve, andaj thanë: "E kush do të ishte në gjendje prej nesh ta bënte këtë, o Pejgamber?" "All-llahul Vahidus Samed është një e treta e Kur'anit", tha Pejgamberi s.a.v.s." Shih: Sahihu-l-Buhari me'a Fet'hul Bari, 9: 49. Hadithet mbi fadiletet (vlerat) e sures Ihlas janë të shumënumërta. Shih: Zadul Me'ad, 1: 82.

“Thuaj: “Ai, All-llahu është Një! All-llahu është mbrojtës i gjithkujt. (Ai) nuk ka lindur prej dikujt, as nuk ka lindur kë. Dhe askush nuk i gjason Atij.” (El-Ihlas: 1-4).

Kjo sure e lartësuar ka përfshirë përshkrimin e çdo forme të përsosmërisë së All-llahut xh.sh. dhe mohimin e çdo të mete. Me anë të saj All-llahu xh.sh. na informon se Ai është i Vetmi Zot dhe se Ai është mbrojtës i çdokujt, se nuk ka lindur kë, as që është i lindur prej dikujt dhe se askush nuk i gjason Atij. Fjala Ehad do të thotë Ai i Cili askush nuk i gjason dhe askush nuk i është i barabartë.⁴² Ky emër tregon atë se All-llahu xh.sh. është i Vetmi që meriton t’i drejtohem i për ndihmë gjatë mynxyrës dhe fatkeqësisë. Këtë fakt nuk e cenon procedimi i atyre të cilët kanë devijuar nga rruga e drejtë dhe kanë humbur, i drejtohen tjetërkujt, dhe ia kthejnë shpinën Krijuesit të tyre. Sepse, nëse All-llahu xh.sh. është Krijues dhe Drejtues i të gjithave dhe pasi që nuk ekziston Krijues dhe Udhëheqës tjetër, përveç Tij atëherë të drejtuarit nga dikush tjetër është marrëzi e madhe, sepse të gjitha janë në duart e tij.⁴³ Pra, sikurse që me emrin El-Ehad mohohen të gjitha cilësitë e të metave dhe të gjymtësisë, po ashtu me emrin Es-Samed vërtetohen të gjitha cilësitë e përsosmërisë dhe madhësisë.⁴⁴

Për këtë shkak i Dërguari i All-llahut ka thënë se kjo sure i përgjigjet një të tretës të Kur’anit, sepse, kjo në vete përmbanë akaidën e plotë, e cila bazohet në përshkrimin e të gjitha cilësive të përsosmërisë së All-llahut xh.sh. dhe mohimin e cilësive të të metave, dhe në adhurimin e All-llahut, Një të Vetmin, me të gjitha llojet e ibadeteve që i përkasin Atij. Në realitet, i tërë Kur’ani

42 El-esmau ves-sifat, f. 21; Sherh Mulla ‘Ali el-Kari ‘alel fikhul-ekber, f. 14.

43 El-esmau ves-sifat, f. 85.

44 Fet’hul Bari, 9: 50.

është akide, që u shpjegon njerëzve se çka janë të obliguar të besojnë nga cilësitë dhe emrat e All-llahut xh.sh., Sheriat, që u shpjegon njerëzve të drejtat dhe obligimet e tyre, mënyrën e sjelljes reciproke, rrëfime dhe tregime me të cilat Kur’ani u shpjegon njerëzve ligjshmëritë e All-llahut në marrëdhënien e Tij ndaj njerëzve dhe të cilëve detajisht u shpjegohet shpërplimi dhe ndëshkimi, premtimi dhe kërcënimi i All-llahut xh.sh.

Alimi i famshëm Ibnul Kajjimi, gjatë komentimit të kësaj sureje thotë: Suretu-l-Ihlas në vete përmbanë të gjitha llojet e tevhidit dhe tërë atë që jemi të obliguar të besojmë nga cilësitë e All-llahut xh.sh., nga ehadijjeti (njësia, uniteti) me çka mohohet çfarëdo forme e ortakllëkut me All-llahun xh.sh., samedijjetit (All-llahu xh.sh. si mbrojtës i gjithkujt), mohimi i lindjes dhe të lindurit që është obligueshmëri e samedijjetit dhe mohimi i çdo barabarësie me Të, që me vete tërheq mohimin e çfarëdo përgjasimi dhe krahasimi të Tij me dikë tjetër. Pra, kjo sure përmban përshtkrimin e të gjitha formave të përsosmërisë All-llahut xh.sh. dhe mohimin e çdo lloj gjymtësie, mohimin e çfarëdo ngjashmërie dhe barabarësie me Të në përsosmërinë e Tij, dhe mohimin e çfarëdo shoku të Tij. Këto indikacione qenësore janë thelb i tevhidit shkencor, sipas të cilit bartësi i tij dallohet nga të gjitha sektet e lajthitjes dhe shirkut.”⁴⁵

Për sa i përket ajetit, ky është ajetu-l-Kursijj, për të cilin Pejgamberi i All-llahut thotë se ky është ajeti më madhështor i Kur’ani, e në të cilin All-llahu i Lartësuar thotë:

“All-llahu është - s’ka tjetër zot përveç Tij - i Gjalli dhe i Përjetshmi! Atë nuk e kaplon as kotja as gjumi! Të Atij janë të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë. Kush mund të angazhohet për

45 Zadul me’ad hedji hajril ‘ibad, 1: 81-82.

ndokend tek Ai pa lejen e Tij?! Ai di çdo gjë që ka ndodhë përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë në të ardhmen. Por, njerëzit, nuk dinë asgjë nga dijenia e Tij, përveç që Ai ka dashur t'ua tregojë. Froni (Kursijja) e Tij përfshinë qiejt dhe Tokën dhe Atij nuk i vie rëndë t'i mirëmbajë ato. Ai është Shumë i Larti, i Madhërishmi!” (El-Bekare: 255).

Ky ajet madhështor përfshin që të tri pjesët e tevhidit, sepse përmban emrat e bukur të All-llahut xh.sh. dhe cilësitë e Tij, dhe çdonjëra prej tyre paraqet një nga parimet e Akides:

Fjalët e All-llahut xh.sh.: “All-llahu është - s’ka tjetër zot përveç Tij” konfirmojnë parimin e uluhijjetit (pranimin se vetëm All-llahu xh.sh. është Ai i Cili adhurohet), që është thelb dhe themel i tevhidit të tërësishtëm, në të cilin prehet aspekti islam i tërë jetës dhe nga i cili rezulton adhurimi dhe të drejtuarit në formë të ibadetit vetëm All-llahut xh.sh., dhe se njeriu nuk mund të jetë rob i askujt tjetër përveç i All-llahut xh.sh., askujt nuk do t’i drejtohet në formën e ibadetit përveç All-llahut xh.sh., askujt nuk do t’i jetë i nënshtruar përveç All-llahut xh.sh., askujt nuk do t’i drejtohet për gjykim përveç All-llahut xh.sh. dhe prej askujt nuk do të pranojë ligje, ideale, rregulla të sjelljes, e as mënyrë të të kuptuarit përveç nga All-llahu xh.sh.⁴⁶

Fjalët e All-llahut xh.sh.: “I Gjalli dhe i Përrjetshmi!”, Qenies shumë të Lartë i përshkruajnë dy cilësi të lartësuar: El-Hajj (i Gjalli) është Ai të cilit i takon jeta e amshueshme dhe ekzistenca e amshueshme, i Cili nuk ka as fillim as mbarim.⁴⁷ Jeta e cila i përshkruhet All-llahut xh.sh. është jeta e Tij e pavarur, e cila nuk ka rezultuar nga ndonjë burim tjetër, siç është rasti me jetët e

46 Fi Dhilalil Kur’anil Kerim, 1: 418-419.

47 Tefsirut-Taberi, 5: 388; El-Esmau ves-sifat, f. 20.

krijesave të gjalla, jeta e të cilave është e dhuruar nga Krijuesi i tyre. Jeta e tij, gjithashtu, është e përhershme dhe e përgjithmoshme, e cila nuk ka filluar në ndonjë moment e as që mbaron në ndonjë termin (kohë të caktuar).⁴⁸

El-Kajjum është Ai, i Cili i mirëmbanë të gjitha krijesat dhe udhëheqë me tërë Gjithësinë, në të gjitha gjendjet (situatat) e tyre. Pra, Ai është udhëheqës i të gjitha krijesave. Ai i furnizon, i ruan, kujdeset për to dhe u cakton atë që dëshiron Vetë.⁴⁹

Këta dy emra (El-Hajj dhe El-Kajjum) bëjnë pjesë ndër emrat më të mëdhenj (më të zgjedhur) të All-llahut xh.sh., sepse në këta bazohen të gjithë emrat e tjerë e të bukur të All-llahut xh. sh dhe domethënia e të gjithë emrave të tjerë reduktohet në këta dy emra. Atributi i jetës, përmban në vete të gjithë atributet e tjera të përsosmërisë dhe asnjëri nga ata nuk mungon, pos nëse është fjala për ndonjë jetë të dobët e jo të plotë, e pasi që All-llahu xh.sh. jeton tërësisht një jetë të përkryer, atëherë Atij i përket çdo lloj përsosmërie. Ndërsa cilësia El-Kajjum në vete përmban pavarësinë e plotë dhe fuqinë absolute të Tij, sepse, Ai ekziston nga vetvetja e Vet dhe nuk ka nevojë për askë nga çfarëdo aspekti qoftë, dhe Ai i mirëmban dhe i furnizon që të gjithë, andaj të gjithë ekzistentët janë varur nga të ekzistuarit e All-llahut xh.sh. dhe nga përcaktimi i Tij.⁵⁰

Këta dy emra, kanë ndikim të madh në njeriun i cili i beson këtyre dhe i cili vetes ia prezenton domethëniet e tyre të lartësuara. Ndërgjegjja e tij gjithnjë do të jetë e lidhur me dashurinë ndaj

48 Fi Dhilalil Kur'anil Kerim, 1: 418-419.

49 Elesmau ves-sifat, f. 48; Sherhul 'akidetit-Tavahijje, f. 124; Tefsirut-Taberi, 5: 388; Er-Revdatun nedijje, f. 61.

50 Sherhul 'akidetit-tahavijje, f. 124-125.

All-llahut xh.sh., me ibadet dhe me devotshmëri ndaj Tij, sepse është i vetëdijshëm dhe e di mirë se All-llahu xh.sh. është Zoti i tij dhe Ai i Cili ia rregullon dhe ia përcakton jetën e tij dhe çdo gjë që ndodh rreth tij, sipas diturisë së Tij dhe sipas planit që më parë të caktuar të Tij. Andaj gjatë jetës së vet do t'i përmbahet rregullave të sistemit me të cilat udhëheqë ajo urtësi dhe mbi të cilat realizohet plani i përmendur, dhe prej të cilave do t'i nxjerrë vlerat dhe direktivat (udhëzimet) e veta dhe sipas tyre do të orientohet në të gjitha situatat.⁵¹

Fjalët e All-llahut xh.sh. “Atë nuk e kaplon as kotja as gjumi!” janë vërtetim se Ai të gjitha i mirëmbanë dhe me ndihmën e Tij ekziston çdo gjë. Sepse, kotja dhe gjumi janë në kontrast me jetën e përkryer dhe me pavarsinë e plotë.⁵²

Fjalët e All-llahut xh.sh. “Të Atij janë të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë”, vërtetojnë sundimin e Tij absolut mbi të gjitha që ekzistojnë, sundimin i cili me kurrnjë gjë nuk është i kufizuar, i cili është larg çfarëdo ortakllëku. Një besim i këtillë, nëse përforcohet në zemrat e njerëzve, ka ndikim shumë të madh në jetën e tyre. Sejjid Kutbi, rahimehullahu, thotë: “Po qe se në mënyrë korrekte (të drejtë) kuptohet pronësia absolute e All-llahut xh.sh., atëherë bëhet e qartë se njerëzit në realitet nuk posedojnë asgjë, porse e tërë ajo që posedojnë ata janë vetëm huazim nga Pronari i Vetëm dhe i vërtetë, në pronësinë e të Cilit është çdo gjë. Prandaj, në këtë huazim duhet të sillen e të veprojnë sipas udhëzimeve të Pronarit të vërtetë, i Cili i ka ngarkuar me to. E, udhëzimet e Tij janë shpjeguar në Ligjin - Sheriatin e Tij, dhe ata nuk kanë të drejtë t'i tejkalojnë këto udhëzime, sepse në të kundërtën do ta humbasin të drejtën e disponimit me gjërat

51 Fi Dhilalil Kurani Kerim, 1: 419

52 Fi Dhilalil Kurani Kerim, 1: 419; Er-Revdatun nedijje, f. 63.

e besuara dhe veprimet e tyre do të jenë të paligjshme. Vetë vetëdija e njeriut për këtë fakt, ndjenja e tij se Sunduesi i vërtetë i të gjithave që ekziston në qiej dhe në Tokë është All-llahu xh.sh., të kuptuarit se vetë nuk është pronar i vërtetë i gjërave që posedon, dhe se Pronar i tij i vërtetë është All-llahu xh.sh., ndjenja se çdo gjë që posedon është vetëm huazim në kohë të caktuar, të cilën pas skadimit të kohës atë do ta merr përsëri Pronari i tij, i Cili ia ka lejuar këtë huazim në kohë të caktuar, vetë vetëdija për këto fakte pakontestuese është e mjaftueshme që ta zbusin zjarrin e lakmisë dhe të pangopshmërisë së njeriut, koprracinë e tij, dorërrudhësinë dhe grabitshmërinë e qartur të tij. Dhe, njëkohësisht është e mjaftueshme, që njeriut t'ia zgjojë fatbardhësinë dhe lumturinë me atë që i vie nga furnizimi, t'ia zgjojë tolerancën dhe shpirtmadhësinë (dorëdhënësinë) me atë që posedon ai dhe t'ia mbushë zemrën me rehati dhe lumturi, pa dallim pat ai apo nuk pat pasuri. Për këtë shkak nuk do të pikëllohet së tepërmi për atë që i shmanget, e as që do t'i gëzohet për së tepërmi asaj që me të vërtetë e ka dëshiruar dhe e ka fituar.⁵³

Me fjalët e All-llahut xh.sh.: “Kush mund të angazhohet për ndokend tek Ai pa lejen e Tij?!” janë acaruar gradat e uluhijetit (hyjnisë) dhe gradat e ubudijetit (robërisë). Sepse, çdo krijesë është rob i All-llahut xh.sh., dhe në asnjë rast nuk mund t'i tejkalojë kufijtë e robërimit, e as të dalë jashtë tyre. Prandaj nuk mund të bëjë diç për të tjerët, pos me lejen e All-llahut xh.sh. Me këtë fakt feja islame ka vuar kufirin e qartë ndërmjet robërimit (ubudijetit) dhe zotërimit (rububijetit), kështu që assesi nuk mund të përzihen dhe nuk kanë asgjë të përbashkët nga cilësitë dhe veçoritë.⁵⁴

53 Fi Dhilalil Kur'anil Kerim, 1: 420-421.

54 Fi Dhilalil Kur'anil Kerim, 1: 420-421.

Fjalët e All-llahut xh.sh.”Ai di çdo gjë që ka ndodhë përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë në të ardhmen. Por, njerëzit, nuk dinë asgjë nga dijenia e Tij, përveç që Ai ka dashur t’ua tregojë.”, janë vërtetim se dijenia e All-llahut xh.sh. përfshinë tërë hapësirën, tërë kohën dhe të gjitha sendet, dhe shpjegim se krijesat janë të pafuqishme, se dijenia e tyre është e mangët, dhe se mund të dijnë vetëm atë që ua lejon All-llahu xh.sh.⁵⁵

Besimi i myslimanit në këtë cilësi të All-llahut xh.sh. dhe ndjenja e thellë në zemrën e tij se vetëm All-llahu xh.sh. i di të gjitha, ndikon në të që vijimisht ta ketë në mendje All-llahun xh.sh. dhe të kujdeset për dispozitat e Tij, që me të shpejtë të pendohet nëse bënë ndonjë vepër të keqe dhe të jetë i vetëdijshëm për dobësinë dhe padijeninë e vet, si dhe të jetë i vetëdijshëm për dhuntitë e All-llahut xh.sh. ndaj tij për të gjitha që e mëson Ai nga e vërteta. E tërë kjo bënë që njeriu vazhdimisht të jetë falënderus ndaj All-llahut xh.sh., dhe të jetë larg kryelartësisë dhe mburrjes.

Fjalët e All-llahut xh.sh.”Froni (Kursijja) e Tij përfshinë qiejt dhe Tokën dhe Atij nuk i vie rëndë t’i mirëmbajë ato.” Janë argument i fuqisë së Tij absolute.

Pastaj All-llahu xh.sh. e përfundon këtë ajet me dy emra të Vet të bukur: “Ai është Shumë i Larti, i Madhërishmi!” Shumë i Larti është Ai, i cili gjendet mbi të gjitha krijesat⁵⁶ dhe askush nuk mund ta arrijë Atë, e nëse dikush tenton ta bëjë këtë, All-llahu xh.sh. do ta turpërojë dhe do ta kthejë në humnerë në këtë botë dhe do t’ia përgatisë ndëshkimin dhe poshtërimin në botën tjetër.

55 Tefsirul Taberi, 5: 396-397; Er-Revdatun nedijje, f. 64.

56 Tefsirul Taberi, 5: 305.

E, i Lartmadhërisë (El-Adhim) është Pronarë i madhërisë dhe çdo gjë tjetër është më e vogël se Ai, dhe nuk ekziston asgjë që është më e madhe dhe më madhështore se All-llahu xh.sh.⁵⁷

Kur i ngulitet njeriut e vërteta mbi madhësitë në lartësinë e All-llahut xh.sh., ai kurrë nuk do të kapërdiset (krenohet) dhe nuk do të bëhet dhunues, por ta ketë drojën e All-llahut xh.sh., do të frikësohet prej Tij dhe do të jetë i njerëzishëm ndaj Tij dhe krijesave të Tij.⁵⁸

Këta janë vetëm disa nga indikatorët mbi lartësinë dhe madhësitë e ajetu-l-Kursijj, që na bëjnë me dije se çdo mysliman do të duhej ta mësonte përmes këtyre ajeteve, të mendojë për domethënien e tij, t'i përkujtohet gjithnjë dhe të përpiqet që të veprojë ashtu siç kërkon ai prej tij.

Mbi vlerën e këtij ajeti flasin shumë hadithe. Buhariu transmeton nga Ebu Hurejre r.a. një hadith tjetër, ku qëndron se i Dërguari i All-llahut ka thënë: “Kur të biesh në shtratin tënd, këndojë ajetin Kursijj: “All-llahu la ilahe ila huvel Hajjul Kajjum” - gjer në fund të ajetit, e All-llahu do ta dhurojë ruajtësin i cili do të të mbrojë nga shejtani, kështu që nuk do të mund të të afrohet gjersa nuk zgjohesh nga gjumi.”⁵⁹ Ndërsa Muslimi transmeton në Sahihun e vet nga Ubejj b. Ka’bi se ka thënë: “I Dërguari i All-llahut ka thënë: “O Ebal Mundhir, a e di se cili është ajeti më i vlefshëm në Kur’an?” Thashë: “All-llahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri.” I Dërguari i All-llahut përsëri tha: “O Ebal Mundhir, a e di se cili është ajeti më i vlefshëm në Kur’an?” Atëherë

57 Tefsirul Taberi, 5: 305.

58 Fi Dhilali Kur’anil Kerim, 1: 424.

59 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 2: 384.

unë i thash: “All-llahu la ilahe ila huvel Hajjul Kajjum.” I Dërguari i All-llahut më përkëdheli në gjoks e tha: “Le të të jetë e këndshme dituria, o Eba Mundhir!”⁶⁰

PJESA E DYTË BESIMI NË ENGJËJ

Një nga bazat e imanit është besimi në engjëj.

Me këtë nënkuptohet bindshmëria e fuqishme se engjëjt ekzistojnë, se All-llahu xh.sh. i ka krijuar ata nga nuri (drita), se ata përpikërisht i kryejnë urdhrat e All-llahut xh.sh., se ata assesi nuk gabojnë dhe se kryejnë funksione të caktuara me të cilat i ka ngarkuar All-llahu xh.sh.⁶¹

Pra, engjëjt janë një lloj krijesash të All-llahut xh.sh. dhe imani i njeriut nuk është korrekt përderisa nuk beson në ekzistimin e tyre dhe në çdo gjë që thuhet në Kur’an dhe transmetohet në hadithe autentike mbi cilësitë dhe punët e tyre, pa kurrfarë shtime apo cungime dhe pa kurrfarë shtrembërimi. All-llahu xh.sh. thotë:

60 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 6: 93.

61 Ibnu Haxheri, përkritazi me domethënien e fjalës melek (engjëll), thotë: ”Shumica e ulemasë islame janë dakort se melekët janë qenie të rafinuara, të cilëve u është dhënë fuqia (mundësia) e shndërrimit në figura të ndryshme dhe se ata janë të vendosur në qiej.”; Fet’hul Bari, 6: 223; El-Esiletu vel edzhvibetul usulijje, f. 21.

“Pejgamberi beson në atë që i shpallet nga Zoti i tij, dhe besimtarët; - të gjithë ata besojnë All-lahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij dhe Pejgamberët e Tij.” (El-Bekare: 285).

Ndërsa në hadithin, të cilin e transmeton Buhariu nga Umeri r. a, kur Xhibrili e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s. mbi imanin, qëndron se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Ta besosh All-llahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, Pejgamberët e Tij, Ditën e gjykimit dhe të besosh se çdo gjë që ndodhë - prej të mirave dhe prej të këqijave - ndodhë me përcaktimin e All-llahut xh.sh.”

Ekzistimi i engjëjve bazohet në argumente pakontestuese në të cilat është e pamundur të dyshohet. Andaj mohimi i ekzistimit të tyre, sipas pajtueshmërisë të të gjithë myslimanëve dhe sipas tekstit kur’anor, është kufër, sepse All-llahu xh.sh. thotë:

“... E ai që nuk beson All-llahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, Pejgamberët e Tij dhe Ditën e Kiametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë.” (En-Nisa’: 136).

Ai i cili i lexonë të gjitha ajetet dhe të gjitha hadithet, që flasin mbi engjëjt, veçoritë e tyre, punët dhe gjendjet e tyre, do të konstatojë se ata (ajetet dhe hadithet) shpjegojnë raportin e tyre ndaj All-llahut xh.sh., ndaj Gjithësisë dhe ndaj njeriut. All-llahu xh.sh. na ka mësuar tërë atë që kemi nevojë për pastrimin e akaidës, për pastrimin e zemrave tona dhe për korrektësinë e veprave tona.

E, për sa i përket esencës së engjëjve, këtë All-llahu xh.sh. e ka lënë për Vete. Kjo edhe është njëra nga veçoritë themelore të besimit islam, e cila i përfshinë të vërtetat e gjithmbarshme dhe na njofton për to vetëm aq sa kanë nevojë njerëzit, në mënyrë që të veprojnë korrekt në këtë botë dhe që të jenë të shpëtuar në botën e ardhme, dhe vetëm aq sa është në gjendje të kuptojë mendja e tyre. Prandaj, All-llahu xh.sh. nuk na ka zbuluar të gjitha gjërat e gajbit (të padukshme), qoftë që

kanë të bëjnë me All-llahun xh.sh., cilësitë e Tij dhe emrat e Tij, qoftë me krijesat e padukshme të Tij.

Besimtari i singertë fuqimisht beson tërë atë që na ka informuar Zoti ynë, përgjithësisht dhe parciaisht, dhe kurrë nuk do të shtojë apo të cunjojë, as që do të përpiqet të kuptojë atë për çka All-llahu xh.sh. nuk na ka informuar nga gajbi, e as që do të lëshohet në polemizime përkitazi me këtë.

VEÇORITË E ENGJËJVE

Nga ajo që parashtruam më lart, kuptohet se All-llahu xh.sh. nuk na informuan detajisht mbi veçoritë e engjëjve, porse vetëm diçka pakëz ka thënë për ta. Na informon se ata janë krijuar para Ademit.⁶² Në Kur'an përmendet se si All-llahu xh.sh. u ka lajmërua atyre se Ai do ta krijojë njeriun dhe se atë do të bëjë mëkëmbës të Vetin në Tokë:

“Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të caktojë përfaqësuesin në Tokë.” - Ata thanë: “A do të jetë përfaqësuesi Yt ai që në të do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak? Na të madhërojmë e të lavdërojmë dhe të ngrisim ashtu si të takon Ty”. Ai tha: “Unë di atë që ju nuk dini.” (El-Bekare: 30).

62 Fet'hul Bari, 6: 234.

E, për sa i përket materies nga e cila janë të krijuar, i Dërguari i All-llahut na informon se All-llahu xh.sh. i ka krijuar nga nuri. Imam Muslimi shënon hadithin nga Aishja r.a. se i Dërguari i All-llahut xh.sh. ka thënë: “Engjëjt janë krijuar nga nuri, e xhinnët nga zjarri i flakëruar, kurse Ademi është krijuar nga ajo mbi çka u është thënë tanimë”⁶³

Ajetet dhe hadithet që flasin për engjëjt, provojnë se engjëjt janë krijuar nga nuri, se nuk kanë figurë materiale që mund të shihet apo të ndihet me shqisat njerëzore dhe se ata nuk janë sikurse njerëzit, nuk hanë, nuk pinë, nuk flejnë dhe nuk martohen, nuk posedojnë pasione shtazarake dhe janë të mbrojtur nga mëkatet dhe gabimet, dhe nuk posedojnë kurrnjë veçori fizike nga ato që posedojnë njerëzit.⁶⁴

Ata kanë mundësi të shndërrohen dhe të shfaqen në figurën njerëzore, me lejen e All-llahut xh.sh. Për këtë na informon All-llahu xh.sh. në Kur’an, kur flet për Xhibrilin a.s. i cili i ka ardhur Merjemës në figurën e njeriut:

“Dhe përmende (o Muhamed!) në Libër (Kur’an) Merjemën (historinë e saj): “kur u tërhoq nga familja në një vend, në lindje, dhe mori një perde që të skajohet nga ata; Na dërguam tek ajo engjëllin - Xhibrilin dhe iu paraqit asaj në formën e mashkullit të zhvilluar mirë.” (Merjem: 16-17).

63 Transmeton Muslimi dhe imam Ahmedi në Mesnedin e vet; Fet’hul bari, 6: 232; Muhtesar Sahih Muslim, 2: 338.

64 Sherh Mulla ‘Ali el-Kari ‘alel fikhil ekber, f. 11; El-’Akidetul islamijje li Sejjid Sabik, f. 111; Fet’hul Bari. 6: 232.

Gjithashtu, Xhibrili përmendet edhe në hadithin e njohur kur pat ardhur që t'i mësojë as'abët për domethënien e Islamit, imanit, ihsanit dhe shenjave të Ditës së Kiametit. Umeri r.a. thotë se ai kishte ardhur në figurën e njeriut, rrobat e të cilit ishin jashtëzakonisht të bardha, e flokët i kishte jashtëzakonisht të zeza, në të cilin assesi nuk vëreheshin gjurmët e udhëtimit dhe se ishte ulur kundruall Pejgamberit s.a.v.s. duke e mbështetur gjurin e vet në të tij dhe duke i vënë duart e veta në këmbët e tij, e pastaj kishte filluar të pyeste.

All-llahu xh.sh. na informon se ata kanë krihë, numri i të cilëve dallon prej engjëlli në engjell. All-llahu xh.sh. thotë:

“Falënderimi qoftë për All-llahun, Krijuesin e qiejve dhe të Tokës, i Cili i ka bërë engjëjt pejgamberë me krahë, me nga dy, tre dhe katër. Ai shton në krijimtari çka të dojë. All-llahu, me të vërtetë, është i pushtetshëm për çdo gjë.” (Fatir: 1).

Muslimi dhe Buhariu transmetojnë hadithin nga Abdull-llah b. Mes'udi r.a., ku thuhet se i Dërguari i All-llahut e ka parë Xhibrilin, i cili i kishte 600 krihë.

Kjo është e tërë ajo që na ka informuar All-llahu i Lartmadhërishtëm mbi krijesat fisnike, mbi natyrën dhe karakterin e tyre, dhe ne i besojmë kësaj ashtu siç ka ardhur tek ne dhe më nuk pyesim asgjë përkritazi me këtë, sepse, sikurse të kishte për ne ndonjë dobi nga shpjegimi më detaj, me siguri se kjo nuk do të fshihej nga ne. Ngase All-llahu xh.sh. është i Mëshirshëm dhe i Butë ndaj nesh dhe Ai na mëson të vërtetën dhe të mirën.

ROBËRIT FISNIKË

E, për sa i përket qëndrimit të tyre ndaj All-llahut xh.sh., ky bazohet në dëgjueshmërinë e plotë, në ibadet dhe në kryerjen e tërësishme të urdhrave të Tij, dhe vetëm në këtë kuptim flitet për qëndrimin e tyre ndaj All-llahut xh.sh., ngase ata nuk janë zotë në krahasim me Të, e as që janë pasardhësit e Tij - djemtë apo vajzat e Tij - siç pohonin mushrikët (idhujtarët).

“Dhe ata thonë: “Mëshiruesi ka marrë për Vete fëmijë”. - I pastër është Ai - Jo, ata (engjëjt) janë robër të ndershëm. Ata nuk flasin pa lejen e Tij, dhe ata punojnë më urdhrin e Tij. Ai di se ç’kishte para tyre dhe çka do të ketë pas tyre, dhe (ata) ndërmjetësojnë vetëm për atë, me të cilin është i kënaqur (All-llahu), e ata edhe vetë janë të brengosur nga frika prej Tij.” (El-Enbija’: 26-28).

“I druajnë Zotit të tyre, që ka pushtet mbi ta dhe punojnë atë që u urdhërohet.” (El-Nahël: 50).

“... Të cilët nuk u kundërshtojnë urdhrave të All-llahut dhe të cilët punojnë atë që urdhërohen.” (Et-Tahrim: 6)

Pra, ata janë një nga krijesat e shumta të All-llahut xh.sh., të cilat i janë të nënshtuara dhe të cilat nuk janë në gjendja të bëjnë asgjë nga vetvetiu, e as që janë në gjendje t’i propozojnë diç All-llahut xh.sh. Ata vijimisht janë të zërë me ibadet ndaj All-llahut xh.sh. dhe i kryejnë të gjitha urdhrat e Tij. All-llahu xh.sh. thotë:

“Çdonjëri prej nesh (engjëjve) e ka vendin e caktuar, ne jemi ata që qëndrojmë në radhë, dhe ne jemi ata që i lutemi Atij (All-llahut).” (El-Saffat: 164-165).

Kjo është vërteta mbi engjëjt, prandaj, të besuarit se ata janë në gjendje të bëjnë çkadoqoftë sipas dëshirës së tyre, bën pjesë në shirk. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ai njeri nuk do t’u urdhërojë juve që engjëjt dhe Pejgamberët t’i konsideroni për zotë. Vallë! Si mund t’ju urdhërojë ai juve të bëheni mohues, pasi jeni bërë myslimanë?” (Ali ‘Imran: 80)

QËNDRIMI I ENGJËJVE NDAJ GJITHËSISË DHE NJERIUT

Pamë se qëndrimi i engjëjve ndaj Sunduesit ishte nënshtrimi i plotë dhe kryerja e përpiktë e urdhrave të Tij, ndërsa qëndrimi i tyre ndaj Gjithësisë dhe njeriut është vetëm një pjesë e atij nënshtrimi. E kjo, ngase ibadeti i tyre nuk shfaqet vetëm me madhërimin dhe lavdërimin e All-llahut xh.sh., por përmbahet edhe nga kryerja e urdhrave të Tij lidhur me rregullimin e tërë Gjithësisë dhe për mirëmbajtjen e saj me të gjitha krijesat që gjenden në të. Këto urdhra i përkasin të gjitha lëvizjeve dhe aktiviteteve, të gjitha gjallesave dhe jogjallesave, të gjitha ligjeve dhe fuqive që gjenden në Gjithësi dhe për realizimin e përcaktimit të Tij ashtu siç ka urdhëruar Ai, për të gjitha krijesat parciaisht (veç e veç). Ata i kryejnë urdhrat e All-llahut xh.sh. në përcjelljen dhe shënimin e vëmendshëm të çdo gjëje që ndodhë në Gjithësi nga lëvizjet e vetëdijshme dhe të pavetëdijshme. Ata janë të ngarkuar për qiejt dhe për Tokën, për çdo lëvizje

në këtë botë, në mënyrë që të bëhet ashtu siç dëshiron All-llahu xh.sh.⁶⁵ Përkitazi me këtë All-llahu xh.sh. Thotë:

“Dhe pasha engjëjt, të cilët me shpejtësi i rregullojnë të gjitha gjërat. (i kryejnë të gjitha urdhrat)” (En-Nazi’at: 4).

Kur’ani dhe Sunneti vënë në pah se ekzistojnë shumë lloj engjëjsh, të cilët janë të ngarkuar për lloj-lloj krijesash. All-llahu xh.sh. i ka caktuar engjëjt për Diellin e Hënën, për yjet, për malet, për retë, për shi, për mitrën e nënës, për embrionin derisa nuk kompletohet krijimi i tij, për çdo krijesë dhe për çdo gjë që ndodhë në Gjithësi nga dukuritë “natyrore”, për të gjitha këto janë ngarkuar engjëjt të caktuar.⁶⁶

E tërë kjo nuk është në kundërshtim me atë që vërejmë në Gjithësi nga ligjet dhe rregullat, të cilat janë të ndërlidhura mes veti, ngase këto ligje dhe këto rregulla janë krijesa të All-llahut xh.sh., dhe engjëjt janë të ngarkuar edhe për to, ashtu siç i ruajnë dhe i mirëmbajnë edhe krijesat e tjera, dhe sikur të mos ekzistonte vullneti i All-llahut xh.sh. për ruajtjen e këtyre ligjeve dhe dukurive, dhe sikur të mos ekzistonte përcaktimi i All-llahut xh.sh. që engjëjt ta ruajnë njeriun, arsyeja nuk do të mund ta kuptonte shkakun dhe domosdoshmërinë e të ekzistuarit gjatë periudhave kaq të gjata të një sistemi kaq preciz dhe të përsosur.

E, për sa i përket njeriut, ai, gjithashtu, sipas natyrës së tij të lindur, i përket këtij kujdesi të engjëjve, ngase edhe ai vetë është një nga krijesat e shumënumërta të All-llahut xh.sh. në Gjithësi,

65 Igathetul lehvan, 2: 120; Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 335.

66 Igathetul lehvan, 2: 120; Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 335.

madje edhe më tepër se kjo, ai është krijesë të cilit All-llahu xh.sh. ia ka nënshtruar të gjitha krijesat e tjera në Gjithësi. All-llahu xh.sh. thotë:

“A nuk po e shihni se si All-llahu ju ka mundësuar t’i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë...” (Llukman: 20).

Prandaj, ruajtja e qiejve dhe e Tokës, dhe e të gjitha atyre që janë në to nga ana e engjëjve, njëkohësisht paraqet edhe ruajtjen e njeriut dhe ndihmesë atij që t’i kryejë obligimet e mëkëmbësisë së vet në Tokë.

Engjëjt kanë edhe obligime dhe detyra të tjera lidhur me jetën e njeriut, që kanë për qëllim, siç ka precizuar All-llahu xh.sh., t’i udhëzojnë dhe t’i bëjnë të lumtur njerëzit në këtë botë dhe t’u ndihmojnë në ibadetin e tyre ndaj All-llahut xh.sh., të zgjedhin udhëzimin kundrejt lajthitjes dhe ta flakin të keqen, çrregullimin dhe bredhjen. All-llahu xh.sh. i ka zgjedhur ata që t’ua dërgojnë njerëzve Udhëzimin e Tij përmes Pejgamberëve të ndershëm të Tij. Engjëlli, të cilin All-llahu xh.sh. e ka caktuar për këtë detyrë të ndershme është Xhibrili a.s. All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe me të vërtetë, ai (Kur’ani), është Shpallja e Zotit të Gjithësisë. Atë e e ka sjellë Shpirti i besueshëm (Xhibrili) në zemrën tënde, që të bëhesh nga ata që paralajmërojnë.” (Esh-Shu’ara’: 192-194).

Ata e përcjellin njeriun në çdo moment të jetës së tij, dhe kanë për detyrë ta udhëzojnë atë në të mirë dhe ta bëjnë të lumtur. U tregojnë sheshit të vërtetën, punët e mira dhe i nxisin t’i kryejnë ato.

Muhammedi a. s ka thënë: “Djalli (shejtani) ka ndikim në njeriun, por edhe engjëlli ka ndikim në njeriun. Djalli e drejton atë në të keq dhe të vërtetën ia bënë të rrejshme, ndërsa engjëlli e drejton atë në të mirë dhe ia vërteton të vërtetën. E, ai i cili prej nesh ndien diç nga kjo e mirë, le ta dijë se ajo është nga All-llahu xh.sh., kurse nëse ndien të kundërtën e kësaj, le të kërkojë mbrojtje nga All-llahu xh.sh. nga shejtani i mallkuar.” Pastaj ka recituar: “Djalli ju frikëson me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni mëkate (si koprracia etj.). Por All-llahu ju premton falje mëkatesh dhe dhuntinë e Tij. All-llahu është i mëshirshëm pa masë dhe i di të gjitha.” (El-Bekare: 268).⁶⁷

All-llahu xh.sh. na informon se i ka angazhuar ata që të bëjnë dua për besimtarët dhe të kërkojnë falje për mëkatet e tyre:

“Ata (engjëjt) që e mbajnë Arshin dhe ata që janë rreth tij, e madhërojnë Zotin e tyre me falënderim dhe i besojnë Atij, si dhe kërkojnë falje (prej All-llahut) për ata që kanë besuar (duke thënë): “O Zoti ynë, Ti përfshinë çdo gjë me mëshirën dhe dijeninë Tënde; prandaj fali ata që u penduan dhe ndoqën rrugën Tënde dhe ruaji Ata prej dënimit të ferrit! O Zoti ynë, shpjeri ata në kopshtet e Adnit, të cilat ju ke premtuar atyre, dhe prindërit e tyre dhe bashkëshortet e tyre dhe pasardhësit e tyre, - ata që kanë qenë të mirë; Ti je i Plotfuqishëm dhe i Urtë. Dhe ruaji ata nga ndëshkimi për shkak të veprave të këqija, sepse, kë e ruan Ti atë ditë nga ndëshkimi për shkak të veprave të këqija - Ti e ke mëshiruar atë, e ky, me të vërtetë do të jetë sukses i madh!” (El-Mu’min: 7-9).

67 Këtë hadith e transmeton Tirmidhiu dhe thotë se është hasen garib. E transmeton edhe Nesaiu dhe Ibnu Hibbani nga Mes’udi. Shih: Fejdul Kadir lil Munavi, 2: 449).

Pejgamberi i All-llahut thotë: “Çdo ditë me të gdhirë zbresin dy engjëj dhe njëri prej tyre thotë: “O All-llah i dashur, Ti dhuroja bereketin në pasurinë e atij që jepë”, e tjetri thotë: “O All-llah i dashur, Ti shkatërroja pasurinë e atij që nuk jepë.”⁶⁸

Ata e nxisin njeriun të jetë i përulët dhe t’i bëjë ibadet Zotit të vet dhe ia bëjnë të këndshëm leximin e Kur’anit dhe përmendjen e All-llahut xh.sh., duke e inkurajuar të përfiton dijeni dhe të bënë vepra të mira, dhe janë të pranishëm gjatë namazit të tij dhe të leximit të Kur’anit. Për të gjitha këto flasin hadithet autentike.

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi i All-llahut ka thënë: “Namazi i njeriut në xhemat është më i vlefshëm se namazi i tij në shtëpinë e tij apo diku tjetër për njëzet e disa shkallë. Kush merr abdest, në formën më të mirë, pastaj shkon në xhami me të vetmin qëllim që ta falë namazin me xhemat, duke mos i interesuar asgjë tjetër, për çdo hap të tij i shtohet nga një gradë dhe i shlyhet nga një mëkat derisa të hyjë në xhami, e kur të hyjë në xhami, atëherë në namaz është aq sa e ka përfshirë namazi. Secilin prej jush e bekojnë engjëjt, derisa të gjendeni në vendin ku keni falë namazin, ata thonë: “O Zot, mëshiroje! O Zot, fale! O Zot, pranoja pendimin”. Engjëjt veprojnë kështu përderisa njeriu të mos fillojë t’i mendojë të tjerët, apo ta prish abdestin në xhami”.⁶⁹

Ebu Hurejre r.a. transmeton se Pejgamberi i All-llahut ka thënë: “Engjëjt ndërrohen në kujdestari mbi ju, engjëjt e ditës dhe engjëjt e natës. Të gjithë ata mbledhen në namazin e sabahut dhe të

68 Muttefekun ‘alejhi. Shih: Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 3: 237; Muhtesar Sahih Muslim, 1: 150.

69 Muttefekun ‘alejhi. Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 5: 165; Shih: Fet’hul Bari 1: 448

ikindisë, pastaj ata që e kanë kaluar natën me njerëzit ngriten te All-llahu xh.sh., e Ai i pyet, edhe pse Ai e di më së miri: “Si i lat robërit e Mi?” Ata përgjigjen: “Ne i kemi lënë e ata faleshin siç i kemi lënë në namaz, kur kemi ardhur.”⁷⁰

Për pjesëmarrjen e tyre nëpër ndejat e dhikrit kuptojmë nga hadithi të cilin e transmeton Ebu Hurejre r.a. ku thotë: “I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: “Vërtetë, All-llahu i Madhëruar ka engjëj që udhëtojnë gjithnjë dhe kërkojnë ithtarë të dhikrit, e kur gjejnë popullin që e përmend All-llahun e Madhëruar, engjëjt thërresin: ‘Eni kah nevojat tuaja!’, e pastaj i rrethojnë me krahët e tyre deri në qiellin e kësaj bote, kurse Krijuesi i tyre, edhe pse e di më mirë se ata i pyeti: ‘Ç’po flasin njerëzit e Mi?’” Ka thënë: “Engjëjt thonë: ‘Po të lavdojnë (tesbih) Ty, po të madhërojnë (tekbir) Ty, po të falënderojnë (tahmid) Ty, dhe po të lartësojnë (temxid) Ty’. All-llahu tha: ‘A më kanë parë robtë e Mi?’ Engjëjt thanë: ‘Jo, për All-llahun, ata nuk Të kanë parë!’ All-llahu pyeti: ‘Çfarë do të ishin, sikur të më shihnin?’ Engjëjt thonë: ‘Sikur Të të shihnin, ata edhe më tepër do Të të adhuronin, do Të të falënderonin dhe do Të të lavdëronin’. All-llahu tha: ‘A po kërkojnë diç robtë e Mi?’ Engjëjt thanë: ‘Po Të lusin për Xhennet’.” Pejgamberi s.a.v.s. tha: “All-llahu thotë: ‘A e kanë parë atë?’. Engjëjt thanë: ‘Jo, për All-llahun, o Krijues, nuk e kanë parë Xhennetin’. All-llahu atëherë u tha: ‘E si do të luteshin për Xhennetin, sikur ta kishin parë?’ Engjëjt thanë: ‘Sikur ta kishin parë Xhennetin, ata edhe më shumë do të lakmonin për të, edhe më shumë do të kërkonin e edhe më shumë do të dëshironin’. Atëherë All-llahu i pyeti ata: ‘Prej çkahit ata kërkojnë mbrojtje dhe strehim?’ Engjëjt thanë: ‘Ata kërkojnë mbrojtje nga zjarri’. All-llahu tha: ‘A e kanë parë ata zjarrin?’ Engjëjt thanë: ‘Jo, për All-llahun, nuk e kanë parë!’ All-llahu tha: ‘E si do

70 Muttefekun ‘alejhi: Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 6: 239.

të kërkonin ata mbrojtjen nga zjarri sikur ta kishin parë?’ Engjëjt thanë: ‘Sikur ta kishin parë zjarrin, ata edhe më shumë do të iknin nga ai, e edhe më shumë do të frikësoheshin nga ai’. All-llahu i Madhëruar thotë: ‘Bëhuni dëshmitarë që po ua fali atyre’. Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: ‘Një prej engjëjve thotë: ‘O Krijues, në mesin e tyre është një që nuk është prej tyre, ai ka ardhur në mesin e tyre për shkaqe private të tyre’. All-llahu i Madhëruar thotë: ‘Ata të gjithë së bashku ulen, nuk mund të jetë i pakënaqur një fqinj i tyre që qëndron ulur në shoqërinë e njëjtë.’⁷¹

Ndërsa për inkurajimin e tyre dijetarëve (alimëve) të cilët kërkojnë dituri, Pejgamberi i All-llahut thotë: ‘Nuk ka kurrnjë njeri, i cili e braktisë shtëpinë e vetë për të kërkuar dituri, e që engjëjt nuk ia zgjasin krihët e vet të kënaqur me atë që bënë ai.’⁷²

Ata po ashtu e përforcojnë njeriun të bëjë vepra të mira, posaçërisht për xhihad në rrugën e All-llahut xh.sh. All-llahu xh.sh. thotë:

“(Kujtoje) kur i urdhëroi Zoti yt engjëjt: “Unë jam me ju, andaj forconi ata që besojnë”. Unë do t’u shtie frikën në zemër mohuesve, andaj rrihni ju ata në qafë dhe në të gjithë gishtërinjtë.” (El-Enfal: 12).

71 Muttefekun ‘alejhi: Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 11: 175-176.

72 Transmeton Tirmidhiu duke thënë se hadithi është sahih, pastaj Ibnu Maxhe e këto janë fjalët të transmetimit të tij, Ibnu Hibbani në Sahih dhe Hakimin e vet dhe thotë se senedi i vet (zinxhiri i transmetuesëve) është autentik (sahih). Shih: Tergib vet-terhib, 1: 104.

Një nga detyrat e engjëjve, për të cilat na flet All-llahu xh.sh., e që kanë ndikim të madh në jetën e njeriut dhe mbrojtjen e tyre nga mëkatet dhe të këqijat, është edhe mbikëqyrja dhe përcjellja e tyre e zellshme e tërë asaj që punojnë njerëzit dhe shënimi i veprave të tyre. All-llahu xh.sh. thotë:

“Na e kemi krijuar njeriun dhe Na dimë se çka i pëshpëritë shpirti atij, ngas Ne jemi më afër se damari i tij i qafës. Kur takohen dy vet dhe ulen njëri nga e djathta, e tjetri nga e majta, ai nuk e thotë asnjë fjalë e që pranë tij të mos jetë ai që mbikëqyrë.” (Kaf: 16-18)

“Dhe mbi ju, me të vërtetë, vigjilojnë rojtarët, që janë të çmuar tek Ne, që i shkruajnë veprat tuaja, të cilët dinë çka punoni.” (El-Infitar: 10-12).

“Vallë, a mendojnë ata se Ne nuk dëgjojmë çka flasin ata tinëzisht dhe haptazi ndërmjet veti? Përkundrazi, Na dëgjojmë, e të dërguarit Tanë (engjëjt), që janë pranë tyre, shënojnë.” (Ez-Zuhruf: 80).

Dhe, në fund të ekspozesë sonë rreth qëndrimit të engjëjve ndaj njeriut dhe ndikimit të tyre në veprat e tyre të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme, t'i përmendim fjalët tejet të bukura të alimit Ibnul Kajjum El-Xhevziut mbi këtë temë në veprën e tij të njohur “Igasetul Lehvan”, ku thotë: “E engjëjt, të cilët janë të ngarkuar të kujdesen për njeriun që nga fillimi i jetës e gjer tek vdekja e tij, kanë tjetër qëndrim ndaj tij. Ata janë të ngarkuar që ta formojnë atë dhe ta bëjnë në figurën më të bukur, që ta mbrojnë atë në “thellësitë e tri errësirave”, që t’ia shkruajnë nafakën (fatin), datën, dhe çastin e vdekjes së tij, a do të jetë fatlum apo fatkeq dhe që gjithnjë ta përcjellin në të gjitha situatat dhe punët e tij. Që t’i shënojnë fjalët e tij dhe çdo vepër të kryer gjatë jetës së tij, që ta ruajnë në jetën e tij, që t’ia marrin shpirtin në çastin e vdekjes së tij dhe ta dërgojnë atë para Zotit dhe Krijuesit të tij. Ata janë të ngarkuar edhe ta ndëshkojnë apo ta shpërblejnë atë në jetën e pas

varrit (berzah) dhe pas ringjalljes, janë të ngarkur edhe për përdorimin e instrumenteve të kënaqësive dhe të ndëshkimeve. Ata e përforcojnë njeriun besimtar dhe ia mësojnë atë prej çka do të ketë dobi, luftojnë duke e mbrojtur atë dhe i janë ndihmës edhe në këtë botë edhe në botën tjetër. Ata e udhëzojnë në të mirë, duke e thirrur në të, dhe e ndalojnë nga e keqja, duke ia tërhequr vërejtjen në të. Pra, ata i janë mbrojtës dhe ndihmës të vërtetë, mbikëqyrës dhe mësuesë, këshillëdhënës dhe batorë të duave, dhe kërkuas të faljes për të. Ata bëjnë salavat për të, përderisa ai është i nënshtruar Zotit të tij dhe përderisa të tjerët i mëson për të mirë. Ata i sjellin lajme të gëzuara për nderimin që e pret tek Zoti i tij, me rast të ëndërrimit, vdekjes dhe ringjalljes. Ata e thërrasin të jetë i prunjshtëm në këtë botë dhe dhënies përparësi Ahiretit. Ata e përkujtojnë kur harron, e aktivizojnë kur e kaplon përtacia dhe e përforcojnë kur frikësohet. Ata punojnë për të mirën e tij në këtë botë dhe në botën e ardhshme. Pra, ata janë të dërguarit e All-llahut xh.sh. të ngarkur që të kujdesen për gjithë krijimtarinë dhe tërë atë lidhur me të dhe ata janë ambasadorët e Tij dërguar tek njerëzit, sipas urdhrimit të Tij, që zbresin në të gjitha pjesët e Botës dhe ngriten tek Ai, gjithashtu sipas urdhrimit të Tij.”⁷³

NUMRI I ENGJËJVE

Engjëjt janë aq të shumtë, saqë numrin e tyre nuk e di askush pos All-llahut xh.sh.

73 gasetul lehvan min mesajidish shejtan, 2: 125-126.

“Na kemi bërë rojtarë të zjarrit (engjëjt) dhe kemi caktuar numrin e tyre, vetëm për t’i provuar jobesimtarët; për t’u bindur njerëzit, të cilëve u është dhënë Libri; që t’u shtohet (forcohet) besimi atyre që besojnë, e mos të dyshojnë, ata, të cilëve u është dhënë Libri, - dhe ata, në zemrat e të cilëve ka sëmundje dhe ata që janë jobesimtarë të thonë” Çka ka dashur Zoti (të tregojë) me këtë shembull?” Kështu, All-llahu e lë në huti (dhe në humbje) atë që do, dhe e udhëzon në rrugë të drejtë atë që do. Askush tjetër përveç Tij nuk e di numrin e ushtrisë së Zotit tënd. Kjo është vetëm këshillë për njerëzit.” (El-Muddeththir: 31).

Tirmidhiu, Ibni Maxhe dhe Bezzari shënojnë hadithin nga Ebu Dherri, i cili transmeton nga Pejgamberi s.a.v.s., ku thuhet: “Kërcëllyen qiejt..., e si mos të kërcëllej në kur në to nuk ka vend as sa katër gishtërinj, e që në te të mos bën sexhde ndonjë engjëll.”⁷⁴

E, në hadithin mbi Mi’raxhin Pejgamberi i All-llahut thotë: “Pastaj qem të ngritur gjer tek Bejt el-Ma’ëmur,⁷⁵ e unë e pyeta Xhibrilin për këtë. Ai u përgjigj: “Ky është Bejt el-Ma’ëmuri, në të për çdo ditë falen 70. 000 engjëj.”⁷⁶

74 Fet’hul Bari, 6: 232.

75 Bejt el-Ma’ëmur - shtëpi e vizituar, që gjendet në qiell; në disa transmetime thuhet se kjo shtëpi është në një vijë me Ka’ben. Sh. p.

76 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 6: 233.

BESIMI NË ENJËJ INDIVIDUALISHT DHE PËRGJITHËSISHT

Jemi të obliguar t'u besojmë egjëjve, emrat e të cilëve janë përmendur individualisht në Kur'an dhe në Sunnet. Më të zgjedhurit ndër ta janë tre engjëj: Xhibrili, Mikaili dhe Israfil. Xhibrili është i obliguar ta bartë Shpalljen, e cila është jetë e zemrave dhe të shpirtave.⁷⁷ Xhibrili dhe Mikaili përmenden në këto ajete kur'anore:

“Thuaj: “Kush është armik i Xhibrilit? (duke qenë i lavdërueshëm); Ai e ka zbritur Kur'anin në zemrën tënde me lejen e All-llahut - për të vërtetuar librat e shenjta - dhe është udhërrëfyes e sihariq për besimtarët. Kush është armik i All-llahut, dhe i engjëjve të Tij, dhe i Pejgamberëve të Tij, dhe i Xhibrilit e Mikailit (ai është kafir) - e All-llahu është me të vërtetë armik i atyre që nuk donë të besojnë.” (El-Bekare: 97-98).

All-llahu xh.sh. e lavdëron Xhibrilin në Kur'an në mënyrën më të bukur dhe e përshkruan atë me cilësi më të bukura:

“Dhe betohem në yjet - që perëndojnë, të cilët lëvizin dhe zhduken nga shikimi (horizonti), dhe në natën kur errësohet, dhe agimin kur gëdhin (zbardhëllon drita), Kur'ani është me të vertetë të dëftuarit e të Dërguarit fisnik (Xhibrilit), të fuqishëm, të çmuar nga Zoti i Arshit, të cilin e dëgjojnë (engjëjt) dhe është i besuar (i madh).” (Et-Tekvir: 15-21).

“E mësoi atë një (engjëll) me fuqi të madhe, me inteligjencë të lartë, i cili u paraqiti në figurën e vet.” (En-Nexhm: 5-6).

⁷⁷ Igasetul-lehvan, 2: 122.

Mikaili është engjëlli i obliguar për shiun i cili është burim i jetës së tokës, i bimëve dhe i kafshëve.⁷⁸

Israfilë është engjëlli i obliguar t'i fryen Surit, zëri i të cilit është burim i jetës i të gjitha krijesave pas vdekjes së tyre.⁷⁹

Në Kur'an përmendet edhe engjëlli Malik, rojtar i Xhehennemit. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ata (atëherë) do të thërrasin: “O Malik (engjëlli i mbikëqyrjes së zjarrit)! Le të bëjë Zoti yt që të vdesim!” - e ai do të thotë: “Ju, do të qëndroni përherë aty!” (Ez-Zuhruf: 77).

Ai përmendet edhe në një hadith autentik.⁸⁰

Jemi të obliguar të besojmë në engjëjt e përmendur individualisht dhe në engjëjt e tjerë, emrat e të cilëve janë përmendur në hadithet sahih, së bashku me detyrat e tyre me të cilat janë të ngarkuar. E, për sa u përket engjëjve, të cilët nuk janë përmendur individualisht, jemi të obliguar të besojmë në ekzistimin e tyre sipas llojeve, ashtu siç i përshkruan Kur'ani dhe Hadithi, me të gjitha punët e tyre që janë përmendur.⁸¹ Prandaj edhe besojmë në Kiramen Kitabën, të cilët All-llahu xh.sh. i ka obliguar të na ruajnë:

78 Iqasetul-lehfan, 2: 122; Usulul iman li Muhammed bin ‘Abdul Vehhab, f. 14.

79 Iqasetul-lehfan, 2: 122; Usulul iman li Muhammed bin ‘Abdul Vehhab, f. 14.

80 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 6, 242.

81 Imam Buhariu e ka ndarë një kaptinë të veçant për hadithet të cilët flasin mbi engjëjt, ku i ka përmendur tridhjetë sish. Shih: Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 6: 232-243.

“Dhe mbi ju, me të vërtetë, vigjilojnë rojtarët, që janë të çmuar tek Ne, që i shkruajnë veprat tuaja, të cilët dinë çka punoni.” (El-Infitar: 10-12).

“Njeriu ka përcjellës (engjëjt), para tij dhe pas tij, - e mbikëqyrin atë me urdhërin e All-llahut.” (Er-Ra’d: 11).

“Vallë, a mendojnë ata se Ne nuk dëgjojmë çka flasin ata tinëzisht dhe haptas në mes tyre? Përkundrazi, na dëgjojmë, e të dërguarit Tanë (engjëjt), që janë pranë tyre, shënojnë.” (Ez-Zuhruf: 80).

Disa mufessirë, duke kometuar këtë ajet, thonë se ata janë nga dy engjëj nga ana e djathtë dhe e majtë e njeriut, të cilët i shënojnë të gjitha veprat e tij. Ai që rri në anën e djathtë i shkruan veprat e mira, kurse ai që rri në anën e majtë i shkruan veprat e këqija. Ndërsa dy të tjerët e mbrojnë dhe e ushqejnë atë, njëri është para tij e tjetri mbrapa tij, kështu që çdo njeri gjendet ndërmjet katër engjëjve.⁸²

Imam Muslimi dhe imam Ahmedi transmetojnë nga ‘Abdull-llah bin Mes’udi r.a. se ka thënë: “Pejgamberi i All-llahut ka thënë: “Për çdonjërin është caktuar përcjellësi i tij nga xhinnët dhe përcjellësi i tij nga engjëjt.” Atëherë as’habët pyetën: “A edhe për ty, o Pejgamber i All-llahut?” “Po, edhe për mua, por mua All-llahu më ka ndihmuar kundër tij (xhinnit - djajit), andaj mu ka dorëzuar tërësisht dhe më udhëzonë vetëm në të mirë.”, tha Pejgamberi s.a.v.s.”⁸³

82 Sherhul ‘akidetit-tahavijje, f. 493.

83 Sahih Muslim bi sherhin Neveviu, 17: 157. Fjala ”esleme” ka domethënie është dorëzuar dhe është bërë i dëgjueshëm, andaj ka thënë: ”dhe më udhëzon vetëm në të mirë.” Këtu nuk mendohet se ai ka

Gjithashtu i besojmë edhe engjëllit të vdekjes, i cili është i obliguar për marrjen e shpirttrave:

“Thuaj: “Do t’ju merr shpirtin engjëlli i vdekjes, i cili është caktuar për ju, e pastaj të ktheheni te Zoti juaj.” (Es-Sexhde: 11).

Kur’ani nuk e ka përmendur emrin e tij, e as që ai përmendet në hadithe autentike, por në disa transmetime nga gjeneratat e para të myslimanëve thuhet se emri i tij është Azrail, e All-llahu e di më së miri.⁸⁴

Dhe i besojmë bartësve të Arshit, për të cilët All-llahu xh.sh. na flet në Kur’an:

“Dhe engjëjt do të rrinë anëve të qiellit, kurse atë ditë - tetë (grupe engjëj) do ta mbajnë Arshin e Zotit tënd.” (El-Hakka: 17).

Së bashku me ta do të jetë edhe Israfil, i cili do të fryjë në Sur (bri).

Gjithashtu u besojmë edhe engjëjve të obliguar për Xhehennem - All-llahu xh.sh. na ruajt nga ai! - torturues (zebanitë) në krye të dymbëdhjetë engjëjve. All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe, ata që gjenden në zjarr, do t’u thonë rojtarëve të skëterrës: “Luteni Zotin tuaj që të na lehtësojë vuajtjet, (madje) qoftë edhe për një ditë!” (El-Mu’min: 49).

pranuar Islamin dhe është bërë besimtar, sepse djajtë nuk mund të jenë besimtarë. Shehrul ‘akidet-tahavijje, f. 439.

84 Usulul iman li Muhammed bin ‘Abdul Vehhab, f. 14.

“O ju që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lëndë djegëse të të cilit do të jenë njerëzit dhe gurët, dhe të cilin do ta mbikëqyrin engjëjt e fuqishëm dhe të ashpër, të cilët nuk u kundërshtojnë urdhrave të All-llahut dhe të cilët punojnë për atë që urdhërohen.” (Et-Tahrim: 6).

“Mbi të vigjilojnë nëntëmbëdhjetë. Na kemi bërë rojtarë të zjarrit engjëj dhe kemi caktuar numrin e tyre, vetëm për t’i provuar jobesimtarët.”(El-Muddeththir: 30-31)

I besojmë edhe engjëjt të obliguar për pallatet dhe kopshtiet e Xhennetit, të cilët janë të ngarkuar t’i gostisin dhe të kujdesen për banorët e tyre, duke u përgatitur rroba, ushqim, pije të llojllojshme dhe gjëra të tjera, çfarë syri i njeriut kurrë nuk ka parë dhe veshi kurrë nuk ka dëgjuar, e as që kanë mundur t’u bien ndërmend gjëra të tilla⁸⁵

ROLI DHE RËNDËSIA E BESIMIT NË ENGJËJ NË JETËN E NJERIUT

Thamë se e tërë ajo që na ka informuar All-llahu xh.sh. nga gjërat e gajbit (të padukshme, të panjohura) paraqet mençuri të madhe dhe janë tejet të vlefshme për ne. Prandaj All-llahu xh.sh., nga mëshira e madhe e Tij ndaj nesh, na ka informuar për këto krijesa fisnike, dhe besimi në to

85 Për t’u njoftuar më gjerësisht për botën e engjëjve, lexoni librin ”Bota e engjëjve fisnik”, vepër kjo e dr. Sulejman Eshkariut. (Kjo vepër tanimë është përkthyer në gjuhën boshnjakishte dhe besoj që së shpejti do të paraqitet në mesin e lexuesve. Sh. p. b.).

është një pjesë e besimit në gajb, besim ky që i përshkruhet besimtarëve të sinqertë. All-llahu xh.sh. thotë:

“Elif, Lam, Mim. Ky libër, në të cilin nuk ka dyshim aspak, është udhëzim për të devotshmit, të cilët e besojnë të fshehtën, e kryejnë faljen dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne.” (El-Bekare: 1-3).

Besimi në engjëj ka pasoja të mëdha në jetën e njeriut, nga të cilat janë:

- Qëndrueshmëria në rrugën e All-llahut xh.sh., ngase ai i cili me plotë zemër e ndien ekzististimin e engjëjve - ushtarët e All-llahut xh.sh., dhe beson se ata përcjellin çdo lëvizje dhe çdo fjalë të tij, dhe se janë të pranishëm në çdo situatë të tij, do të turpërohet nga All-llahu xh.sh. dhe nga ushtarët e tij, e nuk do ti kundërvihet urdhrin të Tij e as që do të jetë i padëgjueshëm ndaj Tij, as haptazi as fshehurazi. Sepse si mund t'i lejojë vetes diç të tillë duke qenë i vetëdijshëm se të gjitha shihen, kundrohen dhe shënohen.

- Durueshmëria dhe vazhdimi i xhihadit pa pikëllim, por duke ndier kënaqësi dhe qetësi. Këto domethënie janë fuqimisht të lidhura me besimin në engjëj dhe në atë që na ka informuar All-llahu xh.sh. përkritazi me ta. Prandaj, njeriu (besimtari) kur të gjendet në shoqërinë e atyre të cilët e kanë devijuar rrugën e drejtë, me të cilët sundon xhahilijeti dhe bëhet i huaj në atdheun e vet, ndër të afërmit të vet dhe ndër popullin e vet, i përqeshur, i nënçmuar dhe i penguar në përlulshmërinë e tij ndaj All-llahut xh.sh. dhe në qëndrueshmërinë në rrugën e Tij, nga ana e tyre, në gjendje të tillë besimtari i gjen vetes shokun dhe mikun, i cili e përcjellë, e shoqëron, i jep zemër, e nxitë të jetë i durueshëm dhe i ndihmon të marshojë rrugës së All-llahut xh.sh. Sepse, ushtria e All-llahut xh.sh. është me të, e adhuron All-llahun siç e adhurojnë edhe ata, aspiron kah

Krijuesi i qiejve dhe i Tokës sikurse edhe ata dhe i inkurajojnë hapat e tij dhe e ndihmojnë atë, duke ia përkujtuar të mirat që e presin tek Zoti i tij. Pra, ai nuk është i vetmuar në rrugë, por udhëton i shoqëruar në varganin e madh së bashku me shumë krijesa të All-llahut xh.sh., me engjëjt fisnik - të dërguarit e All-llahut xh.sh., - me qiejt dhe me Tokën. Pra, ai ka shumë shoqëri dhe mbështetje më të madhe sesa të tjerët. Kjo ndjenjë e sinqertë e bënë atë të durueshëm dhe të qetë, kështu që pengesat e njerëzve vetëm ia përforcojnë qëndrueshmërinë në xhihad.

Shih, o vëlla i dashur, se sa shumë na ka shpërblyer All-llahu xh.sh. me krijimin e engjëjve dhe me besimin në ta, që paraqet ndikim të madh në zemrat tona, në veprat tona dhe në korrektësinë e jetës sonë në këtë botë. E, imani në engjëj është njëkohësisht edhe vërtetimi i fjalëve të All-llahut xh.sh. dhe fjalëve të Pejgamberit të Tij besnik.

PJESA E TRETË BESIMI NË PEJGAMBERËT DHE LAJMËTARËT E ALL-LLAHUT XH.SH.

B

esimi vijues nga bazat e imanit, është edhe besimi në Pejgamberët e All-llahut xh.sh. Në këtë bazë bën pjesë besimi në të gjithë Pejgamberët dhe Lajmëtarët, të cilët i ka emërtua All-llahut xh.sh. në

Kur'an dhe besimi se All-llahu xh.sh. pos tyre, ka dërguar edhe Pejgamber të tjerë, numrin e të cilëve nuk e di askush, përveç All-llahu xh.sh. All-llahu xh.sh. thotë:

“Na, me të vërtetë, para teje kemi dërguar Pejgamberë dhe prej tyre disa t'i kemi treguar, e disa prej tyre nuk t'i kemi treguar.” (El-Mu'min: 78)

“... Nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues.” (Fatir: 24).

“Çdo popull ka pasur Pejgamber.” (Junus: 47).

PEJGAMBERËT DHE LAJMËTARËT⁸⁶

Disa alim konsiderojnë se pejgamber është ai, të cilit i është shpallur ligji i ri fetar (Sheriati), kurse Lajmëtar ai i cili është dërguar të vërtetë ligjin paraprak fetar.⁸⁷

86 Ferrëfytes është ai, të cilit i ka ardhur Shpallja nga All-llahu xh.sh., me urdhër që këtë t'ua kumtojë të tjerëve apo mos t'ua kumtojë. E, nëse nuk është i urdhëruar që këtë t'ua kumtojë të tjerëve, atëherë ky është Lajmëtar e jo Pejgamber. E, nëse është i urdhëruar që t'ua kumtojë të tjerëve, atëherë ai është edhe Pejgamber edhe Lajmëtar, andaj çdo Pejgamber është njëkohësisht edhe Lajmëtar, kurse Lajmëtari nuk është edhe Pejgamber. Shih: Sherhul 'akidetit-tahavijje, f. 167; Sherh Mulla 'Ali el-Kari fikhil ekber, f. 69.

87 Shih: Resulu ver risalet li dr. Sulejman el-Eshkar, f. 15. Ky këtë e bartë nga tefsiri i Alisiut.

Në Kur'an janë përmendur njëzet e pesë Pejgamberë dhe Lajmëtarë: Ademi, Nuhi, Salihu, Ibrahim, Hudi, Luti, Junusi, Ismaili, Is'haku, Ja'kubi, Jusufi, Ejjubi, Shu'ajbi, Musai, Haruni, Eljesani, Dhulkifli, Davudi, Zekerijjai, Sulejmani, Iljasi, Jahjai, Isai dhe Muhammedi, salevatullahi ve selamuhu 'alejhim exhme'in.

Tetëmbëdhjetë prej tyre janë përmendur në këto ajete:

“Këto janë argumentet Tona që ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij. E Ne e ngrisim në shkallë më të lartë kë të dojmë. Me të vërtetë, Zoti yt është i Plotdijshëm dhe i Gjithdijshëm. Na ia dhuruam atij (Ibrahimit) Is'hakun dhe Ja'kubin. Të dy këta i kemi udhëzuar në rrugë të drejtë. Dhe Nuhin e patëm udhëzuar më parë në rrugë të drejtë - dhe nga pasardhësit e tij: Davudin, Sulejmanin, Ejjubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. - Dhe kështu Ne i shpërblejmë ata të cilët bëjnë vepra të mira - dhe Zekerijjain, Jahjain, Isain, Iljasin - të gjithë këta kanë qenë nga njerëzit të mirë; dhe Ismailin, Eljesan, Junusin dhe Lutin - të gjithë këta i veçuam nga të tjerët; edhe disa nga prindërit e tyre, nga pasardhësit e tyre dhe nga vëllezërit e tyre - i kemi zgjedhur ata dhe i kemi udhëzuar në rrugë të drejtë.” (El-En'am: 83-87).

E të tjerët përmenden në vende të ndryshme të Kur'anit:

“Ja dërguam (popullit) Adit, vëllain e tyre - Hudin.” (El-A'raf: 65).

“Dhe (Na, ia dërguam popullit) Themudit - vëllain e tyre - Salihun.” (El-A'raf: 73; Hud: 61).

“Dhe Na (ia dërguam) popullit të Medjenit, vëllain e tyre - Shuajbin.” (El-A'raf: 85; Hud: 84).

“All-llahu e zgjodhi Ademin, Nuhin.” (Ali Imran: 33).

“Dhe (kujtoje) Ismailin, Idrisin dhe Dhulkiflin! Të gjithë këta kanë qenë të durueshëm.” (El-Enbija’: 85).

“Muhammedi është Pejgamber i All-llahut. E, ata që janë me të (shokët e tij) janë të ashpër ndaj mohuesve, e të mëshirshëm ndërmjet veti.” (El-Fet’h: 29).

Pra, duhet të besojmë se të gjithë të përmendurit kanë qenë Pejgamberë apo Lajmëtar, çdo njëri prej tyre veç e veç. Kështu që nëse dikush do të jetë i pyetur për cilindo qoftë prej tyre, nuk do ta mohojë pejgamberllëkun apo ferrëfimin e tyre. E, ai i cilin mohon pejgamberllëkun e cilitdo qoftë prej tyre apo shpalljen e tij, ai është jobesimtar.⁸⁸

Për sa i përket Pejgamberëve dhe Lajmëtarëve, të cilët Kur’ani nuk i ka përmendur personalisht, jemi të obliguar që atyre t’u besojmë përgjithësisht. Dhe ne nuk kemi të drejtë të konfirmojmë se cilitdo prej njerëzve i ka zbritur Shpallja, po qe se nuk është i përmendur në mesin e Pejgamberëve dhe Lajmëtarëve, apo nëse për këtë nuk na ka informuar Pejgamberi s. a. v. s

88 Përpos që për njeriun e paarsimuar (i cili nuk e di këtë) nuk mund të thuhet se është jobesimtar përdërisa nuk i shpjegohet kjo, e të din se ç’flet. Sherhul Bejhuri ‘alel xhevher.

PEJGAMBERËT MË TË ZGJEDHUR (ULUL‘AZM)⁸⁹

Një numër i madh i alimëve, në grupin e Pejgamberëve më të zgjedhur, i njehësojnë pesë prej tyre: Muhammedin, Ibrahimin, Musain, Nuhin dhe Isain ‘alejhim efdalus salati ves selam.⁹⁰ All-llahu xh.sh. i permendë këta në këtë ajet:

“(Kujtoje ti o Muhammed) kur nga Pejgamberët Ne morëm zotimin, edhe prej teje, edhe prej Nuhit, edhe prej Ibrahimit, edhe prej Musait, edhe prej Isait, të birit të Merjemës. Ne, prej tyre kemi marrë zotimin e fortë.” (El-Ahzab: 7)

PËRMBAJTJA E SHPALLJES

Jemi të obliguar të besojmë se All-llahu xh.sh. u ka dërguar njerëzve Pejgamberët e Vet, për t’i sihariqar ata dhe për t’ua tërheq vërejtjen; për t’i sihariqar me kënaqësinë e All-llahut xh.sh., me

89 Në bazat gjuhësore ‘Azm do të thotë mundim, përpjekje. Shih: El-Misbahul munir. Në Kur’an përmendet se sabri dhe takvaja janë veçoritë qenësore të ‘azmit. All-llahu xh.sh. thotë: ”... Nëse jeni durimtarë dhe i druani All-llahut, me të vërtetë, ajo është vendosmëri (‘azm)(e madhe) në vepër.” (Ali Imran: 186).”E, ti bëhu i durueshëm (o Muhammed!) ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje Pejgamberët e tjerë.” El-Ahkaf: 35).”Ne, madje - edhe Ademit që në fillim i patëm urdhëruar, por ai harroi dhe nuk u tregua i vendosur.” (Ta Ha: 115).

90 El-Esiletu vel exhvibetul usulujje, f. 22; Sherhul ‘akidetit tahavijje, f. 349.

shpërblim dhe me Xhennet - nëse i besojnë Atij dhe Pejgamberëve të Tij dhe nëse i nënshtrohen Atij. E, t'ua tërheqin vërejtjen për hidhërimin e All-llahut xh.sh. nëse bëhen jobesimtarë dhe të padëgjueshëm. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ne ua dërguam Pejgamberët vetëm si sihariques dhe qortues. Pra kushdo që beson dhe bënë vepra të mira, mos të frikësohet e as nuk do të pikëllohen. Për ata që përgënjeshtrojnë argumentet Tona, ata do t'i godet dënimi për mëkatet e bëra.” (El-En'am: 48-49).

Jemi të obliguar të besojmë se All-llahu xh.sh. i ka dërguar të gjithë Pejgamberët për realizimin e qëllimit qenësor, të adhurohet vetëm All-llahu xh.sh. dhe të rivendoset ligji i Tij - të besuarit në All-llahun xh.sh. si të Vetmin Krijues, Të Vetmit që i bëhet ibadet dhe të Vetmit që i përkasin të gjithë emrat e bukur dhe të gjitha cilësitë e përsosmërisë. All-llahu xh.sh. thotë:

“Na, nuk kemi dërguar asnjë Pejgamber para teje e të mos ia kemi shpallur atij se: “Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Meje, andaj adhuromëni Mua!” (El-Enbija': 25).

“Ai ju ka urdhëruar nga feja, atë që ia ka urdhëruar Nuhit dhe atë që ta shpallëm ty, dhe me atë që e urdhëruam Ibrahimin, Musain dhe Isain: “Predikoni fenë e drejtë dhe mos u përçani në të!...” (Esh-Shura: 13).

“Na çdo populli i kemi dërguar nga një Pejgamber. (Ata u thonin atyre): “Adhurone All-llahun e shmanguni idhujve!” (En-Nahël: 36).

Jemi të obliguar t'u bindemi atyre dhe të mos punojmë në kundërshtim me urdhrat e tyre, ngase të bindurit ndaj tyre është pjesë e të bindurit ndaj All-llahut xh.sh. All-llahu xh.sh. thotë:

“Kush i bindet Pejgamberit, ai i është bindur All-llahut.” (En-Nisa’: 80).

“Dhe ne kemi dërguar Pejgamber vetëm me qëllim që njerëzit, me lejen e All-llahut, t’u përuhlen atyre...” (En-Nisa’: 64).

Jemi të obliguar të besojmë se ata janë krijesa më të përkryera edhe për nga dijenia edhe për nga veprat, se janë më të sinqertit dhe se janë më të përsosurit sipas edukimit dhe sjelljes së tyre, dhe se All-llahu xh.sh. i ka dekoruar ata mbi të gjitha krijesat e tjera, me veçori çfarë nuk i posedon askush tjetër pos tyre.

Jemi të obliguar të besojmë se, All-llahu xh.sh. i ka mbrojtur ata dhe i ka larguar nga gënjeshtria, mashtrimi, të fshehurit dhe nga të gjitha të metat e tjera, përkitazi me kumtimin e Shpalljes, dhe nga të gjitha mëkatet e mundshme.⁹¹ Mirëpo, ngandonjëherë është e mundur të bëjnë ndonjë lëshim apo gabim të vogël, që nuk ka rëndësi për shkallën e tyre të lartë, siç i ka ndodhur Ademit a.s. kur e pat ngrënë frytën nga pema të cilin e kishte të ndaluar, pasi që për, një çast, e kishte harrua ndalesën.⁹² Por All-llahu xh.sh. ata nuk i lë në gabim, ngase ua mundëson që menjëherë të pendohen.

91 El-fikhul-ekber ve sherhuhu li Mulla ‘Ali el-Kari, f. 65. Më gjerësisht mbi pagabueshmërinë e Pejgamberëve shih: Kitabur-rusul ver-risalet lid dr. Sulejman el-Eshkar, f. 97-112.

92 El-fikhul ekber li Ebi Hanifete ve sherhahu li Mulla ‘Ali el-Kari, f. 57; Ve Sherhul akaid en nefise, f. 467; Ver rusul ver risalet, f. 107.

Gjithashtu jemi të obliguar të besojmë se të gjithë Pejgamberët kanë qenë njerëz - meshkuj. Nuk kanë qenë engjëj, e as që All-llahu xh.sh. për Pejgamber ka dërguar femër⁹³ All-llahu xh.sh. thotë:

“Edhe para teje kemi dërguar vetëm njerëz, të cilëve u kemi shpallur (ashtu si ty).” (El-Enbija’: 7).

Besojmë se All-llahu xh.sh. nuk u ka dhuruar atyre kurrfarë cilësishë mbinatyrore, por i ka zgjedhur nga mesi i njerëzve, të cilët hanë dhe pinë, ecin rrugëve, flejnë, rrinë ulur dhe qeshen. Kanë gra dhe fëmijë, u kanosen mynxyra të ndryshme, i arrinë dora e dhunuesve dhe u ndodhin persekutime dhe trusni. Vdesin sikurse edhe njerëzit e tjerë, e ndodhë që mdokush prej tyre te jetë i mbytur në mënyrë të padrejtë. Ndjejnë dhembje dhe i godet sëmundja, si dhe përjetojnë çdo gjë tjetër që zakonisht u ndodhë njerëzve, e që nuk bie në mospajtim me pozitën e lartë të autoritetit në mesin e njerëzve. Në këtë na udhëzojnë shumë ajete kur’anore:

“Muhammedi është vetëm Pejgamber, e edhe para tij ka pasur Pejgamberë. E, nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa? Kushdo që kthehet prapa (në fe të gabuar) nuk i bënë kurrfarë dëmi All-llahut. Se, All-llahu do t’i shpërblejë mirënjohësit.” (Ali Imran: 144).

“E, Na - edhe para teje kemi dërguar vetëm Pejgamberë, të cilët hanin ushqimin dhe shetisnin nëpër tregje...” (El-Furkan: 20).

93 Ulemaja islame janë të një mendimi se të gjithë Pejgamberët kanë qenë njerëz - meshkuj dhe se All-llahu xh.sh. nuk e ka obliguar kurrnjë femër të kumtojë Shpalljen e Tij. Përkitazi me këtë Kur’ani flet qartë. Mirëpo, një pjesë e ulemasë konsideron se All-llahu xh.sh. disa femra i ka prirur me shkallën nubuvete, siç është Merjemja. Prej atyre që përkrahin këtë mendim janë: Ebul Hasan el-Esh’ariu, Kurtubi dhe Ibnul Hazmi. Shih: El-rusul ver risalet, f. 86.

“Na, me të vërtetë, edhe para teje kemi dërguar Pejgamberë dhe u kemi dhënë gra dhe pasardhës...” (Er-Ra’d: 38).

“Mesihu - i biri i Merjemës, është vetëm Pejgamber, - edhe para tij kanë kaluar Pejgamberë. Nëna e tij kurdoherë ka qenë e drejtë. Që të dy ngrënin ushqim...” (El-Maide: 75).

Pejgamberi i All-llahut ka thënë: “Por, unë agjëroj dhe ha, falem dhe flej, dhe bëj jetë bashkëshortore!”⁹⁴ Ngjante që Pejgamberi i All-llahut të sëmuhej dhe të ndjente dhembje, ndiente uri, etje, hidhërohej, pezmatohet, lodhej dhe të ngjashëm me këtë, ku nuk ekziston kurrfarë e mete e vërtetë.⁹⁵

Ne besojmë se, Pejgamberët nuk posedojnë asgjë nga cilësitë hyjnore, se nuk ndikojnë në lëvizjet në Kozmos, e as që mund ta ndihmojnë apo ta dëmtojnë dikë, se nuk kanë ndikim në vullnetin e All-llahut xh.sh., e as që e dinë gajbin (fshehtësinë), përveç atë që i ka informuar All-llahu xh.sh. All-llahu xh.sh. thotë:

“Thuaj: “Unë nuk mund t’i sjellë vetes as dobi as dëm, përveç atë që don All-llahu. E sikur t’i dija fshehtësitë, do t’i shumëzoja të mirat dhe nuk do të më prekte asnjë e keqe. Unë jam vetëm paralajmërues dhe sihariques për njerëzit që besojnë.” (El-A’raf: 188).

94 Transmeton Buhariu në fillim të kapitlinës mbi martesën.

95 Kjo duket qartë gjatë studimit të jetëshkrimit të Pejgamberit s. a.s. v. Për vetitë dhe virtytet e tij janë shkruar libra të veçanta dhe jashtëzakonisht të vlefshme. Shih p.sh.: ”Esh shemalun nebevijje” nga Tirmidhiu, dhe”El vefa bi ahvalil Mustafa” nga Ibën Dxezviu.

“Vetëm Ai i di fshehtësitë dhe Ai nuk ia zbulon fshehtësitë e Veta askujt; përveç atij të cilin Ai e ka zgjedhur për ta dërguar (Pejgamber).” (El-Xhinn: 26-27).

Mirëpo, ata All-llahu xh.sh. i ka prirur me aftësi të posaçme dhe me virtyte dhe cilësi të cilat i kanë bërë të gatitur për ta pranuar Shpalljen dhe barrën e saj, në mënyrë që t’u jenë shembuj njerëzve të tjerë dhe shembuj të cilët do t’i ndjekin ata përkritazi me çështjet e fesë dhe mënyrës së jetesës në këtë botë. Prandaj, jemi të obliguar të besojmë se Pejgamberët janë të mbrojtur nga çfarëdo e mete, e cila do ta gjymtonte besimin e tyre dhe bindshmërinë ndaj All-llahut xh.sh., apo aftësinë e tyre që ta dorëzojnë Shpalljen, e t’ua kumtojnë njerëzve.⁹⁶ All-llahu xh.sh. për ta thotë:

“Këta janë ata që u kemi dhënë libër, dijeni të hollë dhe pejgamberllëk. E, nëse ata (banorët e Mekës) i mohojnë këto, Na do t’ia besojmë një populli tjetër që nuk di t’i mohojë. Këta janë ata (Pejgamberët e përmendur), të cilët All-llahu i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, andaj edhe ti (o Muhammed!) ndiqe rrugën e tyre.” (El-En’am: 89-90).

Pra, All-llahu xh.sh. flet për besnikërinë e tyre, për sinqeritetin, për mendjemprehtësinë, për konsekuencën në dorëzimin e Shpalljes dhe për cilësitë e tjera, të cilat janë të nevojshme për kryerjen e obligimeve dhe detyrave të parashtruara. Prandaj All-llahu xh.sh. thotë për Ismailin a.s.:

“Dhe përmende (o Muhammed!) në Libër (Kur’an), Ismailin! Me të vërtetë, Ai plotësonte premtimin e dhënë dhe ka qenë Pejgamber, Lajmëtar.” (Merjem: 54).

E për Ibrahimin a.s. thotë:

96 Sherhun-Nevevi ala sahih Muslim, 3: 53.

“(O Muhamed!) Përmende në Libër (Kur’an) Ibrahimin! Ai ka qenë (njeri) i sinqertë, dhe Lajmëtar.” (Merjem: 41).

Edhe në shumë ajete të tjera All-llahu xh.sh. dëshmon për sinqeritetin dhe të udhëzuarit e Pejgamberëve a.s.

Jemi të obliguar të besojmë se All-llahu xh.sh. i ka ndihmuar ata me mu’xhize (vepra të jashtëzakonshme të cilat i bënë All-llahu xh.sh. me anë të Pejgamberëve të Vet, të cilët me to ata i provokojnë njerëzit që të bëjnë diç të ngjashme nëse nuk i besojnë atyre.)⁹⁷ të llojlojshme dhe me argumente të qarta të cilat udhëzojnë në vërtetësinë e asaj me çka kanë ardhur nga Zoti i tyre. Ne u besojmë të gjitha mu’xhizeve të cilat janë përmendur në Kur’an dhe në hadithet autentike, dhe me këto veçori janë të barabartë të gjithë Pejgamberët që i ka zgjedhur All-llahu xh.sh. Mirëpo, edhe pranë kësaj barabarësie, ne besojmë se All-llahu xh.sh. disa prej tyre i ka dekoruar mbi të tjerët. All-llahu xh.sh. thotë:

“Disa nga ata Pejgamberë i kemi dekoruar më shumë se disa të tjerë. Me disa prej tyre ka folë (biseduar) All-llahu, kurse disa prej tyre i ka lartësuar në shkallë të lartë. E Isait, birit të Merjemës, i kemi dhënë argumente të qarta dhe e kemi forcuar me Xhibrilin.” (El-Bekare: 253).

Dhe besojmë se më i zgjedhuri ndër ta, dhe më i zgjedhuri prej të gjitha krijesave, është Pejgamberi Muhammed bin Abdull-llah, s.a.v.s. Disa nga selefët (gjenerata e parë e myslimanëve) fjalët e All-llahut xh.sh.”kurse disa prej tyre i ka lartësuar në shkallë të lartë” i komentojnë se kjo

97 Lume’ul edille li Imamil haremejn, f. 110.

ka të bëj me Pejgamberin tonë, Muhammedin a.s.98 Përkitazi me këtë ekzistojnë shumë hadithe, ndër të cilët është edhe hadithi i transmetuar nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Unë jam kryepar i të gjithë njerëzve në Ditën e Kiametit, i pari do të dal nga kaburi (varri) dhe i pari që do të bëjë shefa’at (ndërmjetësim) dhe shefa’ati im do të pranohet.”99 Vasil bin Eska’ r.a. transmeton: “E kam dëgjuar Pejgamberin e All-llahut që ka thënë: “All-llahu xh.sh. i ka zgjedhur kenanët prej bijve të Ismailit, kurejshitët prej ken'anëve, Benu Hashimët prej kurejshitëve, e mua më ka zgjedhur prej Benu Hashimëve.”100 Hadithet e përmendura dhe hadithet e tjera lidhur me këtë temë, qartazi tregojnë se Muhammed bin Abdull-llahu, a.s. është më i miri nga të gjitha krijesat.101

98 Tefsirut-Taberi, 5: 378.

99 Transmeton imam Muslimi dhe të tjerët. Shih: Muslim bishërhin Nevevi, 15: 37-38.

100 Transmetojnë imam Muslimi dhe Tirmidhiu, të cilët thonë se hadithi është hasen sahih. Shih: Sahih Muslim bishërhin Nevevi, 5: 36; Sunenet-Tirmidhi bishërh Ibnil Arebi el Maliki, 13: 102-103.

101 E, për sa i përket hadithit në të cilin Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: ”Mos më konsideroni më të mirë se Musain”, ky është hadith autentik (muttefekun alejhi), e përgjigja në këtë do të ishte: All-llahu xh.sh. ka ndaluar që kjo të bëhet për inat të dikujt (hebrejëve) apo që me këtë të mos theksohet dobësia e Musait. Sepse, hadithi ka shkakun e vet i cili aludon në këtë. Njëri prej hebrejve ka thënë: ”Jo, pasha Musain, të cilin All-llahu e ka zgjedhur mbi të gjithë njerëzit!” Me këtë rast njëri nga myslimanët ia flakëron një shuplakë dhe i thotë: ”A do të flasësh diç të tillë, e Pejgamberi i All-llahut është mes nesh.” Hebreu vajti tek Pejgamberi s.a.v.s. dhe u ankua për shuplakën e myslimanit. Me këtë rast Pejgamberi s.a.v.s. e ka thënë këtë hadith. Rasti i njëjtë është edhe me hadithin”Mos bëni dallime mes Pejgamberëve të All-llahut”. Shih: Sahih Muslim bishërhin Nevevi, 15: 37, 120; Sherhul Tahavijje, f. 170-171; Er-resulu ver risalet, f. 223.

BESIMI NË MUHAMMEDIN A. S

Jemi të obliguar të besojmë se Muhammed bin Abdull-llahu, a.s. është Pejgamber i All-llahut dhe rob i zgjedhur i Tij. Se kur nuk i ka adhuruar idhujt, se kurrënjëherë nuk i ka bërë shirk All-llahut xh.sh. dhe se kurrë nuk ka bërë ndonjë mëkat, qoftë të vogël e as të madh.¹⁰² Dhe besojmë se ai është Pejgamberi i fundit, ngase për këtë na flet Kur’ani dhe hadithet autentike. All-llahu xh.sh. thotë në Kur’an:

“... por është Pejgamber i All-llahut dhe vulë e Pejgamberëve.” (El-Ahzab: 40).

E Pejgamberi i All-llahut thotë: “Shembulli im dhe i Pejgamberëve të tjerë është si shembulli i një njeriu i cili e ka ndërtuar shtëpinë, pastaj e ka përfunduar dhe e ka stolisur mirë, pos një tjegulle që s’e ka vuar në një qoshe. Njerëzit e vizitonin shtëpinë dhe, të mrekulluar me të, thoshin: “Sikur ta vënte edhe këtë tjegull.” “Unë jam ajo tjegull”, tha,”unë jam Pejgamber i fundit.”¹⁰³ Në një hadith tjetër Resulull-llahu s.a.v.s. thotë: “Unë jam Muhammedi, unë jam Ahmedi, unë jam Mahiu me të cilin fshihet kufri, unë jam Hashir pas të cilit do të ringjallen njerëzit e tjerë dhe unë jam Akib, e Akib është ai pas të cilit më nuk do të ketë Pejgamberë.”¹⁰⁴ Ne, fuqimisht besojmë se më nuk do të ketë Pejgamber pas Muhammedit a.s. dhe se është gënjeshtar secili që thotë për vete se është Pejgamber. Pejgamberi i All-llahut thotë: “Nuk do të vijë Dita e Kiametit përderisa

102 RI-fikhul ekber me’a sherhihi li Mulla ‘Ali el-Kari, f. 59-61.

103 Hadithin e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi (muttefekun) e ky është shënim i Muslimit. Shih: Sahih Muslim bishërhin Nevevi, 15: 15.

104 Muttefekun ‘alejhi, e ky është shënim i Muslimit. Shih: Sahih Muslim bishërhin Nevevi, 15: 104..

nuk paraqiten dexhshalët (rrenacakët), numri i të cilëve do të jetë gjithsej tridhjetë dhe çdonjëri prej tyre do të pohojë se është i dërguari i All-llahut.”¹⁰⁵ Gjithashtu jemi të obliguar të besojmë se Muhammedi a.s. është imam (prijës) i muttekijëve (besimtarëve të vërtetë), i cili është shembull i çdo mirësie. Vetëm ai është i denjë që ta marrim si shembull dhe askush tjetër. All-llahu xh.sh., thotë:

“Thuaj (o Muhammed!): “Nëse ju e doni All-llahun, eni pas meje, atëherë All-llahu ju do juve dhe ju falë mëkatet tuaja!...” (Ali ‘Imran: 31).

“Betohem në Zotin tënd, se ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, përderisa mos të marrin ty për arbitër, për ato konflikte që ekzistojnë ndërmjet tyre, e pastaj të mos ndiejnë kurrfarë dëshprimi ndaj gjyqimit tënd dhe të të binden ty plotësisht” (En-Nisa’: 65).

Gjithashtu besojmë se Muhammedi a.s. është i dashuri i All-llahut xh.sh. dhe se është në shkallën më të lartë të dashurisë së All-llahut ndaj dikujt, e kjo shkallë quhet hulle (shkallë e veçantë e miqësisë dhe dashurisë). Pejgamberi i All-llahut ka thënë: “Sikur të zgjedhja për vete ndonjë halil (mik - dost më i ngushtë), do ta zgjedhja Ebu Bekrin. Por ai është vëllai im dhe shoku im. E All-llahu xh.sh. si halil të Vetin e ka zgjedhur shokun tuaj (duke treguar në vete)”¹⁰⁶

Jemi të obliguar të besojmë se ai është i dërguar i të gjithë xhinnëve dhe njerëzve me udhëzimin dhe me të vërtetën. All-llahu xh.sh. i transmeton fjalët e xhinnëve në Kur’an:

105 Transmeton Muslimi. Shih: Muhtesar Sahih Muslim, 2: 295.

106 Sahih Muslim bishërhin Nevevi, 15: 152.

“O populli ynë, përgjigjuni ju grishtarit të All-llahut dhe besoni Atij! Ai do t’ua falë disa mëkate tuaja dhe do t’ju shpëtojë prej dënimit të dhembshëm.” (El-Ahkaf: 31).

Se ai i është dërguar tërë njerëzimit, e vërtetojnë këto ajete:

“Na të kemi dërguar ty për tërë njerëzimin - sihariques dhe paralajmërues, por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Sebe’: 28).

“Thuaj: “O njerëz, unë jam Pejgamber i All-llahut për të gjithë ju...” (El-A’raf: 158).

“I lartësuar është Ai, që i ka shpallur Kur’anin (i cili ndanë të vërtetën prej të pavërtetës) robit të Vet (Muhammedit), që të jetë paralajmërues për të gjithë botët.” (El-Furkan: 1).

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Unë jam i dekoruar mbi Pejgamberët e tjerë me gjashtë gjëra: më është dhënë aftësia e të shprehurit të veçantë, jam i ndihmuar me frikë, më është lejuar preja (plaçka) e luftës, e gjithë toka më është bërë mesxhid dhe e pastër (për kryerjen e namazit në çdo vend), unë i jam dërguar të gjitha krijesave dhe me mua ka përfunduar pejgamberllëku”.¹⁰⁷ Komentuesi i Tahaviut thotë: “Se Muhammedi a.s. i është dërguar tërë njerëzimit, bënë pjesë në gjërat domosdo të njohura në Islam.”¹⁰⁸ Ne jemi të obliguar që dashurinë ndaj Pejgamberit s.a.v.s. ta vëmë para dashurisë ndaj prindërve, fëmijëve dhe vetvetes sonë.¹⁰⁹ Enesi r.a.

107 Muttefekun ‘alejhi, e ky është shënim i Muslimit. Shih: Sahih Muslim bisherin Nevevi, 5: 5; Ibnul Xhevi, në pjesën e fundit të vëllimit të parë të librit të vet (El vafa bi ahbaril Mustafa), përmend shumë gjëra me të cilat është dekoruar Muhammedi a.s. mbi Pejgamberët dhe Lajmëtarët e tjerë.

108 Shehrul akidetit-tahavijje, f. 178.

109 El vafa bi ahvalil Mustafa.

transmeton se Pejgamberi i All-llahut ka thënë: “Askush prej jush nuk do të jetë besimtar, përderisa nuk i jam atij më i rëndësishëm se prindërit e tij, fëmijët e tij dhe të gjithë njerëzit e tjerë.”¹¹⁰ E, Abdull-llah bin Hishami transmeton: “Kemi qenë tek Pejgamberi i All-llahut kur e mbante Umerin përdore, e Umeri i tha: “O Pejgamber i All-llahut, me të vërtetë, ti më je më i dashur se të gjithë të tjerët përveç vetvetes sime.” Atëherë Resulull-llahu s.a.v.s. tha: “Jo, pasha All-llahun, përderisa nuk të të jam më i dashur se vetvetja yte.” Umeri tha: “Tash, pasha All-llahun, me je më i dashur edhe se vetvetja ime.” Pejgamberi i All-llahut tha: “Tash, o Umer.”¹¹¹

Gjithashtu, jemi të obliguar të besojmë se All-llahu xh.sh. e ka përkrahur atë me mu'xhize, të cilat në mënyrë të padyshimtë argumentojnë vërtetësinë e tërë asaj me çka ka ardhur ai. Dhe se Kur'anit madhështor është mu'xhizeja e tij me të cilën e ka provokuar tërë njerëzimin, por askush nuk ka mundur të bëjë diç të ngjashme me Kur'anin, madje as një pjesë të ngjashme me atë të Kur'anit. All-llahu xh.sh. thotë:

“Nëse dyshoni ju në atë (Kur'anin) që ia kemi dërguar robit Tonë (Muhammedit), atëherë hartone një sure të ngjashme si atë që ia kemi shpallur atij, dhe nëse jeni të drejtë thirrni dëshmitarët tuaj, (hyjnitë që i adhuron), përveç All-llahut. Nëse nuk mundeni, e kurrsesi nuk do të mundeni (me i bë shembull Kur'anit), atëherë ruajuni zjarrit, lëndë djegëse e të cilit do të jenë njerëzit dhe gurët. Ai është përgatitur t'i ndëshkojë mohuesit.” (El-Bekare: 23-24).

110 Muttefekun 'alejhi. Shih: Sahihu-l-Buhari, 1: 39; Sahih Muslim bishërhin Nevevi, 2: 15.

111 Transmeton Buhariu në kaptinën mbi imanin dhe nezrin (zotimin).

Dhe besojmë se All-llahu xh.sh. e ka përkrahur me mu'xhize ndijore, të cilat janë përmendur në hadithe autentike, siç është: çarja e hënës, thirrja e selamit nga ana e gurëve, burimi i ujit nga gishtërinjtë e tij, ngopja e shumë njerëzve me shumë pak ushqim, lajmërimi i deles së pjekur se është e helmuar (kur hebrenjtë patën tentuar ta helmojnë atë), reja e cila gjithnjë i bënte hije para pejgamberllëkut, pastaj rasti i Ebu Xhehlit dhe gurit, me të cilin pat tentuar ta godasë Pejgamberin s.a.v.s. në kokë, rasti i deles Ummu Ma'bed, kur me dorën e vet e pat fërkuar gjirin e saj, gjuajtja e pluhurit në fytyrat e mushrikëve dhe goditja në sytë e tyre, paralajmërimi për gjërat që do të ndodhin, të cilat edhe janë realizuar ashtu siç kishte thënë, plotësimi i lutjes së tij nga ana e All-llahut xh.sh., mbrojtja e tij nga vrasja, dhe shumë gjëra të tjera, për të cilat janë shkruar libra dhe vepra voluminoze.¹¹² Për mu'xhizet e tij ndijore na flasin shumë hadithe, ndërmjet të cilave ka edhe muttevetir hadithe, e shumë prej tyre janë meshhur (shumë të njohura). Këto hadithe tërësisht japin dituri të padyshimtë (el ilmul jekin) se këto ngjarje kanë ndodhur me të vërtetë, dhe se Muhammedi a.s. është me të vërtetë Pejgamber i All-llahut.¹¹³ Siç besojmë edhe në atë se All-

112 Këto dhe mu'xhizet e tjera, të cilat provojnë pejgamberllëkun e Muhammedit a.s., do t'i gjeni në shumë vepra të sireve (jetëshkrime të Muhammedit a.s.) dhe në hadithe. Buhariu në Sahihun e vet e ka emërtuar një kaptinë të tërë me "Kaptina e shenjave të pejgamberllëkut". Të njëjtën gjë e ka bërë edhe Muslim bin Haxhxhaxh el-Kushejri në "Kaptinën mbi mu'xhizet e Resulull-llahut s.a.v.s." Disa alim kanë shkruar vepra individuale mbi këtë temë, siç është "Delailin nubuvveh" nga imam Ebi Nu'ajm Ahmed bin Abdull-llah el Ashshani, i cili e ka shkruar veprën e famshme "Hiljetul evlija"; "Plamun nubuvveh" nga Ebi Hasan bin Muhammed Meverdi; "En nubuvveh" nga El-Bejheki dhe "El vefa bi ahvalil Mustafa" nga bin Xhevzi.

113 El vefa bi ahvalil Mustafa, 1: 139.

llahu xh.sh. e ka përkrahur me argumente pakontestuese dhe me shenja të qarta, të cilat pasqyrohen në cilësitë e tij dhe në virtytet morale të tij.

Besojmë se All-llahu xh.sh. i ka dhuruar asi konstruksioni dhe pamje trupore, saqë çdo njeri mendjehollë nga pamja e tij mund të kuptoj se ka të bëjë me Pejgamberin dhe se është e vërtetë e tërë ajo që flet ai.¹¹⁴ E, sa të bukura janë fjalët e Hassan bin Thabitit r.a.: “Edhe sikur të mos posedonte shenja të qarta, pamja e tij tërësisht do ta thoshte këtë.”

Dhe besojmë se All-llahu xh.sh. ia ka dhuruar të gjitha virtytet morale të cilat i rekomandon Kur’ani, që provon vërtetësinë e tij dhe se All-llahu xh.sh. e ka përkrahur atë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Askush nuk ka dëgjuar asnjë gënjeshtër nga goja e tij, qoftë për ndonjë çështje të fesë, qoftë për çfarëdo çështje tjetër të jetës së tij, as para pejgamberllëkut, e as pas pejgamberllëkut. E, sikur t’i ndodhte atij çkado qoftë nga kjo, madje edhe vetëm një herë, armiqtë e tij do të bënin çmos për t’ua trumbetuar këtë edhe të tjerëve. Nuk ka bërë kurrnjë vepër të keqe apo të pahijshme, as para pejgamberllëkut, as pas pejgamberllëkut. E, as që ka ikur ndonjëherë prej cilitdo armik të tij pa marrë parasysh se në çfarë situatë të rrezikshme e të vështirë gjendej, siç ka ndodhur në Betejën e Uhudit dhe në Betejën e Hendekut. Ka qenë tejet i mëshirshëm dhe shumë i kujdesshëm ndaj ummetit të tij, saqë edhe All-llahu xh.sh. i ka thënë që ta zbusë këtë:

“... e mos u shkatërro ti për humbjen e tyre!” (Fatir: 8).

“Nga gjiu juaj u erdhi një Pejgamber. Atij i vjen rëndë për mëkatet që bëni ju, por ai përpiqet që ju të shkoni rrugës së drejtë, dhe ndaj besimtarëve është i butë dhe mëshirues.” (Et-Tevbe: 128).

114 Isarul hakk ‘alel halk, f. 80.

Ka qenë në nivelin më të lartë të fisnikërisë dhe të dorëdhënësisë, nuk ishte lakmues për këtë botë, kënaqej me pak, nuk kursente asgjë (nuk ka pasur kursim). Ka qenë elokuent i jashtëzakonshëm dhe i prirur me fuqi të posaçme të shprehjes. Ishte shumë i butë dhe falte shumë. Nuk hidhërohej kurrë, pos për All-llahun xh.sh. Ishte modest ndaj besimtarëve, i devotshëm ndaj All-llahut xh.sh. dhe muxhahid në rrugën e Tij. I ka mbetur konsekuent cilësive dhe virtyteve të veta fisnike që nga fillimi i jetës së tij e gjer në vdekje. Assesi nuk është ndryshuar apo korrigjuar. Përkritazi me këtë All-llahu xh.sh. na flet në këtë ajet:

“Thuaj (o Muhammed!): “Unë prej jush nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi për të (Kur’anin), e as nuk jam nga ata që paraqiten të atillë (çfarë nuk janë).” (Sad: 86).

Është e sigurt se ai i cili paraqitet dhe dëshiron të tregohet i atillë çfarë nuk është në realitet, nuk mund të mbetet i tillë gjatë tërë jetës së tij. E Pejgamberin a.s. e kanë stolitur të gjitha cilësitë pozitive, çdonjëra në pikëarritjen e nivelit më të lartë të saj, e që nuk i është mundësuar askujt tjetër përveç atyre që i ka ruajtur All-llahu xh.sh. Kompozimi i të gjitha këtyre cilësive dhe i virtyteve në personalitetin e Pejgamberit s.a.v.s., gjithsesi është një nga argumentet më të mëdha të pejgamberllëkut të tij.¹¹⁵ Prandaj, gjejmë se një numër i madh i mendimtarëve, pasi që janë njoftuar me sjelljen dhe sinqeritetin e tij, dhe me të gjitha detajet e jetës së tij, kanë konkluduar se ai e flet të vërtetën. Ta përkujtojmë vetëm rastin e Hatixhes r.a., e cila e ka njohur mirë sinqeritetin dhe besnikërinë e Pejgamberit a.s., kur e pat informuar se i vie Shpallja, duke i thënë: “Unë frikohem për veten time”, e ajo ka thënë: “Jo, për Zotin, kurrsesi. All-llahu nuk të turpëron dhe nuk të braktisë kurrënjëherë, sepse ti i viziton të afërmit, i ndihmon bonjakët dhe ata që nuk

115 Isarul hakk ‘alel halk, f. 80.

janë të aftë, u jep të varfërve, je mikpritës dhe po u ndihmon atyre të cilët e mbrojnë të vërtetën.”¹¹⁶ Rasti i njëjtë është edhe me Herakleun - mbretin e bizantinëve. Kur Pejgamberi s.a.v.s. ia pat dërguar një mesazh me anë të cilit e thërriste në Islam, ai kishte kërkuar njërin nga arabët, të cilët atëbotë gjendeshin në mbretërinë e tij. Atëbotë Ebu Sufjani së bashku me disa kurejshitë të tjerë ishte në kalim e sipër për në Sham, e Herakleu e ftoi në pallatin e tij, ndërsa rreth tij ishin njerëzit më autoritativ të mbretërisë së tij, e thirri përkthyesin, e pastaj filloj të pyes për Pejgamberin s.a.v.s. Pasi që i dëgjon përgjigjet, ai nxjerrë konkluzionin e sigurt: se ajo që kishte dëgjuar për Muhammedin a.s. dhe për cilësitë e virtytet e tij, është argument i mjaftueshëm, se është e vërtetë ajo me çka ka ardhur dhe se ai është Pejgamber. Për shkak të rëndësisë së madhe të kësaj bisede, e cila është zhvilluar mes Herakleut dhe Ebu Sufjanit, ne do ta citojmë këtu në tërësi ashtu siç e transmeton muhaddissi më i njohur dhe emiri i të gjithë muhaddissëve Buhariu në Sahihun e vet. Në këtë hadith do të gjejmë shumë mësim dhe instrukcione, dhe argumentin se All-llahu xh.sh. e ka përkrahur të Dërguarin e Vet me dëshmi të qartë dhe me shenja të dukshme të vërtetësisë së tij, që pasqyrohet përmes moralit dhe sjelljes së tij gjatë jetës së tij, me gjithë Kur’anin dhe mu’xhizet e qarta.

Buhariu rahimehullahu te’ala thotë: “Na ka treguar Ebu-l-Jeman El-Hakem b. Nafiu, duke transmetuar nga Shu’ajbi, ky nga Zuhriu, ky nga Ubejdullah b. ‘Abdull-llah b. Utbe b. Harbi b. Mea’udi, këtij i ka thënë ‘Abdull-llah b. ‘Abbasi se e ka njoftuar Ebu Sufjani se Herakleu e kishte ftuar në rezidencën e tij së bashku me disa kurejshitë, që kishin ardhur në Sham për tregti, gjatë

116 Transmeton Buhariu. Shih: Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 1: 29.

periudhës së Marrëveshjes Paqësore të Hudejbijes, dhe vajtëm në Ilija' ku gjendej ai së bashku me njerëzit më autoritativ të Bizantit. E thirri përkthyesin e tha:

“Pyeti cili është më i afërt për nga origjina me atë njeri që po pretendon se është Pejgamber?”

Ebu Sufjani u përgjigj: “Unë jam më i afërmi i tij.”

Herakleu tha: “Ma afroni atë, e shokëve të tij thuani që të radhiten prapa tij.” Pastaj Herakleu i tha përkthyesit: “Këtë njeri këtu (Ebu Sufjanin) do ta pyes për atë njeri (Resulull-llahun a.s.), e nëse e fshehë të vërtetën, shokët e tij le të reagojnë.”

Ebu Sufjani tha: “Pasha Zotin, sikur të mos më vinte turp që prej meje të dëgjojnë gënjeshtër, unë do të gënjeja për të”, - tha Ebu Sufjani për vete, - pastaj pyetja e parë që ma shtroi ishte:

“Çfarë origjine ka ai në mesin tuaj?

“Ndër ne ai është me origjinë të ndershme”, - i thashë.

- Herakleu: “A ka folur ndonjëherë dikush prej jush fjalë të tilla para tij?”

- Ebu Sufjani: “Jo.”

- Herakleu: “A ka qenë ndokush prej etërve të tij mbret?”

- Ebu Sufjani: “Jo.”

- Herakleu: “A e pasojnë atë njerëzit e pasur apo njerëzit e varfër?”

- Ebu Sufjani: “Njerëzit e varfër.”

- Herakleu: “A është duke u shtuar numri i tyre apo duke u pakësuar?”
- Ebu Sufjani: “Duke u shtuar.”
- Herakleu: “A e lëshon ndonjëri prej tyre fenë e tij nga urrejtja ndaj saj pasi ta ketë pranuar atë?”
- Ebu Sufjani: “Jo.”
- Herakleu: “A e keni akuzuar për rrenë, para se të flasë këtë që është duke thënë tani?”
- Ebu Sufjani: “Jo.”
- Herakleu: “A është mashtrues?”
- Ebu Sufjani: “Jo - por që prej kur nuk jemi bashkë nuk e kemi të ditur se ç’është duke bërë
- Ebu Sufjani rrëfen: “Nuk munda të shtoj më asgjë tjetër, pas kësaj fjalie.”
- Herakleu: “A keni luftuar kundër tij?”
- Ebu Sufjani: “Po.”
- Herakleu: “Si ka qenë rezultati i luftës mes jush?”
- Ebu Sufjani: “Ndërmerrnim lufta mes veti, lufta garuese, herë fitonin ata, herë fitonim ne.”
- Herakleu: “Çka ju urdhëron?”

- Ebu Sufjani: “Na urdhëron të adhurojmë vetëm All-llahun dhe të mos i përshkruajmë shok Atij. Të braktisim atë që thonë prindërit tanë, ta kryejmë namazin, të jemi të sinqertë, të ndershëm dhe të kujdesshëm ndaj të afërmeve tanë.”

Pastaj Herakleu i tha përkthyesit: “Përktheja atij: Të pyeta për origjinën e tij, e ti më the se është me origjinë të ndershme ndërmjet jush. Kështu është me të gjithë Pejgamberët, ata zgjidhen nga familjet e ndershme. Të pyeta a ka folur dikush prej jush fjalë të tilla, para tij, ti the jo. Sikur të kishte folur ndokush fjalë të tilla para tij, kisha menduar se ky njeri është duke i imituar të tjerët. Të pyeta se a ka qenë ndokush prej të parëve të tij mbret, ti më the jo. Sikur të kishte qenë dikush prej të parëve të tij mbret, kisha menduar se qenka njeri i cili kërkon sundimin - pushtetin e të parëve të tij. Të pyeta se, a jeni duke e akuzuar për gënjeshtëri para se të thotë këtë që është duke thënë, ti më the jo, e unë e di se ai nuk ka mundur të jetë i sinqertë ndaj njerëzve, e rrenacak ndaj All-llahut. Të pyeta se, a janë duke iu përgjigjur thirrjes së tij paria e popullit apo shtresa e ulët (masa e gjerë) e tij, ti më the se është duke iu përgjigjur populli i thjeshtë dhe i pambrojtur, e zakonisht të tillë kanë qenë ithtarët e të gjithë Pejgamberëve. Të pyeta se, a janë duke u shtuar apo duke u pakësuar, e ti më the se numri i ithtarëve të Pejgamberit është duke u rritur. Kjo është zakonisht me besimin derisa shpallja të plotësohet tërësisht. Të pyeta se, a e ka lëshuar ndonjëri prej tyre fenë nga pakënaqësia ndaj saj pasi që e ka pranuar atë, ti më the se jo, kështu ndodh kur njerëzit e pranojnë besimin me gjithë zemër. Të pyeta se, a është mashtrues, ti më the se jo. Kjo është cilësi e të gjithë Pejgamberëve, ata kurrë nuk janë mashtrues. Pastaj të pyeta se, çka ju urdhëron të besoni, e ti më the se ju urdhëron të besoni All-llahun dhe të mos i përshkruani shok Atij, që do të thotë se ju ndalon t'i adhuroni idhujt. Pastaj ju urdhëron ta kryeni namazin, të jeni të sinqertë dhe të ndershëm, e nëse është kështu siç thua ti, atëherë ai së shpejti do të sundojë edhe

në këtë vend ku tani gjenden këmbët e mia. E kam ditur se ai do të paraqitet, por nuk e kam ditur se do të jetë njëri prej jush (arab). Sikur ta dija se do të mund të arrijë tek ai, mu tani do të nisesha në rrugë për tu takuar me të. E sikur të isha pranë tij, do t'ia kisha larë edhe këmbët.”¹¹⁷

PJESA E KATËRT BESIMI NË LIBRAT E ALL-LLAHUT XH.SH.

N

jë nga bazat e imanit është të besohen Librat e All-llahut xh.sh., të cilat ua ka shpallur Pejgamberëve të vet.

Ashtu siç All-llahu xh.sh. ia ka shpallur Kur’anin Muhammedit a.s., ashtu edhe Pejgamberëve të tjerë ua ka shpallur Librat e Veta.

Disa prej këtyre Librave All-llahu xh.sh. i ka përmendur në Kur’an:

1 - Tevratin, të cilin ia ka shpallur Musait a.s. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ne kemi dërguar Tevratin, në të cilin është udhëzimi dhe drita. Sipas tij - Pejgamberët, të cilit ishin të bindur e të ndershëm ndaj All-llahut i gjykonin hebrenjtë, por edhe të diturit dhe juristët,

117 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 1: 26-31.

gjykonin sipas asaj që është ruajtur nga Libri i All-llahut, e për të cilin ata dëshmonin (se është i vërtetë).” (El-Maide: 44).

2 - Inxhili, i cili i është shpallur Isait a.s. All-llahu xh.sh. thotë:

“Na dërguam në gjurmët e Pejgamberëve, Isain - të birin e Merjemës, vërtetues të Tevratit që e kanë para tyre. Dhe na ia dhamë atij Inxhilin, në të cilin ka udhëzim dhe dritë, vërtetues i Tevratit të shpallur para tij - udhërrëfim dhe këshillim për ata që i druajnë All-llahut.” (El-Maide: 46).

3 - Zeburi, i cili i është shpallur Davudit a.s. All-llahu xh.sh. thotë:

“... dhe Davudit i kemi dhënë Zeburin.” (El-Is’ra: 55).

4 - Suhufet (fletushkat), të cilat All-llahu xh.sh. ia ka shpallur Ibrahimit a.s. dhe Musait a.s. Për to All-llahu xh.sh. na informon në këto ajete:

“Vallë, a nuk është i lajmëruar ai - për atë që gjendet në fletët e Musait (në Tevrat) dhe të Ibrahimit: - i cili i plotësoi (obligimet) - që askush nuk do t’i bartë mëkatet e personit tjetër, dhe që njeriu do të ketë vetëm atë që është marrë me te (punuar atë) dhe që përpjekjet e tij pa dyshim do të shihen së shpejti, (dhe se) do të shpërblehet me shpërblim të plotë, dhe se te Zoti yt do të jetë kthimi.” (En-Nexhm: 36-42).

“Shpëtimin do ta arrijë ai që pastrohet (nga të këqijat) dhe që e përmend emrin e Zotit të vet dhe bënë namaz! Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, por, jeta tjetër është më e mirë dhe e përhershme (e amshuar). Kjo, me të vërtetë, ka qenë shënuar në faqet e broshurave të lashta, në fletët e Ibrahimit dhe Musait.” (El-A’la: 14-19)

E, për sa i përket Librave të tjera, që u janë shpallur Pejgamberëve të tjerë, All-llahu xh.sh. nuk na informon për emrat e tyre, porse na lajmëron se çdo Pejgamber i Tij, ka pasur shpalljen të cilën ia ka kumtuar popullit të vet. All-llahu xh.sh. thotë:

“(Dikur) të gjithë njerëzit i kanë takuar një bashkësie (pastaj lindi mospajtimi ndër ta), dhe All-llahu u ka dërguar Pejgamberë si sihariques dhe si qortues, dhe me ta dërgoi Libër në të cilin gjendej e vërteta, që me të, të gjykoheshin njerëzit për ato gjëra që nuk janë pajtuar...” (El-Bekare: 213).

Ne jemi të obliguar t’u besojmë këtyre Librave edhe pse nuk janë përmendur me emra. Por nuk e kemi të lejuar që All-llahu xh.sh. t’ia përshkruajmë çfarëdo libri qoftë të cilën Ai Vet nuk ia ka përshkruar Vetes në Kur’an.

Jemi të obliguar edhe të besojmë se të gjitha këto Libra kanë ardhur me të vërtetën, dritën, udhëzimin dhe tevhidin (veçimin, njësimin) e All-llahut xh.sh., në rububijetin e Tij, uluhijetin e Tij me emrat e bukur dhe me cilësitë hyjnore të Tij. E çdo gjë që është shkruar më vonë në to dhe kundërshtohen me këto baza, ky është falsifikim që e kanë bërë njerëzit. All-llahu xh.sh. për Tevrat thotë:

“Na kemi dërguar Tevratin, në të cilin është udhëzimi dhe drita.” (El-Maide: 44).

Për Inxhilin thotë:

“Na dërguam në gjurmët e Pejgamberëve, Isain - të birin e Merjemës, vërtetues të Tevratit që e kanë para tyre. Dhe na ia dhamë atij Inxhilin, në të cilin ka udhëzim dhe dritë, vërtetues i Tevratit të shpallur para tij - udhërrëfim dhe këshillim për ata që i druajnë All-llahut.” (El-Maide: 46).

Jemi të obliguar të besojmë se Kur'ani është Libri i fundit që është shpallur nga All-llahu xh.sh. dhe se All-llahu xh.sh. e ka dekoruar atë me dekoratë të posaçme mbi të gjitha librat tjera të shpallura më herët. Dekoratat më të rëndësishme janë:

1 - Se ai përmbanë porosinë e Zotit dhe se ka ardhë si vërtetim i vërtetësisë të asaj se çka kishte ardhur në Librat e mëparshme mbi tevhidin (njësimin) e All-llahut xh.sh., adhurimit kushtuar vetëm Atij dhe obligueshmërinë e të nënshtruarit vetëm Atij. Se Kur'ani ka përmbledhur tërë atë që ka qenë e shpërndar nëpër ato Libra mbi të mirën dhe mbi vërtetët. Se Kur'ani ka ardhur si fjalë e fundit me të cilin kontrollohet korrektësia e të gjitha librave të tjera, sepse ky verifikon të vërtetën që gjendet në to, ndërsa i flakë ato që njerëzit kanë futur në to duke u përpjekur t'i shtrembërojnë ato. All-llahu xh.sh. thotë:

“Na ty (o Muhammed!) ta kemi dërguar Librin (Kur'anin), të vërtetën e kulluar, që t'i vërteton Librat e shpallura më parë dhe të vigjilon mbi to.” (El-Maide: 48).

Të besuarit se ai ka ardhur me Sheriatin (Ligjin) për tërë njerëzimin gjithashtu e kemi obligim. Sheriati përmbanë tërë atë që i nevojitet njerëzve për lumturinë e tyre në të dy botët dhe me këtë janë anuluar të gjitha ligjet e mëparshme që u kanë ardhur popujve të mëparshëm. Në Sheriat janë caktuar ligjet e fundit e të përjetshme (amshueshme), të cilat vlejné për të gjitha kohët dhe për të gjitha vendet.

2- Se Kur'ani është i vetmi Libër mbrojtjen e të cilin e garanton All-llahu xh.sh.:

“Na, me të vërtetë, kemi shpallë Kur'anin dhe, Na, me të vërtetë, do ta ruajmë atë (originalitetin e tij).” (El-Hixhër: 9).

“Me të vërtetë, ata që e kanë mohuar Këshillën (Kur’anin), kur u ka ardhur atyre (do të dënohen), Me të vërtetë, ai (Kur’ani) është Libër i madhërueshëm (i mbrojtur), të cilit nuk mund t’i vie gënjeshtër, nga asnjëra anë (as përpara, as përmbapa). Kjo është Shpallja prej të Gjithdijshmit, të Falënderuarit.” (Fussilet: 41-42).

Kjo cilësi dalluese rrjedh nga një tjetër cilësi dalluese, e kjo është se Kur’ani i është shpallur tërë njerëzimit përmes Muhammedit a.s., se nuk i është dërguar vetëm një popull, siç ka qenë rasti me shpalljen e Librave të tjera. Prandaj, mbrojtja e tij nga falsifikimi dhe nga keqpërdorimi është e domosdoshme, në mënyrë që të mbetet argumenti i All-llahut xh.sh. kundër njerëzve gjithnjë derisa ekziston kjo botë.

E, për sa u përket librave të tjerë, fjala e çdonjërit prej tyre ka qenë e dedikuar vetëm një popull të caktuar. Dhe ato, edhe pse janë në pajtueshmëri për nga bazat e besimit, kanë ardhur me dispozita ligjore lidhur vetëm për një kohë të caktuar dhe për një popull të caktuar. All-llahu xh.sh. thotë:

“... Na për të gjithë ju kemi bërë ligj dhe rrugë të qartë.” (El-Maide: 48).

Prandaj All-llahu xh.sh. nuk është angazhuar që t’i ruaj ato gjatë tërë historisë, siç ka bërë me Kur’anin. Mirëpo, All-llahu xh.sh. na informon për falsifikimet që kanë përjetuar ato Libra. Për falsifikimet dhe ndërrimet që kanë bërë hebrenjtë në Tevrat, All-llahu xh.sh. thotë:

“A shpresoni ju se për hir tuajin hebrenjtë do të bëhen besimtarë, kur disa prej tyre i dëgjonin fjalët e Zotit, e pasi i kuptonin, me vetëdije i pëshjtellonin (ato fjalë).” (El-Bekare: 75).

“Në mesin e hebrenjve ka të tillë që shtrembërojnë kuptimin e fjalëve...” (En-Nisa’: 46).

Ndërsa për ndërrimet që i kanë bërë të krishterët ne Inxhil, All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe prej atyre që thanë: “Jemi të krishterë”, kemi marrë zotimin e tyre, por edhe këta kanë harruar një pjesë nga ato që janë këshilluar, prandaj ua shtiem armiqësinë dhe urrejtjen në mes tyre deri në Ditën e Kiametit. Se, All-llahu, me të vërtetë, do t’i lajmërojë ata për ato që kanë punuar. O ithtarët e Librit! Ju erdhi juve Pejgamberi Ynë i cili u shpjegon gjëra nga ato që i keni fshehur ju prej Librit (Tevratit dhe Inxhilit) dhe ju falë shumë (kalon në heshtje). E, prej All-llahut ju erdhi juve dritë (Pejgamberi) dhe Libri i qartë (Kur’ani).” (El-Maide: 14-15).

Nga gjërat e shtrembëruara që i kanë futur hebrenjtë dhe të krishterët në fenë e tyre është edhe ajo se hebrenjtë pohojnë se Uzejri është i biri i All-llahut, e të krishterët pohojnë se Mesihu është i biri i All-llahut. All-llahu xh.sh. thotë:

“Hebrenjtë thonë: “Uzejri është i biri i All-llahut”, të krishterët thonë: “Isai është i biri i All-llahut”. Këto janë fjalët e tyre, nga goja e tyre, i imitojnë fjalët e mohuesve të mëparshëm. I vraftë All-llahu! Si po shmangen (nga e vërteta)!” (Et-Tevbe: 30).

Kur’ani e korrigjon këtë gabim dhe shtrembërim të tyre të fjalëve të All-llahut xh.sh., e thotë:

“Thuaj: Ai, All-llahu është Një! All-llahu është mbrojtës i gjithkujt. (Ai) nuk ka lindur prej dikujt, as nuk ka lindur kë. Dhe askush nuk i gjason Atij.” (El-Ihlas: 1-4).

Kur’ani verifikon faktin se, të gjithë Pejgamberët janë njerëz, të cilët All-llahu xh.sh. i ka dekoruar me shpallje dhe me cilësi të cilat u mundësojnë ta pranojnë atë nga All-llahu xh.sh. dhe t’ua komunikojnë besnikërisht njerëzve. All-llahu xh.sh. i drejtohet Pejgamberit të Vet duke thënë:

“Thuaj: “Unë jam vetëm njeri si ju, mua më është shpallur që Zoti juaj është vetëm një Zot. Kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të punojë vepra të mira, dhe, le të mos i bëjë shok askë në të adhuruarit e Zotit të vet!” (El-Kehf: 110).

Nga shtrembërimet që i kanë bërë të krishterët, e për çaka na informon All-llahu xh.sh. në Kur’an, bën pjesë edhe ajo se disa prej tyre e kanë çoroditur domethënien e pejgamberllëkut dhe kanë filluar të përshkruajnë Isait, birin të Merjemës, cilësi hyjnore, ndërsa të tjerët atë e konsideronin njërin prej të treve. All-llahu xh.sh. thotë:

“Jobsimtarë janë ata të cilët thonë: “Me siguri Zot është Mesihu - i biri i Merjemës!” (El-Maide: 72).

“Jobsimtarë janë ata që thonë: “All-llahu është njëri prej treve! E, s’ka zot tjetër përveçse një Zot!” (El-Maide: 73).

Kur’ani arrinë duke sinjalizuar në këtë falsifikim dhe duke shpjeguar korrektësinë e besimit përkitazi me Isain a.s.:

“Mesihu - i biri i Merjemës, është vetëm Pejgamber, - edhe para tij kanë kaluar Pejgamberë. Nëna e tij përherë ka qenë e drejtë. Që të dy grënin ushqim...” (El-Maide: 75).

Fakti, rreth të cilit nuk do të kundërshtohet kurrnjë njeri objektiv, është se sot nuk ekziston asnjë libër i cili me siguri të plotë mund t’i përshkruhet All-llahut xh.sh. përveç Kur’anit madhështor. Në këtë fakt udhëzojnë edhe shumë argumente shqisore, me gjithë lajmërimet e All-llahut xh.sh. se Librat e mëparshme janë falsifikuar që të tëra. Ja disa prej këtyre argumenteve:

1 - Ekzemplarët original të Librave të shpallura para Kur'anit, janë humbur, andaj sot në duart e njerëzve ekzistojnë vetëm përkthimet e tyre. E, për sa i përket Kur'anit, ai gjer më sot është ruajtur me të gjitha kaptinat, fjalitë, fjalët dhe shkronjat, ashtu siç e ka mësuar Xhibrili a.s. Pejgamberin e All-llahut dhe ashtu siç i ka mësuar Pejgamberi a.s. as'habët e vet r.a.¹¹⁸

2 - Në këto libra janë përzier fjalët e All-llahut xh.sh. me fjalët e njerëzve, të cilët kanë komentuar dhe kanë folur për historinë, për jetëshkrimin e Pejgamberëve dhe nxënësve të tyre dhe për konkluzionet e fakihëve (juristëve). Prandaj nuk mund të dihet se cilat janë fjalët e All-llahut xh.sh. e cilat janë fjalët e njerëzve. E, për sa i përket Kur'anit, ai në tërësi është e folmja e All-llahut xh.sh., dhe në të nuk është përzier asgjë tjetër, as hadithi i Pejgamberit s.a.v.s., e as e folmja e as'habëve apo e kujdo qoftë tjetër.¹¹⁹

Ebu Vefa Ali bin Akliu thotë: “Nëse dëshiron të vërtetohesh se Kur'ani nuk është e folmja e Pejgamberit s.a.v.s., por se atij i është shpallur, shikoje të folmen e tij se si dallohet nga Kur'ani, dhe kundroje dallimin ndërmjet dy të folmeve dhe dy stileve. Është e njohur se e folmja e njerëzve i ngjanë njëra-tjetrës, kurse asnjë fjalë e Pejgamberit s.a.v.s. nuk i ngjanë të folmes së Kur'anit. Gjithashtu nga mu'xhizet e Kur'anit bën pjesë edhe ajo se askush nuk mund të gjejë në Kur'an ndonjë fjali të marrur nga librat e mëparshme, ndërsa njerëzit edhe sot e kësaj dite zbulojnë se si njerëzit marrin njëri nga tjetri, e themi, bie fjala, se Mutenebbi ka marrë nga Buhariu e të ngjashme.”¹²⁰

118 Bazat e Islamit, El-Mevdudi f. 77.

119 Bazat e Islamit, El-Mevdudi f. 77.

120 El vefa bi ahvalil Mustafa, 1: 270.

3 - Shkencërisht nuk mund të dëshmohet lidhshmëria e asnjë libri me Pejgamberin a.s. të cilit i përshkruhet ai. Asnjëri prej tyre nuk posedon lidhshmërinë e rrjedhës historike (sendin) të personave të cilët i transmetojnë ato. Kaptinat e Biblës, që quhet Dhiata e Vjetër, apo Tevratit, janë shkruar disa shekuj pas vdekjes së Musait a.s. Muhammed Ferid Vexhdi transmeton nga enciklopedia shkencore "Laros" këto fjalë: "Shkenca bashkëkohore, e para së gjithash kriticizmi gjerman, pas studimeve të gjata të zbulimeve arkeologjike dhe pas njohurive gjuhësore, konstaton se Tevratin nuk e ka shkruar Musai a.s., por se ai është vepër e priftërinjve hebrej, emrat e të cilëve nuk janë përmendur. Ata e kanë shkruar këtë periodikisht, duke u bazuar në traditat gojore të cilat i kanë dëgjuar para robërimit në Babiloni. Aq më tepër, një numër i shkencëtarëve pohojnë se këto pesë libra të Dhiatës së Vjetër nuk përmbajnë të gjitha traditat e hebrejve, por ato përmbajnë vetëm tezat, simbolet dhe tregimet më elementare."¹²¹ E për sa i përket Kur'anit, ky është i vetmi Libër autenticiteti dhe lidhshmëria me Pejgamberin që i është shpallur, me Muhammedin a.s., e të cilit mund të argumentohet në mënyrë të padyshimtë. Kur'ani është transmetuar me të gjitha kaptinat dhe fjalët e tij, me radhitjen e tyre dhe me mënyrën e shqiptimit në çdo periudhë pas shpalljes së tij, nga ana e një numri të madh njerëzish. Kështu që nuk ka dyshim se Kur'ani, të cilin ne e mësojmë sot, është Kur'ani i njëjtë të cilin All-llahu xh.sh. ia ka shpallur Pejgamberit të Vet të ndershëm.¹²²

121 El-'Akaidul islamijje li Nedim el-Mellah, f. 57.

122 Bazat e Islamit, f. 77, El-Mevdudi, f. 78.

4 - Një nga argumentet e shtrebbërimit të këtyre librave është edhe të ekzistuarit e ekzemplarëve të llojllojshëm, të cilët esencialisht dallojnë mes veti sipas përmbajtjes së tyre.¹²³

5 - Një nga argumentet pakontestuese mbi shtrebbërimin e Biblës është edhe ai se ajo përmbanë besime të parregullta dhe prezentimin e gabueshëm të Zotit xh.sh. dhe të Pejgamberëve të Tij fisnik. Në bibël do të geshë krahasimin e Zotit me njeriun dhe dhunimin e dinjitetit të Pejgamberëve, që është gjithsesi në kundërshtim me pagabueshmërinë e tyre.¹²⁴ Pas

123 El-‘Akaidul islamijje, Sejjid Sabik, f. 168. Në këtë vepër, mes tjerash, qëndron: ”Argument i mjaftueshëm për ndërrimet që janë bërë në Inxhil, i cili sot gjendet në duart e të krishterëve, është edhe ai se, prej shtatëdhjetë ekzemplarësh janë zgjedhur vetëm katër. Këta ungjij përmbajnë shkresa mbi jetëshkrimin e Isait a.s., shkruesit e të cilave janë të njohur, emrat e tyre janë të shkruar në frontespiket e librave. Vetë kritikët e krishterë kanë pranuar se premisat religjioze të ungjijve të sotëm janë të bazuara në mendimin e Pavlit (Pavlosit) pa mendimin e nxënësve të tjerë të Isait a.s. dhe të ithtarëve më të afërt të tij. Në bibliotekën e një princi të Parisit është gjetur një ekzemplar i ungjillit të Barambinit, i cili në shumë gjëra dallon nga katër ungjijtë e njohur. Ky ekzemplar është përkthyer në gjuhën arabe dhe e ka botuar shtëpia botuese El-Menar.

124 Në librin e zanafillës 3/22 qëndron: ”Atëherë Zoti tha: ”Ja, tani njeriu u bë sikurse njëri prej nesh, e një mirë edhe të keqen.” E pastaj: ”Zoti u pikëllua që e krijoi njeriun dhe u pendua thellë në zemrën e vet.” Ndërsa detajet të cilat e dhunojnë dinjitetin e Pejgamberëve janë më të shpeshta. Për Ibrahimin a.s. thonë se është rrenacak. Për Lutin a.s. thonë se ka bërë kurvëri me dy vajzat e tij. Për Harunin thonë se ai i ka thirrë izraelitët që ta adhurojnë vëçin. Për Sulejmanin thonë se i ka adhuruar idhujt në mënyrë që ta bënë të kënaqur gruan e vet. A ekziston argument më i madh për shtrebbërimin e Biblës se ky? Këtë e kemi cituar nga libri: El-‘Akaidul islamijje, Sejjid Sabik, f. 168. Shih edhe Er-resul ver-risalet, f. 104-106.

shtrembërimeve dhe ndryshimeve që kanë përjetuar Librat e mëparshme, jemi të obliguar të besojmë se ato në esencën e tyre janë nga All-llahu xh.sh. të cilat ua ka shpallur Pejgamberëve të Vet, me qëllim të njëjtë për çka është shpallur edhe Kur’ani. Për përmbajtjen e tyre, sot, nuk besojmë se është nga All-llahu xh.sh. përveç asaj që na ka informuar Kur’ani apo Pejgamberi s.a.v.s. E, për sa i përket Kur’anit madhështor, jemi të obliguar të besojmë se ai është ekskluzivisht fjala e All-llahut xh.sh., se është e Vërteta e kulluar, dhe se është ruajtur çdo fjalë e tij. Jemi të obliguar t’i zbatojmë të gjitha urdhrat e tij, e t’i shmangemi të gjitha ndalesave të tij. T’i besojmë asaj që flet ai dhe t’i flakim të gjitha ato që janë në kundërshtim me të.

PJESA E PESTË

BESIMI NË BOTËN E ARDHSHME

Me besimin në botën e ardhshme nënkuptohet të besuarit në tërë atë që na ka informuar All-llahu xh.sh. në Librit e Vet dhe Pejgamberi Tij në Hadithin e vet, mbi atë se çka do të ndodhë pas vdekjes, siç është: provimi dhe vuajtja apo kënaqësia në kabur (varr), ringjallja pas vdekjes, tubimi në një vend, parashtrimi i librit të veprave, llogaria, peshimi (matja) e veprave, Huvdi (Burimi), ura Sirat, shefa’ati, Xhenneti, Xhehennemi dhe çdo gjë tjetër që All-llahu xh.sh. ka përgatitur në to për banorët e tyre.

AKCENTI I KUR'ANIT NË KËTË BAZË TË BESIMIT DHE SHKAKU I KËSAJ

Kur'ani madhështor tejet shpesh përmend botën e ardhshme, duke provuar me kujdes në çdo vend ekzistimin e saj dhe në të gjitha rastet duke tërhequr vërejtjen në të, e gjatë tërë kësaj përdor metoda të ndryshme ligjërimi të gjuhës arabe.

Një nga argumentet e theksimit të kësaj baze të besimit është ai se, Kur'ani ndërlidhë fuqimisht besimin në All-llahun xh.sh. me besimin në botën e ardhshme. All-llahu xh.sh. thotë:

“...Mirësia është kur (njeriu) beson All-llahun, Ditën e Kiametit.” (El-Bekare: 177).

“...Kushdo që beson All-llahun (si është urdhëruar) dhe jetën tjetër, e bënë vepra të mira, për ata, me të vërtetë, ka shpërblim të Zoti i tyre; për ta nuk ka kurrfarë droje, e as mërzie!” (El-Bekare: 62).

“Kështu këshillohet çdonjëri prej jush që beson All-llahun dhe Ditën e Kiametit.” (El-Bekare: 232).

“Luftoni kundër atyre që nuk besojnë All-llahun, as Ditën e Kiametit.” (Et-Tevbe: 29).

“... Adhuron vetëm All-llahun, shpresoni në Ditën e Kiametit (shpëtimin) dhe mos bëni keq në Tokë.” (El-Ankebut: 36).

Ekzistojnë edhe shumë ajete të tjera të cilët flasin përkitazi me këtë.

Se sa rëndësi të madhe i jep Kur'ani botës së ardhshme, shihet edhe nga ajo se sa shpesh përmendet. Gati se nuk e kalon asnjë faqe të Kur'anit, e që në të, të mos flitet për botën e ardhshme dhe për atë se, çka do të ndodhë në të nga ngjarjet dhe situatat e ndryshme, e tërë kjo përmes mënyrave të ndryshme të shpjegimit. Gjithashtu do të vëreshë se Kur'ani hollësisht i parashtron detajet e fillimit të Ditës së Kiametit, që nuk është rast me temat e ndryshme të gajbit.

Një nga argumentet është edhe shumësia e emrave me të cilat e quan Kur'ani, kurse çdo emër tregon një nga detajet e asaj Dite. Disa prej atyre emrave janë: El-Kijame (ngritja, zgjimi), Es-Sa'a (çasti), El-Ahireh (bota tjetër), Jevmud-Din (Dita e fesë), Jevmul-Hisab (Dita e dhënies së llogarisë), Jevmul-Fet'h (Dita e fitores), Jevmul-Telak (dita e takimit), Jevmul-Xhem' (Dita e tubimit), Jevmul-Tegabun (Dita e vetëmashtrimit), Jevmul-Hulud (Dita e amshimit), Jevmul-Hasre (Dita e pendimit), Jevmul-Tenad (Dita e thirrjes), El-Azife (Kiameti), Et-Tamme (vështirësia, mynxyra), El-Sahha (zëri shurdhues), El-Hakka (çasti i pashmangshëm), El-Gashije (mynxyrë e rëndë), El-Vaki'a (ndodhia), etj.¹²⁵ Ndërsa shkaku i dhënies rëndësi kaq të madhe kësaj baze të besimit qëndron me sa vijon:

Besimi në botën e ardhshme ka ndikim të madh në jetën e njeriut. Imani (besimi) në botën e ardhshme dhe i çdo gjëje që do të ndodhë në të: Xhenneti, Xhehennemi, dhënia e llogarisë, ndëshkimi dhe shpërblimi, shpëtimi dhe dështimi, në mënyrë efikase ndikojnë në drejtimin e njeriut, në disiplinën e tij gjatë jetës në këtë botë, në kryerjen e veprave të mira dhe në përmbajtjen e imperativit të devotshmërisë. Ekziston dallim i pakrahasueshëm ndërmjet dy njerëzve: njërit që nuk i beson ringjalljes pas vdekjes, as dhënies së llogarisë për veprat dhe fjalët e

125 El-'Akaidul islamijje, Sejjid Sabik, f. 261-264.

veta dhe i cili me asgjë nuk udhëhiqet gjatë veprimeve të veta përveçse me interesin personal dhe me leverdinë personale, dhe tjetrit i cili beson se do të vijë dita kur do të jetë i pyetur për veprat dhe fjalët e veta para Gjykatësit më të drejtë, e do të jetë i shpërblyer për veprat e mira, ose i ndëshkuar për veprat e këqija. I pari, gjithsesi është jashtë çdo kontrolli, përveç pasioneve dhe lakmive të veta dhe qëllimi i tij është tërësisht egoist, e arsyeton përdorimin e të gjitha mjeteve dhe të gjitha sjelljet pa marrë parasysh se sa të dëmshme janë ato. Gjersa i dyti është i kufizuar me kufijtë e së vërtetës dhe së mirës, e këto janë gjëra të cilat atë ditë do ta kenë peshën dhe vlerën e vet tek All-llahu xh.sh. All-llahu xh.sh. thotë:

“Peshimi (i veprave) atë Ditë do të jetë i drejtë, atij që i rëndohet terezia me vepra të mira, do të jetë i lumtur; kurse atij që i lehtësohet terezia me vepra të mira, ai do ta humb veten, për shkak se i ka mohuar argumentet Tona.” (El-A’raf: 8-9).

Për këtë, në shumë vende, tregon sheshit edhe metoda kur’anore e thirrjes në kryerjen e veprave të mira duke besuar në botën e ardhshme:

“A e di ti për atë që e përgënjeshton Ditën e llogarisë? E ai është ai që ashpër i dëbon bonjakët dhe nuk nxiton t’i ushqejë të varfërit.” (El-Ma’un: 1-3).

“Xhamitë e All-llahut i mirëmbajnë vetëm ata që i besojnë All-llahut dhe botës tjetër...” (Et-Tevbe: 18).

“Nga ti nuk do të kërkojnë leje për të luftuar me pasurinë dhe trupin e tyre ata që besojnë All-llahun dhe Ditën e Kiametit. E All-llahu i di mirë ata që ruhen nga mëkatet. Nga ti do të kërkojnë

leje vetëm ata që nuk besojnë në All-llahun dhe në Ditën e gjykimit, dhe zemrat e atyre që dyshojnë. Ata luhaten në dyshimin e vet.” (Et-Tevbe: 44-45)

“Nuk duhet që njerëzit të cilët besojnë All-llahun dhe Ditën e Kiametit të ushqejnë dashuri ndaj atyre të cilët kundërshtojnë All-llahun dhe Pejgamberin e Tij.” (El-Muxhadele: 22)

“Me të vërtetë, ky ka qenë shembull i mirë për ju, për ata që shpresojnë në All-llahun dhe në Ditën e Kiametit.” (El-Mumtehine: 6).

“... Kjo është këshillë për ata që i besojnë All-llahut dhe Ditës së Kiametit.” (Et-Talak: 2).

“... Ata që besojnë në jetën e ardhshme besojnë edhe në të (Kur’an).” (El-En’am: 92).

Ekzistojnë edhe shumë ajete të tjera që flasin përkitazi me këtë.

Meqenëse njeriu është i prirur t'i përmbushë interesat e veta dhe të largon çfarëdo dëme prej vetes, besimi në botën e ardhshme e nxitë vetëkontrollin e tij dhe prirjen për të bërë vepra të mira, duke e larguar të keqen. Për këtë shkak Kur’ani shpeshherë dhe me kujdes të madh përkujton Ahiretin, e pasqyron dhe e prezenton atë në mënyra të ndryshme, në mënyrë që kjo ndjenjë (vetëkontrolli) të zmadhohet në zemrën e njeriut dhe të rritet ndikimi i tij.

Shkaku i potencimit të shpeshtë të ngjarjeve në Ahiret nga ana e Kur’anit, me siguri qëndron edhe në atë që njerëzit shpeshherë e harrojnë atë dhe nuk i japin rëndësi, për shkak të lojalitetit të madh ndaj jetës së kësaj bote dhe nga dashuria ndaj kënaqësive të kësaj bote. Prandaj, besimi në botën e ardhshme, me të gjitha kënaqësitë dhe ndëshkimet që do të jenë në të, e zbutë dëshirën e tepruar për kënaqësitë e kësaj bote dhe njerëzit bëhen të vetëdijshëm se të gjitha kënaqësitë e

kësaj bote nuk meritojnë çfarëdo mundimi qoftë dhe garim për to, ngase, ajo që meriton që për shkak të saj të garojmë është ajo që na ka përgatitur All-llahu xh.sh. në botën tjetër. Përkitazi me këtë All-llahu xh.sh. thotë:

“O besimtarë! Çka kini që nguroni, - thuajse jeni ngjitur për tokë - kur ju thuhet: “Dilni në luftë, në rrugën e All-llahut!” A jeni të kënaqur me jetën e kësaj bote, në vend të përhershëm (amshueshmës). E, kënaqësia e kësaj bote, në krahasim me atë të botës tjetër - është shumë e vogël.” (Et-Tevbe: 38).

Shkaku i përmendjes së shpeshtë të Ahiretit me siguri është edhe fakti se edhe sot e kësaj dite ky nxitë tek jobesimtarët dhe kafirat çudi dhe habi, për shkak se kjo i kundërvihet asaj që ata shohin me pamjen e tyre të kufizuar e i udhëzon në të kundërtën e ringjalljes pas vdekjes. Ata, bie fjala shohin se trupi i njeriut shndërrohet në pluhur, e si të ringjallet pastaj? Për ata All-llahu xh.sh. thotë:

“Kaf. Pasha Kur’anin e madhërishtëm, ata janë çuditur që nga mesi i tyre u ka ardhur një paralajmëruer, e, mohuesit thanë: “Kjo gjë është e çuditshme: vallë, a pasi të vdesim e të bëhemi dhé (do të ringjalletmi)? Ky kthim nuk mund të paramendohet!” (Kaf: 1-3).

All-llahu xh.sh. u përgjigjet atyre në shumë ajete (disa do t’i përmendim më vonë) se shqisat, në bazë të të cilave ata refuzojnë këtë fakt, janë të papërkryera dhe të paafta të shohin këtë, edhe pse ekzistojnë shumë shembuj në jetën e njeriut të cilat udhëzojnë në ringjalljen pas vdekjes, por, nuk janë të verbët sytë po të verbëta janë zemrat që gjenden në kraharor.

ARGUMENTET E BESIMIT NË BOTËN E ARDHSHME DHE PËRGJIGJJA NË DYSHIMIN E JOBESIMTARËVE

Se duhet besuar në botën e ardhshme provon Kur'ani, Hadithi i Pejgamberit s.a.v.s., mendja njerëzore dhe karakteri (natyra) korrekt. All-llahu xh.sh. shpeshherë përmend besimin në botën e ardhshme dhe sjellë argumente për të dhe në shumë vende i përgjigjet dyshimeve të jobesimtarëve në botën e ardhshme. Gjithashtu, Kur'ani gjer në detaje i përshkruan ngjarjet e Ditës së Kiametit, që nuk është rast me asnjë Libër të mëparshëm, edhe pse çdo Pejgamber që e ka dërguar All-llahu xh.sh. e ka sihariquar popullin e vet me lajme të gëzuara për këtë Ditë dhe ua ka tërheqë vërejtjen për mynxyrat e saj. Prandaj çdo njëri që mohon këtë apo dyshon në të, konsiderohet si jobesimtar. All-llahu xh.sh. thotë:

“All-llahu është Një, i Vetëm - i pashoq. Ai me të vërtetë do t'ju tubojë në Ditën e Kiametit, Për këtë nuk ka dyshim fare! E kush është në fjalë më i drejtë se All-llahu?” (En-Nisa': 87).

“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj kah lindja dhe perëndimi, por, mirësia është kur (njeriu) beson All-llahun, Ditën e Kiametit...” (El-Bekare: 177)

“... E ai që nuk beson All-llahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, Pejgamberët e Tij dhe Ditën e Kiametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejt.” (En-Nisa': 136)

Kur'ani na informon se Nuhi a.s. i ka thënë popullit të vet:

“All-llahu ju ka krijuar nga toka (dheu) ashtu si bimët, pastaj ju kthen në të dhe prej saj sërish do t'ju nxjerrë.” (Nuh: 17-18).

E Ibrahim i a. s thotë:

“Dhe i Cili, shpresoj, se do t’mi falë gabimet e mia në Ditën e Kiametit!” (Esh-Shu’ara’: 82).

E Musai a.s. ka thënë:

“Çasti i ringjalljes do të arrijë me siguri - nga çdokush e fshehi atë - kur secili sipas angazhimit të vetë i shpërblyer apo i ndëshkuar do të jetë. Andaj, le të mos shmangë ty assesi nga besimi në të ai që nuk i beson kësaj dhe që jepet pas epsheve të tija, e të humbasësh” (Ta Ha: 15-16).

All-llahu xh.sh. në shumë vende të Kur’anit i ka urdhëruar Pejgamberit të Vet, Muhammedit a.s., që të përbetohet me Të për njëmendësinë e ringjalljes pas vdekjes:

“Mohuesit kujtojnë se kurrsesi nuk do të ringjallen. Thuaj: “Po, pasha Zotin tim, pa tjetër do të ringjalleni dhe pastaj do të informoheni se ç’ keni punuar!” - E kjo për All-llahun është lehtë!” (Et-Tegabun: 7)

Ata që mohojnë ringjalljen, i përgënjeshtrojnë të gjithë Pejgamberët, për sinqeritetin e të cilëve dhe për tërë atë që kanë thënë ekzistojnë argumente pakontestuese racionale dhe shqisore. Prandaj të konsideruarit si të rrejshëm cilindo lajm që kanë sjellur ata, do të thotë mospërfilljen globale të arsyes, e cila ka nxjerrë konkluzion mbi sinqeritetin e tyre dhe përgënjeshttrimin e vetë asaj (arsyes), që gjithsesi paraqet kokëfortësi e cila nuk ka kurrfarëkuptimi.

Mohuesit e ringjalljes nuk kanë kurrfarë argumenti për mohimin e tyre, ngase kjo është çështje e gajbit (të padukshmës) të cilin nuk e di askush përveç All-llahut xh.sh. Dhe, rregull e përgjithshme e gjërave që i përkasin gajbit është se, askush nuk është në gjendje që t’i argumentojë apo t’i

mohojë këto, përveçse në një mënyrë të vetme - me lajmërimin e All-llahut xh.sh. përkritazi me të. E, ai i cili posedon argumente të pakontestueshme se ka pranuar Shpalljen nga All-llahu xh.sh., ai gjithsesi është tërësisht i sigurt për atë që transmeton mbi ndonjë gjë të gajbit.¹²⁶ Ky sinqeritet është vërtetuar vetëm tek Pejgamberët fisnikë. Këta janë ata, të cilët All-llahu xh. sh i ka përkrahur dhe i ka forcuar me mu'xhize, dhe u ka zbuluar diç nga bota e gajbit, e tanimë kemi thënë se të gjithë ata kanë folur për botën e ardhshme.

Mirëpo, ata të cilët e mohonin ringjalljen, i potenconin disa dyshime për ekzistimin e botës së ardhshme, siç bie fjala konsiderimi i tyre se është shumë larg dhe i pamundur kthimi i sërishëm në jetë pasi që njëherë bëhen hi e pluhur, patën thënë atë që All-llahu xh.sh. thotë për ta:

126 Kjo rregull është një nga bazat e të vërtetave mendore, ngase ne automatikisht e dimë se askush nuk ka mundësi të pohojë apo të mohojë ekzistimin e diçkaje në vend të caktuar, pos nëse e sheh vetë ose për këtë e informon dikush që e ka parë, me kusht që ekzistimin e saj nuk e kundërshton arsyeja dhe vetvetiu nuk është e pamundshme. Sikur dikush nga njerëzit e thjeshtë të pohonte apo të mohonte, për shembull, ekzistimin e yllit në ndonjë vend të caktuar në qiell, e që për këtë të mos jetë i informuar nga askush, ne me siguri do të thoshim se ky njeri gënjen. Gjithashtu, për çdo person i cili do të pohonte se nuk ekziston bota e ardhshme, do të thoshim se gënjen, madje edhe nëse askush nuk na ka informuar për ekzistimin e saj, e sidomos pasi që për këtë na kanë informuar ata, gënjeshtër e të cilëve është e pamundur - Pejgamberët dhe Lajmëtarët e All-llahut xh.sh. Të gjithë njerëzit, nga pikëpamja e botës së gajbit, janë injorant në raport me ta, dhe i vetmi që di për të dhe e sheh atë, është All-llahu xh.sh., prandaj, përkritazi me këtë çështje, ne i pasojmë vetëm ata të cilët i ka mësuar All-llahu xh.sh., e këta ja Pejgamberët e tij fisnikë.

“Vallë, a pasi të vdesim e të bëhemi dhe (do të ringjallemi)? Ai kthim është larg (mendjes e mundësisë)!” (Kaf: 3).

“E, ata thonë: “Ekziston vetëm jeta jonë në këtë botë, vdesim dhe jetojmë, e vetëm koha na shkatërron. Ata për këtë nuk kanë kurrfarë dijenie, ata vetëm parafytyrojnë ashtu.” (El-Xhathije: 24).

Pra, të gjitha dyshimet e tyre mbështeten në konstatimin se ringjallja është e largët, e pamundshme dhe e çuditshme.

All-llahu xh.sh. është përgjigjur në këto dyshime dhe në shumë vende të Kur’anit e ka sqaruar pabazueshmërinë e tyre. U ka sqaruar se arsyeja nuk e mohon besimin në ringjallje, porse e pranon atë, dhe se ringjallja nuk është në kundërshtim me atë që është e zakonshme, por ajo posedon shembujt e vet në jetën e kësaj bote dhe për këtë dëshmojnë shumë dukuri natyrore, të cilat gjithashtu janë vepra të All-llahut. Xh.sh.

1 - All-llahu xh.sh. thotë:

“Ata thonë: “Vallë, kur të bëhemi eshtra dhe pluhur, a do të ringjallemi në krijesa të reja?” Thuaj: “Po, edhe sikur të jeni gurë ose hekur, ose çfarëdo krijese qoftë për të cilën mendoni se nuk mund të ringjallet.” Ata do të thonë: “Kush do të na rikthejë neve në jetë?” Thuaj: “Ai që ju ka krijuar herën e parë”. E ata do të tundin kokat e tyre kah ti (duke të përqeshur) e do të thonë: “Kur është ajo (ringjallja)?” Ti thuaj: “Ndoshta së shpejti!” Atë ditë kur do t’ju thërras juve Ai, e do t’i përgjigjeni duke iu falënderuar Atij dhe do të mendoni se në këtë jetë, nuk keni qëndruar veçse pak kohë”. (El-Isra’: 49-52).

Shikoj vetëm dyshimet, të cilat i potencojnë ata dhe pyetjet që i bëjnë mohuesit e ringjalljes në të gjitha kohët, e do të shohësh se ato sillen rreth asaj që: ata e konsiderojnë si të pamundshme (nga ana e All-llahut xh.sh.) se hiri dhe pluhuri, në çka do të shndërrohen trupat e njerëzve, do të shndërrohen në krijesa të reja të cilat do të ecin dhe do të ndiejnë. Ata mendojnë se kjo është përtej fuqisë së All-llahut xh.sh. dhe konsiderojnë se kjo është larg, ngase nuk dinë se kur do të ndodhë kjo.

Siç po e sheh, të gjitha dyshimet e tyre rrjedhin nga mosnjohja e realitetit të jetës dhe vdekjes, nga mosnjohja e fuqisë së All-llahut xh.sh., dhe nga mospërfillja e argumentit të qartë të kësaj fuqie absolute, që mund të krijojë nga hiçi. E, do të mjaftonte të jenë të arsyeshëm, t'u përkujtohet fuqia e All-llahut kur i krijoj herën e parë, pasi që ishin hiç, e të bëhen të sigurt në vërtetësinë e Sunduesit, kur i informon ata për ringjalljen e sërishme, për dhënien e llogarisë, për shpërblimin dhe ndëshkimin. Pra, çështja është e thjeshtë e përgjigjja shembullore, e njëkohësisht e thjeshtë dhe bindëse. Sepse, njeriu e di se është krijuar edhe pse nuk ka ekzistuar më parë. Pra, duhet të ekzistojë krijuesi i cili e ka krijuar, pasi që assessi nuk ka ekzistuar. Pastaj, me vdekjen e tij, është shndërruar nga një gjendje në tjetër dhe duhet të ekzistojë faktori i këtij ndërrimi. Gjithsesi, ky nuk mund të jetë askush tjetër përveç All-llahut xh.sh., i cili e ka krijuar herën e parë, ngase, sikur ta kishte bërë këtë dikush tjetër, atëherë ai do të ishte në gjendje që edhe ta shpëtojë nga vdekja. Prandaj, çdo polemizimi rreth asaj se, a mundet Krijuesi, Dhuruesi i jetës dhe i vdekjes, - kur thotë se do ta ringjallë njeriun edhe për të dytën herë dhe do t'ia kthejë pamjen dhe figurën e tij, ta bëjë këtë me të vërtetë, - është vetëm inatosje dhe kryelartësi. All-llahu xh.sh. thotë:

“Thuaju (atyre): “All-llahu ju ngjallë (u jep jetën), pastaj ju vdes, e mandej do t’ju tubojë në Ditë e Kiametit, në këtë nuk ka kurrfarë dyshimi, por (këtë) shumica e njerëzve nuk dinë.” (El-Xhathije: 26).

All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe ai na sjell shembull, e harron krijimin e vet. (thotë): “Kush do t’i ngjallë eshtrat duke qenë ato të kalbura (shkapërderdhura)?” Thuaj: “Do t’i ngjallë Ai që i krijoi herën e parë; Ai i di të gjitha ato që i ka krijuar, (Ai) i Cili e bëri për ju - prej drurit të njomë - zjarrin dhe ju prej tij ndezni. Vallë, a nuk është i fuqishëm Ai, që krijoi qiejt dhe Tokën - të krijojë qenie të ngjashme (të ringjallë pas vdekjes)? Po, me të vërtetë, Ai është Krijues i çdo gjëje dhe Ai është i Gjithdijshëm.” (Ja Sin: 78-81).

Komentuesi i Tahaviut, duke i komentuar këto ajete, thotë: “Sikur ndonjë njeri ndër më të njohurit, me oratori më të madhe dhe me shkathtësi hulumtimi, do të bënte përpjekje që të vijë me argument më të mirë se ky, apo të ngjashëm me të, sipas fjalëve që do t’i përngjanin këtyre fjalëve, sipas koncizionit dhe qartësisë së argumentimit, nuk do të ishte në gjendje ta bënte këtë. All-llahu xh.sh. e fillon këtë argumentim me pyetjen të cilën e parashtron jobesimtari dhe kërkon përgjigje në të duke harruar se si është krijuar. Fjalët e All-llahut xh.sh. përmbajnë përgjigje dhe argument të mjaftueshëm, sa që më nuk ka vend për dyshim. E kur All-llahu xh.sh. ka dashur ta vërtetojë argumentin dhe ta arsyetojë edhe më, atëherë ka thënë: “Thuaj: “Do t’i ngjallë Ai që i krijoi herën e parë”, duke marrë krijim nga hiçi si argument të fuqisë për rikthimin në gjendjen e përparshme. Pra, duke argumentuar krijim e parë me mundësinë e krijimit të sërishëm, ngase çdo njeri i arsyeshëm e di se ai i cili ka mundur të krijojë diç për herë të parë, ai mund të krijojë edhe

për herë të dytë, e nëse nuk është në gjendje të krijojë për herë të dytë, atëherë as që do të jetë në gjendje të krijojë për herë të parë. E pasi që akti i krijimit kërkon fuqinë e krijuesit për krijimin e krijesave dhe njohjen e të gjitha pjesëve të krijesave të veta, All-llahu xh.sh. vazhdon: “dhe Ai është i Gjithdijshëm”. Ai i di të gjitha detajet lidhur me krijimin e parë, pjesët e materies dhe të formës. Rasti i njëjtë është edhe me krijimin e dytë. E, nëse Sunduesi posedon dituri të përsosur dhe të plotë, atëherë si të mos jetë në gjendje t’i ngjallë eshtrat e kalbura!? Pastaj këtë e konfirmon me argument të pakundërshtueshëm dhe të qartë, i cili në vete përmbanë përgjigjen në pyetjen e jobesimtarit tjetër i cili thotë: “Kur eshtrat shndërrohen në pluhur, atëherë ato bëhen të thata dhe me natyrë të ngurtë, ndërsa është e njohur se bartësi i jetës duhet të jetë me natyrë të ngrohtë dhe të lagësht (të njomë)”. E All-llahu xh.sh. thotë: “(Ai) i Cili e bëri për ju - prej drurit të njomë - zjarrin dhe ju prej tij nderzni.” All-llahu xh.sh. na informon për nxjerrjen e kësaj substance (zjarrin) jashtëzakonisht të nxehtë (të thatë) nga drunjtë e njomë, i cili është plotë lagështirë dhe i ftohtë. Prandaj, Ai i Cili prej diçkaje nxjerrë diçka tërësisht të kundërtën dhe të Cilit i nënshtrohen të gjitha krijesat dhe pjesët përbërëse të tyre, që nuk paraqet kurrfarë vështirësie për Të, atëherë Ai është në gjendje që me të vërtetë të bëjë atë që mohojnë jobesimtarët. Pastaj tërë këtë e vërteton duke marrë argument prej shembujve shumë më të mëdhenj dhe më të vështirë, ngase çdo njeri i arsyeshëm është i vetëdijshëm se ai i cili është në gjendje të bëjë diç të madhe dhe të komplikuar, gjithsesi është në gjendje të bëjë diç më të thjeshtë dhe më të lehtë. Ai i cili është në gjendje ta bartë peshën njëtonshe, ai gjithsesi e ka shumë më lehtë ta bartë një barrë më të lehtë. All-llahu xh.sh. thotë: “Vallë, a nuk është i fuqishëm Ai, që krijoi qiejt dhe Tokën - të krijojë qenie të ngjashme (të ringjallë pas vdekjes)?” Pra, Ai i Cili i ka krijuar qiejt dhe Tokën, madhësinë e tyre,

rolin e tyre dhe mënyrën mrekulluese të funksionimit të tyre, Ai gjithsesi e ka shumë më lehtë t'i ngjallë eshtrat të shndërruara në pluhur dhe t'i rikthejë në gjendjen e tyre të mëparshme.¹²⁷

3 - All-llahu xh.sh. thotë:

“O njerëz, nëse ju dyshoni në ringjalljen (pas vdekjes), dine se Ne ju kemi krijuar juve prej dheut (Ademin), pastaj prej pikës së farës (spermës), pastaj prej droçkave të gjakut, pastaj prej (copëzës) mishit (embrionit) me pjesë (gjymtyrë) të dukshme e të padukshme, për t’ju treguar juve (fuqinë Tonë). Dhe Na, e mbajmë në mitër atë që duam deri në kohën e caktuar. Pastaj ju nxjerrim juve si fëmijë; e pas kësaj, do të arrini ju (fuqinë) më të madhe. Disa nga ju vdesin e disa ngelin deri në kufirin më të ulët të jetës, që mos të dijë asgjë nga ajo që ka ditur më parë. Dhe, ti, e sheh tokën e thatë, e kur Ne lëshojmë ujin (të reshurat) në të, ajo lëkundet dhe gufon, dhe mbijnë (rriten) gjithfarë lloj bimësh të mrekullueshme, meqë All-llahu ekziston, dhe Ai është i fuqishëm për t’i ngjallë të vdekurit, dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë, dhe, ngase, me të vërtetë Dita e Kiameti do të vijë. Për të s’ka dyshim dhe që, në të vërtetë, All-llahu do t’i ringjallë ata që janë në varre (të vdekurit).” (El-Haxh: 5-7).

Kundroi mirë këto ajete të madhërishtme nga sureja Haxh. Në to do t’i gëshë argumentet për ringjalljen pas vdekjes dhe shenjat e qarta për fuqinë e All-llahut që t’i ngjallë të vdekurit. Këto argumente zhdukin çdo dyshim nga zemrat përkitazi me këto çështje, duke larguar çdo çuditje, dhe i rrëzojnë të gjitha dyshimet e jobesimtarëve:

127 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 460-461.

a) - Para së gjithash ato përmbajnë argumentin e krijimit të të gjitha krijesave, ndërsa njerëzit janë krijuar nga dheu, ku nuk ekzistojnë kurrfarë shenjash të jetës. Për këtë argument tanimë kemi folur.

b) - Me anë të këtyre ajeteve shprehet një aspekt i fuqisë së All-llahut xh.sh. nëpërmjet krijimit të njeriut dhe bartjen e tij nga një fazë në fazën tjetër, e cila tërësisht ndryshon nga ajo e para, e kështu me radhë. Me të vërtetë, Ai që e ka bartë nga faza e një pike të farës në fazën e droçkave të gjakut, pastaj në fazën e një copëze mishi, pastaj ia ka formuar të dëgjuarit dhe të pamurit, pastaj ia ka vënë shqisat, i ka dhënë fuqi, eshtrat, nervat e të tjera, e pastaj e ka përsosur qenien e tij në mënyrën më të mirë dhe e ka nxjerrë në këtë formë dhe pamje, që paraqet formë dhe pamje më të bukur. All-llahu xh.sh. thotë:

“Me të vërtetë, Na e kemi krijuar njeriun në formën (harmoninë) më të bukur.” Et-Tin: 4)

A thua vallë, Ai i Cili i ka bërë të gjitha këto, nuk është në gjendje ta ringjallë njeriun dhe t’ia kthejë jetën? E kjo nuk paraqet asgjë tjetër veçse kalim prej një faze në fazë tjetër, e këtë e vëren edhe fanatiku në veten e vet dhe tek çdo njeri tjetër në këtë botë.

Profesor Sejjid Kutbi - rahimehull-llahu - pas komentimit të ajeteve të cekura, na ka tërhequr vërejtjen për një porosi shumë të rëndësishme të tyre: “...dhe se këto faza, përmes cilave kalon embrioni, e pastaj fëmija pasi që ta ketë parë dritën, na mësojnë se ky vullnet, që me këtë drejton historinë e njeriut gjersa ky nuk arrinë përsosmërinë e plotë në shtëpinë e përsosmërisë, e duke qenë se njeriu nuk mund të arrijë përsosmërinë gjatë jetesës në këtë botë, sepse ai ngecë në të, e pastaj kthehet (në mënyrë që së shpejti të harroni atë që dini), prandaj është nevoja për botën e ardhshme ku do të përkryhet personaliteti i njeriut.

Këto, etapa përmes së cilave kalon njeriu, në dy mënyra provojnë ringjalljen pas vdekjes. Ato provojnë ringjalljen nga aspekti i faktit, se ai i cili ka qenë në gjendje të krijojë nga hiçi, gjithsesi është në gjendje përsëri ta rikthejë në jetë. Dhe provojnë ringjalljen me atë që “vullneti sundues” do ta prefeksionojë zhvillimin e njeriut në botën e ardhshme.

Pra, shohim se si takohen ligjet e krijimit me ligjet e kthimit të sërishëm, ligjet e jetës me ligjet e ringjalljes dhe ligjet e llogarisë me ligjet e ndëshkimit apo të shpërblimit. E tërë kjo dëshmon për ekzistimin e Krijuesit udhëheqës në përhershmerinë e të Cilit nuk ka kurrfarë dyshimesh.”¹²⁸

Përmes kuvendimit mbi fazat e njeriut dhe krijimin e tij nga pika e farës dhe droçkave të gjakut, shënojmë edhe një vërejtje, me çka dëshirohet t’u tërhiqet vëmendja atyre të cilët me kokëfortësi refuzojnë të besojnë në ringjallje se ajo pasqyrohet në vetvetën e tyre dhe tek çdo njeri, ngase ai, para se të bëhet vërtet krijesë, ka qenë vetëm një pikë lëngu pa kurrfarë vlere, pastaj droçkë gjaku, pastaj mish i pa formësuar (impersonal). Të gjitha këto janë faza të ulëta në të cilat njeriu është pothuajse tërësisht i vdekur. Mirëpo, pas kësaj All-llahu xh.sh. ia jep jetën, e formëson dhe e pajisë me nevojat elementare për jetë, përderisa, në fund, nuk rritet në njeri të kompletuar, i cili mendon, ndien, bënë polemizime dhe diskutime. A nuk i ngjanë kjo vepër e All-llahut xh.sh. ngjalljes të të vdekurve, të cilën e mohojnë negatorët e ringjalljes? Prandaj All-llahu xh.sh. thotë:

“A s’ka qenë njeriu së pari pikë fare (sperme) që hudhet lehtë, pastaj u bë gjak i droçkuar, nga i cili, Ai (All-llahu) e ka krijuar dhe e ka formuar të plotë, dhe, prej tij i bëri çiftet: mashkullin e femrën, e, vallë, Ai Krijues, a nuk ka fuqi edhe t’i ngjallë të vdekurit?” (El-Kijame: 37-40).

128 Fi Dhilali Kur’anil Kerim, 5: 583.

c) - Në ajetet e cituara gjendet edhe një argument për ringjalljen dhe për fuqinë e All-llahut xh.sh. që t'i ngjallë të vdekurit. Kjo tokë e tharë (shkretëtira arabe sh. p.), në të cilën nuk sheh kurrnjë gjurmë të jetës, e as që mbien diç nga ajo, pasi që All-llahu xh.sh. e lëshon shiun mbi të, në të paraqitet jeta, mbijnë bimët llojloj ngjyrash, shijesh, aromash dhe dedikimesh. Lidhur me këtë All-llahu xh.sh. thotë:

“E, s’ka dyshim se Ai që e ngjallë atë, do t’i ngjallë edhe të vdekurit, sepse Ai është i plotfuqishëm për çdo gjë.” (Fussilet: 39).

E kanë pyetur Pejgamberin s.a.v.s. “Si do t’i ngjallë All-llahu xh.sh. të vdekurit? Dhe çka është argument për këtë në vetë krijesat e tij? Pejgamberi s.a.v.s. përgjigjet: “A nuk ke kaluar ndonjëherë pranë luginës që ka pësuar nga thatësira?” Tha: “Po.” “E pastaj një herë tjetër ke kaluar pranë saj dhe e ke parë se ajo tundet nga gjelbërimi?” Tha: “Po, e kam parë.” “Kështu All-llahu do t’i ngjallë të vdekurit dhe kjo është shenjë e Tij në mesin e krijesave të tij.”¹²⁹

4 - All-llahu xh.sh. thotë:

“Mos vallë, keni menduar se Ne ju krijuam kot dhe se nuk do ktheheni te Ne?” (El-Mu’minun: 115).

“Vallë, a mendon njeriu se do të lihet në vullnet të vet (pa përgjegjësi).” (El-Kijame: 36).

129 Transmeton Ahmed, Ebu Davudi dhe Ibni Maxhe. Shih: Tefsir Ibën Kethir, 2: 208; Sahihu-l-xhami’is sagir, 1: 42).

Këto dy ajete, dhe të tjerat të ngjashëm me këto, vërtetojnë se të besuarit në ringjallje, në llogari dhe në ndëshkim apo shpërblim, është pjesë e përbërëse e besimit në cilësitë e përsosmërisë dhe në emrat e bukur të All-llahut xh.sh. Kjo bazë, është e lidhur ngusht me bazën e parë të emrave, prandaj ai që e mohon këtë bazë, ai nuk e beson All-llahun xh.sh., ngase kjo në mënyrë të pashmangshme shpie në mohimin e urtësisë së All-llahut xh.sh. dhe drejtësisë së Tij në krijim, dhe shpie kah mohimi i cilësive të Tij.

Gjithashtu, nga mohimi i ringjalljes rezulton edhe nënçmimi i vetë njeriut, sepse konsideron se ai është krijuar më kot, e jo nga urtësia e madhe, se ekzistenca e tij është e kufizuar vetëm me jetën e shkurtër të kësaj bote, e cila është përplotë me vështirësi, mynxyra, fatkeqësi, padrejtësi, krime dhe mëkate. Dhe konsideron se ai është i lenë vullnetit të vet dhe se dhunuesi nuk do të jetë i ndëshkuar për krimet e tij, as që i drejti do të shpërblehet për drejtësinë e tij, e as që shkatërruesi do të ndëshkohet për veprën e tij.

Pra, ringjallja pas vdekjes pikërisht i përgjigjet madhërisë së All-llahut xh.sh. dhe drejtësisë e urtësisë së Tij. Këtë e konkludon arsyeja njerëzore siç e pranon edhe natyra e paturbulluar e njeriut.¹³⁰

130 El-vahjul Muhammedijj, f. 178-179; Mebadiul Islam lil Mevdudi, f. 91; El 'akaidul islamijje, f. 279-280; Sherhul 'akidetil vasitijje li Muhammed Halil Herras, f. 129-130.

DETAJET E BESIMIT NË BOTËN E ARDHSHME

Besimi në botën e ardhshme është një nga bazat më të rëndësishme të imanit dhe ky nuk do të realizohet e as që do të plotësohet përderisa nuk përfshihen edhe këto dy gjëra:

E para: Që njeriu të besojë në botën e ardhshme përgjithësisht. E ky është minimi i cili duhet të realizohet në mënyrë që të posedohet ky themel i imanit.

E dyta: Që të besojë tërë atë që na ka informuar Pejgamberi i All-llahut se do të ndodhë pas vdekjes. Në faqet vijuese do t'i shqyrtojmë gjërat më të rëndësishme për të cilat na flasin ajetet kur'anore dhe hadithet autentike.

1 - SPROVIMI DHE PROVIMI NË VARR NGA ANA E DY ENGJËJVE

Jemi të obliguar të bosojmë në tërë atë që na ka informuar Pejgamberi s.a.v.s. lidhur me sprovimin dhe pyetjet e dy engjëjve që do t'ia bëjnë çdo njeriu për Zotin e tij, për fenë e tij dhe për Pejgamberin e tij. Pejgamberi s.a.v.s. na ka informuar me anë të haditheve autentike, se njerëzit do të pyeten në varret e tyre dhe se çdonjërit prej tyre do t'i thuhet: “Kush është Zoti yt? Cila është feja yte? Kush është Pejgamberi yt?” Në këto pyetje besimtari do të përgjigjet: “Zoti im është All-llahu, feja ime është Islami, ndërsa Muhammedi është Pejgamberi dhe Lajmëtari im.” Ai i cili është i hutuar do të përgjigjet: “Nuk e di, i dëgjoja njerëzit se diçka shqiptonin, andaj shqiptoja edhe unë”, pastaj do të jetë i rrahur dhe i munduar.

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Enesi r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Mu në këtë çast pash tërë atë që nuk më është treguar gjer më tani, madje e pash Xhennetin dhe Xhehennemin dhe më është shpallur se ju do të jeni të sprovuar në varret tuaja, me srovim i cili do të jetë i ngjashëm sprovimit të Mesihut me Dexhhalin. Çdonjëri prej jush do të pyetet: “Çka di ti për këtë njeri?” Besimtari - mu’mini ose mukini - do të përgjigjet: “Ky është Muhammedi, i Dërguari i All-llahut. Na ka ardhur me argumentin e qartë dhe me Udhëzimin, e ne iu kemi përgjigjur dhe e kemi pasuar atë. Ai është Muhammedi (tri herë).” Pastaj do t’i thuhet: “Flij i qetë, ne e kemi ditur se ti fuqimisht i ke besuar atij.” E, për sa i përket munafikut, ai do të thotë: “Nuk di, i dëgjoja njerëzit se shqiptonin diç, andaj edhe unë shqiptoja.”¹³¹

Buhariu dhe Muslimi gjithashtu transmetojnë nga Enes bin Maliku r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Kur njeriu vendoset në varr e largohen të pranishmit - e ai i dëgjon mirë rropatjet e këpucëve të tyre - do t’i vijnë dy engjëj e do te vendosin ulur, e pastaj do te pyesin: “Çka mendon ti për këtë njeri?” Për sa i përket besimtarit ai do të thotë: “Dëshmoj se ai është robi i All-llahut dhe i Dërguari i Tij.” Pastaj do t’i thuhet: “Shikoje vendin tënd në zjarr të cilin All-llahu xh.sh. ta ka zëvendësuar me një vend në Xhennet.” Atëherë Pejgamberi i All-llahut tha: “E do ti sheh që të dyja.” Katade thotë: “Na ka thënë se varri i tij do të zgjerohet dhe do të bëhet shtatëdhjetë llëra (bërryla), do të mbushet me gjelbërim dhe do të qëndrojë kështu gjer në ringjalljen e sërishme.” E për sa i përket munafikut dhe kafirit, atij do t’i thuhet: “Ç’ke folur për këtë njeri?” Ai do të përgjigjet: “Nuk di, kam folur për të ashtu si flisnin njerëzit.” Pastaj do t’i thuhet: “As që ke ditur

131 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 1: 148. Ky hadith është muttefekun ‘alejhi, e këto janë fjalët e Buhariut.

as që ke folur.” Pastaj do të jetë i goditur me çekan të hekurt aq fort, sa që klithmën e tij do ta dëgjojnë të gjitha krijesat në afërsi të tij, pos njerëzve dhe xhinnëve.”¹³²

Buhari dhe Muslimi transmetojnë edhe nga Bera bin ‘Azibi r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “All-llahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme.”

Ky ajet është shpallur përkitazi me çështjen e sprovimit në varr, ku do t’i thuhet njeriut: “Kush është Zoti yt?” Ai do të përgjigjet: “Zoti im është All-llahu, e Muhammedi është Pejgamberi im.” Këto janë fjalët e All-llahut xh.sh.:

“All-llahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme, në këtë botë dhe në botën tjetër, kurse zullumqarët i shpie në humbje; All-llahu punon ç’të dojë.” (Ibrahim: 27).

Ekzistojnë shumë hadithe autentike që flasin për sprovimet e varrit dhe pyetjet e engjëjve.

2 - VUAJTJET DHE KËNAQËSITË NË KABUR

Jemi të obliguar të besojmë edhe në vuajtjet dhe kënaqësitë në varr që do të ndodhin pas provimit, e për të cilat na flet Pejgamberi s.a.v.s. Mbi këtë temë flasin shumë ajete dhe hadithe. All-llahu xh.sh. thotë:

132 Muttefekun ‘alejhi. Shih: Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 17: 203; Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 3: 184.

“...e ithtarët e faraonit i kaploi dënimi i vrazhdë. Ata ia nënshtroi zjarrit mëngjes e mbrëmje, e kur të arrijë Çasti (Dita e Kiametit, ju thuhet engjëjve): “Shpini ithtarët e Faraonit në dënimin më të rëndë!” (El-Mu’min: 45-46)

All-llahu xh.sh. u është kërcënuar njerëzve të faraonit me dy lloj dënimesh: së pari me fjalët: “Ata ia nënshtroi zjarrit mëngjes e mbrëmje” e së dyti me fjalët: “e kur të arrijë Çasti (Dita e Kiametit, ju thuhet engjëjve): “Shpini ithtarët e Faraonit në dënimin më të rëndë!” Pjesës së dytë ia ka shtuar “atf”, që do të thotë se ato dënime nuk janë të llojit të njëjtë. Nëse lloji i dytë i dënimit fillon pas Ditës së Kiametit (siç kuptohet nga ajeti), atëherë është e qartë se lloji i parë fillon pas vdekjes së tyre e gjer në ringjallje, që është gjithsesi vuajtje e varrit. All-llahu xh.sh. tërheq vërejtjen në vuajtjet e varrit edhe me këto fjalët:

“... E, sikur t’i shihje mizorët kur janë në agoni të vdekjes, e engjëjt zgjasin duart (për tua marrë shpirtin, duke thënë): “Shpëtoni pra vetveten (nëse mundeni)!”. “Sot ju do të ndëshkoheni me dënim të turpshëm për shkak të pavërtetave që i keni thënë për All-llahun dhe që jeni krenuar (duke mos besuar) ajetet e Tij.” (El-En’am: 93).

Transmetohet se Ibni Abbasi r.a., duke komentuar këtë ajet, ka thënë: “Kjo ngjanë gjatë vdekjes së tyre, atëherë ata do të jenë të goditur nëpër fytyrat dhe shpindët e tyre.” Ibni Haxheri thotë: “Këtë e vërteton edhe ky ajet: “E, si do të jetë atëherë puna e tyre, kur engjëjt ua marrin shpirtin, duke i rrahur ata nëpër fytyrat dhe shpindët e tyre?” (Muhammed: 27), e pastaj tha: “Edhe pse këtu flitet për vuajtjen para varrimit, kjo megjithatë bën pjesë në vuajtjet që do të ngjajnë gjer në

Ditën e gjykimit. I përshkruhet kaburit, pasi që shumica e këtyre vuajtjeve (para Ditës së gjykimit), do të ndodhin në të.”¹³³

Për sa u përket haditheve që flasin për vuajtjet e varrit, ata janë të shumënumërt dhe arrijnë shkallën e tevaturit. Imam Neveviu, në komentarin e vet të Sahihut të Muslimi, thotë: “Dije se, pasuesit e drejtimit të ehli Sunnetit, dënimin e kaburit e konsiderojnë të vërtetë, sepse për të ekzistojnë shumë argumente nga Kur’ani dhe Sunneti. All-llahu xh.sh. thotë: “Ata i nënshtroi zjarrit mëngjes e mbrëmje”, ndërsa ekzistojnë shumë hadithe të Pejgamberit s.a.v.s. që i transmetojnë shumë as’habë nga viset e ndryshme e që flasin në favor të kësaj. Gjithashtu, duke shikuar arsyeshëm, nuk është e pamundur që All-llahu xh.sh. t’ia kthejë jetën një pjese të trupit dhe ta ndëshkojë atë. E, nëse kjo nuk bie në kundërshtim me arsyen, e për këtë kemi vërtetim në argumentin shariatik, atëherë kjo duhet të pranohet dhe të besohet.”¹³⁴

Imam Muslimi në Sahihun e vet cek shumë hadithe që vërtetojnë vuajtjen në kabur, dhe thotë se Pejgamberi s.a.v.s. i ka dëgjuar ata të cilët vuajnë në kabur, se të vdekurit dëgjojnë rropëllimën e këpucëve të atyre që largohen nga varrezat, e të ngjashme. Në hadithe përmendet edhe fjalimi i Muhammedit a.s. viktimave idhujtarësh të varrosur në varrin e përbashkët pas Betejës së Bedrit, atëherë kur i është përgjigjur as’habëve se ata aspak nuk dëgjojnë më mirë se ata (të varrosurit). Pastaj flitet për atë se si do t’u zgjerohet varri atyre që janë të shpëtuar dhe do t’u tregohet vendi në Xhennet, ndërsa në të kundërtën e kësaj atyre që kanë pësuar e të tjera, që mund të lexohen në këto hadithe.

133 Fet’hul Bari, 3: 180.

134 Sherhul Nevevi ‘ala sahih Muslim, 17: 200-201.

Imam Muslimi në Sahihun e vet transmeton nga Zejd bin Thabiti se ka thënë: “Së bashku me Pejgamberin s.a.v.s. ishim në një parcelë e cila ishte në pronësinë e Beni Nexhxharit, kur papritmas u shqetësua mushka në të cilën ishte hipur dhe pak sa nuk e hudhi nga vetja. Kur, aty i vërejtëm disa varre (gjashtë, ose pesë, ose katër) e Pejgamberi s.a.v.s. pyeti: “Cili prej jush i njeh këta që janë varrosur këtu?” Njëri nga të pranishmit tha: “Unë” Pejgamberi s.a.v.s. pyeti: “Kur kanë vdekur?” “Para Islamit”, tha (njeriu).”Njerëzit vërtetë ndëshkohen në varre. Sikur ju të mos varroseshi, do ta lusja All-llahun xh.sh. që t’ua mundësojë t’i dëgjoni vuajtjet e varrit siç i dëgjojë unë.” Pastaj u kthye kah na, e tha: “Kërkoni nga All-llahu mbrojtje prej zjarrit.” Ne të gjithë zëshëm e lutëm All-llahun që të na mbrojë nga zjarri. Pastaj tha: “Kërkoni mbrojtje nga vuajtjet e varrit.” Atëherë ne kërkua mbrojtje nga vuajtjet e varrit. Pastaj tha: “Kërkoni nga All-llahu mbrojtje prej të gjitha ngatërresave - të hapta dhe të fshehta.” Ne atëherë kërkua mbrojtje nga të gjitha llojet e ngatërresave - të hapta dhe të fshehta. Pastaj tha: “Kërkoni mbrojtje nga All-llahu prej sprovimit të Dexhxhalit.” Atëherë ne kërkua mbrojtje nga Dexhxhali dhe sprovimi i tij.”¹³⁵

Buhariu, Muslimi dhe të tjerët transmetojnë nga Ibni Abbasi r.a. se ka thënë: “Pejgamberi s.a.v.s. duke kaluar pranë dy varreve e ka thënë: “Ata janë duke u ndëshkuar, e dënimi u ka arritur për shkak gjërave të imëta.” Pastaj ka thënë: “Njëri prej tyre bartte lajme të rrejshme, me të cilat i fuste të tjerët në ngatërresë, e i dyti nuk merrte tahret (pastrim) pas kryerjes së nevojës të vogël.”¹³⁶

135 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 17: 202.

136 Muttefekun ‘alejhi, e këto janë fjalët e Buhariut. Shih: Sahihu-l-Buhari, 3: 188.

Buhariu e Muslimi transmetojnë nga Abdull-llah bin Umeri r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Kur dikush prej jush vdes, vendi i tij i tregohet për çdo mëngjes dhe mbrëmje. Nëse është nga banorët e Xhennetit, i tregohet vendi në Xhennet, e nëse është nga banorët e Xhehennemit, i tregohet vendi në Xhehennem. Dhe i thuhet: “Ky është vendi që të pret pas Ditës së gjykimit.”¹³⁷

Për sa i përket mënyrës së ndëshkimit në varr apo të kënaqësisë në të, dhe mënyrën e kthimit të shpirtit në trupin e mejjtit, përkitazi me këtë çështje nuk është e lejuar t’i shtohet asgjë asaj që është transmetuar në hadithet sahih. Komentuesi i Tahaviut thotë: “Hadithet që flasin mbi vuajtjet apo kënaqësitë e varrit dhe për provimet e engjëjve, kanë arritur shkallën e tevaturit, prandaj jemi të obliguar të besojmë në këtë. E dimë se Sheriati nuk ka ardhur me asgjë që është në kundërshtim me arsyen, por mund të vijë me diç që do të mund ta hutonte arsyen, prandaj ne nuk do të shqyrtojmë mënyrën e vuajtjeve të varrit, ndëshkimit apo provimit, sepse arsyeja nuk është në gjendje të kuptojë këtë, ngase kjo nuk ndodhë në këtë botë. Gjithashtu, kthimi i shpirtit në trup nuk është mënyrë e zakonshëm në jetën e kësaj bote, por kjo ndodhë në mënyrë krejtësisht tjetër, e për ne të panjohur.

Dhe dije se vuajtja e varrit është - vuajtje në berzah. Secili që ka vdekur, e që ka merituar vuajtjen e varrit, ajo do ta arrijë atë, njësoj u varros ai apo jo, e kanë hëngër bishat apo është djegur, a është bërë hi e është shpërndarë në ajër, a është gozhduar apo është mbytur në det - shpirtin dhe trupin e tij do ta arrijë dënimi njësoj sikur të ketë qenë varrosur. E. për sa i përket haditheve në të cilat transmetohet se i vdekuri do të vendoset ulur, se brinjte do t’i ndahen nga dhembja dhe

137 Muttefekun ‘alejhi. Shih. Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 3: 118; Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 17: 200.

ngjashëm me këtë, prej këtu duhet të nxirret mësimi i Pejgamberit s.a.v.s. pa shtime apo mungime. Prandaj fjalët e tij nuk do të komentohen me atë që ato nuk përmbajnë e as që do të lihen pas dore, saqë të vihet në mohim të udhëzimit dhe shpjegimit të Pejgamberit s.a.v.s.¹³⁸

Ibni Kajjumi thotë: “Seleful ummeti (brezat e para) dhe të parët në dituri, konsiderojnë se kur njeriu vdes, ai do të jetë në kënaqësi apo në vuajtje dhe se kjo pasqyrohet në shpirtin e tij dhe në trupin e tij, dhe se shpirti pas ndarjes së tij nga trupi edhe më tej mbetet në kënaqësi apo në vuajtje dhe se ai ngandonjëherë bashkohet me trupin i cili së bashku me të kënaqet apo vuan. E kur të vijë Dita e gjykimit shpirtrat do t’u kthehen trupave të tyre dhe njerëzit do të ngriten nga varret dhe do të nisen kah Zoti i tyre. Ringjallja e trupit është gjë në të cilën janë në pajtueshmëri myslimanët, hebrenjtë dhe të krishterët.”¹³⁹

3 - PARASHENJAT E DITËS SË GJYKIMIT

Jemi të obliguar të besojmë se Dita e gjykimit do të vijë dhe se në këtë nuk ka aspak dyshim. Se kohën e saj nuk e di askush përveç All-llahut xh.sh., i Cili e ka fshehtë këtë nga njerëzit, madje edhe nga Pejgamberët dhe Lajmëtarët, dhe se askush nuk është në gjendje të mësojë se edhe sa kohë i ka mbetur kësaj bote.

138 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 451-452.

139 El ‘akaidul islamijje, Sejjid Sabik, f. 237.

Të pyesin ty (o Muhammed!) kur do të ngjajë Dita e Kiametit. Thuaj: “Atë e di vetën Zoti im. Kohën kur do të ndodhë do ta tregojë vetëm Ai. (Tmerret e Ditës së Kiametit) do të jenë të rënda për qiejt dhe Tokën, do t’u vie krejtësisht papritmas. Të pyesin, thuase ti di diçka për të. Thuaj: “Këtë e di vetëm All-llahu; e shumica e njerëzve nuk e kuptojnë këtë (të vërtetë).” (El-Araf: 187).

Mirëpo, ne jemi të obliguar të besojmë në parashenjat e Ditës së gjykimit, për të cilat na flet Pejgamberi s.a.v.s. në hadithet sahih. Është transmetuar me besnikëri nga Resulull-llahu s.a.v.s. se ai i ka përmendur parashenjat e vogla të Ditës së gjykimit, të cilat më së shpeshti flasin për prishjen e njerëzve kohëve të fundit, për çrregullimet që do të paraqiten në mesin e tyre, e disa flasin për udhëzimin e All-llahut xh.sh. dhe për rrugën e Pejgamberit a.s., si dhe për parashenjat e mëdha.

Për sa i përket parashenjave të vogla, për këto flasin shumë hadithe, e ne do t’i përmendim vetëm disa prej tyre:

a - Buhariu dhe Muslimi transmetojnë një hadith nga Resulull-llahu s.a.v.s. ku thotë: “Unë jam i dërguar, e gjer në Ditën e gjykimit ka mbetur vetëm aq sa është largësia ndërmjet këtyre dy gishtërinjve”, dhe e zgjati gishtin tregues dhe gishtin e mesëm.”¹⁴⁰

Ky hadith është argument për pejgamberllëkun e Muhammedit a.s. dhe përfundimin e pejgamberllëkut me të, që është një nga parashenjat e ardhjes së afërt të Ditës së gjykimit. Nga

140 Transmetojnë Buhariu, Muslimi dhe Tirmidhiu. Shih Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 11: 293; Muhtesar Sahih Muslim, 1: 113.

hadithi kuptohet se ndërmjet Resulull-llahut s.a.v.s. dhe Ditës së gjykimit nuk do të ketë më asnjë Pejgamber, porse ajo do të vie menjëherë pas tij, që gjithsesi paralajmëron afërsinë e Ditës së gjykimit.¹⁴¹

b - Në hadithin e njohur të Xhibrilit, ku ai e pyet Resulull-llahun s.a.v.s. për Ditën e gjykimit, në çka Resulull-llahu s.a.v.s. është përgjigjur: “Kur robëresha i lind vetes zotëriu¹⁴² dhe kur t’i shohësh barinj të dhe varfanjakët e zbathur dhe të mbathur ligsht se si garojnë në ndërtimin e ndërtesave të larta.”¹⁴³

141 El ‘akaidul islamijje,

142 Ibni Haxheri, duke i komentuar këto fjalë, thotë: ”Do të përhapet padëgjësia e fëmijëve ndaj prindërve të tyre, fëmija do të sjellet ndaj nënës së vet sikurse zotëriu ndaj robëreshës së vet, duke e poshtëruar, duke e sharë, duke e rrahur dhe duke kërkuar prej saj shërbime të ndryshme. Prandaj ky fëmijë quhet zotëriu i nënës së vet duke i simbolizuar të gjitha këto domethënie. Ose me emrin zotëri nënkuptohet kujdestari, që sipas mendimit tim është komentimi më i drejtë. Ngase në hadith flitet për atë se kjo gjendje do të jetë e çuditshme, se shenja e afërsisë së Ditës së gjykimit do të jetë ajo që shumë gjëra do të jenë të kthyer plotësisht mbrapshtë, kështu fëmija që edukohet do të shndërrohet në edukator, e të pavlefshmit do të shndërrohen në vlefshmit, që puthitet me pjesën vijuese të hadithit, ku flitet se barinj të zbathur do të bëhen pronarë të tokës.” Shih: Fet’hul Bari, 1: 101.

143 Muttefekun ‘alejhi. Shih: Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 1: 99-100; Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 1: 158. Kurse për domethënien e garimit të barinjve të zbathur në ndërtimin e ndërtesave të larta, Kurtubi thotë: ”Me këtë dëshirohet të tërhiqet vërejtje në ndryshimet tejet të mëdha që do të ndodhin, kështu që beduinët përdhunshëm do të ngadhënjnë në disa shtete dhe do të sundojnë padrejtësisht, pastaj do të tubojnë pasuri që do ta shpenzojnë në ndërtimin e ndërtesave të larta duke u

c - Buhariu transmeton nga Ebu Hurejre r.a. se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Nuk do të ndodhë Dita e gjykimit përderisa nuk fillojnë luftën dy grupe të mëdha 144 ndërmjet të cilave do të bëhet luftë shumë e madhe, e të dyja do t’i takojnë të njëjtës fe. Dhe përderisa të mos paraqiten pejgamberë të rrejshëm, numri i të cilëve do të arrijë 30,145 e çdonjëri prej tyre do të thotë se është i dërguari i All-llahut. Përderisa nuk zhduket dituria (ilmi), me vdekjen e ulemasë. Përderisa nuk rritet numri i tërmeteve. Përderisa koha nuk bëhet e shkurtër dhe të kalojë shpejtë. 146 Përderisa nuk rritet numri i luftërave dhe i vrasjeve. Përderisa në mesin tuaj nuk paraqitet pasuri aq e madhe sa që njeriu do të ofron zekatin e vet e askush nuk do të dëshirojë ta marrë, por ai të cilit i ofrohet do të thotë: “Unë nuk kam nevojë për të.” Përderisa në mesin e njerëzve nuk paraqitet garimi në ndërtimin e ndërtesave të larta. Përderisa nuk vie aso kohe kur njeriu, duke kaluar pranë varrit të shokut të vet të thotë: “Ku të kisha fat e të isha unë në vendin tënd.”

krenuar me to, e ne jemi dëshmitar të kësaj këto ditë.” Transmeton Ibni Haxheri nga Kurtubi në Fet’hul Bari, 1:101.

144 Ibni Haxheri thotë: ”Këtu mendohet për grupin e Aliut dhe grupin e Mu’aviut.” Fet’hul Bari, 12: 72.

145 Njëri prej tyre është El-Esved el-’Anesi, i cili është paraqitur në San’a’ dhe Muselejme el-Kedhdhabi, i cili është paraqitur në Jemame. Se janë pejgamber kanë pohuar edhe Tulejhe bin Huvejlidi dhe Sexhxhahi, por këta dy janë penduar për veprat e tyre. Ndër këta të sotmit bën pjesë edhe themeluesi sektit kadijanië dhe bahaië. Shih: Fet’hul Bari, 13: 73; El ‘akaidul islamijje li Sejjid Sabik, f. 246.

146 Kjo do të thotë se do të ketë bereqet nga gjithçka, madje edhe nga koha. Kështu që, një vit do të jetë sikur një muaj, një muaj si një javë, një javë si një ditë, një ditë si një orë. Fet’hul Bari, 13: 13; Tejsirul vusul, 4: 91.

Përderisa Dielli të mos lind nga perëndimi,¹⁴⁷ e kur të ndodhë kjo, e njerëzit ta shohin këtë, të gjithë do të besojnë, por atëherë askujt nuk do t'i shërbejë imani i tij nëse nuk ka besuar më herët, ose si besimtar nuk ka bërë ndonjë vepër të mirë. Dita e gjykim do të ndodhë aq befasisht, saqë rroba për të cilën kanë bërë pazar dy veta do të mbetet e pablerë dhe e pa mbështjellur (e kthyer), njeriu do ta bartë qumështin që e ka mjelë nga deveja e vet, por nuk do të arrijë ta pijë atë. Do të arrijë aq befasisht saqë njeriu do ta riparojë burimin, por nuk do të arrijë të pijë ujë nga ai. Do të arrijë aq befasisht saqë njeriu nuk do të këtë kohë ta hajë kafshatën të cilën tanimë e ka afruar te goja e vet.”¹⁴⁸

d - Enes b. Maliku r.a. transmeton se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Prej parashenjave të Ditës së gjykimit është edhe ajo që do të zhduket dituria e do të paraqitet mosdija, zinallëku (prostitucion), alkooli, do të rritet numri i grave e do të zvogëlohet numri i meshkujve, kështu që mes pesëdhjetë grashë do të jetë vetëm një mashkull.”

e - Ebu Hurejre r.a. transmeton: “Një njeri i ka thënë Resulull-llahu s.a.v.s.: “Kur do të ndodhë Dita e gjykimit?” Resulull-llahu s.a.v.s. u përgjigj: “Kur të zhduket besimi ndërmjet njerëzve, prite Ditën e gjykimit.” Njeriu përsëri pyeti: “Si do të zhduket besimi ndërmjet njerëzve?” “Kur funksionet me përgjegjësi të madhe i besohen atyre që nuk e meritojnë, prite ditën e gjykimit.”¹⁴⁹

147 Kjo është një nga parashenjat e mëdha, e të gjitha të tjerat në këtë hadith janë të vogla.

148 Transmeton Buhariu. Shih Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 13: 70, 76.

149 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 11: 279.

f - Ebu Hurejre r.a. gjithashtu transmeton se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Nuk do të ndodhë Dita e gjykimit përderisa myslimanët nuk fillojnë luftën kundër hebrenjve, kur myslimanët aq shumë do t’i mbysin sa që hebrenjtë do të fshihen pas drunjve dhe gurëve, por çdo dru dhe çdo gurë do të flasë: “O myslim, o rob i Zotit, ja tek është një hebre, është fshehur pas meje, eja e mbyte atë”, përveç drurit Gardak, sepse ai është dru hebrej.”¹⁵⁰

Ekzistojnë edhe shumë hadithe të cilat na flasin për parashenjat tjera të Ditës së gjykimit, e që mund të kërkohen në koleksionet autentike të haditheve.¹⁵¹

E, për sa i përket parashenjave të mëdha në hadithet autentike përmenden dhjetë sish, siç është hadithi i Hudhejfe b. Usejd el Gaffarit, ku thuhet: “Resulull-llahu s.a.v.s. na hasi duke i përsëritur disa leksione, e pyeti: “Çka mësoni kështu?” “Leksionin mbi Ditën e gjykimit” - thamë ne. Ai tha: “Dita e gjykimit nuk do të vijë përderisa para tij nuk i shihni dhjetë parashenja”, e pastaj përmendi Duhanin, Dexhxhalin, lindjen e Diellit nga perëndimi, zbritjen e Isait a.s., birit të Merjemës, Je’xhuxhi dhe Me’xhuxhi, tri depresione të mëdha të tokës: në lindje, në perëndim dhe në Gadishullin Arabik, e i fundit prej tyre do të jetë zjarri, i cili do të paraqitet në Jemen dhe do t’i përzë njerëzit në vendin e llogarisë.”¹⁵²

150 Transmeton Buhariu dhe Muslimi e ky është transmetim i Muslimit. Shih: Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 18: 44.

151 Këto hadithe do t’i gjejmë tek Buhariu dhe Muslimi në kaptinën ”mbi çrregullimet dhe parashenjat e Ditës së gjykimit”, në kaptinën “er rikak” dhe në vende të tjera.

152 Shih: Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 18: 27.

Në faqet vijuese do t'i sqarojmë parashenjat më të rëndësishme, me radhë ashtu siç i kanë përmendur komentuesit e haditheve.

A - LINDJA E DIELLIT NGA PERËNDIMI

Kjo parashenjë është fillimi i ndërrimit që do ta bëjë All-llahu xh.sh. në sistemin e Gjithësisë së kësaj bote, kështu që do të paraqiten gjërat të cilat njerëzve u janë tërësisht të jashtëzakonshme e që do të jenë argument i qartë për fillimin e Ditës së Kiametit, në të cilën do të vijë gjer tek ndërrimi total në sistemin e Gjithësisë. Për këtë ndërrim All-llahu xh.sh. na flet në shumë sure të Kur'anit madhështor. Fillimi i këtij ndërrimi, siç përmendet në shumë hadithe do të jetë lindja e Diellit nga perëndimi, që është tërësisht në kundërshtim me ligjet ekzistuese. Por, Ai që ka qenë në gjendje të bëjë që Dielli të lind nga lindja, Ai është në gjendja ta ndërrojë këtë e Dielli të lind nga perëndimi, sepse Ai e ka krijuar atë dhe e mirëmbanë atë.

Në disa hadithe autentike thuhet se kjo do të jetë parashenja e parë e madhe sipas dukurisë së saj.¹⁵³ Abdull-llah bin Amër bin Asi r.a. transmeton se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë:

153 Për nga çështja e radhës së paraqitjes së parashenjave të mëdha, Ibni Haxheri thotë: "Prej të gjitha haditheve bashkarisht mund të konkludohet se parashenja e parë e madhe që do të paraqitet është Dexhxhali, me të cilin do të paralajmërohet ndërrimi tejet i madh në shumë gjëra në tërë botën. E kjo do të përfundojë me vdekjen e Isait a.s. të birin e Merjemës. Kurse lindja e diellit nga perëndimi e para nga parashenjat e mëdha me të cilën do të shënohet fillimi i këtij ndërrimi në Gjithësi e do të

“Parashenjat e para që do të paraqitet është lindja e Diellit nga perëndimi dhe dalja e kafshës nga toka në mëngjesin e ditës së njëjtë, dhe cilado prej tyre që paraqitet e para, e dyta pason menjëherë pas saj.”¹⁵⁴

Në hadithin më parë të përmendur, të cilin e transmeton Ebu Hurejre r.a., thuhet se pas paraqitjes së kësaj parashenje të gjithë njerëzit do të besojnë, por atëherë nga imani nuk do të kenë dobi ata të cilët nuk kanë besuar më parë, siç thotë All-llahu xh.sh.:

“Atë ditë kur të vijnë parashenjat nga Zoti, atëherë askush nuk do të ketë dobi prej asaj që do të besojë, nëse nuk ka besuar më parë, ose nuk ka bërë ndonjë të mirë si besimtar.” (El-En'am: 158)

përfundojë me ndodhjen e Ditës së Kiametit. Për sa i përket daljes së kafshës (Ed-Dabbe) nga toka, me siguri se kjo do të ndodhë në të njëjtën ditë kur Dielli lind nga perëndimi. E shkaku i kësaj është se me lindjen e Diellit nga perëndimi do të mbyllen dyert e pendesës, e nga toka do të del kafsha e cila do t'i shënon besimtarët dhe t'i ndajë ata nga jobesimtarët, si plotësim i aktit të mbylljes së dyerve të pendesës. Parashenja e parë, e cila me të vërtetë do ta shënojë çastin e fillimit të Ditës së gjykimit është zjarri që do t'i ndjekë njerëzit nga lindja në perëndim.” (Fet'hul Bari, 1: 296-297). Nga fjalët e Ibni Haxherit konkludojmë se këtu ka të bëjë me tri lloj parashenjash të mëdha: parashenjat me të cilat paralajmërohet fillimi i ndërrimeve të mëdha të gjendjes në Tokë, parashenjat me të cilat paralajmërohet fillimi i ndërrimeve në Gjithësi dhe parashenjat të cilat paralajmërojnë fillimin e Ditës së Kiametit. Andaj lindja e Diellit nga perëndimi konsiderohet si parashenjë e madhe nga grupi i dytë, pas paraqitjes të së cilës do të mbyllen dyert e imanit.

154 Transmeton Muslimi dhe Ebu Davudi. Shih: Fet'hul Bari, 11: 297; Sunen Ebu Davud - kaptina mbi parashenjat e Ditës së Kiametit; Tejsirul vusul - kaptina mbi parashenjat e ndryshme; Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 18: 77.

Një numër i madh i mufessirëve, duke komentuar këtë ajet thonë se jobsimtarit nuk do t'i bëjë dobi imani pas lindjes së Diellit nga perëndimi, sikurse që nuk do të vlejë as pendimi i mëkatarëve, e as veprat e mira të atyre që këto nuk i kanë bërë më parë, madje edhe nëse janë besimtarë.¹⁵⁵

B - DALJA E KAFSHËS NGA TOKA

Për këtë parashenjë All-llahu xh.sh. flet në Kur'an, ku thotë:

“Dhe, kur të vijë koha që ata të ndëshkohen, Ne do të bëjmë që nga toka të del një kafshë, e cila do t'u thotë atyre se njerëzit nuk u janë bindur argumenteve Tona” (En-Neml: 82).

Dalja e kafshës nga toka përmendet edhe në shumë hadithe, prej të cilave disa janë sahih (disa i kemi përmendur), por në hadithet sahih nuk transmetohet përshkrimi i kësaj kafshe, të cilën All-llahu xh.sh. do ta nxjerrë prej toke si parashenjë për ardhjen e Ditës së Kiametit. E tërë ajo që përmendet në disa libra si përshkrim i saj, është marrë nga hadithet të cilat nuk kanë arritur shkallën e autenticitetit. Mirëpo, besimtari as që lakmon që të mësojë përshkrimin e saj, sepse atij i mjafton të mbetet në tekstin e Kur'anit dhe të hadithit sahih, ku thuhet se dalja e kësaj kafshe është një nga parashenjat e Ditës së gjykimit, kur do të përfundojë periudha kur pranohen pendesat, dhe kur njerëzit do të gjykohen sipas veprave të bëra gjer në atë çast. Atëherë All-llahu

155 Fet'hul Bati, 11: 297.

xh.sh. do ta nxjerrë kafshën nga toka dhe do t'i shënojë besimtarët dhe jobesimtarët. E, nëse njerëzit nuk janë mësuar me të folmen e kafshëve, All-llahu xh.sh. Krijuesi i Gjithmbarshëm, është Ai, i Cili do t'ia mundësojë këtë asaj. Njerëzit do ta kuptojnë atë, dhe do të dinë se ajo është një prej mrekullive të All-llahut xh.sh., me të cilën paralajmërohet afrimi i Ditës së Kiametit, pasi që para kësaj nuk kishin besuar në shenjat e All-llahut xh.sh., e as në Ditën e gjykimit.¹⁵⁶

C - PARAQITJA E DEXHXHALIT

Dexhxhal në gjuhën arabe do të thotë rrenacak, i cili posedon aftësi të madhe mashtrimi. Prandaj rrenacaku quhet dexhxhal, ngase ai të vërtetën e fshehë me gënjeshtren e vet.

Një nga parashenjat e mëdha të Ditës së gjykimit është edhe paraqitja e personit, të cilin All-llahu xh.sh. e ka quajtur “Dexhxhal”, për shkak të gënjeshtrove dhe mashtrimeve tejet të mëdha të tij. Ai veten do ta konsiderojë për zot dhe do të përpiqet t'i kthejë njerëzit nga feja e tyre me gjërat mbinatyrore të tij, të cilat me dëshirën e All-llahut xh.sh. do të jetë në gjendje t'i bëjë. Në këtë mënyrë, ai do ta mashtrtojë një pjesë të njerëzve, e pastaj All-llahu xh.sh. do të lejojë që sprovimit të tij t'i vijë fundi, andaj do të zbret Isai a.s. dhe do t'a mbysë atë. Në komentarin e Neveviut të Sahihut të Muslimit qëndron: “Hadithet të cilat i përmend Muslimi dhe të tjerët mbi Dexhxhalin janë argument për pasuesit e së vërtetës për njëmendësinë e ardhjes së tij. Ai është person i

156 Fi Dhilalil Kur'anil Kerim, 6: 308

caktuar me anë të cilit All-llahu xh.sh. do t'i sprovtojë robërit e Vet. All-llahu xh.sh. do t'ia mundësojë atij gjërat të cilat nuk është në gjendje t'i bëjë askush përveç All-llahut xh.sh., siç është ngjallja e njerëzve të vdekur të cilët i ka mbytur ai, kopshti i gjelbër që do ta përcjellë gjithnjë, Xhenneti dhe zjarri, dy lumenj, pasuria e thesarëve të kësaj bote, urdhri qiejve që ta lëshojë shiun, e ata me të vërtetë e bëjnë këtë, urdhri tokës që të mbiejë, e kjo e bënë këtë, e të gjitha këto do t'i bëjë me dëshirën dhe fuqinë e All-llahut xh.sh. Pastaj All-llahu xh.sh. do t'ia bëjë të pamundshme këtë, e nuk do të jetë më në gjendja të mbysë asnjë njeri, e as të bëjë më çkado qoftë prej asaj që bënte më parë. Pastaj këtë do ta mbysë Isai a.s., e All-llahu xh.sh. do t'i përforcojë besimtarët në imanin e tyre. Ky është qëndrimi i pjesëtarëve të ehli Sunnetit, i të gjithë muhaddissëve, fakihëve dhe apologjetëve. Për dallim nga Havarixhi, Xhemhiu dhe disa mu'etezilë, të cilët mohojnë këtë, dhe për dallim nga të tjerët të cilët këtë e konsiderojnë si të vërtetë, porse ai nuk do të mund të realizojë asgjë nga veprat mbinatyrore të cilat përmenden, por kjo do të jetë vetëm mashtrim dhe imagjinatë e cila nuk është e vërtetë. Dhe konfirmojnë se, nëse kjo është e vërtetë, atëherë mu'xhizet e Pejgamberëve nuk do të ishin kompetente. Mirëpo, ky është gabim total i të dy grupeve, ngase ai nuk do të pohojë se është pejgamber e që këto vepra mbinatyrore t'i shërbejnë për vërtetim, por ai do të pohojë se është zoti vetë, që ai automatikisht e mohon këtë me paraqitjen e vet pasi që gjer më tani nuk ka ekzistuar assesi, me figurën e tij të gjymtë dhe me paaftësinë e tij që ta largojë verbërinë e cila tek ai do të duket në mënyrë të qartë, si dhe fjala (kafir) që do të jetëtë e shkruar ndërmjet syve të tij. Për shkak të gjitha këtyre, ai nuk do të jetë në gjendje t'i mashtrtojë njerëzit, përveç injorantët total dhe të gjorët të cilët do t'i besojnë atij në mënyrë që t'i kënaqin nevojat e veta për ushqim dhe për gjëra të tjera, ose do ta bëjnë këtë në mënyrë iluzore duke u frikësuar nga ndëshkimi i tij, ngase sprovimi i tij do të jetë shumë i rëndë, do ta hutojë arsyen dhe do ta marrë mendjen. E tërë kjo do të përcillet me lëvizjen e tij shumë të

shpejtë, kështu që njerëzit e dobët nuk do të mund të shohin gjendjen e tij të vërtetë dhe gjymtësinë e tij, dhe kështu do t'i besojnë atij. Për këtë shkak, të gjithë Pejgamberët ua kanë tërhequr vërejtjen njerëzve për sprovimin e tij dhe kanë treguar sheshit mangësitë e tij dhe argumentet e rrejtshme të pohimit të tij. E, për sa i përket atyre që janë të përkrahur nga All-llahut xh.sh., ata nuk do të mashtrohen me të e as me marifetllëqet e tij, sepse do t'i njohin shenjat e tij të pavërtetësisë, të cilat tanimë i kemi përshkruar, duke poseduar dituri paraprake për paraqitjen e tij”.¹⁵⁷

Për Dexhxxhalin flasin një numër hadithesh. Ja disa prej tyre:

- Nga Abdull-llah bin Umeri r.a. transmetohet se ka thënë: “Resulull-llahu s.a.v.s. është ngritur mes njerëzve, i është falënderuar All-llahut xh.sh. në mënyrë të denjë çfarë e meriton Ai, pastaj e ka përmendur Dexhxxhalin dhe ka thënë: “Unë ua tërheq vërejtjen në të, nuk ka pasur asnjë Pejgamber, e që popullit të vet të mos ia ketë tërhequr vërejtjen në të. Por, unë do t’ju themë juve diçka që, asnjë Pejgamber para meje nuk i ka thënë popullit të vet: Ai është i verbër, e All-llahu nuk është i verbër.”¹⁵⁸

- Hudhejfe bin Jemani r.a. transmeton se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Unë di më shumë për atë se çka do të ketë me vete Dexhxxhali se sa ai vetë: do t’i ketë dy lumenj të cilët do të rrjedhin, njëri prej tyre në shikim të syve do të duket se ka ujë të bardhë, ndërsa tjetri zjarr të flakëruar, e nëse dikush prej jush arrinë, le ta zgjedh lumin i cili duket si zjarr dhe le t’i mbyllë sytë, pastaj le të

157 Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 18: 58-59

158 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 13: 80; Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 18: 59.

përkulet dhe le të pijë ujë nga ai dhe do ta shohë se uji është i ftohtë. Një sy i Dexhxhalit do të jetë krejtësisht i mbyllur me një xhungë të vrazhdë e të mishtë, e ndërmjet syve do t'i shkruan "kafir", që do ta lexojë çdo besimtar, i këndueshëm apo analfabet.¹⁵⁹

- Nga Bevas b. Sem'ani r.a. transmetohet se ka thënë: "Me një rast Resulull-llahu s.a.v.s. e ka përmendur Dexhxhalin dhe e ka nënçmuar aq tepër duke folur për shenjat e dukshme të gënjeshtres së tij, e pastaj e ka ngritur aq tepër duke folur për madhësinë e sprovimit me të cilin do t'i sprovojë njerëzit, saqë menduam se tanimë ka ardhur në paralagjen e Medinës. Pas kësaj, kur shkuam tek Resulull-llahu s.a.v.s., ai e diktoi këtë tek ne, e pyeti: "Ç'po ndodhë me ju?" Ne u përgjigjëm: "O Pejgamber i All-llahut! Sot e përmende Dexhxhalin dhe aq tepër e nënçmove, e pastaj aq tepër e ngrite, saqë menduam se tanimë ka ardhur gjer tek plantacionet e Medinës." Tha: "Unë për ju frikësohem nga diçka tjetër pos Dexhxhalit, nëse paraqitet gjersa jam unë me ju, unë do t'ju mbroj nga ai, e nëse paraqitet e unë nuk jam në mesin tuaj, atëherë çdonjëri prej jush le ta ruaj veten, e All-llahun xh.sh. e lus që ta mbrojë çdo myslimanë. Ai është i ri me flokë jashtëzakonisht kaçurel, i verbër në një sy, i përngjanë Uzza bin Katit. Kush e përjeton prej jush, le të këndojë fillimin e sures El-Kehf. Ai do të paraqitet ndërmjet Shamit e Irakut dhe do të fillojë t'i bartë sprovimet e veta djathtas e majtas, prandaj, o robërit e All-llahut, mbahuni fuqishëm." Atëherë na thamë: "O i Dërguari i All-llahut, sa kohë do të qëndrojë në tokë?" Ai u përgjigj: "Dyzet ditë. Dita si viti, dita si muaji, dita si java, e ditët e tjera do t'i jenë sikurse edhe ditët e juaj." Na thamë: "A do të jetë e mjaftueshme për ne që t'i falim vetëm namazet e një dite në ditën që do të jetë sa viti?" Tha: "Jo, por do t'i caktoni kohët e namazit." Thamë: O i Dërguari i All-

159 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 18: 91

llahut, me çfarë shpejtësie do të ecë në tokë?” Tha: “Si shiu kur e bartë era. Do të vijë tek popujt e do t’i thërrasë që ta besojnë, e ata do t’i përgjigjen thirrjes së tij dhe do t’i besojnë, e ai do t’i urdhërojë qiellit, e qielli do ta lëshojë shiun, dhe do t’i urdhërojë tokës e cila menjëherë do të mbijë, e bagëtia do t’u bëhet më e trashë se kurrënjëherë më parë, me gjinjë dhe me barqe të mëdha (nga ngopja). E pastaj do t’i vijë një populli e do t’i thërrasë që t’a besojnë, e populli do ta refuzojë, e ai do t’i braktisë ata, por ata do të varfërohen, do të mbesin pa kurrëgjë nga pasyria e tyre. Do të kalojë pranë gërmadhve të vjetra e do t’u thotë: “ Nxirrni jashtë pasurinë tuaj!”, e pas tij do të nisen thesarët e artë si krina bletësh. Pastaj do ta thërrasë një djalë të ri e të shëndoshë të cilin do ta godasë me shpatë e do ta prejë në dysh, pastaj përsëri do ta thërrasë e ai do të ngritet dhe do të niset kah ai me fytyrë të qeshur. Ai do të veprojë kështu gjersa All-llahu nuk e dërgon Isain, të birin e Merjemës, i cili do të zbresë tek minarja e bardhë nga ana lindore e Damaskut, i veshur me rroba të bardha, duke u mbajtur me duar për krihët e engjëjve, kur e ulë kokën, i pikojnë lotët, e kur e ngritë, nga fytyra e tij bien gurë të çmuar si margaritarë. Asnjë jobesimtarë nuk do të mund të mbetet gjallë kur e ndien erën e frymës së tij, ndërsa fryma e tij do të shtrihet në largësi sa mund të shihet para tij. Ai do ta kërkojë Dexhxhalin gjersa nuk e gjenë në Babulludd (në Kuds, Palestinë) ku edhe do ta mbysë atë.”¹⁶⁰

Këto hadithe dhe hadithet e tjera janë argument të ehli Sunnetit për obligueshmërinë e besimit në ardhjen e Dexhxhalit në mënyrën çfarë na ka shpjeguar Pejgamberi s. a. v. s, me të gjitha cilësitë dhe vetitë për të cilat na ka informuar ai dhe se, fundi i tij do të jetë ashtu siç ka thënë ai, dhe se ky është një nga parashenjat e mëdha të Ditës së Kiametit.

160 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 18: 63 e më tej.

Nëse dikush do të thoshte: “Si do t’ia mundësojë All-llahu xh.sh. të gjitha ato vepra mbinatyrore, kur e dimë se mu’xhizet janë karakteristike vetëm për Pejgamberët?”, do të përgjigemi me fjalët e imamit të famshëm El-Hattabit, i cili në lidhje me këtë çështje ka thënë: “Kjo është kështu vetëm për t’u sprovuar njerëzit, sepse ata në të njëjtën kohë kanë argumente të qarta në të cilat në mënyrë pakontestuese flasin se ai është rrenacak dhe se nuk është e vërtetë ajo që konfirmon ai, siç është verbëria e tij dhe fjala “kafir” që i shkruan në ballë, e që do ta lexojë çdo besimtarë. Pra, komfirmimet e tij janë përgënjeshtuar me vetë faktin se ai nuk do të jetë në gjendje t’i largojë shenjat e mangësisë dhe të gjymtësisë nga vetvetja, e sikur të ishte zot, ai do të ishte në gjendje ta bëjë këtë. Ndërsa, mu’xhizet e Pejgamberëve nuk viejnë në kundërshti me asgjë, kështu që ato assesi nuk mund të krahasohen me këtë.”¹⁶¹ Ndërsa Ibni Haxheri thotë: “Megjithatë, Dexhxhali në vete mbanë shenja të cilat janë të mjaftueshme për atë që është i arsyeshëm, që të kuptojë se ai me të vërtetë është rrenacak. Sepse, ai është i përbër nga pjesët dhe në të shihet se është i krijuar. Duke i pasur këto të meta të dalluara, të cilat shihen në syrin e tij dhe në ballin e tij, kur u thotë njerëzve se ai është zoti i tyre, gjëja më e vogël që do të konkludojë njeriu më i paditur nga njerëzit e ditur do të jetë se ai i cili nuk është në gjendje t’ia largojë vetes të metat, ai as që mund të jetë në gjendje që të tjerët t’i krijojë në formë të përkryer. Andaj, më së paku që do të mund të thuhet, është: “O ti, që pohon se je krijuar i qiejve dhe i Tokës, së pari rregulloje veten dhe largoji të metat tua, e nëse thua se Zoti asgjë nuk i bënë vetes atëherë fshije atë që të është shkruar në mes dy syve të tu!”¹⁶²

161 Transmeton Ibni Haxheri në Fet’hul Bari, 13: 89.

162 Transmeton Ibni Haxheri në Fet’hul Bari, 13: 89.

D - ZBRITJA E ISAÏT A.S.

Ekzistojnë argumente në hadithe, si dhe pajtueshmëria e ulemasë në atë se, në periudhën e fundit të kësaj bote do të zbresë Isai a.s. në kohën e Dexhxhalit, dhe se do ta mbyisë atë, e pastaj do të sundojë sipas ligjeve të Sheriatit, do t'i ringjallë të gjitha ato që njerëzit i kanë lënë pas dore nga ligjet e All-llahut xh.sh., do të qëndrojë në tokë një kohë të caktuar nga ana e All-llahut xh.sh. dhe do të vdesë. Ndërsa myslimanët do t'ia falin xhenazen dhe do ta varrosin. Për këtë na flasim shumë hadithe sahih, prej të cilave disa tanimë i kemi cituar. Prandaj, çdo mysliman është i obligueshëm të besojë në zbritjen e tij dhe në atë që na flet Kur'ani në mënyrë të qartë se atë nuk e kanë mbytur hebrenjtë, por se All-llahu xh.sh. e ka ngritur tek Ai, dhe se ai nuk do të vdes para se të zbresë në prag të Ditës së Kiametit. All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe për shkak të fjalëve të tyre: “Ne e kemi mbytur Mesihun - Isain, të birin e Merjemës, Pejgamberin e All-llahut”. Por, ata, as nuk e kanë mbytur as nuk e kanë gozhduar (nuk e kanë kryqëzuar në gozhda), por iu ka përngja atyre (një person). Ata që bënë polemikë rreth çështjes së tij, ata me siguri gjenden në dyshim për të (Isain). Ata nuk kanë ditur kurrëgjë për te, por vetëm u janë mbështetur supozimeve. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë mbytur, por, All-llahu e ka ngritur pranë Vetes (në një vend që nuk arrijnë njerëzit). Se All-llahu është i Plotfuqishëm, i Gjithdijshtëm. Të gjithë ithtarët e Librit, para se të vdesin, do t'i besojnë Isait (që është Pejgamber e jo Zot); e, në Ditën e Kiametit, ai (Isai) do të jetë dëshmitar kundër tyre” (En-Nisa': 157-159).

Kundroji vetëm fjalët e All-llahut xh.sh.: “Por, ata, as nuk e kanë mbytur as nuk e kanë gozhduar, por iu ka përngja atyre.” Ibni Kethiri, duke i komentuar fjalët e All-llahut xh.sh.: “Të gjithë ithtarët e Librit, para se të vdesin, do t'i besojnë Isait.”, thotë: “Ibni Xheriri thotë: “ Mendimi më i

drejtë prej këtyre mendimeve është ai ku thuhet se nuk do të mbetet asnjëri nga ehli kitabët pas zbritjes së Isait a.s., e të mos besojë në të para se të vdes.” Dhe nuk ka dyshim se kjo që ka thënë Ibni Xheriri është e saktë, sepse plotësisht insertohen në kontekstin e rrëfimit kur’anor mbi pavërtetësinë e konfirmimeve të hebrenjve se ata e kanë mbytur Isain a.s., dhe se e kanë gozhduar, e që u kanë besuar një numër i të krishterëve. All-llahu xh.sh. na informon se kjo nuk ka ndodhur kështu, por se vetëm iu ka përngja atyre, dhe e kanë mbytur një të ri që i përngjante Isait a.s., e ata as që kanë qenë të vetëdijshëm për këtë. Pastaj All-llahu xh.sh. e ka ngritur pranë Vetes dhe ai ka mbetur gjallë e do të zbresë para ardhjes së Ditës së Kiametit, për çka na flasin hadithet të cilat kanë arritur shkallën e tevaturit. Ai do ta mbysë Dexhhalin, do ta thyejë kryqin, do ta mbysë derrin dhe do t’i lirojë njerëzit nga xhizja (ngase më nuk do të ketë jobesimtarë). Ky ajet na informon se atij do t’i besojnë të gjithë hebrenjtë dhe të krishterët dhe se askush prej tyre nuk do të mbetet pa besuar.”¹⁶³

Nga hadithet që flasin për zbritjen e Isait a.s., është edhe hadithi që e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi, se Ebu Hurejre r.a. ka thënë: “Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Pasha All-llahun, nuk është larg koha kur mes jush do të zbresë i biri i Merjemës e të gjykojë drejtësisht, pastaj do ta thyejë kryqin,¹⁶⁴ do ta mbysë derrin dhe do të lirojë nga xhizja,¹⁶⁵ atëherë do të shumëzohet

163 Tefsir bin Kethir, 1: 577.

164 Me këtë nënkuptohet se ai më në fund do ta rrëzojë teorinë mbi kryqin dhe do ta përgënjeshtrojë madhërimin e tij nga ana e të krishterëve. Shih: Ed-Dinul kalis, 1: 92.

165 Isai a.s. do ta anulojë xhizjen ndaj pasuesve të ehli kitabit dhe kjo nuk do të pranohet prej tyre, por vetëm Islami. E kjo nuk do të thotë se Isai a.s. do ta anulojë një dispozitë të Sheriatit, por se ky hadith

pasuria¹⁶⁶ kështu që askush nuk do të dëshirojë ta pranojë atë (xhizjen). Atëherë një sexhde do të jetë me e vlefshme¹⁶⁷ se çdo gjë në këtë botë.”¹⁶⁸

Ekzistojnë edhe shumë hadithe të tjera, të cilat flasin për këtë.¹⁶⁹ Kadi Ijadi thotë: “Zbritja e Isait a.s. dhe mbytja e Dexhxhalit nga ana e tij, është e vërtetë dhe besimi në këtë nga ana e ehli Sunnetit është korrekt për shkak të haditheve sahih që flasin për këtë dhe se nuk ekziston asgjë, as në arsyen, as në Sheriat, që e konteston këtë, prandaj edhe ne jemi të obliguar të pranojmë këtë. Disa mu’etezilë dhe ithtarët e tyre e refuzojnë këtë, duke konsideruar se këto hadithe i kundërshton ajeti kur’anor ku thuhet se Muhammedi a.s. është Pejgamberi i fundit, që ka vërtetuar edhe vetë Resulull-llahu s.a.v.s. me fjalët: “Pas meje më nuk ka Pejgamber.” Me të vërtetë, pajtueshmëria e plotë e të gjithë myslimanëve në atë se pas Pejgamberit tonë s.a.v.s. nuk do të ketë më Pejgamberë dhe se Sheriati i tij do të jetë në fuqi gjersa ekziston kjo botë dhe se askush nuk mund ta zhvlerësojë atë, është tërësisht me vend. Mirëpo, të merret kjo si argument është tërësisht e pa bazë, ngase hadithi nuk thotë se Isai a. s do të zbresë si Pejgamber me Sheriat

tregon se pranimi i xhizjes nga ehli kitabët është caktuar gjër tek zbritja e Isait a.s. Shih: Ed Dinul kalis, 1: 92.

166 Pasuria do të shtohet për shkak të drejtësisë së Isait a.s. të cilën do ta zbatojë mes njerëzve.

167 Me këtë tregohet se njerëzit shumë më pak do ta lakmojnë pasurinë, për shkak të të kuptuarit të tyre se Dita e Kiametit është afër, andaj do të dëshirojnë që sa më shumë të bëjnë vepra të mira.

168 Muttefekun ‘alejhi. Shih: El lu’lu’ vel merxhan, 1: 31.

169 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 7: 302; Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 2: 189; Sahih Tirmidhi, 9: 76; Sunen bin Maxhe, vëllimi i dytë, kaptina mbi finelucët; El Fet’hur Rabani, 2: 143.

të ri. Kështu nuk mund të kuptohet nga hadithet e përmendura, e as nga hadithet e tjera që flasin për zbritjen e Isait a.s.

Përkundrazi, në këto hadithe theksohet se ai do të sundojë drejtësisht sipas Sheriatit tonë dhe do t'i ringjallë të gjitha ato gjëra që i kanë lënë njerëzit pas dore nga ligjet e tij.”¹⁷⁰

D - PARAQITJA E JE'XHUXHIT DH ME'XHUXHIT

Edhe për këtë parashenjë flitet në Kur'an. All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe ai përsëri shkoi (në një rrugë kah veriu). Kur arriti në mes dy bjeshkëve, gjeti afër tyre një popull, i cili, thuajse nuk kuptonte asnjë të folme. Ata thanë: “O Dhulkarnejn, - me të vërtetë Je'xhuxhi dhe Me'xhuxhi bëjnë çrregullime në Tokë, a don të të japim dhuratë që të ndërtosh një mur në mes nesh dhe atyre?” (Dhulkarnejni) tha: “Atë që më ka mundësuar Zoti im, është më e mirë (nga ajo që ofroni ju), por më ndihmoni ju mua sa të mundeni, e unë do të ndërtoj një mur ndërmjet jush. Më sillni copa të mëdha hekuri!” E, kur ai i rrafshoi dy anët e bjeshkëve, tha: “Fryni zjarrit, përderisa hekuri të mos skuqet si zjarri!” Pastaj tha: “Më sillni bakër të shkrirë që ta hudhi në të!” Dhe kështu, ata (Je'xhuxhi dhe Me'xhuxhi) nuk kanë mundur ta kapërcejnë as nuk kanë mundur ta zhbirojnë (pendën). (Dhulkarnejni) tha”Kjo është dhuntia e Zotit tim! E, kur të

170 Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 18: 75-76.

plotësohet premtimi i Zotit tim, (Ai) do ta rrafshojë atë (pendën) me tokë, e premtimet e Zotit tim janë të vërteta.” (El-Kehf, 92-98)171

171 Sejjid Kutbi - rahimehullahu - duke komentuar këto ajete, thotë: ”Ne, me siguri mund të konfirmojmë se vendi ku ka arritur Dhulkarnejni është ndërmjet dy kodrave, por cilat janë këto dy kodra, ne nuk mund ta dimë. E tërë ajo që mund të mësohet nga këto ajete, është se ai ka vajtur në një vend i cili gjendet ndërmjet dy parmakëve natyrorë ose dy pendave artificiale, të cilat ndajnë kalimin në luginë dhe se aty ka hasur një popull të cilët mezi kuptoheshin mes veti. Kur e panë se ai ishte i fuqishëm dhe i drejtë, e lutën që t’ua ndërtojë një pendë përpara Je’xhuxhit dhe Me’xhuxhit, të cilët vazhdimisht i sulmonin nga ato dy kodra përmes atij kalimi dhe u shkaktonin dëme të mëdha në njerëz dhe në pasuritë materiale, e ata nuk ishin në gjendje të mbroheshin prej tyre. Si kundërvlerë ata do t’ia paguanin një shumë të caktuar të hollash që do të mund t’i mblihdnin. Mirëpo, sunduesi i drejtë i mbetet konsekuent parimit të bamirësisë dhe luftës kundër padrejtësisë dhe çrregullimeve, dhe pranon që vullnetarisht t’ua ndërtojë pendën duke refuzuar ofertën e tyre. Ai vërenë se, mënyra më e lehtë ishte ta mbyllë kalimin ndërmjet dy kodrave, andaj kërkoi prej tyre që ta ndihmojnë me mjete materiale dhe me fuqi punëtore. Ata mblodhën copa të mëdha hekuri të cilat ai i vendosi ndërmjet dy parmakëve, dhe kur e rrafshoi shtresën e hekurit, atëherë kërkoi prej tyre bakër të shkrirë të përzier me hekur në mënyrë që ta derdhë atë mbi shtresën e hekurit e kështu ta përforcijë pendën. Sot në mënyrën më bashkëkohore përdoret i njëjti sistem për përforcimin e hekurit dhe është konstatuar se me shtimin e një sasive të bakrit në hekur, forcohet qëndrueshmëria dhe rezistenca e tij. Në këtë All-llahu xh.sh. qysh atëherë e ka udhëzuar Dhulkarnejnin dhe e ka shënuar në Librin e Vet të amshueshëm duke i paraprirë kështu shekuj me rradhë shkencës bashkëkohore njerëzore, numrin e të cilëve nuk e di askush përveç All-llahut xh.sh. Në këtë mënyrë tërësisht u bashkuan dy parmakët dhe u mbyllë rruga e Je’xhuxhit dhe Me’xhuxhit, të cilët nuk ishin në gjendje as ta kapërcejnë e as ta zhbirojnë, dhe iu bë e pamundshme që

“Dhe kur të hapet ajo (penda), e dalin Je’xhuxhi e Me’xhuxhi dhe lëshohen prej çdo lartësie duke shpejtuar dhe të afrohet premtimi i vërtetë (Dita e Kiametit), në atë çast - shikimet e atyre që nuk kanë besuar, do të shtangen, (e do të thonë): “Të mjerët ne! Na kemi qenë të pakujdesshëm ndaj kësaj. Jo, por ne - vetes i kemi bërë zullum.” (El-Enbija: 96-97).

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Zejneb bint Xhahshi r.a., e cila thotë se një herë Resulull-llahu s.a.v.s. kishte hyrë tek ajo shumë i shqetësuar duke thënë: “La ilahe ilAll-llah, mjer arabët nga fatkeqësia e cila tanimë u është afuar, sot penda e Je’xhuxhit dhe Me’xhuxhit është hapur kaq”, dhe e bëri një rreth me gishtin tregues dhe të madh. Zejnebja tha: “O i Dërguari i All-llahut! A mos vallë, do të jemi të shkatërruar, e ndër ne ka njerëz të mirë?” Tha: “Po, nëse rritet e keqja.”¹⁷²

ta sulmojnë atë popull të pafajshëm dhe të prapambetur. Dhulkarnejni e shikoi projektin e madh të cilin e përfundojë vetë, por nuk e kaplojë kryelartësia dhe madhështia, e as që e joshi fuqia dhe dijenia e vet, por e përkujtoi All-llahun xh.sh. dhe e falënderoi Atë, duke ia përshkruar Atij këtë punë të madhe, të cilën ia mundësojë ta kryente me sukses. Ai tërësisht u rezervua nga fuqia e vet dhe këtë ia përshkruajti All-llahut xh.sh., duke u shprehur se ai beson se të gjithë pendat dhe të gjitha malet do të thërrmohen tërësisht në Ditën e Kiametit dhe se Toka do të bëhet tërësisht e rrafshtë dhe lakuriq. E, për sa i përket pyetjes: kush janë Je’xhuxhi dhe Me’xhuxhi, ku janë ata tani, ç’ka ndodhur me ta dhe çka do të ndodhë me ta, në të gjitha këto pyetje është tejet vështirë të përgjigjemi, sepse ne për ta nuk dimë asgjë më tepër se ç’na ka informuar Kur’ani dhe ndonjë hadith sahih lidhur me ta.” Fi Dhilali Kur’ani Kerim, 5: 411-413.

172 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 13: 91 e tutje.

Imam Muslimi transmeton nga Nuvas bin Sem'ane r.a. një hadith, të cilin tanimë e kemi cituar, ku përmendet zbritja e Isait a.s. dhe Je'xhuxhi e Me'xhuxhi të cilët do të zbresin nga bregoret e tyre, e pjesa e parë e tyre do të kalojë pranë liqenit Tabarijje dhe do ta pijnë tërë ujin e saj, e kur të arrijnë ata të fundit, do të thonë: “Si duket, këtu më parë ka pasur ujë.”¹⁷³

Ekzistojnë ende hadithe që flasin për Je'xhuxhin dhe Me'xhuxhin, ndërsa tërësia e të gjitha ajeteve dhe haditheve që flasin për ta, na bën të ditur se ekziston bindja e fuqishme se ky popull do të paraqitet duke bërë çrregullira në përfundim të kësaj bote. Prandaj, çdo mysliman është i obliguar të besojë në tërë atë me çka ka ardhur Kur'anit dhe hadithet sahih lidhur me ta. E. për sa i përket përcaktimit të kohës se kur do të paraqiten, detajet se si duken e të ngjashme, apo për vendin se ku gjenden ata sot, të gjitha këto bëjnë pjesë në gajb, të cilin nuk e njeh askush përveç All-llahut xh.sh.

4 - FILLIMI I DITËS SË GJYKIMIT

Jemi të obliguar të besojmë se, pas ndodhjeve të ngjarjeve të përmendura, do të ngjajë ajo mbi çka All-llahu xh.sh. na informon në Kur'an, e posaçërisht në suren Et-Tekvir dhe El-Infitar ku shpjegohen ngjarjet e asaj dite dhe fillimi i jetës së ardhshme. Togu i ajeteve kur'anore mbi këtë temë na mëson se bota e ardhshme do të fillojë me ndërrime tejet të mëdha në Gjithësi, se qielli

173 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 18: 68.

do të çahet, yjet do të bien, planetët do të ndeshen, toka do të copëtohet dhe do të bëhet krejtësisht e rrafshtë dhe lakuriq, malet do të bëhen si lesh i lënurur, se gjithçka do të ndërrohet dhe çdo gjë që kanë njohur njerëzit në këtë botë do të jetë e shkatërruar. All-llahu xh.sh. thotë:

“Në ditën kur Toka do të zëvendësohet me tokë tjetër, por edhe qiejt, e kur të gjithë dalin sheshazi para All-llahut, Një të Vetmit, të Plotfuqishmit.” (Ibrahim, 48).

Kjo do të ndodhë pas fryrjes së parë në bri, që do ta bëjë Israfilin, sipas urdhrit të Zotit të tij, kur do të vdes gjithçka që gjendet në Tokë dhe në qiejt, pos atyre që All-llahu xh.sh. do t'i i shpëtojë me vullnetin e Vet.¹⁷⁴ All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe do të fryhet në Sur (bori), dhe do të vdesin ata që gjenden në qiejt dhe që gjenden në Tokë, do të mbesin vetëm ata që do All-llahu, pastaj do të fryhet për të dytën herë në Sur dhe ata përnjëherit do të ngjallen e do të presin (se çka do të ndodhë).” (Ez-Zumer: 68).

“E kur të fryhet një herë buria, e toka dhe malet të ngriten e të copëtohen nga një shpërthim (eksplozim), atë ditë do të ngjajë Dita e Kiametit, dhe qielli do të çahet - atëherë do të jetë i thyeshëm, dhe engjëjt do të qëndrojnë në skajet e tij, e atë ditë, tetë (engjëj) do ta bartin Arshin e Zotit tënd.” (El-Hakka: 13-17)

Ebu Hurejre r.a. transmeton se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “All-llahu do ta marrë Tokën e qiejt do t'i mbështjellë me të djathtën e Vet, pastaj do të thotë: “Unë jam Sunduesi, ku janë sunduesit e Tokës?”¹⁷⁵

174. Sahihu-l-Buhari me'a Fet'hul Bari, 11: 313.

5 - RINGJALLJA

Dhe besojmë se pas kësaj All-llahu xh.sh. do ta urdhërojë Israfilin që të fryjë për të dytën herë,¹⁷⁶ pas së cilës do t'u kthehet jeta të vdekurve. Dhe kjo është Dita e ringjalljes, kur njerëzve do tu kthehen shpirtrat dhe trupat e tyre, siç kanë qenë në jetën e kësaj bote (dynjallëk). Pastaj All-llahu xh.sh. do t'i nxjerrë njerëzit prej varreve të tyre, e jobesimtarët dhe munafikët do të thonë:

“...duke thënë: ‘Të mjerët ne! Po kush na ngjalli (çoj) prej shtretërve tanë?’” (Ju thuhet): “Ja, kjo është ajo që e ka premtuar Mëshiruesi i Madh, e Pejgamberët e kanë thënë të vërtetën.” (Ja Sin: 52).

Në hadithet autentike transmetohet se Muhammedi s.a.v.s. do të jetë i pari që do të dalë nga varri i tij. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Të gjithë njerëzit do të vdesin atë Ditë, e unë do të jem i pari që do të çohet, e Musai tanimë do të jetë nën Arsh, nuk e di se a ka vdekur fare me të tjerët.”¹⁷⁷

175 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 11: 313.

176 All-llahu xh.sh. na tregon për fryrjen e parë dhe të dytë në këto ajete: ”Ditën kur Toka do të dridhet nga tërmeti, pas të cilit pason tjetri.” (En-Nazi’at: 6-7). Er-raxhife do të thotë pas fryrjes së parë, kurse Er-radife pas fryrjes së dytë, siç na informon Ibni ‘Abbasi r.a. Shih: Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 11: 310-311.

177 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 11: 312.

6 - (EL-HASHËR) TUBIMI I TË GJITHË NJERËZVE NË NJË VEND PËR DHËNIEN E LLOGARISË

Gjithashtu besojmë se, pas ringjalljes dhe pas daljes nga varret, të gjithë njerëzit do të tubohen në një vend. All-llahu xh.sh. thotë:

“(Kujtoju atyre) Ditën kur do t’i tubojmë të devotshmit te i Gjithëmëshirshmi si musafirë të ftuar. Ndërsa mëkatarët i grahim në Xhehennem (si grigjën e kafshëve të etshme kah burimi).” (Merjem: 85-86).

Hashër është tubimi i të gjithë njerëzve në një vend të caktuar, ku do të presin derisa të gjykojnë. Pas ringjalljes All-llahu xh.sh. do t’u urdhërojë engjëjve që t’i sjellin të gjithë njerëzit në atë vend. Ata do të jenë ashtu siç kanë lindur: të zbathur, të zhveshur dhe të pabërë synet.

Në një hadith sahih transmetohet nga Aishja r.a. se ka thënë: “E kam dëgjuar Resulull-llahun s.a.v.s. duke thënë: “Në Ditën e gjykimit njerëzit do të ringjallen të zbathur, të zhveshur dhe të pabërë synet”. Unë i thashë: “O i Dërguari i All-llahut, e meshkujt dhe femrat bashkë, të shikojnë në njëri-tjetrin?” Tha: “Oj Aishe, gjendja (çështja) do të jetë aq e ashpër, saqë askujt nuk do t’i bie ndërmend ta shikojë tjetrin”. Sipas një transmetimi tjetër: “Çështja do të jetë më e rëndësishme se sa të shikojnë njëri-tjetrin”.

Transmetohet nga Ibni Abbasi r.a. i cili ka thënë: “I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. duke na këshilluar tha: “O njerëz, ju vërtet do të tuboheni tek All-llahu i Madhërisëm të zbathur, të zhveshur dhe të pabërë synet.” Pastaj tha: “Ashtu siç ju kemi krijuar herën e parë do të përsërisim

atë (krijim). Ky është premtimi Ynë, Ne me të vërtetë do ta bëjmë këtë” (El-Enbija:104)¹⁷⁸. Pastaj tha: “Njeriu i parë i cili do të vishet në Ditën e gjykimit është Ibrahim i s.a.v.s. Atëherë do të sillen disa njerëz të ummetit tim, e do të dërgohen në anën e majtë, e unë do të themë: “O Krijuesi im, këta janë shokët e mi!” Pastaj do të më thuhet: “Ti vërtet nuk e di çfarë kanë bërë ata pas teje”, kurse unë do të themë siç ka thënë Robi i mirë (Isai a.s.):”Kam qenë dëshmitar derisa isha në mesin e tyre, e pasi që ma more shpirtin, mbete Ti mbikëqyrës i tyre? Dhe Ti je dëshmitar i çdo sendi. Nëse i dënon, dënon robërit Tu, e nëse ua fal, me të vërtetë Ti je i fortë e i urtë”¹⁷⁹, e pastaj do të më thuhet: “Ata vazhdimisht janë kthyer prapa (janë bërë murted) qysh se je ndarë ti prej tyre”¹⁸⁰.

Në vendin e pritjes njerëzit do t’i godasë vështirësi e madhe. Nga Mikdad bin El-Esedi transmetohet se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Në ditën e Kiametit Dielli do t’u afrohet njerëzve, kështu që do të vijë në lartësi vetëm një mile,¹⁸¹ e njerëzit do të jenë në djersë në përshtatshmëri me veprat e tyre. Disa prej tyre do të jenë në djersë gjer te zokthat e këmbëve, disa gjer në gjunjë, disa gjer në fyt e disave do t’ua stërpikë gojën sikur të ishte i frenuar.” Resulull-llahu s.a.v.s. tregoj me dorë gojën e vet.”¹⁸² Gjatë asaj kohe, disa njerëz do të jenë nën hijen e

178 El-Enbija: 104.

179 El-Maide: 117-118.

180 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 8: 230 dh 11: 322.

181 Selim bin ‘Amir - transmetues i hadithit nga Mikdadi - thotë: ”Pasha All-llahun, unë nuk di se çka nënkuptonte me fjalën (mile), a milen tokësore apo Mil me të cilën stolisen sytë.” Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 17: 196.

182 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 17: 196

All-llahut xh.sh., siç na informon Resulull-llahu s.a.v.s. Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. dhe Ebu Se'idi r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Shtatë persona (lloje njerëzish) All-llahu do t'i vendosë nën hijen (mbrojtjen) e Tij atë Ditë kur nuk do të ketë tjetër përveç hijes së Tij. Ata janë: - Imami (udhëheqësi) i drejtë; - një i ri i cili është rritur në ibadet dhe respekt të All-llahut të Madhëruar; - një njeri, zemra e të cilit është e lidhur për xhamitë; - dy njerëz të cilët në emër të All-llahut duhen, janë shoqëruar dhe të tillë kanë mbetur gjer në ndarje (vdekje); - një njeri të cilin e ka thirrë një grua autoritative dhe e bukur, kurse ai e refuzon duke i thënë se i frikësohet All-llahut - njeriu i cili ndanë sadaka fshehurazi, ashtu që dora e majtë nuk e di çka bën (sa ndanë) e djathta; dhe njeriu që në vetmi e përmend All-llahun dhe i mbushen sytë me lotë”.¹⁸³

Kur njerëzit të mundohen dhe kur vështirësia e kësaj Dite të rëndë do t'u bëhet e padurueshme, ata do të kërkojnë nga Pejgamberët që ta lusin All-llahun xh.sh. t'i shpëtojë nga këto vuajtje dhe të ngutet me gjykim, e çdo Pejgamber do t'u preferojë Pejgamberin pas tij, derisa nuk vijnë tek Pejgamberi ynë, Muhammedi s.a.v.s., e ky do të angazhohet për ta, e All-llahu xh.sh. do të pranojë ndërmjetësimin (shefa'atin) e tij dhe njerëzit do të drejtohen ka gjykimi përfundimtar.

183 Sahihu-l-Buhari bi hashijetis Sindi, 1: 170; Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 7: 120-122; Es-sunenul kubra, 10-87; Sunenun Nesai, 8: 22-223.

7 - SHPËRBLIMI - NDËSHKIMI PËR VEPRAT E BËRA

Jemi të obliguar të besojmë se në Ditën e gjykimit njerëzit do të jenë të shpërblyer apo të ndëshkuar për veprat që i kanë bërë në këtë botë. All-llahu xh.sh. thotë:

“Atë Ditë All-llahu do t’ua plotësojë dënimin e merituar, dhe do ta dinë ata se All-llahu është e vërteta e qartë.” (En-Nur: 25).

“Kush bën një të mirë, për te ka shpërblim më të mirë (se atë që ka punuar),. E, ai që bën një të keqe, ai dënohet vetëm aq sa e meriton vepra e tij.” (El-Kasas: 84).

All-llahu xh.sh. në një hadith kudsijj thotë: “O robtë e Mi! Çdo gjë varet nga veprat tuaja, të cilat tek Unë janë të ruajtura dhe të llogaritura, kurse për të cilat Unë do t’ju shpërblej. Kush gjenë mirë, le ta falënderojë All-llahun kurse kush gjenë të kundërtën, mos ta fajësojë askë përveç vetvetes”.¹⁸⁴

¹⁸⁴ Kjo është pjesë e një hadithi të gjatë, të cilin e shënon Muslimi. Shih: Rijadus Salihin, 62-63 (në gjuhën shqipe f. 57).

8 - PARASHTRIMI I VEPRAVE NJERËZORE DHE GJYKIMI

Besojmë se shpërblimi apo ndëshkimi do të pasojnë pas gjykitimit të drejtë në Ditën e Kiameti, kur çdo njeri do të vijë para Zotit të vet, me ç'rast do ti prezentohen të gjitha veprat e tij dhe vetë do ta lexojë librin e vet. Pra jemi të obliguar t'i besojmë parashtrimin të veprave, gjykitimit dhe leximit të librit të veprave, sepse e tërë kjo është e vërteta që e ka theksuar Kur'ani, Sunneti dhe pajtueshmëria e ulemasë myslimane.

Argument për parashtrimin e veprave janë fjalët e All-llahut xh.sh.:

“... atë ditë do të ngjajë Dita e Kiametit, dhe qielli do të çahet - atëherë do të jetë i thyeshëm, dhe engjëjt të do të qëndrojnë në skajet e tij e atë ditë, tetë (engjëj) do ta bartin Arshin e Zotit tënd. Atë ditë do të pyeteni (paraqiteni ju), dhe asnjë fshehtësi e juaj nuk do të mbetet e pazbuluar.” (El-Hakka: 15-18)

“Dhe ata do të sillen para Zotit tënd, të radhitur (e do t'u thuhet): “Ju: Na keni ardhur ashtu siç u kemi krijuar herën e parë. E, ju keni menduar se nuk do t'jua plotësojmë premtimin.” (El-Kehf: 48).

Prandaj, çdo mysliman është i obliguar të besojë se secili njeri do të jetë i pyetur para All-llahu xh.sh. dhe se All-llahu xh.sh. do t'i drejtohet çdonjërit drejtpërdrejt pa ndërmjetësues.

Transmetohet nga Adijj ibën Hatimi se ka thënë: “I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: “Secilit prej juve Krijuesi i vet do t'i drejtohet drejtpërdrejt (me të folur-pyetje) pa përkthyes. Do të shikojë nga ana e tij e djathtë, e nuk do të shoh tjetër gjë veçse veprat e tij (të mira). Pastaj do të

shikojë nga ana e tij e majtë, e nuk do të shoh tjetër gjë veçse veprat e tij (të këqija). Do të shikojë përpara vetes e nuk do të shoh tjetër veçse zjarrin (e Xhehennemit) para fytyrës së tij. Andaj, mbrohuni nga zjarri (i Xhehennemit), qoftë edhe me gjysmë hurme, e kush nuk e gjen këtë atëherë me fjalë të mirë”.¹⁸⁵

Në parashtrimin e veprave bën pjesë edhe parashtrimi publik para të gjithë njerëzve të tjerë. Çdonjërit do t’i prezentohen veprat e tij, e nëse është njëri prej të shpëtuarve, atij do t’i ipet libri (i veprave) nga ana e djathtë dhe All-llahu xh.sh. do t’ia falë të gjitha mëkatet dhe nuk do ta pyes detajisht. Pastaj do ta shpie në Xhennet dhe nuk do të jetë i ndëshkuar me zjarr. E atij, mëkatet e të cilit janë më të mëdha, libri do t’i ipet nga mbrapa dhe do të jetë i pyetur detajisht për çdo vepër që ka bërë, të vogël apo të madhe. Transmetohet nga Aishja r.a. se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Ka dështuar çdonjëri veprat e të cilit do të shqyrtohen hollësisht në Ditën e Kiametit.” E unë thashë: “O i Dërguari i All-llahut, a nuk ka thënë All-llahu xh. sh: “Ai të cilit do t’i jepet libri në dorën e djathtë të tij, leht do të japë llogari.” Resulull-llahu s.a.v.s. tha: “Kjo ka të bëjë vetëm me parashtrimin e veprave, e secili që do të pyetet për veprat e tij në Ditën e Kiametit, ai do të jetë i ndëshkuar.”¹⁸⁶ Pra, ai që do të pyetet hollësisht për çdo vepër të tij, kjo është tanimë shenjë se nuk do të jetë i falur.¹⁸⁷

Pranimi dhe leximi i librit të veprave në Ditën e Kiametit nga ana e njerëzve është fakt i vërtetë të cilin jemi të obliguar ta besojmë. Kush mohon këtë, bëhet jobesimtar. All-llahu xh.sh. thotë:

185 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 11: 340.

186 Sahihu-l-Buhari, 11: 138.

187 Fet’hul Bari, 11: 138.

“Çdo njeriu ia kemi varë në qafë punën e tij dhe Na - do t’i paraqesim atij në Ditën e Kiametit - librin e hapur: (i thuhet): “Lexoje librin tënd, mjafton që ti sot vetë për veten të japish llogari!” (El-Isra: 13-14).

Gjithashtu jemi të obliguar ta besojmë atë ç’është thënë mbi të nga ana e All-llahut xh.sh. në këto ajete:

“Ti, o njeri, që përpiqesh shumë, mundin tënd do ta gjesh te Zoti yt. Atij që do t’i jepet libri i tij në dorën e djathtë, lehtë do të japë llogari, dhe do të kthehet i gëzueshëm te të afërmit e tij; e atij që do t’i jepet libri i tij pas shpinës, e thërret shkatërrim, dhe do të digjet në zjarr, sepse, (në jetë) ka qenë i gëzueshëm me familjen e tij, dhe ka menduar se kurrë nuk do të kthehet (ringjallet për të dhënë llogari). Po, po, do të kthehet te Zoti i tij, me të vërtetë, Ai i sheh të gjitha punët e tij!” (El-Inshikat: 6-15).

Me dhënien e librave, të cilat njerëzit do t’i lexojnë, nënkuptohen fletoret ku engjëjt kanë shkruar (shënuar) çdo gjë që ka punuar njeriu në këtë botë.¹⁸⁸ E, tanimë ke mësuar se një nga bazat e imanit është të besohet e tërë ajo që na ka informuar All-llahu xh.sh. përkritazi me engjëjt dhe punët e tyre dhe se jemi të obliguar të besojmë se All-llahu xh.sh. i ka obliguar engjëjt e caktuar që t’i shkruajnë (shënojnë) të gjitha veprat tona dhe fjalët tona, e këta janë Kiramen kitabin, për të cilit All-llahu xh.sh. thotë:

“Me të vërtetë, mbi ju vigjilojnë përcjellësit, që janë shkruar të nderuar tek Ne. Ata dinë se çka punoni.” (El-Infitar: 10-12).

188 Sherhul Bejxhuri ‘ala xhevhereti tevhid, f. 212.

“Ky është Libri Ynë (shënimet e veprave tuaja) që do t’ju tregojë të vërtetën Na, me të vërtetë, i kemi urdhëruar (engjëjt) që të shkruhen (shënohen) të gjitha ç’keni bërë.” (El-Xhathije: 29).

Tërë atë që shkruajnë engjëjt, njerëzit do ta lexojnë në Ditën e gjykimit.

E, për sa i përket llogarisë (hisabit), me këtë nënkuptohet se nga ana e All-llahut xh., sh njerëzve do t’u prezentohen veprat, fjalët dhe bindshmëritë e tyre,. qofshin ato të mira apo të këqija. Kjo do të ndodhë në vendin e tubimit, para se të nisen në vendet e caktuara të tyre, e pas pranimit të Librit. Atëherë, çdonjëri do ta kuptojë se çka ka bërë nga të mirat dhe nga të këqijat. All-llahu xh.sh. thotë:

“... Pastaj ata do të kthehen te Zoti i tyre, e Ai do t’i lajmërojë ata për atë që kanë punuar.” (El-En’am: 108).

Njerëzit do të dallohen nga pikëpamja e llogarisë. Disa prej tyre do ta japin atë shumë lehtë dhe shpejtë, kështu që All-llahu xh.sh. do t’ua tregojë të gjitha veprat e tyre dhe do t’i përkujojë për mëkatet që i kanë bërë, porse këtë askush tjetër nuk do ta shohë. E pastaj do t’ua falë ato dhe do të urdhërojë që t’i dërgojnë në Xhennet. Kurse disa prej tyre do të pyeten hollësisht për çdo vepër të bërë, madje edhe për atë më të voglën, dhe do të pyeten për shkakun dhe arsyen, porse asnjëra nuk do t’u pranohet. Andaj, këta njerëz do të jenë të shkatërruar së bashku me ata që janë shkatërruar. All-llahu xh.sh. do t’i urdhërojë një engjëlli që veprat e tyre të këqija t’i parashtojë haptazi para njerëzve, dhe kështu do të jenë të turpëruar dhe të poshtëruar para tyre.

Prandaj, besimtari është i obliguar që përherë t’ia parashtroi vetes llogarinë, para se të vijë ky i fundit, në mënyrë që të bëjë sa më shumë vepra të mira para se të bëhet vonë, dhe ta besojë llogarinë e Ditës së gjykimit dhe të përgatitet për të:

“Dhe Ne, në Ditën e Kiametit do të vendosim peshoja të sakta, e askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi për asgjë edhe nëse është fjala për peshë sa të një kokrrë haradalli (një lloj mëlme), Na do ta sjellim atë (për llogari), e Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje.” (El-Enbija: 47).

Resulull-llahu s.a.v.s. thotë: “Nuk do të lëvizë këmba e njeriut, përderisa nuk përgjigjet në pyetje: “Si e ka kaluar jetën? Çka ka punuar? Si e ka fituar pasurinë dhe ku e ka harxhuar atë? Në çka e ka dërmuar trupin e vet?”¹⁸⁹

Disa hadithe sahih na bëjnë me dije se një grupi besimtarësh All-llahu xh.sh. do t’u shprehë nderim të posaçëm dhe do t’i veçojë ata nga njerëzit e tjerë dhe do t’i shpie në Xhennet pa llogari dhe pa kurrfarë pyetjesh. Imam Muslimi shënon hadithin nga Ebu Hurejre r.a., i cili thotë se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Në Xhennet do të hyjnë 70. 000 njerëz nga ummeti im pa dhënë llogari.”¹⁹⁰

Për sa i përket mënyrës së llogarisë, në besojmë në atë që ka ardhur në Kur’an përkitazi me të dhe në hadithet autentike dhe në këtë nuk shtojmë asgjë, e as që mungojmë diçka, dhe as që pyesim diç që nuk është përmendur në to. Besojmë se All-llahu xh.sh. do ta përkujtojë çdo njeri për çdo

189 Transmeton Tirmidhiu dhe thotë se hadithi është hasen sahih. Shih: Sahihut-Tirmidhi bi sherh ibnil Arabi, 9: 253.

190 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 3: 88.

gjë që ka bërë në këtë botë, qoftë nga të mirat apo të këqijat dhe se kundër tij do të dëshmojë çdo gjë prej kujt All-llahu xh.sh. kërkon që të dëshmojë,¹⁹¹ e do të dëshmojë edhe Toka lidhur me atë që ka bërë njeriu në të. All-llahu xh.sh. thotë:

“Kur Toka të dridhet me dridhjen e tmerrshme të saj, dhe kur ajo (Toka) të nxjerrë atë që ka në mbrendinë e saj (barrën nga brenda), dhe njeriu të thërret: “Çka ka ajo (që bën këtë dridhje)?!” Atë ditë, ajo i tregon lajmet e veta (veprat e mira dhe të këqija) që kanë ngjarë në të, sepse Zoti yt e ka urdhëruar atë. Atë ditë, njerëzit do të paraqiten në grupe-grupe (të ndara), për t’ju treguar veprat e tyre: ai që ka punuar mirë, qoftë ajo e vogël madje sa thërmia - do ta shohin atë, kurse ai që ka punuar të keqe, qoftë madje sa thërmia - do ta shohin atë.” (Ez-Zilzal: 1-8).

Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se ka thënë: “Resulull-llahu s.a.v.s. na mësonte: “Atë ditë ajo do t’i tregojë lajmet e veta”, e pastaj tha: “A e dini se ç’janë lajmet e saj?” As’habët u përgjigjën: “All-llahu dhe i Dërguari i Tij e dinë këtë më së miri.” Ai tha: “Lajmet e saj janë, se ajo do të dëshmojë për çdo vepër që kanë bërë në të meshkujt dhe femrat, kështu që do të thotë: “Atë ditë dhe atë ditë ka bërë këtë e këtë.” Këto janë lajmet e saj.”¹⁹²

191 Mahmud Hattab es-Sebki thotë: ”Dije se atë Ditë madhështore kundër njeriut do të dëshmojnë njëmbëdhjetë dëshmitarë: gjuha, duart, këmbët, veshët, sytë, lëkura, Toka, nata, dita, engjëjt shkrues dhe pasuria”. Pastaj, si argument për këtë ka parashtruar disa ajete dhe hadithe. Shih: Ed Dinul halis, 1: 105 e më tej.

192 Transmeton Tirmidhiu dhe thotë se hadithi është hasen garib. Shih: Sahihut-Tirmidhi bi sherh ibnil Arabi, 9: 260.

Ne besojmë se gjatë dhënies së llogarisë do të dëshmojnë edhe pjesët e trupit: ghuha, duart, këmbët, lëkura dhe të tjera, për çdo gjë çka ka punuar njeriu, dhe se armiqtë e All-llahut do të grinden me organet veta, siç e thotë këtë All-llahu xh.sh.:

“(Kujtoju atyre) Ditën kur armiqtë e All-llahut do të tubohen te zjarri (në vendin e llogarisë), e do të tubohen duke u shtyrë me forcë (dhunë), dhe kur të vijnë tek ai (zjarri), kundër tyre do të dëshmojnë: veshët e tyre, sytë e tyre dhe lëkurat e tyre - për atë që kanë punuar. Ata u thonë lëkurave të tyre: “Pse dëshmuat kundër nesh?”, e ato do të përgjigjen: “All-llahu na ka bërë që të flasim - ashtu siç i ka dhënë aftësinë e të folurit çdo sendi. Ai u ka krijuar për të herë parën dhe tek Ai do të ktheheni (përsëri)”. Ju nuk jeni fshehur (nga frika), që kundër jush të dëshmojnë veshët tuaj, dhe sytë tuaj dhe lëkura juaj, porse keni besuar se All-llahu nuk do t’i dijë ato që i keni punuar.” (Fussilet: 19-22).

Gjithashtu, besojmë se Ditën e gjykimit All-llahu xh.sh. do të jetë i mëshirshëm ndaj besimtarëve, përkundër jobesimtarëve, ngase për këtë na informon Resulull-llahu s.a.v.s. All-llahu xh.sh. do të veçohet me robin e Vet mu’minin dhe do t’ia përkujtojë mëkatet që i ka bërë, e pastaj do t’ia fsheh ato dhe nuk do ta pyesë hollësisht. Transmetohet se dikush i ka thënë Ibnî Umerit r.a.: “Çka ke dëgjuar nga Resulull-llahu s.a.v.s. se ka thënë lidhur me pëshpëritjen e All-llahut xh.sh. me robin e vet mu’minin në Ditën e gjykimit?” Tha:”Dëgjova se tha: “Besimtari do t’i afrohet All-llahut përderisa Ai nuk e vë dorën e Vet mbi të e i thotë: “A e ke bërë këtë dhe këtë? Ai do të përgjigjet: “Po, e kam bërë.” Atëherë do t’i thotë: “A e kë bërë këtë dhe këtë?” Ai do të përgjigjet: “Po, e kam bërë.” E pastaj do t’i thotë: “Unë t’i kam fshehur ato në dynjallëk, e sot po t’i falë.” Pastaj do t’i jepet libri i veprave të mira. E, për sa i përket jobesimtarëve, ata do të thirren para të

gjithë njerëzve me fjalë: “Këta janë ata që kanë gënjyer për Zotin e tyre, le të jetë mallkimi i Allahut mbi mizorët.”¹⁹³

9 - HAVDI (BURIMI) I RESULULL-LLAHUT S.A.V.S.

Jemi të obliguar të besojmë në tërë atë që na ka informuar Pejgamberi s.a.v.s. për burimin e vet, të cilin All-llahu xh.sh. ia ka dhuruar atij dhe ummetit të tij, ngase hadithet që flasin për këtë, arrijnë gradën e tevaturit, dhe i transmetojnë më tepër se tridhjetë as’habë.¹⁹⁴

I pari që do të pijë nga ky burim do të jetë Muhammedi a.s., e pastaj ummeti i tij, gjersa jobesimtarët dhe mëkatarët që kanë bërë mëkate të mëdha¹⁹⁵, do të jenë të përzënë nga ai. Kjo do të ngjajë pas përfundimit të llogarisë me të gjitha detajet e saj, siç janë: vështirësitë e ndryshme, peshimi i veprave, leximi i librave etj. Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë:

“Unë do të jem para jush tek burimi. Ai i cili arrinë tek ai, do të ngopet. E, ai që pi nga ai, më kurrë nuk do të ketë etje. Atëherë do t’u ndalohet të afuarit njerëzve që i njoh unë dhe të cilët më njohin mua, dhe do të pengohen të takohen me mua, e unë do të themë: “Ata janë nga ummeti

193 Muttefekun ‘alejhi. Shih: Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 13: 407-408.

194 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 25; Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 15: 53; Sherhun ‘akidetil vasitijje li Muhammed Halil Herras, f. 115; Sherhul Bejxhuri ‘alal Xhevhere, f. 223; Ed Dinul halis, 1: 111.

195 Ed Dinul halis, 1: 111.

im!” Atëherë do të më thuhet: “Ti nuk e di se ç’kanë bërë ata pas teje.” E unë do të themë: “Mjer, ai, mjer ai që ka bërë ndërrime pas meje.”¹⁹⁶

Transmetohet nga Ukbe b. Amiri r.a. se Resulull-llahu s.a.v.s. doli një ditë dhe ua fali namazin e xhenazes luftëtarëve të vrarë në Uhud, mandej hipi në minber e tha: “Unë do të jem para jush (në burim) dhe unë jam udhëheqës dhe dëshmitar i juaj. Pasha All-llahun, ja, mu tani po e shoh burimin tim. Mua më janë dhënë çelësat e të gjithë thesarëve të tokës. Pasha All-llahun, unë nuk frikësohem se ju, pas vdekjes sime, do t’i ktheheni idhujtarisë, por kam frikë se do të grindeni duke garuar se cili prej jush do të arrijë më tepër pasuri.”¹⁹⁷

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Esmā, vajza e Ebu Bekrit r.a. se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Unë do të jem tek burimi dhe do të shikoj se cili prej jush do të më afrohet. Disa njerëz do të largohen, e unë do të themë: “O Zoti im, ata janë prej meje dhe nga ummeti im!” E do të më thuhet: “A s’ke dëgjuar se ç’kanë bërë pas teje? Pasha All-llahun, pas teje ata tërësisht kanë reneguar.”¹⁹⁸

Ne i besojmë tërë asaj që ka thënë All-llahu xh.sh. për përshkrimet e tij dhe konsiderojmë se ai është i vërtetë. Komentuesi i akaidës të Tahaviut thotë: “Nga hadithet që e përshkruajnë burimin mund të konkludohet se ai është burim shumë i madh, i cili mbushet nga Xhenneti, nga lumi Keuther, dhe është më i bardhë se qumështi, më i ftohtë se akulli, më i ëmbël se mjalti dhe ka erë

196 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 15: 53-54; El lu’lu’ vel merxhan, f. 106.

197 Muttefekun ‘alejhi. Shih: Sahihu-l-Buhari - pjesa për xhenazen - kapitina për namazin shehidit dhe Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 15: 75.

198 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 15: 55.

më të mirë se misku, se përfshinë një sipërfaqe jashtëzakonisht të madhe, i gjerë sa edhe i gjatë, saqë largësia ndërmjet dy skajeve të tij është sa zgjatë ecja në këmbë një muaj. Në disa hadithe qëndron se, sa më tepër që pihet ujë nga ai, aq më tepër do të zmadhohet. I Gjithëmadhërishëm është Krijuesi që mund të bëjë çdo gjë!”¹⁹⁹

Ndërmjet haditheve, që e përshkruajnë burimin, është edhe hadithi që e transmeton Buhariu nga Abdull-llah b. Amri r.a. i cili thotë se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Gjatësia e burimit tim është sa një muaj ecje në këmbë, ujin e ka më të bardhë se qumështi, erën e ka më të mirë se era e miskut, ndërsa enët e tij janë sikurse yjet në qiell, kush pinë prej tij më kurrë nuk do të ketë etje.”²⁰⁰

Hadithet që flasin për burimin e Pejgamberit s.a.v.s. e arrijnë gradën e tevaturit, janë të shumtë, prandaj të besuarit në to është pjesë e imanit. Kadi ‘Ijadi, rahimehullahu te’ala, thotë: “Hadithet që flasin për burimin janë autentike, të besuarit në të është farz, të konsideruarit për të vërtetë është pjesë e imanit dhe ky është realitet tek ehli Sunneti, nuk komentohet me alegori, e as që rreth këtij ekziston far mospajtimi. Hadithet mbi të janë muttevetir dhe i transmetojnë shumë as’habë. Muslimi i transmeton këto nga Ibni Amër b. El-Asi, Aishja, Ummu Seleme, Ukbe b. Amiri, Ibën Mes’udi, Hudhejfe, Harith b. Vehbi, El-Mustevridi, Ebu Dherri, Sevban, Enesi dhe Xhabir b. Sumeri. Të tjerët i transmetojnë nga Ebu Bekri, Zejd b. Erkame, Ebu Umame, Abdull-

199 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 251.

200 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 13: 396-398. Të njëjtin hadith e transmeton edhe Muslimi. Shih: Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 15: 55.

llah b. Zejdi, Ebu Berzete, Suvejd b. Hable, Abdull-llah b. Sanabihui, Bera' b. Adhibi, Esma bint Ebu Bekri, Havle bint Kajsî e të tjerë. Me këto transmetime hadithet arrijnë gradën tevatûr.”²⁰¹

Në disa hadithe sahih transmetohet se, çdo Pejgamber do ta ketë burimin e vet, ndërsa burimi i Pejgamberit tonë s.a.v.s. është më i madhi dhe më i ëmbli, dhe se prej tij do të pinë më shumë njerëz.²⁰²

10 - PESHORJA (PESHIMI I VEPRAVE)

Jemi të obliguar të besojmë se Ditën e gjykimit veprat e njerëzve do të peshohen me peshore, në mënyrë që të tregohet drejtësia e All-llahut. Xh.sh., e për çka na informon Kur’ani dhe hadithet autentike. All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe Ne, në Ditën e Kiametit do të vendosim peshore të sakta, e askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi për asgjë, edhe nëse është fjala për peshë sa të një kokrrë haradalli (një lloj mëlme), Na do ta sjellim atë (për llogari), e Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje.” (El-Enbija: 47).

“Peshimi i veprave atë ditë do të jetë i drejtë: atij që i rëndohet peshorja me vepra të mira, ai do të jetë i lumtur; kurse atij që i lehtësohet peshorja me vepra të mira, ai do ta humb veten, për shkak se i ka mohuar argumentet Tona” (El-A’raf: 8-9).

201 Këtë e transmeton Kadi ‘Tjad Neveviu në komentarin e vet Sahih Muslim, 15: 53.

202 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 151; Sherhul Bejxhuri ‘alel Xhevhere, f. 223; Ed Dinul halis, 1: 111.

“Atij (njeriu) veprat e të cilit rëndojnë në peshore, ai do të jetë në jetën e kënaqur (në jetën e përhershme), e atij (njeriu), veprat e mira të të cilit nuk rëndojnë në peshore, vendbanimi i tij do të jetë gremina e skëterrës.” (El-Kari’a: 6-9).

Hadithet na bëjnë të ditur se, kjo peshore, është terezi e vërtetë, e cila do t’i ketë dy krahë të barabartë dhe dy pjata, dhe se All-llahu xh.sh. do t’i shndërrojë veprat e njerëzve në gjëra me peshë, prej të cilave veprat e mira do t’i vë në një anë, ndërsa ato të këqijat në anën tjetër.²⁰³

Përkitazi me këtë Ibnul Kajjimi e ka thënë kasidën e njohur, ku qëndron:

“A mos vallë, nuk beson, se veprat e njerëzve, Ditën e Gjykimit, do të vihen në peshore,

Kjo do të ndodhë, e nganjëherë do të rëndojë njëra pjatë,

E nganjëherë pjata tjetër, siç qëndron në Kur’an,

Ajo do ta ketë edhe gjuhëzën, të cilën pjatat do ta lëvizin dhe do të shikojnë në të,

Kjo nuk është imagjinatë, por njëmendësi, për atë që ka iman.”²⁰⁴

Peshimi i veprave do të bëhet pas kryerjes së llogarisë, sepse peshimi është për shkak të ndëshkimit, andaj do të ngajë pas shqyrtimit të hollësishëm të të gjitha veprave. Me këtë do të

203 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 472; Sherhul ‘akidetil vasitijje, faqe 123; Ed Dinul halis, 1: 107.

204 Kasideti bin Kajjim - me komentarin e tij, 2: 593.

tregohet drejtësia e gjykimit,²⁰⁵ por nuk do të peshohen veprat e Pejgamberëve dhe veprat e njerëzve të cilat All-llahu xh.sh. i ka liruar nga dhënia e llogarisë.²⁰⁶

11 - URA SIRAT

Dhe besojmë se pas dhënies së llogarisë dhe peshimit të veprave, njerëzit do të nisen kah ura Sirat, e cila është vënë përmbi Xhehennem.

Kalimi nëpër Urë i përfshin të gjithë njerëzit: Pejgamberët, besimtarët, jobesimtarët, edhe ata që kanë dalur në llogari edhe ata që nuk kanë dalur. Dhe, ai që i është mbajtur rrugës (siratit) së drejtë në këtë botë, ai me siguri do ta kalojë këtë Sirat (urë). Në disa hadithe sahih, transmetohet se njerëzit do të kalojnë përmbi të, dhe se lehtësia dhe shpejtësia e kalimit nëpër të do të varet nga veprat e mira në këtë botë. Ndërmjet tyre do të ketë të tillë, që do të kalojnë me shpejtësinë e derdhjes së yllit (dritës), disa do të kalojnë me shpejtësinë e erës, disa me shpejtësinë e kapsallitjes së syrit, e disa duke ngarë. Pra, ata do të kalojnë me shpejtësinë e cila i përgjigjet veprave të tyre, gjersa nuk kalon besimtari i cili ka pasur pak vepra të mira, i cili me një këmbë do ta bëjë një hap përpara, ndërsa me tjetrën do të shkalitet, me një dorë do të kapet e tjetra do t'i shpëtojë, dhe atë do ta pëcëllojë zjarri, e kur të kalojë, do të thotë: “Qoftë i Lavdëruar All-llahu xh.sh. që na

205 Këtë e transmeton nga Kurtubi komentuesi i akaidës së Tahaviut, f. 472.

206 Sherhul Bejxhuri ‘alel Xhevhere, f. 215.

shpëtojë prej teje (zjarrit), pasi që na tregojë atë. Me të vërtetë, All-llahu xh.sh. neve na ka dhuruar atë që nuk ia ka dhuruar askujt tjetër.”²⁰⁷

Për urën Sirat, flasin disa hadithe, e ne do ta citojmë hadithin që e transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.:

“Disa njerëz e kanë pyetur Resulull-llahun s. a. v. s: “O i Dërguari i All-llahut, a do ta shohim Zotin tonë në Ditën e Gjykimit?” “A e keni vështirë ta shihni Hënën e plotë natën e kthjellët?” - pyeti Pejgamberi s.a.v.s.”Jo, o i Dërguari i All-llahut” - u përgjigjën ata.”A e keni vështirë ta shihni Diellin, para të cilit nuk ka kurrfarë reje?” - pyeti Pejgamberi s.a.v.s.”Jo, o i Dërguari i All-llahut” - u përgjigjën ata.”Ja pra, po kështu do ta shihni All-llahun. All-llahu xh.sh. do t’i tubojë njerëzit Ditën e gjykimit, e do të thotë: “Kush kë e ka adhuruar le ta ndjekë edhe tash!” Atëherë, ata që e kanë adhuruar Diellin, do ta ndjekin Diellin, ata që e kanë adhuruar Hënën, do ta ndjekë Hënën, e kush i adhuron tagutët (tërë ajo që adhurohet përveç All-llahut xh.sh.), do t’i pasojë tagutët, e do të mbetet ky ummet me munafikët mes tyre.²⁰⁸ Pastaj do t’u vijë All-llahu xh.sh. në pamjen çfarë nuk e njohin ata, e do të thotë: “Unë jam Zoti juaj”. E, ata do të thonë: “Kërkojmë mbrojtje nga

207 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 470; Sherhul ‘akidetil vasitijje, faqe 126.

208 Ata kanë mbetur në mesin e grupit të besimtarëve, ngase janë fshehur me iman në dynjallëk, e po ashtu edhe në Ahiret do t’i përcjellin besimtarët, dhe do të shkojnë pas nurit (dritës) së tyre, përderisa All-llahu xh.sh. nuk vë një mur mes tyre, me ç’rast e humbasin nurin e besimtarëve. Dhe vendi i tyre do të jetë pjesa më e thellë e Xhehennemit. Shih: Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 3: 19).

All-llahu prej teje,²⁰⁹ ky është vendi ynë dhe këtu do të qëndrojmë derisa të na vijë Zoti ynë. E kur të na vijë Ai, ne do ta njohim Atë.” Atëherë, All-llahu do t’u vijë në pamjen çfarë tanimë e njohin, e do t’u thotë: “Unë jam Zoti juaj.” Ata do të përgjigjen: “Ti je Zoti ynë.” Pastaj do të nisen pas Tij. Atëherë do të vendoset ura Sirat mbi Xhehennemin, e unë, së bashku me ummetin tim, do të jem i pari që do të kaloj. Atë Ditë do të flasin vetëm Pejgamberët a.s. Lutja (duaja) e tyre do të jetë: “O All-llahu im, shpëto, shpëto!” Mbi Urë do të ketë grremça të mëdhenj, si gjembat e sa’danit.²¹⁰ A e keni parë sa’danin?” - Po, u përgjigjën ata. “Ja pra, ata janë si gjembat e sa’danit, pos që madhësinë e tyre nuk e di askush pos All-llahut xh.sh. Ata do t’i rrëmbejnë njerëzit në pajtueshmëri me veprat e tyre të këqija. Ndërmjet tyre do të ketë edhe besimtarë të cilët, për shkak të mëkateve të tyre, do të mbesin në ta, e do të ketë të tillë të cilët megjithatë do të kalojnë e do të shpëtojnë.”²¹¹

209 Duke i komentuar këto fjalë, Kurtubi thotë: ”Ky do të jetë akt i tmerrshëm, me të cilin All-llahu xh.sh. do t’i sprovtojë robtë e Vet e t’i ndaj të mirët nga të këqijët. Pasi që munafikët kanë mbetur me besimtarët, duke pohuar se edhe ata janë besimtarë, dhe duke menduar se kjo është e lejuar edhe në Ahiret, ashtu siç ka qenë në dynjallëk, All-llahu xh.sh. do t’i sprovtojë ata në atë mënyrë që do të vijë në figurë të posaçme e të gjithëve do t’u thotë: ”Unë jam Zoti juaj.” Besimtarët do të përgjigjen negativisht, ngase ata e kanë njohur Atë dhe e dinë se një pamje e tillë nuk i përket All-llahut xh.sh. Prandaj kanë thënë: ”Kërkojmë mbrojtje nga All-llahu prej teje. Ne Atij nuk i përshkruajmë shok.” Ibni Haxheri e transmeton këtë nga Kurtubi në Fet’hul Bari, 11: 380-381.

210 Sa’adani është një lloj druri me gjemba jashtëzakonisht të mëdhenj.

211 Kjo është pjesë e një hadithi të gjatë, të cilin e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi, e këto janë fjalët e Muslimit. Shih: Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 13: 367 dhe Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 3: 17.

Me të kaluarit e Urës, mendohet në fjalët e All-llahut xh.sh.

“Dhe, nuk ka asnjë prej jush e që të mos arrijë tek ai.” (Merjem: 71).

E, tanimë kemi përmendur se të gjithë njerëzit do të kalojnë mbi të. Muslimi transmeton se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Në Xhehennem nuk do të hyjë askush prej as’habëve të mi, të cilët më janë zotuar nën lis.” Atëherë Hafsa tha: “Dhe secili prej jush do të arrijë tek ai?” Resulull-llahu s.a.v.s. tha: “All-llahu thotë: “Pastaj do t’i shpëtojmë ata që kanë besuar, e zullumqarët do t’i lëmë të gjunjësuar në të.” (Merjem: 72).²¹²

Me këtë hadith Pejgamberi s.a.v.s. na shpjegon se nuk do të thotë se secili që arrinë tek Xhehennemi edhe do të hyjë në të.²¹³ Pra, çdonjëri do ta kalojë Urën përmbi Xhehennem, e All-llahu xh.sh. do t’i shpëtojë besimtarët, ndërsa jobesimtarët do t’i lë të gjunjësuar në të. E, kur besimtarët e kalojnë Urën, do të ndalen mbi një bregore ndërmjet Xhehennemit dhe Xhennetit ku do të pastrohen llogaritë mes tyre, dhe, vetëm pasi që të pastrohen tërësisht, do t’u lejohet të hyjnë në Xhennet.

Transmetohet nga Ebu Se’id el-Hudrij r.a. se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Besimtarët do ta kalojnë rrezikun nga zjarri, pastaj do të jenë të ndalur në bregoren ndërmjet Xhennetit dhe Xhehennemit, ku do t’i pastrojnë mes veti të gjitha padrejtësitë që i kanë bërë njëri-tjetrit në dynjallëk, e kur të jenë tërësisht të pastruar dhe të gatshëm, do t’u lejohet të hyjnë në Xhennet.

212 Transmeton Muslimi. Shih: Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 16: 57.

213 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 471.

Pasha All-llahun, çdonjëri prej tyre do ta njoh vendin e vet në Xhennet më mirë sesa e ka njohur shtëpinë e vet në dynjallëk.”²¹⁴

12- XHENNETI DHE XHEHENNEMI

Pas të gjitha që i përmendëm, ne besojmë në ekzistimin e Xhennetit dhe Xhehennemit, dhe se ata janë krijime të All-llahut xh.sh., që i ka përgatitur për shpërblimin apo për ndëshkimin e robërve të Vet. Besojmë se All-llahu i ka krijuar para se t'i krijojë krijesat e tjera, se ekzistojnë tani dhe do të ekzistojnë përgjithmonë e kurrë nuk do të zhduken. All-llahu xh.sh. thotë:

“O ju që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lëndë djegëse të të cilit do të jenë njerëzit dhe gurët, dhe të cilin do ta mbikëqyrin engjëjt e fuqishëm dhe të ashpër, të cilët nuk u kundërshtojnë urdhrave të All-llahut dhe të cilët punojnë për atë që urdhërohen.” (Et-Tahrim: 6).

“Ditën kur do ta pyesim Xhehennemin: “A je mbushur?” E ai, përgjigjet: “A ka edhe më?” (Kaf: 30).

“A më e mirë është kjo gjendje, apo druri zekum. Ne, këtë sprovë e kemi bërë për zullumqarët. Njëmend, ky dru del nga fundi i Xhehennemit. Fryti i saj është si koka e dajve. Me të vërtetë, ata

²¹⁴ Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 11: 386.

do ta hanë këtë frut dhe do ta mbushin barkun. Pastaj, ata do të kenë një përzierje me ujë të nxehtë (për të pirë)” (Es-Saffat: 62-67).

Resulull-llahu s.a.v.s., duke përshkruar Xhehennemin, ka thënë: “Zjarri juaj është vetëm një nga shtatëdhjetë pjesët e zjarrta të Xhehennemit.” Dikush tha: “O Dërguari i All-llahut, me të vërtetë, edhe ajo është e mjaftueshme.” Pejgamberi s.a.v.s. tha: “Zjarri i Xhehennemit është më i fuqishëm se zjarri i dynjallëkut për 69 shkallë, e çdo njëra është e barabartë me temperaturën e saj.”²¹⁵

Duke i përshkruar ndëshkimet më të vogla (të buta) në Xhehennem, Resulull-llahu s.a.v.s. thotë: “Me ndëshkim më të vogël (të butë) në Xhehennem, në Ditën e Kiametit, do të jetë njeriu të cilit do t’i vihet gaca e zjarrit nën shputën e tij, e nga ajo do t’i vlijë truri.”²¹⁶

E, për sa i përket Xhennetit, All-llahu xh.sh. shpeshherë i përmend bukuritë e tij në Kur’an:

“E ata që i druajnë All-llahut, me të vërtetë, do të jenë në vend të sigurt, në mes kopshtijeve dhe burimeve; të veshur në petka (rrroba) mëndafshi të hollë dhe të trashë, duke ndejtur ulur përballë njëri-tjetrit. Kështu (do të jenë të shpërblyer), dhe ne do t’i martojmë ata me hyri, sybukur. Aty do të kërkojnë, çfarë pemësh dëshirojnë, e do të kënaqen (duke qenë të sigurt). Në to (xhennete), nuk do ta shijojnë vdekjen, pos vdekjes së parë (në këtë botë) dhe i ruan (All-llahu) prej dënimit të Xhehennemit. Kjo do të jetë dhunti prej Zotit tënd. Ky, me të vërtetë, do të jetë sukses i madh!” (Ed-Duhan, 51-57)

215 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 6-256-257; El-Muvetta’ f. 614.

216 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 11: 361.

“E, Xhenneti do t’u afrohet besimtarëve, jo larg. Kjo ju është premtuar, çdokujt që është penduar dhe ruajtur (nga kalimi në kufër), i cili frikohet prej Mëshiruesit edhe atëherë kur nuk e sheh kush dhe i cili vie me zemër të kthyer kah All-llahu. (U thuhet atyre) “Hyni në të (në Xhennet), në qetësi (e mirësi), kjo është Dita e përhershme!”. Në të do të kenë çka të duan - e prej Nesh edhe më shumë. (Kaf: 31-35).

“Me të vërtetë, ata që kanë besuar do të gjenden në kopshtet e Xhennetit dhe në lumturi, duke u kënaqur me atë që u ka dhënë Zoti i tyre. Zoti i tyre i ka ruajtur ata prej dënimit të Xhehennemit. (Atyre u thuhet): “Hani e pini me kënaqësi, për atë që keni punuar!” Të mbështetur në divane (kanape) të renditura, do t’i martojmë ata me hyrie, sysh të bukur. E, ata që kanë besuar dhe u shkojnë pas pasardhësit e tyre në besim, do t’ju bashkojmë pasardhësit e tyre dhe nuk do t’ju pakësojmë asgjë nga veprat e tyre - çdonjëri është peng (përgjegjës) për atë që ka punuar - dhe do t’ju zgjerojmë dhuntinë atyre me pemë dhe mish që ju ka ënda; ia zgjasin njëri-tjetrit gotat e mbushura, aty nuk do të ketë biseda të kota, as mëkate, - e, do të sillen rreth tyre shërbyes (gilmanët) djelmosha të ngjashëm me margaritarin e ruajtur” (Et-Tur: 17-24).

Resulull-llahu s.a.v.s. thotë se Zoti i tij, duke përshkruar Xhennetin, i ka thënë: “Unë u kam përgatitur robërve të mi të sigurtë çfarë sytë nuk kanë parë, veshët nuk kanë dëgjuar e as që ka mundur ti bie ndërmend dikujt.” Pastaj tha: “Lexoni, nëse doni: “Dhe askush nuk e di se çfarë gëzimesh të fshehta i presin si shpërblim për atë që kanë punuar.” (Es-Sexhde: 17).

Gjithashtu besojmë në polemika dhe diskutime që do të bëhen mes banorëve të Xhennetit dhe Xhehennemit. Shiko vetëm këtë skenë nga sureja El-A’raf:

“Dhe banorët e Xhennetit u thonë banorëve të zjarrit: “Na e kemi gjetur të vërtetën, atë që na është premtuar nga Zoti ynë. E ju, a e keni gjetur të vërtetën, atë që u ka premtuar Zoti juaj?” Ata (banorët e zjarrit) thonë: “Po!”. E, atëherë, një lajmëtar ndërmjet tyre thërret: “Me të vërtetë, mallkimi i All-llahut u takon zullumqarëve, të cilët i pengojnë të tjerët nga rruga e All-llahut dhe kërkojnë ta shtrembërojnë, e nuk besojnë në jetën tjetër!” (El-A’raf: 44-45).

“Banorët e zjarrit do t’u thonë banorëve të Xhennetit: “Derdhni pak ujë në ne, ose diçka nga ajo që u ka dhuruar All-llahu!” - Ata (në Xhennet) thonë: “Me të vërtetë, All-llahu këto i ka ndaluar për mohuesit.” (El-A’raf: 50).

Për sa i përket përjetësisë së Xhennetit dhe Xhehennemit dhe qëndrimit të përhershëm të besimtarëve në të parin, e jobesimtarëve në të dytin, lidhur me këtë flitet shpeshherë dhe kjo nënvizohet gati në çdo vend të Kur’anit ku përmendet Xhenneti dhe Xhehennemi. Përkitazi me këtë Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Kur të hyjnë xhennetlinjtë në Xhennet, e xhehennetlinjtë në Xhehennem, lajmëtari do të thërras: “O banorë të Xhennetit, nuk ka vdekje! O banorë të Xhehennemit, nuk ka vdekje!” Atëherë banorët e Xhennetit do të gëzohen edhe më shumë, ndërsa banorët e Xhehennemit, do të pikëllohen edhe më shumë.”²¹⁷

217 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 11: 351.

PJESA E GJASHTË BESIMI NË PËRCAKTIMIN E ALL-LLAHUT XH.SH.

Besimi në përcaktimin e All-llahut xh.sh. është një nga bazat e akaidës dhe baza e gjashtë e imanit. Andaj kush e mohon kaderin (përcaktimin e All-llahut xh.sh.), ai ka dalur nga feja e All-llahut xh.sh.

Që në fillim e kemi cituar Hadithin e Ibni Umerit r. a, prej të cilit transmetohet se Resulull-llahu s.a.v.s., kur e pat vizituar Xhibrili dhe e pat pyetur për imanin, ka thënë: “Të besosh All-llahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, Pejgamberët e Tij, botën e ardhshme dhe se çdo gjë që ndodh (e mirë a e keqe), ndodh sipas përcaktimit të All-llahut.”

DEFINICIONI I KADAASË DHE KADERIT

Dijetarët islam kanë qëndrime divergjente përkitazi me definicionin e kadaasë dhe kaderit. Disa këto i konsiderojnë si sinonime për një gjë të njëjtë, kurse disa të tjerë kaderin e definojnë ndryshe nga kadaaja, duke thënë: “Kaderi është dituria e All-llahut xh.sh. mbi atë se çka do të bëjnë krijesat e Tij në të ardhmen.²¹⁸ Ndërsa kadaa është krijimi i krijesave nga ana e All-llahut xh.sh. në pajtueshmëri me diturinë dhe vullnetin Tij.”

218 Tebsitul ‘akaidil islamijje li Hasan Ejjub, f. 79.

Disa të tjerë e thonë të kundërtën, e definicionin e kadaasë ia përshkruajnë kaderit, kurse definicionin e kaderit kadaasë, gjë që është e mundur.²¹⁹

E disa i definojnë me definicion të njëjtë duke thënë: “Kadaaja dhe kaderi janë pikërisht dy sisteme precize të cilat All-llahu xh.sh. i ka vendosur në këtë botë, Ligjet dhe ligjshmëritë e përgjithshme (natyre) me të cilat i ka ndërlidhë shkaqet dhe pasojat.”²²⁰ Këtë domethënie e përmend edhe Kur’ani, kur flet për Kaderin, siç qëndron në këtë ajet:

“... Dhe, çdo gjë tek Ai është me masë.” (Er-Ra’d: 8).

“Nuk ekziston asnjë send, e që të mos gjendet ajo në thesarin Tonë, e nga ajo Na japim vetëm aq sa është e nevojshme.” (El-Hixhër: 21).

“Ne çdo send kemi krijuar me masë të caktuar.” (El-Kamer: 49).

Sa bukur është përgjigjur imam Ahmedi, kur është pyetur për kaderin: “Kaderi është kudretur-Rrahman (fuqia e Mëshirëplotit).” Ibni Kajjimi në kasidën e vet thotë:

“E vërteta mbi kaderin, i cili shumë veta i ka hutuar, është se ai është kudretur Rrahman.”

Ibni Akili e ka lavdëruar këtë, kur ka dëgjua se Ahmedi - All-llahu qoftë i kënaqur me të - e ka thënë këtë. Definicioni i Ahmedit është, në të vërtet, i tërësishëm dhe i mjaftueshëm, sepse kaderi do të thotë ajo që All-llahu xh.sh. konfirmon me fjalët:

219 Kubral jekiniyatil kevnijje, f. 147.

220 Ela ‘akidul islamijje li Sejjid Sahik, f. 95.

“. Thuaj (o Muhammed!): “Për të gjitha vendos vetëm All-llahul.” (Ali Imran: 154).

“Dhe çdo gjë kthehet tek Ai.” (Hud: 123).

“... Në duart e të Cilit është pushteti mbi çdo gjë!” (Ja Sin: 83).

“... S’ka ndërmjetës tek Ai, përpos me lejen e Tij.” (Junus: 3).

Janë të shumtë ajetet që flasin se në Gjithësi nuk mund të ndodhë asgjë pa lejen dhe vullnetin e All-llahut xh.sh.

Tema e kaderit bazohet në të besuarit e cilësive të përsosura të All-llahut xh.sh. dhe në emrat e Tij të bukur, siç janë dituria, fuqia dhe vullneti. All-llahu xh.sh. thotë:

“... Ai di çdo gjë.” (El-Bekare: 29).

“Ai është më i dijsلمي për çdo gjë.” (El-Hadid: 2).

“Ai punon çka dëshiron Vet.” (El-Buruxh: 16).

Tahaviut thotë: “Çdo gjë zhvillohet sipas përcaktimit dhe dëshirës së Tij. Dëshira e Tij realizohet, e jo dëshira e njerëzve, përpos çka dëshiron Ai. Prandaj ajo që Ai u dëshiron, ajo edhe do të ndodhë, e ajo që Ai nuk u dëshiron, ajo as që do t’u ndodhë. Askush nuk është në gjendje t’i kundërvihet urdhrin të Tij, e as ta ndryshojë atë apo në çfarëdo mënyrë të ndikojë në të dhe askush nuk mundet ta zmbraps urdhrin e All-llahu xh.sh. me urdhrin e dikujt tjetër.”²²¹

221 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 153.

DOMETHËNIA E IMANIT NË KADER

Çdo myslimanë është i obliguar të besojë në përcaktimin e All-llahut xh.sh. dhe se çdo gjë që ndodhë, e mirë apo e keqe, e këndshme apo e hidhët, ndodhë më përcaktimin e Tij. Me besimin në kader nënkuptohet të besuarit në diturinë e amshueshme të All-llahut xh.sh., në vullnetin e All-llahut xh.sh. i cili realizohet dhe në plotfuqinë e Tij të tërësishme. Duke sqaruar këtë, shejhul-islam Ibni Tejmiu thotë: “Besimi në kader përfshinë dy shkallë, e çdo shkallë përfshinë nga dy gjëra:

SHKALLA E PARË:

Të besuarit në atë se All-llahu xh.sh., me diturinë e Tij origjinare, me të cilën është i stolisur përherë, e ka ditur se çka do të bëjnë krijesat e Tij. Se i ka ditur të gjitha punët e tyre, veprat e mira dhe mëkatet, nafakën e tyre dhe çastin e vdekjes së tyre. Pastaj All-llahu xh.sh. i ka shkruar në Lehti Mahvudh përcaktimet e të gjitha krijesave. Së pari e ka krijuar pendën (lapsin), e i ka thënë: “Shkruaj!” Penda pyeti: “çka të shkruaj?” “Shkruaj çdo gjë që do të ndodhë gjer në Ditën e Kiametit!” Prandaj, çdo gjë që i ndodhë njeriut, le ta dijë se assesi nuk ka mundur t’i shmanget asaj, e çdoherë që iu është shmangur diçkaje, le ta dijë se ajo assesi nuk ka mundur t’i ndodhë. Pendat janë tharë, ndërsa librat janë mbyllur. Përkitazi me këtë, All-llahu xh.sh., thotë:

“A nuk e di ti, se All-llahut - i është e njohur çdo gjë që gjendet në qiej e në Tokë? Të gjitha këto janë (shënuar) në Libër. Me të vërtetë, të gjitha këto, për All-llahun janë të lehta.” (El-Haxh: 70).

“S’ka mjerim (fatkeqësi) që e godet Tokën dhe juve, përveç asaj që është shënuar më parë në Libër (Lehvi Mahvudh) - kjo për All-llahun, me të vërtetë, është lehtë!” (El-Hadid: 22).

SHKALLA E DYTË:

Të besuarit në vullnetin e All-llahut xh.sh., i cili realizohet në tërësi dhe në plotfuqinë e pakufishme të Tij. Pra, të besuarit se çdo gjë ndodhë, ndodhë sipas dëshirës së All-llahut xh.sh., e ajo që nuk dëshiron Ai, as që mund të ndodhë. Dhe se, çdo lëvizje, sado e vogël që të jetë ajo, në qiej apo në Tokë, apo të prajturit (të moslëvizurit), ndodhë sipas vullnetit të All-llahut xh.sh. Dhe se në mbretërinë e Tij, nuk mund të ndodhë asgjë, që nuk dëshiron Ai. Se All-llahu xh.sh. është i plotfuqishëm të bëjë çdo gjë dhe se nuk ekziston kurrnjë krijesë as në qiej, e as në Tokë, e që All-llahu xh.sh. të mos e ketë krijuar atë, sepse tjetër Krijues dhe Sundues nuk ekziston. Krahas të gjitha këtyre, All-llahu xh.sh. i ka urdhëruar njerëzit që t’i binden Atij dhe Pejgamberëve të Tij, dhe ua ka ndaluar mëkatet. Ai i do mutekijët (të devotshmit), mirëbërësit dhe të drejtët. Është i kënaqur me ata të cilët besojnë dhe bëjnë vepra të mira. E, nuk i do jobesimtarët, e as që është i kënaqur me mëkatarët. Nuk urdhëron vepra të shëmtuara, e as që u lejon kufrin robërve të Vet, dhe nuk i pëlqen trazirat (fesad). Dhe, njerëzit bëjnë vepra, por në realitet, All-llahu xh.sh. është

Krijues i veprave të tyre. Njeriu është besimtar apo jobesimtar, i mirë apo i keq, ai falë namazin dhe agjëron, dhe posedon fuqinë e vet me të cilën vepron dhe posedon vullnetin, por All-llahu xh.sh. i ka krijuar edhe ata, edhe fuqinë e tyre, edhe vullnetin e tyre.²²²

Nga fjalët e Ibni Tejmiut - rahimehullahu te'ala - konkludohet se kaderi përfshinë katër shkallë:

Shkalla e parë: Besimi në diturinë origjinare të All-llahut xh.sh., dhe se Ai e ka ditur çka do të bëjnë njerëzit para se të bëjnë diç;

Shkalla e dytë: Të shkruarit e të gjitha këtyre në Lehvi Mahvudh;

Shkalla e tretë: Vullneti i All-llahut xh.sh. i cili realizohet dhe plotfuqia e tij e pakufishme;

Shkalla e katërt: Krijimi i të gjitha krijesave nga ana e All-llahut xh.sh. dhe se Ai është Krijuesi i vetëm, e çdo gjë tjetër është e krijuar.

Ndarja e kaderit, të cilit jemi të obliguar t'i besojmë, në kader të mirë dhe në kader të keq, bëhet vetëm në raport të njeriut me krijesa e tjera, e, për sa i përket kaderit në raport me All-llahun xh.sh., në tërësinë e tij, ai është vetëm kader i mirë, sepse e keqja nuk i përshkruhet All-llahut xh.sh.²²³ Dituria e All-llahut xh.sh., vullneti i tij, shkruarja, krijimi i të gjitha krijesave dhe i të gjitha ngjarjeve - të gjitha këto janë urtësi, drejtësi, mëshirë dhe e mirë, sepse e keqja nuk bën pjesë në kurrnjë cilësi dhe vepër të All-llahut xh.sh. Atij nuk mund t'i ngajë kurrnjë mangësi apo

222 Er revadetun nedijje sherhul 'akidetil vasijje, f. 252-253.

223 Mexhmu' fetava ibnu Tenijje, 8: 94-95; Sherhul 'akidetit-Tahavijje, f. 282; Er revdatin nedijje, f. 356.

e keqe dhe Ai është plotësisht i përkryer dhe i paarritshëm në Lartmadhërinë e Vet.²²⁴ Prandaj, nuk është e lejuar që vetë e keqja t'i përshkruhet All-llahut xh.sh., por është e lejuar që e keqja të jetë në strukturën e tërësisë, e cila i përshkruhet All-llahut xh.sh., siç thotë All-llahu xh.sh.:

“All-llahu është Krijues i çdo gjëje.” (Ez-Zumer: 62).

Dhe është e lejuar që e keqja të lidhet me shkakun e saj, siç thotë All-llahu xh.sh.:

“Thuaj: “I mbështetem Zotit të agimit, prej dëmit të çdo krijese, që Ai e krijoi.” (El-Felek: 1-2).

Dhe është e lejuar që e keqja të përmendet për pa e emëruar bërësin e saj, siç thotë All-llahu xh.sh. se xhinnët kanë thënë:

“Dhe ne - nuk dimë, se e keqja u është kushtuar atyre që janë në Tokë, apo Zoti i tyre don t'i udhëzojë ata në rrugë të mirë.” (El-Xhinn: 10).

Në realitet, All-llahu xh.sh. nuk ka krijuar të keqe të pastër, e cila në vete nuk përmbanë aspak të mirë, ngase urtësia e Tij nuk e lejon këtë. Nuk është e mundur që All-llahu xh.sh. të dëshirojë diç, ku ekziston e keqja totale dhe që në krijimtarinë e tij të mos ketë kurrfarë dobie. Në duart e All-llahut xh.sh. janë të gjitha të mirat, kurse e keqja nuk i përshkruhet Atij, por e tërë ajo që i përshkruhet Atij është e mira, e keqja ndodh ngase kjo nuk i përshkruhet Atij, sepse sikur t'i ishte përshkruar Atij, atëherë kjo nuk do të ishte e keqe. E të përshkruarit All-llahut xh.sh. e keqja sipas krijimit dhe lejimit, nuk është e keqe.²²⁵

224 El hasenetu ves-sejje li ibni Temijje, f. 190; Tejsirul ‘Azizil Hamid, f. 625.

225 Ed Dinul halis, 1: 144; Er revdatun nedijje, f. 356.

Sëmundja, bie fjala, për njeriun është mynxyrë momentale, por hajri, duke shikuar në ardhmëri dhe në raport me All-llahun xh.sh., është gjithsesi hajr, duke pasur parasysh se si All-llahu xh.sh. i falë mëkatet dhe i pastron njerëzit me anë të sëmundjes, të cilën ua jep atyre. Gjithashtu burgosja e besimtarëve nga ana e armiqve të All-llahut xh.sh., në shikim të parë, është e keqe, për shkak të dhembjeve dhe sprovimeve që e përcjellin atë, por kjo është pastrim i nefsit të njeriut, pastrim i radhëve të njerëzve dhe kultivim i shpirtit të njeriut, duke ia shtuar kësaj edhe shpërblimin e madh, mirësinë e pakufishme tek All-llahu xh.sh. Krijimi i Iblisit, gjithashtu, në vete mbanë urtësi të dukshme: siç është pendimi i njerëzve pas gabimeve, realizimi i adhurimit ndaj All-llahut xh.sh. përmes luftës kundër shejtanit dhe ndihmësve të tij, mbështetja në All-llahun xh.sh. dhe kërkimi i mbrojtjes tek Ai.²²⁶

226 Ibni Kajjim el-Xhevziije përmend shumë urtësi me krijimin e Iblisit. T'i përmendim disa prej tyre:

- a - Që njerëzit të binden në fuqinë e All-llahut xh.sh. për krijimin e kundërshtive. E ka krijuar këtë krijesë e cila është më e keqja nga krijesat e tjera, dhe e cila është shkaktare e të gjitha të këqijave, kurse të kundërtën nga ajo, e ka krijuar Xhibrilin i cili është një ndër krijesat më fisnike, më të pastra dhe më të ndershme dhe është shkaktar i të gjitha të mirave. Fuqia e All-llahut xh.sh. shfaqet edhe në krijimin e ditës dhe natës, sëmundjes dhe ilaçit, jetës dhe vdekjes, të bukurës dhe të shëmtuarës dhe i shumë gjërave të tjera, që, në mënyrë të padyshimtë, udhëzojnë në plotfuqinë e Tij.
- b - Shfaqja e shenjave të All-llahut xh.sh., të emrave të cilat udhëzojnë në plotfuqinë e Tij, siç janë: i Plotfuqishmi, Ai i cili ashpërsisht hakmerret, Ai i Cili ashpërsisht ndëshkon, Ai i Cili shpejtë i pastron llogaritë, Ai i Cili dënon me ndëshkim të ashpër, Ai i Cili e lartëson kë të dojë, dhe e poshtëron kë të dojë. Pra, duhet të ekzistojë diç që do t'i ndërlidhte të gjitha këta emra, e sikur njerëzit dhe xhinnet ta kishin natyrën e engjëjve, atëherë këto pasoja nuk do të mund të shiheshin.

Çdo e keqe është relative, sepse e mira është lidhur me veprat e All-llahut xh.sh. dhe me lejimin e Tij të së njëjtës, ndërsa e keqja është lidhur me atë që me të vërtetë paraqet të keqe. Pra, e keqja i ka dy anë, njëra prej tyre është e mira, e kjo është ana e cila ndërlidhet me All-llahun xh.sh., i Cili e ka krijuar dhe e ka lejuar atë për shkak të urtësisë së caktuar dhe dobisë së saj, të cilën vetëm Ai e di dhe i tregon kujt të dojë prej robërve të Vet.²²⁷

-
- c - Realizimi i emrave dhe cilësive të All-llahut xh.sh., të cilat në vete përmbajnë butësi, tolerim, falje, mbulesë, kalim mbi kundërvajtjet lidhur me të drejtat e Tij dhe lirim nga ndëshkimi kë të dojë prej robërve të Vet. Sikur të mos i kishte krijuar mjetet dhe shkaqet, me ndihmën e të cilave shprehen këto cilësi, atëherë nuk do të ekzistonin të gjitha këto dobi dhe urtësi.
- d - Realizimi i emrave të urtësisë dhe diturisë, sepse All-llahu xh.sh. e lartëson kë të dojë dhe e poshtëron kë të dojë, dhe Ai e di më së miri se kujt do t'ia besojë Shpalljen dhe kush është i denjë ta pranojë atë dhe ta falënderojë Atë, për këtë dhunti të Tij.
- e - Sajimi dhe shfaqja e ibadeteve të llojeve të ndryshme, të cilat nuk do të ekzistonin, sikur të mos ishte krijimi i Iblisit. Sikurse që është xhahadi, shoqërimi dhe dashuria në emër të All-llahut, urrejtja në emër të All-llahut urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, pendimi ndaj All-llahut xh.sh. dhe kthimi tek Ai, kundërshtimi i armiqve të All-llahut dhe kërkim mbrojtjeje prej tyre nga All-llahu xh.sh., tërheqja e vërejtjes nga kryelartësia dhe mendjemadhësia dhe të ngjashme. Shih: Mudarixhus salikin, 2: 194.
- 227 Er revadetun nedijje sherhul 'akidetil vasijje, f. 356.

ARSYETIMI I JOBESIMTARËVE ME KADER

Jobesimtarët do të dëshironin që mosbesimin e tyre ta arsyetojnë në atë mënyrë, që konfirmojnë se, All-llahu xh.sh. ka dashur që ata të jenë jobesimtarë dhe se Ai e ka përcaktuar këtë, sepse, sikur të mos dëshironte, ata nuk do të mund të jenë të këtillë. All-llahu xh.sh. e demanton dhe e përgënjeshtroon këtë arsyetim të tyre në këto ajete:

“Idhujtarët do të thonë: “Sikur të donte All-llahu, nuk do t’i bënim shok Atij, as ne as baballarët tanë, dhe nuk do të punonim asgjë të ndaluar”. Kështu mohonin edhe ata para tyre, derisa e shijuan dënimin Tonë. Thuaj: “A keni ju ndonjë argument të na paraqitni? Ju mbështeteni vetëm në hamendje dhe jeni vetëm gënjeshtarë”. Thuaj: “All-llahu ka argument të qartë dhe po të donte Ai, të gjithëve do t’u udhëzonte (me forcë) në rrugë të drejtë!” (El-En’am: 148-149).

Kjo është përgjigjja e All-llahut xh.sh. për atë që i arsyeton mëkatet e veta. Për mbrojtjen e tij, All-llahu xh.sh. posedon argumentin më të fortë. Përgjigjja e All-llahut xh.sh. është plotësisht e qartë, sepse ajo bazohet në dy gjëra të ditura nga të gjithë dhe të pranuar nga të gjithë, në të cilat nuk ka aspak dyshim dhe mbi të cilat mund të polemizojë vetëm ai që e ka zgjedhur lajthitjen dhe kështu i ka kontribuar shkatërrimit të vet. Këto dy gjëra janë:

E para: All-llahu xh.sh. jobesimtarët e mëhershëm i ka dënuar me ndëshkim të ashpër. Po qe se ata nuk do të ishin të lirë që të zgjedhin atë që kanë bërë nga mëkatet, veprave të këqija, mohimit dhe shirkut, atëherë Ai nuk do t’i dënonte ata, sepse All-llahu xh.sh. është i drejtë dhe askujt nuk i bënë padrejtësi. Ai i cili mëkatet e veta dhe mosbesimin e vet, e arsyeton me kader, është njëri prej dy vetave: ose besimtar i All-llahut, ose mohues. E, nëse është besimtarë, atëherë duhet të

besojë në drejtësinë e All-llahut xh.sh. dhe pastërtinë e qenies së Tij nga çdo padrejtësi, ngase padrejtësia është negativiteti i cili nuk i ka hije Krijuesit, ndërsa All-llahu xh.sh. është larg çdo të metë nga çdo pikëpamje. S'ka dyshim se, të ndëshkuarit e atij, që ka qenë i detyruar të bëjë diç, është padrejtësi e madhe. Prandaj, arsyetimi i mëkatit me kader, me gjithë ndëshkimin e mëkatarit, paraqet përshkrimin e padrejtësisë All-llahut xh.sh., që gjithsesi është në kundërshtim me besimin e tij në Të. E, nëse njeriu i cili arsyetohet me kader, është jobesimtar, atëherë arsyetimi i tij është kontradiktë dhe marrëzi e kulluar.

E dyta: Ai i cili mosbesimin dhe mëkatimin e vet e arsyeton me kader, ai për All-llahun flet pa kurrfarë dijenie dhe pa bazë. Si mund të ndodhë që, jobesimtari apo mëkatari, të arsyetohet me kader para se ta bëjë mëkatin apo kufirin, duke qenë se përcaktimi i All-llahut, para se të ndodhë, është gajb të cilin askush nuk e di përpos All-llahut xh.sh.? E dimë se çdo njeriu, para se të nisëj të bëjë ndonjë mëkat apo kufër, i është urdhëruar që t'i bindet All-llahut xh.sh. dhe t'i kryejë urdhrat e Tij. Thënë ndryshe: si mund të thotë njeriu: All-llahu ka caktuar që unë të vjedhi, prandaj unë vajta ta kryejë përcaktimin e All-llahut? A mos vallë, ai ka vështruar në Lehi Mahvudh dhe ka lexuar se çka shkruan në të, e në këtë mënyrë ka kuptuar se çka i është përcaktuar, përderisa njëkohësisht është i thirrur që të mos bëjë kurrnjë mëkat, vjedhje apo diç tjetër?

Kësi përgjigje të qartë All-llahu xh.sh. ua kthen atyre që arsyetohen me kader edhe në disa vende në Kur'an:

“E kur të punojnë vepra të shëmtuara, thonë: “Na i kemi gjetur prindërit tanë në to; Por edhe All-llahu na ka urdhëruar me këtë”. Thuaj: “All-llahu nuk urdhëron të punohen vepra të shëmtuara! Përse flisni për All-llahun atë që nuk e dini?” (El-Araf: 28).

Kjo metodë kur'anore gjatë përgjigjes në kësi lloj konfirmimesh, ka ardhur për ta përmirësuar mënyrën e të menduarit dhe të analizimit njerëzor, dhe t'u shpjegohet njerëzve se All-llahu xh.sh. kërkon prej tyre që t'i zbatojnë urdhrat e All-llahu xh.sh. dhe të shmangen nga ndalesat e Tij, e jo ta hulumtojnë gajbin e fshehur të Tij, në mënyrë që t'i adaptohen atij.

Profesor Sejjid Kutbi, duke komentuar ajetin e përmendur, thotë: “Pjesa e dytë e ajetit udhëzon në përmirësimin e mënyrës së mendimit dhe shqyrtimit njerëzor. All-llahu xh.sh. i ka obliguar ata me urdhra të caktuara dhe ua ka ndaluar disa gjëra të caktuara, dhe ata me siguri mund të mësojnë për këtë. E, për sa i përket vullnetit dhe përcaktimit të All-llahut xh.sh., kjo është gajb (fshehtësi) dhe ata nuk kanë kurrfarë mënyre që ta mësojnë këtë, e atëherë si mund ta perceptojnë këtë? E, nëse nuk e njohin, atëherë si mund të thirren në të? Ekzistojnë urdhra dhe ndalesa të All-llahut xh.sh. të cilat janë tërësisht të njohura, atëherë përse ata i braktisin këto informata të sigurta, e jipen sipas supozimeve dhe hamendjeve në fushën, të cilën aspak nuk e njohin?

Esenca e këtij problemi është kjo: All-llahu xh.sh. nuk i ka obliguar njerëzit që të dinë për vullnetin dhe kaderin (përcaktimin) e Tij, në mënyrë që t'u adaptohen atyre. Por i ka obliguar që t'i perceptojnë urdhëresat dhe ndalesat e All-llahut xh.sh., në mënyrë që të veprojnë sipas tyre. E, kur ata përpiqen që ta bëjnë këtë, atëherë All-llahu xh.sh. i udhëzon dhe ua zgjeron kraharorin që ta pranojnë Islamin. Dhe kjo u mjafton njerëzve për sa i përket kësaj teme, e cila në këtë mënyrë,

në praktikë, bëhet shumë e thjeshtë dhe e qartë, pa kurrfarë paqartësish të cilat paraqiten gjatë diskutimeve të panevojshme lidhur me të.

All-llahu xh.sh. është në gjendje të krijojë njerëz që, sipas natyrës së tyre, të gjithë të bëhen besimtarë, apo t'i detyrojë që të gjithë të besojnë, apo të gjithëve t'ua fut imanin në zemër, e që të gjithë ta pranojnë Udhëzimin e Tij. Por, All-llahu xh.sh. ka dashur diç krejtësisht tjetër. Ka dashur që t'i sprovtojë njerëzit në atë mënyrë që i ka lënë plotësisht të lirë dhe u ka mundësuar ta pranojnë udhëzimin apo lajthitjen, e Ai do ta ndihmojë atë që përcaktohet për udhëzim, ndërsa atë që përcaktohet për lajthitje, do ta lë që edhe më shumë të devijojë dhe të verbërohet. Dhe, është bërë ashtu siç ka dashur All-llahu xh.sh.

Pra, çështja është tërësisht e qartë, dhe është prezentuar në mënyrën më të lehtë, të cilën mendja e njeriut mund ta kuptojë lehtë. E, për sa i përket diskutimit dhe polemizimit lidhur me këtë çështje, kjo është tërësisht e huaj për etikën dhe stilin e Islamit. Polemika në këtë temë, në cilëndo filozofi dhe religjion, nuk ka rezultuar me ndonjë zgjidhje të kënaqshme, ngase kjo është polemikë që mirret me tematikë e cila assesi nuk i nënshtrohet polemizimit e as që i përgjigjet natyrës së saj.

Kjo fe, ka ardhur në mënyrë që të krijojë një model të caktuar në shoqëri, të cilën e kufizojnë urdhëresat dhe ndalesat e qarta. Prandaj, të drejtuarit kah vullneti i panjohur, paraqet labirint nëpër të cilin bredh arsyeja e njeriut pa kurrfarë orientimi dhe humbje kohe e cila për ndryshe do të duhej të shpenzohej në punët pozitive dhe kreative.”²²⁸

228 Fi Dhilalil Kur'anil Kerim, 8: 1227.

Prandaj, vëlla i dashur, dije se prej teje kërkohet që t'i kryesh urdhrat e All-llahut xh.sh. dhe të largohesh nga ndalesat e Tij, para se të bësh çkado qoftë tjetër. E, pasi që e ke bërë ndonjë vepër: nëse ke bërë diç të mirë, me të cilën All-llahu xh.sh. është i kënaqur, je i obliguar që ta falënderosh Atë për udhëzimin që ta ka mundësuar, e nëse ke bërë ndonjë mëkat, je i obliguar të pendohesh e t'i kthehesh All-llahut xh.sh., pastaj të mbështetesh në All-llahun xh.sh. duke shpresuar që do të të falë, i bindur në drejtësinë dhe urtësinë e Tij. Duhet ta urreshë mëkatimin para se të mëkatosh, në mënyrë që të të shmang nga mëkati, e nëse megjithatë bënë ndonjë mëkat, kjo duhet të inkurajojë të pendohesh dhe t'i kthehesh All-llahut xh.sh. Dhe, ta dishë se urrejtja jote ndaj mëkateve, nuk do të thotë edhe urrejtja e përcaktimit të All-llahut xh.sh., por prej teje kërkohet që ta urreshë atë që e urrenë All-llahu xh.sh., dhe ta duash atë që e do Ai. Të jeshë i kënaqur me atë që është i kënaqur Zoti yt, dhe të hidhërohesh për atë që hidhërohet Ai. Dhe ta dishë se All-llahu xh.sh. nuk e do kufirin, e as që ua lejon atë robërve të Vet, dhe nuk e do mëkatin, e as që ua lejon këtë robërve të Vet. All-llahu xh.sh. thotë:

“Nëse ju e mohoni (Atë), me të vërtetë, All-llahu është i pavarur prej jush, Por Ai nuk është i kënaqur me mohimin e robërve të Tij; e është i kënaqur me ju, nëse e falënderoni.” (Ez-Zumer: 7).

FSHEHTËSIA E PËRCAKTIMIT TË ALL-LLAHUT XH.SH. DHE NDALIMI I POLEMIZIMIT RRETH TIJ

Kjo që thamë gjer më tani, është e tëra që i mjafton besimtarit të dijë përkitazi me kaderin. Atij i mjafton ta dijë domethënien e tij, shkallët e tij dhe të besojë në të. Të besojë se All-llahu xh.sh. i di të gjitha, i ka krijuar të gjitha dhe se nuk mund të bëhet diç që nuk dëshiron Ai. Se Ai është i drejtë dhe askujt nuk ia bënë të padrejtën, se është i mençur dhe se nuk i përket marrëzia. Kjo tematikë nuk kërkon nga besimtari asgjë më tepër. Sepse, All-llahu xh.sh. na ka shpjeguar atë që e ka ditur se është e mjaftueshme për ne, e askujt nuk i është e lejuar të gjurmtojë atë që All-llahu xh.sh. ka fshehur prej nesh, ngase atëherë do të përçaheshim dhe kështu të shkatërroheshim. Arsyeja e jonë është e kufizuar. All-llahu xh.sh. e ka krijuar atë në mënyrë që të udhëheqim me këtë botë, e jo që ta zbulojmë fshehtësinë (gajbin), të cilën nuk e di askush tjetër përveç All-llahut xh.sh. Njëra prej këtyre (gajb) temave është edhe raporti i krijimit të veprave njerëzore nga ana e All-llahut xh.sh. dhe vullnetit njerëzor, dhe realizimin e tyre nga ana e njerëzve. Kjo nuk është e vetmja temë e gajbit, esencën e së cilës arsyeja e njeriut nuk është në gjendje ta kuptojë. Ne mund të perceptojmë, bie fjala, vetëm shenjat e cilësive të All-llahut xh.sh., e nuk jemi në gjendje të perceptojmë esencën e tyre, siç është rasti me qenien e All-llahut xh.sh., të cilën arsyeja njerëzore nuk është në gjendje ta kuptojë.²²⁹ Për këtë arsye Resulull-llahu s.a.v.s. e ka ndaluar polemizimin rreth kaderit dhe shqyrtimin më të thellë mbi të. Imam Ahmedî transmeton, me senedin e vet, nga Amër b. Shu'ajbi, i cili transmeton nga babai i tij, e ky nga gjyshi i tij, i cili thotë: “Një ditë,

229 Tebsitul ‘akaidul islamijje li Hasan Ejjub, f. 84.

Resulull-llahu kishte dalur hasur njerëzit duke diskutuar rreth kaderit, e atij sikurse t'i kishte shpërthyer nari në fytyrë, aq tepër u skuq nga hidhërimi, e pastaj u tha: “Ç’është kjo me ju? A mos vallë, do të lejoni që një pjesë të Librit ta mujoni me pjesën tjetër? Për këtë shkak janë shkatërruar ata që kanë qenë para jush.”²³⁰

Një njeri erdhi tek Aliu r.a. dhe e pyeti mbi kaderin, e Aliu r.a. u përgjigj: “Rrugë e errët, andaj mos u nis asaj.” Ai e përsëriti pyetjen, e Aliu r.a. u përgjigj: “Det i thellë, andaj mos hy në të.” Ai përsëri pyeti, e Aliu r.a. tha: “Fshetësi e All-llahut xh.sh., andaj mos u mundo ta perceptosh atë.”²³¹

Sa të bukura janë fjalët e Tahaviut, i cili thotë: “Kaderi në esencën e vet, është fshehtësi e All-llahut xh.sh. në vetë krijesat e Tij të cilën askush nuk është në gjendje ta perceptojë, as engjëlli më i zgjedhur, e as cilido nga Pejgamberët e All-llahut xh.sh. Debatimi dhe shqyrtimi rreth tij është shkak i shkatërrimit, është punë e ndaluar dhe tejkalim i kufijve. Prandaj ruajuni mirë nga çdo diskutim, meditim dhe pyetje rreth tij, ngase All-llahu xh.sh. e ka fshehur diturinë e kaderit nga krijesat e Veta dhe e ka ndaluar hulumtimin e tij. All-llahu xh.sh. thotë:

“Nuk do të pyetet (Ai), për atë që punon, e ata do të jenë të pyetur.” (El-Enbija: 23).

Prandaj, ai që pyet: përse All-llahu xh.sh. ka bërë diç, ai i ka shkelur fjalët e All-llahut xh.sh., e kush e bën këtë, është bërë jobesimtar.

230 El-Fet’hurrabbani, 1: 142; Sunen bin Maxhe, 1: 33.

231 Tejsirul ‘Azizil Hamid, f. 620; El ‘akaidul islamijje, f. 99; Esh-sheria lil Axhurri, f. 212.

Ja, kjo është shkurtimisht e tërë ajo që i nevojitet robit të sinqertë të All-llahut xh.sh., zemra e të cilit është e ndriçuar me nur. Kjo është grada e shumë të njohurve, ngase ekzistojnë dy lloj ilmesh (diturish): dituria që ekziston mes njerëzve dhe dituria që nuk ekziston mes tyre. Mohimi i diturisë që ekziston është kufër. Ndërsa konfirmimi se njihet dituria që nuk ekziston është po ashtu kufër. Dhe imani nuk do të jetë i pranuar prej askujt, përderisa nuk pranohet dituria ekzistuese dhe përderisa nuk flaket hulumtimi për diç që nuk ekziston.”²³²

NDIKIMI I BESIMIT NË KADER NË JETËN E MYSLIMANIT

Feja Islame bazohet në dorëzimin e plotë urtësisë së All-llahut xh.sh. dhe vullnetit të Tij dhe në pranimin e urdhrave dhe ndalesave të Tij, pa hulumtimin e hollësishëm të mençurisë së All-llahut xh.sh. në tërë këtë, siç kanë qenë as’habët e Resulull-llahut s.a.v.s., ngase Islami nuk mund të përforcohet me asgjë tjetër, përveçse me devotshmëri. E, shenja e parë e pranimit të diçkaje, është të besuarit në të, e pastaj kalimit sa më të shpejt në zbatimin e saj.²³³

Të këtillë kanë qenë as’habët e Resulull-llahut s.a.v.s. Kanë pasur edukim të shkallës jashtëzakonisht të lartë ndaj Zotit të tyre dhe ndaj Pejgamberit të Tij. Ibni Abbasi r.a. thotë për ta:

232 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 276-292.

233 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 291.

“Kurrë nuk kam parë njerëz më të mirë se as’habët e Resulull-llahut s.a.v.s. Ata ia kanë bërë vetëm trembëdhjetë pyetje gjatë jetës së tij.”²³⁴

Përkitazi me kaderin janë në pajtim të gjithë as’habët, tabi’inët dhe të gjithë pasuesit e ehli Sunnetit dhe Hadithit. Janë në pajtim me atë se, çdo gjë që do të ndodhë gjer në Ditën e Kiametit është e shkruar në Lehtë Mahvudh.

Transmetohet se Ibni Dejlemi ka thënë: “Vajta tek Ubeje bin Ka’bi e i thash: “Unë po ndiej në vete diç të pakëndshme përkitazi me kaderin, andaj të lutem më thuaj diçka për të. Shpresoj se All-llahu xh.sh. do të bëjë që kjo ndjenjë ta braktisë zemrën time.” Ai më tha: “Sikur të donte All-llahu xh.sh. që t’i ndëshkonte të gjithë banorët e Tokës dhe të qiejve, Ai këtë do ta bënte dhe askujt nuk do t’i shkaktonte padrejtësi, e nëse i mëshiron ata, mëshira e Tij do të jetë për ta më e mirë se veprat e tyre. Sikur të japish për sadaka ari sa është kodra e Uhudit, All-llahu xh.sh. nuk do ta pranonte këtë, përderisa nuk beson në kaderin dhe përderisa nuk e kupton se ajo që të ka ndodhur ty, assesi nuk ka mundur të të shmanget. E, nëse vdes me çfarëdo bindje tjetër përkitazi me këtë çështje, do të hysh në Xhehennem.” Ibni Dejlemi thotë: “Pastaj vajta tek Ibni Mes’udi, e ai ma tha të njëjtën gjë. Pastaj vajta tek Zejd bin Thabiti, e ai ma tregoi hadithin e Resulull-llahut s.a.v.s. në këtë kuptim.”²³⁵

234 Plamil muveki’in, 1: 71.

235 Transmeton Ebu Davudi, Ibni Maxhe, Ahmedi, Taberani dhe Ibni Hibbani, e në senedin (zinxhirin e transmetuesëve) gjendet Se’id bin Sinan esh-Shejbani, të cilin Ibni Me’ini e konsideron si të besueshëm, ndërsa për të polemizon Ahmedi dhe të tjerët.

Transmetohet nga Ubade bin Samiti r.a. se para se të vdes, i ka thënë të birit të vet: “O biri im! Ti nuk do ta shijosh ëmbëlsinë e imanit të vërtetë, përderisa nuk e di se nuk ka mundur të të shmangët ajo që të ka ndodhur, e as që mund të të ndodh diç që të është shmangur. Unë e kam dëgjuar Resulull-llahun s.a.v.s. duke thënë: “Gjëja e parë që ka krijuar All-llahu xh.sh. ka qenë penda, të cilës i ka thënë: “Shkruaj!” Penda tha: “O Zoti im, çka të shkruaj?” “Shkruaj tërë atë që do të ndodhë gjer në Ditën e Kiametit”, tha All-llahu.” O biri im, e kam dëgjuar Resulull-llahun s.a.v.s. duke thënë: “Ai që vdes, e në këtë nuk ka besuar, ai me mua nuk ka asgjë.”²³⁶

Kjo bindshmëri ka pasur ndikim të madh në as’habët e Resulull-llahut s.a.v.s. Ata janë shpërndarë nëpër vise të ndryshme të Tokës, duke bartur me vete besimin në kader, ashtu siç i ka mësuar Resulull-llahu s.a.v.s., i cili me një rast i pat thënë Ibni Abbasit r.a.”O djalosh! Ke kujdes për All-llahun e edhe Ai do të kujdeset për ty. Kujdesu për All-llahun, e do ta geshë para vetes. Nëse don ta pyesish dikë, pyete All-llahun, e nëse prej dikujt duhet të kërkosh ndihmë, kërkko prej All-llahut. Dhe dije mirë se sikur e tërë bota do të mblidhej për të të ndihmuar, nuk do të mund të të ndihmonin, përpos me atë që All-llahu xh.sh. tanimë ta ka caktuar. E sikur të mblidheshin për të të dëmtuar, nuk do të mund të të dëmtonin me asgjë tjetër, përpos me atë që ta ka caktuar All-llahu. Pendet kanë mbaruar së shkruari, dhe ngjyra tanimë është tharë.”²³⁷

Kjo bindshmëri i ka mbushur zemrat e tyre me qetësi dhe stabilitet, dhe i ka edukuar në krenari. Prandaj, nervat e tyre kanë qenë të matur gjersa vizitonin vende të ndryshme të botës duke ia interpretuar këtë fe tërë njerëzimit. Ata i kanë konsideruar të parëndësishme dhe të pavlefshme të

236 Transmeton Ebu Davudi. Shih: Xhem’al Fevaïd, 2: 328; Kitabish-sheri’a lil Axhurri, f. 211.

237 Transmeton Tirmidhiu, dhe thotë se hadithi është hasen sahih. Shih: Xhem’al Fevaïd, 2: 329.

gjitha fuqitë botërore para emrit të vet në përcaktimin e All-llahut xh.sh. Selman El-Farisi është pyetur: “Çka thonë njerëzit kur bëhen besimtarë për përcaktimin e të mirës dhe të keqës nga ana e All-llahut xh.sh.?” Ai është përgjigjur: “Kur të besosh në kader bëhesh i vetëdijshëm se nuk ka mundur të të ndodhë ajo që të është shmangur, e as të shmanget ajo që të ka ndodhur.”²³⁸ Këto nuk kanë qenë fjalët vetëm të Selmanit, por fjalët e të gjithë as’habëve te Resulull-llahut s.a.v.s.

Çfarë fatbardhësie i sjellë njeriut kjo bindshmëri dhe çfarë heroizmi përmbajnë në vete zemrat, të cilat kanë besuar se çdo gjë gjendet në duart e All-llahut xh.sh., e njerëzit nuk posedojnë asgjë. Të gjitha fuqitë e kësaj bote nuk janë në gjendje ta ndalin një njeri i cili në vete mbanë këtë bindshmëri dhe këtë iman. Shikuar vetëm në këtë mënyrë, mund të arrijmë gjer tek sqarimi i vërtetë për veprat kolosale që i ka bërë imani përmes atij grupi të vogël njerëzish, që janë nisur për t’u interpretuar këtë fe në botë. Këto janë vepra të cilat i gjasojnë mrekullirave, por megjithatë të vërteta. Të gjitha këto vepra kolosale, të cilat i ka realizuar Resulull-llahu s.a.v.s. me as’habët e tij fisnik janë fryt i imanit të tyre në All-llahun xh.sh., në botën e ardhshme dhe në përcaktimin e All-llahut xh.sh.

Vetëm njeriu i cili është i lumtur duke i besuar kaderit, i cili e di se nuk ka mundur t’i shmanget ajo që i ndodhë, dhe e di se edhe sikur e tërë bota të bashkohet nuk do të mund të bënte asgjë përpos asaj që All-llahu xh.sh. ka caktuar, dhe kush e di se asnjë njeri nuk do të vdes përderisa tërësisht nuk e harxhon nafakën e vet dhe ditët e jetës së vet, me të vërtetë, vetëm njeriu i tillë lirohet tërësisht nga robëria ndaj njerëzve dhe kalon në robërimin ndaj Zotit të njerëzve. Sepse, si mund t’i përulet balli i tij çfarëdo fuqie qoftë në sipërfaqe të Tokës, duke e ditur se çdo gjë

238 Esh-sheri’a lil Axhurri, f. 206

gjendet në duart e Krijuesit të qiejve dhe të Tokës dhe i çdo gjëje që gjendet në to dhe mes tyre? Dhe si mund t'i nënshtrohet robit nga pluhuri? Ibni Rexhebi - rahimehullahu te'ala - thotë: “Ai i cili është dëshmuar (është bindur) se çdo krijesë në Tokë është pluhur (dhé), ai e di se edhe vetë është pluhur. Atëherë, si mundet ky që, në përulshmërinë e tij, t'i japë përparësi atij i cili është nga pluhuri kundrejt Sunduesit të të gjithë sunduesve? Ose, si mund ta bëjë të kënaqur dikë tjetër në llogari të hidhërimit të Sunduesit të Gjithmbarshëm? Me të vërtetë, kjo është gjë tejet e çuditshme.”²³⁹

Kjo bindshmëri çrrënjosë çdo simptom paburrërie (frike) nga zemra në të cilën gjendet kjo dhe pronarin e saj e inkurajon për xhihad kundër jobesimtarëve dhe zullumqarëve pa marrë parasysh mjetet dhe metodat e tyre, çfarëdo që të jenë ato. E, përse të lodhet duke menduar për ta, duke qenë se Krijuesi dhe Furnizuesi i tij i ka garantuar se do ta harxhojë çdo atom të nafakës së vet para se t'i vie çasti? E, përse të frikohet kur është i vetëdijshtëm se me siguri do t'i ndodhë ajo që i është caktuar, ndërsa ajo që nuk i është caktuar kurrë nuk do t'i ndodhë. Sa bukur e ka thënë këtë shkrimtari me këto fjalë:

“Prej cilës ditë të vdekjes sime të iki?

Nga dita që m'është caktuar, apo nga dita që nuk m'është caktuar?

Ditës që nuk m'është caktuar nuk i frikësohem,

E përcaktimit nuk mund t'i ikë as njeriu më i kujdesshëm.”

239 Xhami'ul 'ulum vel hikem, f. 385.

Njeriu i cili beson në kaderin e All-llahut xh.sh., gëzon edhe një dhunti, të cilës nuk i janë të barabarta të gjitha dhuntitë e tjera të kësaj bote, e kjo është lumturia në të gjitha situatat. E kjo ngase njeriu i tillë e di se përcaktimet e All-llahut xh.sh. zhvillohen sipas urdhrit të Tij, vullnetit dhe rregullit të Tij, dhe se ngjarjet ndodhin si fryt i urtësisë dhe dëshirës së Tij, e, Ai e di e njerëzit nuk e dinë. All-llahu xh.sh. thotë:

“Mund ta urreni një gjë, por ajo është e mirë për ju; e mund ta doni një gjë, por ajo është e dëmshme për ju - All-llahu e di e ju nuk e dini” (El-Bekare: 216)

Pra, shpirti i mu'minit e di se Ai i Cili e ka caktuar të mirën dhe të keqen, është i urtë dhe i mëshirshëm, prandaj nuk do të krenohet në mirëqenie as që do ta humbas shpresën në vështirësi. Ai i është mirënjohës All-llahut xh.sh. në të mirë dhe i durueshëm në vështirësi, prandaj çdo gjë që i ndodhë, është e mirë për të. Siç na shpjegon Resulull-llahu s.a.v.s.: “Sa i çuditshëm është shembulli i besimtarit! Çdo situatë në të cilën gjendet është hajr për të, e ky nuk është rasti me askë tjetër pos me besimtarin: Nëse i ndodhë ndonjë gëzim, ai falënderohet për të, andaj shpërblehet për këtë, e nëse i ndodhet në ndonjë vështirësi, ai është i durueshëm, e edhe për këtë shpërblehet.”²⁴⁰

Besimtari e kundron vështirësinë dhe e di se ajo ka ardhur sipas përcaktimit të All-llahut xh.sh., andaj qetësohet dhe me kënaqësi e pranon atë dhe nga kjo bëhet edhe më i njerëzishëm e as që i bie ndër mend që t'i ankohet Zotit dhe Krijuesit të vet. Shikon në pasojat e vështirësisë dhe e di se do të jetë i shpërblyer për këtë, andaj kënaqet me të dhe duron. Tek Buhariu dhe Muslimi

240 Transmetojnë Muslimi dhe Ahmedi nga Suhejbi. Shih: Rijadus salihin me'a Delilil falihin, 1: 147.

qëndron se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Në sprovimin më të madh me mynxyra janë Pejgamberët, e pastaj atë të cilët i pasojnë sipas kualitetit të tyre. Njeriu sprovohet në pajtueshmëri me imanin e tij. E, nëse e ka imanin e fortë, do të jetë i sprovuar varësisht nga fortësia e imanit të tij, e nëse ka iman të dobët, sprovimet do t’i ketë më të lehta. Në këtë mënyrë sprovimet do t’i vijjnë njeriut pandërprerë gjersa nuk pastrohet plotësisht, e të ecën nëpër tokë pa kurrfarë mëkatesh në vete.”²⁴¹

Ibni Kajjumi e ka thënë këtë në mënyrë shumë të mirë:

“Nëse të ndodhë ndonjë vështirësi, bëhu i durueshëm ndaj saj,

Me durim të Bujarit, sepse Ai ndaj teje është edhe më bujar.

E nëse i ankohesh të birit të Ademit, i je ankuar,

Kundër Mëshiruesit, atij që mëshirë nuk ka.”

Alkame r.a. i komenton fjalët e All-llahut xh.sh.: “Nuk ngjanë kurrfarë fatkeqësie pa lejen e All-llahut, e ai që i beson All-llahut, ia udhëzon (në rrugë të drejtë) zemrën e tij. All-llahu di mirë çdo gjë.” (El-Tegabun: 11), e thotë: “Ky është njeriu i cili, kur t’i ndodhë ndonjë fatkeqësi, e di se ajo është nga All-llahu xh.sh., andaj është i kënaqur me të dhe i dorëzohet dëshirës së All-llahut xh.sh.”²⁴² Ndërsa Ibni Abbasi thotë: “All-llahu xh.sh. do t’ia udhëzojë zemrën atij në jekin

241 Muttefekun ‘alejhi.

242 Tefsir bin Kethir, 4: 275.

(perceptim i fuqishëm), andaj do të kuptojë se nuk ka mundur t'i shmanget ajo që i ka ndodhur, e që nuk ka mundur t'i ndodhë ajo që i është shmangur.”²⁴³

Nën hijen e këtij konceptimi janë ngritur as'habët r.a., janë lartësuar shpirtrat e tyre dhe është forcuar ndërgjegjja e tyre, gjer në ato përmasa, saqë tek ata është barazuar fatkeqësia me gëzimin dhe se falënderimi (shukri) dhe durimi (sabri) janë bërë të njëjtë, siç thotë Umeri r.a.: “Sikur sabri dhe shukri të ishin dy deve, unë assesi nuk do të mërzitesha se në cilën do të hipja.” E, Ebu Muhammed El-Hariri, thotë: “Sabri është që të mos bësh dallim mes shpërblimit dhe sprovimit, me qetësi të tërësishme në të dy rastet.”

Imam Ahmedin e kanë pyetur se a mund njeriu me njëqind dinarë të bëhet zahid? E është përgjigjur: “Mundet, por me kusht që të mos gëzohet nëse i shtohen dhe që të mos hidhërohet nëse i pakësohen.” E njëri prej selefëve ka thënë: “Zahid është ai falënderimin (shukrin) e të cilit nuk mund t'ia kalojë mirëqenia, e as mynxyrat durimin e tij.”²⁴⁴

Umer bin Hattabi r.a. i ka shkruar letër Ebu Musa El-Esh'ariut, ku qëndron: “Dije se e tërë e mira është në kënaqësi, e nëse je në gjendje bëhu i kënaqur, e nëse nuk je, atëherë bëhu i durueshëm.”²⁴⁵ E, Ibni 'Ata', thotë: “Kënaqësia është qetësia e zemrës sipas asaj që All-llahu xh.sh. që moti i ka zgjedhur robët të Vet dhe bindshmëria se Ai ka zgjedhur për të më të mirën.”²⁴⁶

243 Tefsir bin Kethir, 4: 275.

244 Këto dhe proverbe të tjera lexoi në 'Uddetus-sabrin, f. 90 dhe 226.

245 Medarixhus-salikin, 2: 177.

246 Medarixhus-salikin, 2: 175.

Sabri është vaxhib sipas mendimit të ulemasë islame. E më shumë se kjo është kënaqësia me përcaktimin e All-llahut xh.sh. Për kënaqësinë disa nga ulemaja thonë se është vaxhib, e disa të tjerë se është mustehabb, e të gjithë janë të një mendimi se nuk është nën mustehabb.²⁴⁷ Ndërsa themeli i kënaqësisë është besimi në përcaktimin e All-llahut xh.sh. dhe vetëdija mbi mëshirën e All-llahut xh.sh. ndaj njerëzve, siç kemi thënë edhe më parë. Abdul Vahid bin Zejdi thotë: “Kënaqësia (ridaluk) është porta më e madhe e All-llahut xh.sh. - Xhennet i dynjallëkut dhe pushim. Pronarët e shkallëve të kënaqësisë përherë shikojnë shpërblimin e Atij që i sprovon ata dhe e dinë se Ai ua ka zgjedhur këtë, dhe janë të sigurt se është e pamundur që Ai të gjykojë padrejtësisht. Ngandonjëherë, të kapluar nga kënaqësia me kaderin, as që e ndiejnë dhembjen e sprovimit të caktuar. Ngandonjëherë, i kaplon madhështia dhe lartësia e Atij që i sprovon ata dhe tërësisht zhyten në ato ndjenja kështu që assesi nuk ndiejnë dhembje. Përkundrazi, ndoshta edhe ndiejnë ëmbëlsi në tërë këtë për shkak të vetëdijes së tyre se ajo u ka ardhur nga Ai i Cili i do ata.”²⁴⁸

Dije se kënaqësia dhe durimi, që janë rezultat i imanit në kader, kanë të bëjnë me kënaqësinë ndaj mynxyrave dhe fatkeqësive që i ndodhin njerëzve, dhe durimi në kryerjen e urdhrave të All-llahut xh.sh., pastaj shmangia nga mëkatet dhe gjërave të tjera të qortuara.²⁴⁹ Këtu nuk mendohet në kënaqësinë në kufër dhe në mëkate, as në kthimin nga urdhrat e All-llahut xh.sh., e as në sabër në poshtërim dhe kob. Sepse, All-llahu xh.sh. nuk është i kënaqur me kufrin, me mëkatimin dhe me

247 Medarixhus-salikin, 2: 117; Er revdatun nedijje, f. 489.

248 Medarixhus-salikin, 2: 167; Er revdatun nedijje, f. 489; Xhami’ul ‘ulum vel hikem, f. 170.

249 Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 3: 101.

poshtërimin e robërve të Vet. Prandaj, kënaqësia jote le të jetë në harmoni me kënaqësinë e Zotit tënd, durimi yt në kryerjen e urdhrave të All-llahut xh.sh. dhe sakrificimi në rrugën e Tij.

Kënaqësia me përcaktimin e All-llahut xh.sh., durimi gjatë sprovimeve dhe bindshmëria në drejtësinë e përcaktimit të All-llahut xh.sh. janë themelet më të rëndësishme në të cilat bazohet lumturia njerëzore. Dhe këto janë motivet më të fuqishme për lëvizjen e tërë fuqisë njerëzore kah puna në këtë planet në harmoni me dispozitat e All-llahut xh.sh. Në këtë rast nuk ekziston kthimi mbrapa, nuk ekziston të ngecurit për shkak të pikëllimit dhe pendimit, e as “sikur të ishte kështu e kështu do të bëhej kështu e kështu”, por “All-llahu xh.sh. e ka përcaktuar dhe ka bërë çka ka dashur Vet”.

Në këtë bindshmëri prehet qetësia e zemrës dhe rehatia e trupit, e shpirtit dhe e nervave, zhdukja e brengave etj. Prandaj nuk ekziston thyerje psikike, tendosje nervash dhe shizofreni abnormale, por kënaqësia, qetësia, lumturia, pushimi, ëmbëlsia e bindshmërisë së fuqishme, shkarkimi i ndërgjegjës, zemërgjerësia dhe siguria totale në mëshirën dhe drejtësinë e All-llahut xh.sh., në diturinë dhe urtësinë e Tij të gjithmbarshme, sepse, Ai është mbrojtës, strehim dhe vetëm prej Tij kërkohet ndihmë nga dyshimet dhe mendimet e këqija.

BESIMI NË KADER PRODHON REZULTATE KOLOSALE NË JETËN TOKËSOR TË NJERIUT.

Ato shoqëri, të cilat e kanë lënë pas dore këtë bindshmëri dhe të cilat nuk kanë iman në All-llahun xh.sh. dhe në udhëheqjen e Tij me çdo gjë lidhur me jetën dhe me qeniet e gjalla, ato në Ahiret do të jenë në zjarr të përhershëm dhe vuajtje të rënda, e në këtë botë do të jenë me fat të humbur, me nerva të shkatërruara, me jetë plotë brenga dhe gjithnjë të tendosur, siç e shpjegon këtë All-llahu xh.sh. ne ajetin vijues:

“... e kush e pason udhëzimin Tim, nuk do të humb (në këtë botë) as që do të jetë fatkeq (në botën tjetër). E, ai që shmanget nga Libri Im, ai do të ketë jetë të vështirë dhe, Na në Ditën e Kiametit do ta ringjallim të verbër atë.” (Tas Ha: 123-124).

BESIMI NË KADER NUK BIE NË KUNDËRSHTIM ME PUNËN E BAZUAR NË SHKAQET DHE PASOJAT

Nuk guxojmë të harrojmë se jemi të urdhëruar që të punojmë në pajtueshmëri me ligjshmëritë e shkaqeve dhe pasojave të cilat All-llahu xh.sh. i ka caktuar në botë, së bashku me tevakkulin (mbështetjen) në All-llahun xh.sh. dhe me iman se çdo gjë është në duart e Tij, pastaj me bindshmëri se shkaqet nuk japin pasoja, përpos me lejen e All-llahut xh.sh. Ai i Cili i ka krijuar shkaqet, i ka krijuar edhe pasojat dhe rezultatet. Prandaj, ai i cili dëshiron pasardhës të edukuar,

është i obliguar që të punojë sipas këtij plani dhe t'i zbatojë shkaqet që do të sjellin gjer aty. Duhet të martohesh, e kjo martesë mund të sjellë pasardhës, por mund edhe të mos sjellë, në pajtueshmëri me vullnetin e të Gjithfuqishmit e të Urtit dhe me dëshirën e Mëshirëplotit e të Gjithdijshtit:

“I All-llahut është pushteti mbi qiej dhe mbi Tokë. Ai krijon çka të dojë! Ai, i dhuron kujt të dojë vajza, e kujt të dojë i dhuron djem, ose u dhuron dy gjinitë: djem e vajza, e kë të dojë e bënë steril, Ai, në të vërtetë, është i Gjithdijshtëm dhe i Pushtetshëm.” (Esh-Shura: 49-50).

Prandaj myslimani e ka të ndaluar të mos e përfillë procedimin në pajtueshmëri me ligjshmëritë mbi shkaqet dhe pasojat. Kështu, sikur njeriu ta linte pas dore punën për përfitimin e nafakës, do të ishte mëkatar, edhe pse nafaka është në dorën e All-llahut xh.sh. Resulull-llahu s.a.v.s. shpjegon se shkaqet e lejuara gjithashtu janë nga kaderi, e kur i është thënë: “Çka thua për këndimin e Kur’anit për shkak të ilaçit dhe shërimit me mjekim, a e ndërrojnë këta përcaktimin e All-llahut xh.sh.?” Ai është përgjigjur: “Ata janë pjesë të kaderit të All-llahut xh.sh.”²⁵⁰ Prandaj të merren parasysh vetëm shkaqet dhe të konsideruarit se ato ndikojnë në pasojat, është shirk në tevhid, ndërsa mospërfillja e shkaqeve dhe mohimi se ato janë shkaqe, kjo është mangësi në mendje. Kurse, devijimi nga shkaqet, të cilat na janë të urdhëruara me Sheriat, është përdhosje e Sheriatit.²⁵¹

250 Zadul me’ad, 3: 528.

251 Mexhmu’ fetava ibnu Tejmijje, 8: 528.

Prandaj All-llahu xh.sh. e ka urdhëruar shërimin: Autorët e koleksioneve të hadithit (sunenit) transmetojnë nga Usame bin Sheriku se ka thënë: “Vajta tek Resulull-llahu s.a.v.s., e me të ishin as’habët, të cilët dëgjonin aq me kujdes, sikur të kishin shpesë në koka (e frikohen që me lëvizje do t’i trembnin). Dhashë selam dhe u ula. Erdhën beduinët nga krahinat e ndryshme, e pyetën: “O i Dërguari i All-llahut, a duhet të mjekohemi?” Ai u përgjigj: “Mjekohuni, sepse All-llahu xh.sh. nuk e ka dhënë asnjë sëmundje, e që për te të mos ketë dhënë edhe ilaçin, përpos një sëmundjeje - pleqërisë.”²⁵² Tek Buhariu dhe Muslimi qëndron se Ebu Hurejre r.a. ka thënë: “Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “All-llahu xh.sh. nuk ka dhënë kurrnjë sëmundje, e që për te të mos ketë dhënë ilaç.”²⁵³ Duke u bazuar në këtë hadith, fakihët (njohësit e fikhut) islam konsiderojnë se mjekimi është i dëshirueshëm (i preferuar), e disa konsiderojnë se është vaxhib. Komentuesi i akaidës së Tahaviut thotë: “Disa njerëz mendojnë se mbështetja në All-llahun xh.sh. bie në kundërshtim me përfitimin e nafakës dhe me hulumtimin e shkaqeve, dhe se: nëse gjërat janë caktuar që më parë, atëherë nuk është nevoja të ketë shkaqe. Kjo gjithsesi është gabim, sepse puna është farz (detyrim), mustehabb (e rekomanduar), mubah (e lejuar) ose mekruh (e papëlqyer) dhe haram (e ndaluar). E, Resulull-llahu s.a.v.s., mutevakkili më i madh, e ka vënë helmetën gjatë luftës dhe ka vajtur në treg për të fituar diç.”²⁵⁴

252 Transmetojnë që të katërt në sunenet e veta, e Tirmidhiu thotë se hadithi është hasen sahih. Shih: Muhtesar Ebu Davus, f. 346.

253 Transmeton Buhariu në kaptinën mbi mjekësinë.

254 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 301.

Në këtë mënyrë edhe as'habët e kanë kuptuar raportin ndërmjet kaderit dhe punës, dhe se kjo e dyta hynë në besimin në kader, e lë më t'i kundërvihet atij, por kjo rezulton nga besimi në kader. Buhariu transmeton nga Umeri r.a. se gjatë hyrjes në Sham e kanë pritur paritë e krahinave dhe e kanë informuar se atje është paraqitur murtaja. Atëherë ai u konsultua me muhaxhirët dhe ensarët, e pastaj me muhaxhirët para çlirimit të Mekës dhe me disa kurejshitë, dhe muhaxhirët u pajtuan që të kthehen, në mënyrë që të largohen nga murtaja, dhe Umeri kështu edhe urdhëroi. Atëherë i tha Ebu Ubejde: “A mos vallë duhet të ikim nga përcaktimi i All-llahut xh.sh.?” Umeri u përgjigj: “Eh..., sikur ta thoshte këtë dikush tjetër, o Ebu Ubejd! Të ikim nga përcaktimi i All-llahut në përcaktimin e All-llahut. Çka mendon, sikur ta kishe një grigjë devesh, e cila ka arritur në një luginë e cila i ka dy anë: njëren të pllëshme ndërsa tjetren të shkretë, e sikur ta kullotshe në anën e pllëshme a do ta bëshe këtë sipas kaderit, apo sikur ta kullotshe në anën e shkretë a do të punoshe edhe tani sipas kaderit?”²⁵⁵ Gjithashtu Umeri r.a. i ka qortua një grup njerëzish nga Jemeni, të cilët udhëtonin për në haxh pa ushqim. Mu'aviu bin Kurre thotë: “Umeri r.a. i takoj njerëzit nga Jemeni, e i pyeti: “Kush jeni ju?” Ata u përgjigjën: “Ne jemi mutevakkilunë (të cilët mbështeten në All-llahun).” Përkundrazi, ju jeni muteakilunë (ata që presin që t'i ushqejë dikush tjetër), kurse mutevakkil është ai i cili e mbjellë farën në tokë e pastaj mbështet në All-llahun.”²⁵⁶

Ibni Kajjum El-Xhevziu thotë: “Tevhidi i vërtetë nuk do të jetë i plotë tek njeriu, përderisa nuk punon duke u mbështetur në shkaqe të cilat i ka vënë All-llahu xh.sh. Ndërsa mospërfillja e tyre është shkelje e vet tevakkulit. Kurse lënia pas dore e tyre është dobësi e cila i kundërvihet

255 Fet'hul Bari, 10: 150-151; El Muvetta', f. 557-558.

256 Xhami'ul 'ulum vel hikem, f. 384.

tevakkulit islam, që do të thotë mbështetja me zemër në All-llahun xh.sh. për arritjen e asaj që do t'i bëjë dobi edhe në këtë botë edhe në botën tjetër dhe që do ta mbrojë nga ai që i bënë dëm fesë së tij dhe dynjallëkut. Krahas tevakkulit puna është e domosdoshme, sepse, në të kundërtën, do të ndyhej urtësia All-llahut xh.sh. dhe Ligji (Sheriati) i tij. Prandaj njeriu dobësinë e vet nuk do ta bëjë tevakkul, e as tevakkulin dobësi.”²⁵⁷ Ndërsa Sehël bin Abdull-llahu ka thënë: “Kush e mohon punën, e ka mohuar Sunnetin, e kush e mohon tevakkulin, e ka mohuar imanin. Sepse, tevakkuli është ajkë e Resulull-llahut s.a.v.s. ndërsa puna është Sunneti i tij, e kush punon sipas ajkës së tij, ai nuk e braktisë Sunnetin e tij.”²⁵⁸

KAPITULLI I DYTË ESENCA E IMANIT

N

ë kaptinën e mëparshme folëm për gjërat të cilat jemi të obliguar të besojmë, por, çka do të thotë imani,? Si ngjanë ai? Ç’është ajo që me të vërtetë i përgjigjet ky emër?

257 Zadul me’ad, 3: 67.

258 Medarixhes salikin, 2: 116.

Ulemaja islame, përkitazi me këtë çështje ka dy mendime:²⁵⁹

Mendimi i parë: imani është emër me të cilin quhet deklarimi (shehadeti) me gjuhë, vërtetimi me zemër dhe zbatimi në praktikë me organet tjera të trupit. Këtë mendim e mbështet shumica e ehli Sunnetit.²⁶⁰

259 Ulemaja përkitazi me këtë çështje ndahet në më tepër se dy mendime, por, ehli Sunneti i ka vetëm dy mendime, ndërsa mendimet e tjera, janë mendime të fraksioneve të ndryshme. Shumë libra të akaidës i kanë trajtuar detajisht të gjitha këto mendime, prandaj nuk është nevoja që këtu t'i përmendim të gjitha ato, sepse pasaktësia e tyre është e qartë, ndërsa ulemaja e ehli Sunnetit është në pajtueshmëri se ato janë larg të vërtetës e cila bazohet në Kur'an dhe Sunnet. Më detajisht përkitazi me këto mendime dhe përgjigjet në to, shih: Sherhul 'akidetit-Tahavijje, f. 373 e më tej.

260 Imam Ibnul Kajjimi thotë: "Dhe thuaju atyre se imani i njeriut është të folurit, puna dhe vërtetimi me zemër." Komentuesi thotë: "Qëndrimi i ehli Sunnetit është të vërtetuarit me zemër, praktika me organe dhe shqiptimi me gjuhë. Imam Shafiu r.a. në librin e vet të njohur El-Umm, thotë: "As'habët, tabi'inët dhe të tjerët pas tyre, të cilët i kemi hasur ne, kanë qenë të një mendimi dhe të gjithë thoshin: Imani është shqiptimi, zbatimi dhe nijeti, asnjëra prej këtyre triave nuk ka dobi pa dy të tjerat." Imam Ahmed bin Hambeli r.a. thotë: "Për këtë shkak fjalët e ehli Sunnetit se imani është shqiptimi dhe vepra, janë bërë një nga shenjat e Sunnetit." Ebu Umer el-Talemanki transmeton me senedin e vet të njohur nga Musa bin Harun El-Hammali se ka thënë: "Is'hak bin Raheveji na ka diktuar se imani është e folmja dhe vepra, se zmadhohet dhe zvogëlohet, dhe nuk ka dushim se kjo është ashtu siç na ka përshkruar ai. Ne e kemi kuptuar këtë nga burimet e sigurta, nga rregullat e përgjithshme të Islamit dhe nga fjalët e as'habëve të Resulull-llahut s.a.v.s., tabi'inëve dhe brezave të ilmit pas tyre. Të gjithë ata kanë qenë në pajtim përkitazi me këtë çështje dhe assesi nuk janë kundërshtuar. E njëjta situatë ka qenë edhe në kohën e Evza'ut në Sham, Sufjan Eth-Thevriut në Irak, Malik bin Enesit në Hixhaz dhe Mu'ammerit

Mendimi i dytë: imani është emër me të cilin emërtohet shqiptimi (i shehadetit) me gjuhë dhe vërtetimi me zemër, e këtu nuk hyjnë veprat. Por, ata thonë: “Kryerja e të gjitha gjërave që janë urdhëruar dhe janë shpjeguar në hadithe sahih të Resulull-llahut s.a.v.s. është vaxhib për të gjithë besimtarët të cilët këtë emër e kanë fituar me fjalë dhe me vërtetim.”²⁶¹

Edhe pse argumentet nga Kur’ani dhe Sunneti janë më tepër në favor të mendimit të parë,²⁶² edhe pse të gjithë përpiqen që mendimet e veta t’i mbështesin me sa më shumë argumente, duket qartë se mospajtimi në mes tyre është i karakterit teorik. Në të nuk bazohet kurrfarë dallimi në praktikë, edhe pse në të ndërtohen mospajttime të tjera, gjithashtu me karakter teorik. Komentuesi i Tahaviut thotë: “Mospajtimi ndërmjet Ebu Hanifes dhe imamëve të tjerë të ehli Sunnetit është me karakter formal. Sepse, konstatimi se veprimet e oraganeve, krahas imanit të zemrës, janë të domosdoshme ose ato janë një pjesë e vetë imanit, krahas pajtueshmërisë se ai i cili bënë mëkat të

në Jemen, siç shpjeguar më parë, se imani është fjala dhe vepra, dhe se zmadhohet dhe zvogëlohet.” Hafëz bin Abdul Berrai në Tahmidin e vet, thotë: ”Fakihët dhe muhaddisët janë të një mendimi se imani është fjalë dhe vepër, e nuk ka vepër pa nijet. Imani tek ata zmadhohet me ta’at e zvogëlohet me ma’sijet. Të gjitha veprat e pëlqyera nga All-llahu xh.sh., tek ta, janë iman. Përveç që nga Ebu Hanife dhe pasuesit e tij përmendet se veprat e pëlqyera nga All-llahu xh.sh. nuk quhen iman. Ata thonë se imani është vërtetim (me zemër) dhe shqiptim (me gjuhë).” Shih Sherh kasideti Ibnul Kajjim, 2: 139-141.

261 El-’Akidetut-Tahavijje me’a sherhiha, f. 373; Kitabul irshad lil Xhujeni, f. 399; El-Fikhul ekber ve Sherhuhu li Mulla Ali El-Kari, f. 87-88.

262 Shih argumentet për përparësinë e mendimit të parë në: Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 3: 148 Dhe në: Ebu Ubejd El-Kasim bin Selam, f. 54.

madh nuk del nga imani, por se ai është nën vullnetin e All-llahut xh.sh. - nëse don, do t'ia falë, e nëse nuk don, do ta ndëshkojë, është mospajtim teorik, i cili nuk rezulton nga pasaktësia në akaidë.²⁶³

Shkaku i kësaj është, e këtë All-llahu e di më së miri, se të dy palët janë në pajtim nga çështja e rëndësisë së veprës në Islam, edhe pse nuk pajtohen në definicionin e tij - a është pjesë e imanit apo vetëm njëra nga shkaqet dhe rezultatet e domosdoshme të imanit. Prandaj, ata që e konsiderojnë këtë si pjesë të imanit, nuk i japin shkallë të njëjtë sikurse shqiptimit me gjuhë dhe vërtetimit me zemër, ngase sikur të mungonte njëra prej këtyre dyjave, do të zhdukej edhe imani, që nuk është rasti me veprën. Ndërsa të tjerët, edhe pse nuk e konsiderojnë si pjesë të imanit, megjithatë konsiderojnë se ajo është e domosdoshme, ngase është pjesë e pandashme e imanit.

Për këtë shkak polemizimi dhe thellimi i hollësishëm në këtë shqyrtim është i panevojshëm dhe i pavlefshëm, ngase është më e nevojshme të merremi me çështje të tjera. Por megjithatë konsiderojmë se është e dobishme t'i sqarojmë disa rregulla të cilat mund të konkludohen nga një pjesë e definicionit ku pajtohen që të dy palët, e me ndihmën e të cilave mund caktojmë se cilët njerëz hyjnë nën emrin e imanit, e cilët nuk hyjnë:

1 - Të dy palët janë të një mendimi se nuk hyjnë në iman ata të cilët publikisht e shqiptojnë shehadetin, por me zemër e mohojnë. Këta janë munafikë, për të cilët All-llahu xh.sh. na

263 Sherhul 'akidetit-Tahavijje, f. 374.

informon se do të jenë të ndëshkuar më ashpër se jobesimtarët dhe se ata do të jenë në fund të Xhehennemit.²⁶⁴

2 - Gjithashtu janë të një mendimi se perceptimi me zemër nuk është i mjaftueshëm për realizimin e emrit iman, ngase krahas perceptimit dhe vërtetimit me zemër është edhe i nevojshëm shqiptimi me gjuhë. Faraoni dhe populli i tij e kanë ditur vërtetësinë e Musait dhe Harunit a.s., por megjithatë kanë qenë jobesimtarë. All-llahu xh.sh., duke na informuar se çka ka thënë Musai a.s., thotë:

“(Musai) tha: “Me të vërtetë, ti e di se këto mrekulli të qarta, nuk i ka shpallur askush tjetër, përpos Zotit të qiellit dhe të Tokës, dhe unë jam i bindur se ti je i hudhur (në humbje)” (El-Isra: 102).

“Dhe, ata, i mohuan ato - duke qenë zullumqarë dhe mendjemëdhenj - por shpirti i tyre i besonte për të vërteta. E, shiko se çfarë ka qenë fundi i ngatërrestarëve!” (En-Nemël: 14).

Ehli Kitabët e kanë ditur se Resulull-llahu s.a.v.s. është i Dërguar, por nuk e kanë besuar. All-llahu xh.sh. thotë:

“Atyre që u kemi dhënë Librin, e njohin (Muhammedin), ashtu si i njohin fëmijët e tyre. E nuk do të besojnë ata që e kanë shkatërruar veten.” (El-En’am: 20).

Madje edhe Iblisi është i vetëdijshëm për Zotin e vet, mirëpo, edhe pranë kësaj, ai është udhëheqës i jobesimtarëve.²⁶⁵

264 Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 3: 147.

Pjesëtarët e ehli Sunnetit janë të një mendimi si besimtar, pjesëtar i kiblës sonë (mysliman), i cili nuk do të mbetet përherë në Xhehennem, nuk mund të jetë, përveç atij që me zemrën e vet fuqimisht ka pranuar fenë tonë Islamin, pa kurrfarë dyshimi dhe nëse e ka shqiptuar kelimeit shehadetin. Sepse, nëse kënaqet vetëm me njëren prej këtyre, ai assesi nuk mund të konsiderohet si pjesëtar i kiblës sonë, pos nëse nuk ka mundur ta shqiptojë shehadetin me gjuhë për shkaqe të arsyeshme, të cilat nuk ka mundur t'i evitojë, siç është ai, i cili shehadetin nuk ka mundur ta shqiptojë për shkak të metës në gjuhë, ose për shkak se e ka hasur vdekja para se ka mundur ta shqiptojë shehadetin, ose dhuna e paevitueshme për shkak të cilës ka qenë i detyruar që të mos e shqiptojë shehadetin.²⁶⁶

3 - Pjesëtarët e ehli Sunnetit janë të një mendimi se All-llahu xh.sh. nga njerëzit kërkon fjalë dhe vepra. Me fjalë nënkuptohen fjalët e zemrës - bindshmëria dhe në fjalët e gjuhës si vërtetim dhe manifestim publik të kësaj bindshmërie. Ata ndahen në mendime vetëm rreth çështjes se ajo që kërkon All-llahu xh.sh. prej nesh, a i takon në tërësi emrit iman apo jo: disa thonë se e tërë ajo, edhe fjalët edhe veprat i takojnë këtij emri, ndërsa të tjerët thonë se vetëm pjesa e parë hyn në iman, e pjesa e dytë është rezultat i obligueshëm i tij.²⁶⁷

4 - Gjithashtu janë në pajtim edhe me atë se, nëse njeriu beson me zemër, e këtë e deklaroi me gjuhë, por i lë pas dore veprat, është mëkatar ndaj All-llahut xh.sh. dhe të Dërguarit të Tij, dhe se

265 Kitabul iman lil Kasim bin Selam, f. 102; Sherhul 'akidetit-Tahavijje, f. 373-374.

266 Sherhun Nevevi 'ala Sahih Muslim, 1: 149.

267 Sherhul 'akidetit-Tahavijje, f. 374.

meriton ndëshkimin që All-llahu xh.sh. për të tillët përmend në Kur'an dhe Resulull-llahu s.a.v.s. në hadithet e veta.²⁶⁸

5 - Pajtohen se vepruesi i mëkatit të madh, me këtë nuk del prej imanit, gjithnjë gjersa nuk e konsideron atë si të lejuar, edhe nëse vdes para pendimit. Shumica e ehli Sunnetit, edhe pse veprat i konsiderojnë si pjesë përbërëse të imanit, nuk thonë se del prej imanit ai i cili beson me zemër, e besimin e tij e deklaron me gjuhë, por i lë pas dore veprat. Ndërsa hanefitët, edhe pse veprat i kanë larguar nga definicioni i imanit, konsiderojnë se veprat janë rezultat i pashmangshëm i imanit. Pra, të gjithë janë të një mendimi se me mungesën e veprave nuk dilet nga imani.²⁶⁹

6 - Gjithashtu nuk ka mospajtim mes ehli Sunnetit përkitazi me atë që kemi thënë mbi definicionin e imanit - se aty bënë pjesë fjala, vërtetimi dhe vepra, dhe se e tërë kjo është në raport me All-llahun xh.sh. dhe meritën e hyrjes në Xhennet dhe mosmbetjes përgjithmonë në Xhehennem. E, për sa i përket imanit në raport me dispozitat e kësaj bote, ai është vetëm shqiptimi i kelimeit shehadetit me gjuhë. Dhe, ai që e shqipton këtë, ndaj tij aplikohen të gjitha dispozitat e kësaj bote dhe prej tij kërkohet që t'i përmbahet atyre, ndërsa atij i sigurohen të drejtat të cilat i takojnë sipas tyre dhe nuk do të konsiderohet jobesimtar, pos nëse bënë diçka (me fjalë apo me vepër) që do ta anulojë kelimeit shehadetin e shqiptuar.²⁷⁰

268 Sherhul 'akidetit-Tahavijje, f. 374.

269 Sherhul 'akidetit-Tahavijje, f. 375.

270 Fet'hul Bari, 1: 39-40.

Argument për këtë, është hadithi i Usame bin Zejdit r.a., i cili thotë: “Resulull-llahu s.a.v.s. na dërgoi në luftë, dhe na zuri agimi duke sulmuar fisin Xhuhejn. Unë e arrita njërin prej tyre i cili tha: “La ilahe il-llah”, e unë e mbyta. Kjo filloj të më mendojë, andaj i tregova Resulull-llahut s.a.v.s. se ç’kishte ndodhur. Ai më tha: “A mos vallë, e ke mbytur pasi që e ka thënë La ilahe il-llah?” Dhe vazhdimisht ma përsëriste këtë, saqë dëshirova që vetëm atëherë të kisha kaluar në Islam.”²⁷¹ Këto janë fjalët e Resulull-llahut s.a.v.s.: “A mos ia ke hapur zemrën atij (e të bindesh se nuk ka qenë i sinqertë)? Në jemi të obliguar të sillemi dhe të gjykojmë sipas së jashtëmës dhe sipas asaj që shqipton gjuha, sepse ne nuk kemi mundësi të dimë se çka gjendet në zemra.”

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I IMANIT

Në bazë të mospajtimit në definicionin e imanit, ulemaja gjithashtu nuk janë të një mendimi edhe rreth çështjes së dytë, çështjes së zmadhimit dhe zvogëlimit të imanit. Grupi që veprat i klasifikon si pjesë përbërëse të imanit, konsideron se ai zmadhohet dhe zvogëlohet, ndërsa ata që me iman nënkuptojnë vetëm bindshmërinë me zemër dhe shqiptimin me gjuhë, konfirmojnë të kundërtën. Tanimë kuptuam se mospajtimi rreth definicionit të imanit është vetëm nga ana teorike dhe formale, e i njëjti rast është edhe rreth kësaj çështjeje. Sepse, ata që konsiderojnë se imani nuk zmadhohet dhe nuk zvogëlohet, konfirmojnë se njerëzit dallohen sipas devotshmërisë dhe

²⁷¹ Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 2: 299.

veprave të mira, dhe se në përputhje me këtë do të jenë ndryshe të shpërblyer, dhe se ata do të kenë shkallën e caktuar tek All-llahu xh.sh. Tahaviu, në veprën e vet të njohur El-'Akide, thotë: “Imani është një, dhe bartësit e tij në esencë janë të njëjtë, ndërsa, dallimet ndërmjet tyre prehen në devotshmëri, takvallëk, ruajtjen nga pasionet dhe kryerjen e asaj që është më e rëndësishme.”²⁷²

Ndërkaq, ajetet kur'anore dhe hadithet na mundësojnë të kuptojmë se imani zmadhohet dhe zvogëlohet. Ja disa prej këtyre ajeteve:

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet All-llahu, vërgëllojnë (nga frika dhe përulja), e kur t'u lexohen argumentet e Tij, iu shtohet thellimi në besim dhe mbështeten vetëm te Zoti i tyre”. (El-Enfal: 2).

“E atyre, të cilëve u thanë njerëzit: “Armiku është përgatitur kundër jush, frikohuni!”, kjo përkundrazi ua shtoi atyre besimin, e thanë: “Neve na mjafton All-llahu, dhe Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!” (Ali Imran: 173).

“Ai është që sjellë qetësi në zemrat e besimtarëve për t'ua forcuar (edhe më tepër) besimin, krahas besimit që kanë.” (El-Fet'h: 4).

Ndërsa nga hadithet që e argumentojnë këtë, është hadithi ku Resulull-llahu s.a.v.s. thotë: “Imani përbëhet prej shtatëdhjetë e ca pjesësh. Më e madhja prej tyre është maksima: La ilahe il-IAll-llah, ndërsa më e vogla është: të largosh nga rruga diç që u pengon kalimtarëve. E, edhe turpi është

272 Sherhul 'akidetit-Tahavijje, f. 375.

pjesë e imanit.”²⁷³ Gjithashtu hadithi: “Besimtari më i kompletuar me iman është ai që ka sjellje më të mira.”²⁷⁴ Pastaj hadithi: “Kush prej jush sheh ndonjë të keqe, le ta pengojë me dorën e vet, e nëse nuk është në gjendje, le ta bëjë këtë me fjalë, e, nëse edhe kështu nuk është në gjendje, atëherë le ta urrejë këtë me zemrën e vet, e ky është imani më i dobët.”²⁷⁵ Transmetohet nga Abdull-llahu bin Mes’udi r.a. se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Secili Pejgamber, që e ka dërguar All-llahu xh.sh. para meje, ka pasur pasuesë (havarijunë) dhe shokë të vet, të cilët i zbatonin udhëzimet e tyre dhe e ndjeknin shembullin e tyre. E, pastaj, pas tyre vinin gjenerata të cilat flisnin atë që nuk e punonin dhe punonin atë që nuk ishin të urdhëruar. Andaj, kush prej jush lufton kundër tyre me dorë, ai është mu’min, e kush prej jush lufton kundër tyre me fjalë, edhe ai është mu’min, dhe kush prej jush lufton kundër tyre me urrejtje në zemrën e vet, edhe ai është mu’min, por pas kësaj më nuk ka iman as sa një kokërr sinapi (bimë barishtore që bën fara të vogla).”²⁷⁶

Ndërsa, nga fjalët e as’habëve, që konfirmojnë këtë, janë: Transmetohet se Ebu Derda r.a. ka thënë: “Është e udhës që çdo njeri ta përtëritë imanin e vet kur zvogëlohet diç prej tij, dhe është e udhës që ta dijë se, a është duke iu zmadhuar apo zvogëluar.” Umeri r.a. e kishte zakon t’u thoshte as’habëve: “Hajde ta zmadhojmë imanin tonë”, pastaj i bënim dhikër All-llahut xh.sh.”

273 Muttefekun ‘alejhi, e ky është transmetim i Muslimit. Shih: Sahih Muslim bi sherhin Nevevi., 1: 6 dhe Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 1: 44.

274 Transmeton Tirmidhiu, i cili thotë se hadithi është hasen dhe Hakimi, i cili thotë se hadithi është sahih ‘ala shartihima. Shih: Et-Tergib vet terbih, 3: 404.

275 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi., 2: 22.

276 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi., 2: 27.

Ekzistojnë edhe shumë ajete, hadithe dhe proverba (thënie) të as'habëve të cilat na bëjnë të kuptojmë zmadhimin apo zvogëlimin e imanit, varësisht nga veprat që i bëjmë.²⁷⁷

E, nëse ajetet dhe hadithet sipas domethënive të tyre parësore provojnë zmadhimin dhe zvogëlimin e imanit, atëherë nuk është nevoja që t'i shmangemi kësaj domethënieje, sidomos kur nuk kemi kurrfarë dobie nga komentimi alegorik (te'vilit), dhe as nga kjo ndarje në mendime që rezultojnë prej këtu. Më e rëndësishmja është, që njeriu vazhdimisht ta përtëritë imanin e vet dhe ta kontrollojë vetveten se a i është duke iu zmadhuar imani apo duke iu zvogëluar. E, pastaj t'i konstatojë shkaqet e zvogëlimit të tij, në mënyrë që t'i eliminojë ato dhe të largohet prej tyre, ose t'i hulumtojë shkaqet për zmadhimin dhe rritjen e imanit dhe këndelljes së zemrës së tij, ashtu siç kanë bërë as'habët r.a. Shkaqet më të rëndësishme për zmadhimin e imanit janë këto:

1 - Dituria: zmadhimi i diturisë shkakton rritjen e bindshmërisë dhe perceptimit. Ibni Xhundubi, Ibni Umeri e të tjerët r.a. kanë thënë: “E kemi mësuar imanin, pastaj e kemi mësuar Kur'anin, e na është shtuar imani.”²⁷⁸ Me dituri nënkuptohet dijenia për All-llahun xh.sh. përmes emrave, cilësive, veçorive dhe veprave të Tij, dhe dijenia për Resulull-llahun s.a.v.s. dhe udhëzimet e tij nga pikëpamja e moralit e të ngjashme dhe parimet e ligjit. Të diturit e mënyrës së kryerjes së ibadetit, xhihadit dhe të punuarit. Dijenia për Librin e All-llahut xh.sh. dhe përmbajtjen e tij, për rrëfimet historike, shembujt që i parashtron ai, proverbat e tij, mësimet dhe sqarimet e tij.

277 Sherhul 'akidetit-Tahavijje, f. 386.

278 Sherhu kasideti Ibnul Kajjim, 2: 141.

Imani, në esencën e vet, është pranimi dhe njohja për të vërtetë se All-llahu xh.sh. është i Vetmi që meriton të adhurohet me të gjitha cilësitë që janë të denja për Të, pranimi i pejgamberllëkut të Muhammedit a.s. dhe njohja për të vërtetë të tërë asaj që ka interpretuar ai nga Zoti i tij globalisht, që dëshmohet me shehadet. Dhe, ai që e shqipton këtë, duke besuar në atë që thotë, ai arrinë themelin e Islamit, por ky nuk mund të krahasohet me atë, i cili ka perceptuar domethënien e tij në hollësi dhe të gjërave që rezultojnë nga ai. Sepse, është e pamundur të barazohet në iman ai që i di detajet për të cilat ka folur Resulull-llahu s.a.v.s., lidhur me ndodhitë pas vdekjes, me engjëjt, me vuajtjet dhe kënaqësitë etj., me atë që nuk i di këto, edhe pse e tërë kjo globalisht hynë në dëshminë se Muhammedi a.s. është i Dërguari i All-llahut xh.sh. Gjithashtu nuk mund të barazohet ai i cili është i njohur me detajet mbi ahiretin dhe çka do t'i ndodhë atij, duke filluar nga ringjallja dhe tubimi, e gjer tek parashtrimi dhe leximi i librit të veprave për dhënien e llogarisë. Pastaj për vështirësitë në të cilat do të gjenden njerëzit, për burimin e Resulull-llahut s.a.v.s., urën Sirat, Xhennetin dhe Xhehennemin. Ky nuk mund të barazohet me atë i cili ka besuar në botën e ardhshme përgjithësisht pa i ditur detajet për të. Gjithashtu nuk mund të barazohet ai, i cili është njohur hollësisht mbi jetën e Resulull-llahut s.a.v.s. dhe madhësitinë e tij me atë që nuk është njohur me këtë. Prandaj All-llahu xh.sh. ka thënë:

“... Me të vërtetë, All-llahut i druajnë vetëm të dijshtmit prej robërve të Tij.” (Fatir: 28).

“... Thuaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?” (Zumer: 9).

2 - Veprat: Me rritjen e një numri të veprave të mira dhe me përujten ndaj All-llahut xh.sh. zmadhohet jekini dhe forcohet imani. Ndërsa, me zvogëlimin e veprave dhe më zhytjen në pasione dhe në mëkate, zvogëlohet imani. Disa njerëz, mëkatimet e tyre të vazhdueshme i sjellin

gjer tek mohimi i dispozitave fetare dhe të konsideruarit për të lejueshëm diç që është e ndaluar, dhe gjer tek mohimi i haditheve të Resulull-llahut s.a.v.s. duke i asryetuar mëkatet e veta, e në këtë mënyrë dalin nga imani e futen në kufër. All-llahu na ruajt nga ky kob i keq! Sepse, siç thamë edhe më parë, baza e imanit është pranimi dhe njohja për të vërtetë se All-llahu xh.sh. është i Vetmi që meriton të adhurohet dhe se vetëm Atij duhet T'i përulemi. E ky pranim dhe njohje është i dylojshëm: pranimi teorik duke besuar dhe pranimi praktik me përlulje dhe me aplikim. Kush përkufizohet vetëm në mënyrën e parë, imani i tij në All-llahun xh.sh. është i mangët, jo i plotë, e sa më shumë që rritet përlulësia e tij aq më shumë rritet edhe imani i tij. Ndërsa për iman të plotë janë të nevojshme që të dy mënyrat.

3 - Dhikri dhe përsiatja: Me të parin mendohet ta kujtosh All-llahun xh.sh. me cilësitë e Tij dhe me atë që i përshtatet Madhërisë dhe Lartësisë së Tij dhe këndimin e Kur'anit (fjalët dhe ajetet e Tij), ngase kjo përforcon lidhshmërinë e zemrës me Krijuesin e saj, ndërsa zvogëlimi i kësaj shkakton harresën në All-llahun xh.sh. Tanimë e kemi thirrjen e Umerit r.a. që i ka bërë as'habëve që ta zmadhojnë imanin e tyre duke përmendur All-llahun xh.sh. Transmetohet nga Ebu Xha'feri, i cili transmeton nga gjyshi i tij Umejr bin Habibi, as'hab i Resulull-llahut s.a.v.s., se ka thënë: "Imani zmadhohet dhe zvogëlohet", i është thënë: "Si zmadhohet dhe si zvogëlohet?" Është përgjigjur: "Kur e përmendim All-llahun dhe e falënderojmë Atë, atëherë imani na zmadhohet, e kur shkujdesemi dhe e harrojmë Atë, atëherë zvogëlohet imani." Ndërsa Abdull-llah bin Revaha e kishte zakon ta merrte përdore ndonjërin prej as'habëve e t'i thoshte: "Eja të besojmë një orë (nu'minu sa'a) e pastaj të shkojmë e të rrimë në shoqëri ku përmendet All-llahu xh.sh."²⁷⁹

279 Sherhu kasideti Ibnul Kajjim, 2: 140-141.

Ndërsa All-llahu xh.sh. na informon se nga veçoritë e besimtarit është edhe ajo që All-llahun e përmend duke qëndruar në këmbë, ulur dhe ratë:

“Për ata që e përmendin All-llahun duke qëndruar në këmbë, dhe ndenjor.” (Ali Imran: 191).

Kurse me përsiatje mendohet që gjithnjë të bëjmë përpjekje që përherë të mendojmë për krijimin e All-llahut xh.sh. duke përsiatur për krijimet e Tij dhe duke i vështruar shenjat dhe mu'xhizet e Tij. Sepse, në iman bën pjesë edhe vetëdija mbi Madhërinë e All-llahut xh.sh. dhe Plotfuqinë e Tij, cilësitë e lartësuar dhe veprat e përsosura të Tij. E kjo ndjenjë formohet duke i vështruar dhe duke i vëzhguar mbretëritë e All-llahut xh.sh., duke përsiatur dhe duke marrë mësim nga çdo gjë që mund të shihet. A nuk po e vëren se bindshmëria jote që ndonjë njeri është mjeshër i madh në zejen e tij do të rritej sikur ta shihje me sytë e tu ndonjë vepër të tij, pasi që vetëm ke dëgjuar për të dhe për mjeshtrinë e tij nga njerëzit e tjerë. E, nëse do të shihje më tepër shembuj të mjeshtrisë së tij, me siguri se bindshmëria jote do të ishte rritur edhe më. Dhe, gjithsesi kjo bindshmëri do të rritej gjithnjë e më tepër sikur të kishe gjasa që më hollësisht t'i shikoje e t'i studioje këta shembuj. Ndërsa cilësitë e All-llahut xh.sh. dhe veprat e Tij madhështore, janë të dukshme për çdonjërin në këtë Gjithësi kolosale. Mirëpo, ekzistojnë njerëz që pranë këtyre shenjave kalojnë të shurdhër dhe të verbër dhe assesi nuk shkojnë më larg se kënaqësitë dhe pasionet të cilat gjenden në të. Këta janë jobesimtarë dhe besimtarë me iman të dobët. Ndërsa, ekzistojnë edhe të tillë, që në to shohin madhësinë e All-llahut dhe madhësinë e mbretërisë së Tij, plotfuqinë dhe përcaktimin e Tij, dhe për shkak të gjitha këtyre, imani dhe jekini u rritet edhe më shumë. Të tillët janë ata që All-llahu xh.sh. i ka përshkruar në këto ajete:

“... dhe që mendojnë në krijimin e qiejve dhe të Tokës.” (Ali Imran: 191).

“Dhe ata, të cilët, kur përkujtohen me argumentet e Zotit të tyre, nuk binë para tyre, as të shurdhër as të verbër (por dëgjojnë e meditojnë).” (El-Furkan: 73).

Ndërsa për të tjerët, thotë:

“Ata (që janë zhytur në të këqija e bredhin andej e kënde) janë të ngjashëm me ata që ndezin zjarrin, i cili kur të ndriçojë rrethin e tyre, All-llahu ua merr dritën, i le në errësirë dhe ata nuk shohin asgjë! Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër; prandaj nuk kthehen (nga e keqja në të mirë).” (El-Bekare: 17-18).

KAPITULLI I TRETË FJALËT DHE VEPRAT TË CILAT NXJERRIN NGA IMANI

N

ë kapitujt e mëparshëm, kuptuam se çka duhet besimtari të njoh për të vërtetë dhe të pranojë atë, e assesi ta mohojë. Gjthashtu kuptuam edhe rëndësinë e imanit, i cili duhet të jetë i ndërlidhur me ato gjëra.

Në këtë kapitull do të flasim për gjërat të cilat mohojnë imanin e njeriut dhe e nxjerrin atë nga rrethi i besimtarëve, dhe e bëjnë atë pjesëtar të shoqërisë së jobesimtarëve. Mirëpo, sqarimi i kësaj

kërkon prej nesh që ta japim fjalën hyrëse mbi parimet e imanit dhe të Islamit. Mbi kufirin gjer tek i cili njeriu i moshës madhore duhet të arrijë që të konsiderohet si besimtarë dhe myslimanë, e nëse nuk e arrinë atë, atëherë bëhet jobesimtar. Kjo duhet bërë në mënyrë që ta kemi më të qartë perceptimin mbi kornizat e imanit dhe kornizat e kufirit, para se të fillojmë të flasim për atë që nxjerrë nga e para dhe shpie në të dytën.

Për këtë arsye ky kapitull përmbahet prej dy pjesësh, pjesa e parë konsiderohet si hyrje në pjesën e dytë:

- e para është kur jobesimtari bëhet besimtar (si hyhet në fenë e All-llahut xh.sh.);
- e dyta është kur besimtari bëhet jobesimtarë (gjërat që nxjerrin nga imani).

PJESA E PARË

KUR JOBESIMTARI BËHET BESIMTAR

Si hyhet në fenë e All-llahut xh.sh.?

Nga shpjegimi i gjertanishëm mund të konkludojmë se bazat e imanit kanë domethëniet e veta të përgjithshme dhe të zgjeruara. E, ai që e koncepton domethënien e zgjeruar të këtyre bazave, ai beson në to dhe i kryen veprat që kërkohen prej tij dhe ai është prej atyre për të cilët All-llahu xh.sh. thotë:

“Ata, pa dyshim, janë besimtarë të vërtetë. Për ata ka pozita te Zoti i tyre, falje dhe dhunti fisnike” (El-Enfal: 4).

Mirëpo, All-llahu xh.sh. me urtësinë e Tij, ka dashur t’ua lehtësojë robërve të Vet, andaj dyert, përmes cilave njerëzit hynë në iman, i ka bërë shumë më të thjeshta sesa ato detaje të gjerësishtme. Ai është kënaqur që ata ta njohin domethënien e përgjithshme ku hyjnë të gjitha ato detaje. Është kënaqur që, në fillim, vetëm me gjuhë e me zemër të pranojnë se All-llahu xh.sh. është Zot i tyre, se do ta adhurojnë Vetëm Atë, se Muhammedi s.a.v.s. është i Dërguari i Tij dhe se e tërë ajo me çka ka ardhur ai nga Zoti i tij është e vërtetë dhe se e tërë kjo duhet të zbatohet në vepër. Tërë kësaj All-llahu xh.sh. i ka dhënë një titull, fjalën e njohur dhe të bukur - Shehadet: La ilahe il-lallah Muhammedun Resulull-llah - Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut, Muhammedi është Pejgamber i All-llahut.

Prandaj, kush i shqipton këto fjalë me gjuhën e vet, beson në to me zemrën e tij dhe nuk bënë asgjë nga veprat, fjalët dhe bindja, të cilat i asgjësojnë këto, ai ka hyrë në fenë e All-llahut dhe e ka braktisur kufrin në të cilin ka qenë gjer në atë çast.²⁸⁰

280 Ndoshta dikush do të thotë: Bazat e imanit, siç shihet nga hadithi i cituar, janë diç shumë më shumë sesa është vetëm imani në All-llahun xh.sh. dhe në Pejgamberin e Tij, andaj si mund të jetë i mjaftueshëm vetëm shehadeti për të hyrë në iman? Përgjigja në këtë pyetje është: Ekzistojnë dy lloj imanesh: imani i përgjithshëm dhe imani në kuptimin e tij më të gjerë. I pari është imani në All-llahun xh.sh. dhe në tërë atë me çka ka ardhur Resulull-llahu s.a.v.s., pa i përmendur detajet e tyre. Prandaj, kur njeriu dëshmon se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i All-llahut, ai me këtë e njeh për të vërtetë tërë atë me çka ka ardhur Resulull-llahu s.a.v.s. dhe për çka na ka

ARGUMENTET PËR KONFIRMIMIN E PARASHTRUAR

Se prej njerëzve kërkohet vetëm shqiptimi dhe pranimi i kelimeit shehadetit, pa partikularitetet e hollësishme të bazave të imanit dhe të Islamit, e vërtetojnë shumë hadithe sahih. Në to, hyrja në iman e në Islam, hyrja në Xhennet dhe mosqëndrimi i përhershëm në zjarr, bazohet në bindshmëri se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut xh.sh. dhe se Muhammedi është i Dërguar i All-llahut.

Gjithashtu, edhe shumë ngjarje nga jeta e Resulull-llahut s.a.v.s. na bëjnë të ditur se Resulull-llahu s.a.v.s. dhe as'habët të tij e kanë konsideruar si besimtar atë që shqiptonte kelimeit shehadetin, ndërsa prej tij, në fillim, nuk kërkonin asgjë më tepër se kjo. Do t'i citojmë disa hadithe që e vërtetojnë këtë, e pastaj do t'i përmendim disa ngjarje nga jetëshkrimi i Resulull-llahut s. a. v., të cilat gjithashtu e vërtetojnë këtë.

Hadithet:

informuar ai, ku gjithsesi hyjnë edhe bazat e imanit dhe të Islamit, edhe pse ende nuk i di parçialisht. Sepse, nga shehadeti i tij rrjedh se ai do të besojë dhe do të pranojë tërë atë që do të vijë tek ai nga i Dërguari i All-llahut. Mirëpo, ai, tek te i cili kanë arritur të gjitha detajet e imanit, i beson atyre dhe punon sipas tyre, imani i tij gjithsesi është më i fortë dhe ai është në pozitë më të lartë tek All-llahu xh.sh. E, ai që beson përgjithësisht, e pastaj tek ai arrin diç që transmetohet nga Resulull-llahu s.a.v.s., e nuk i beson kësaj, ai me këtë mohon shehadetin të cilin më parë e ka shqiptuar, e me këtë ai bëhet renegat i fesë, për çka do të flasim më vonë. Shih: El-furkan bejne evlijair-Rahman ve evlijaish-shejtan li ibni Tejmijje, në librin Muxhmu'atit-tevhid, f. 510; dhe Usulus-Serahsi, 1: 203.

1 - Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se unë jam i Dërguari i All-llahut. Asnjë njeri te i cili All-llahu xh.sh. në Ditën e gjykimit has se i beson bindshëm këtyre fjalëve, pa kurrfarë dyshimi, do të hyjë në Xhennet.”²⁸¹ Në një rivajet tjetër qëndron: “Asnjë njeri te i cili All-llahu xh.sh. në Ditën e gjykimit has se i beson këtyre fjalëve fuqishëm, pa aspak dyshim, nuk do të mbetet mahrum nga Xhenneti.”²⁸²

2 - Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Kush vdes, duke ditur se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, do të hyjë në Xhennet.”²⁸³

3 - Transmetohet nga Ubade bin Samiti r.a. se e ka dëgjuar Resulull-llahun s.a.v.s. duke thënë: “Kush dëshmon se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i All-llahut, nuk do të hyjë në Xhehennem.”²⁸⁴

Hadithet të cilat kanë domethënie²⁸⁵ të njëjtë janë të shumta dhe të njohura, dhe të gjitha ato na bëjnë të ditur se ai i cili vdes me tevhid dhe e takon All-llahun xh.sh. me kelime shahadet, do të hyjë në Xhennet, dhe se nuk do të qëndrojë përherë në zjarr, edhe pse ndëshkohet me të për shkak të veprave të këqija dhe mëkateve që i ka bërë.

281 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 1: 224.

282 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 1: 226.

283 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 1: 218.

284 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 1: 229.

285 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 1: 218-240.

SHEMBUJT NGA PRAKTIKA E RESULLULL-LLAHUT S.A.V.S. DHE NGA NDODHITË NGA SIREJA

Nga praktika e Resullull-llahut s.a.v.s. dhe nga disa raste gjatë jetës së tij, shohim se ai i ka konsideruar për besimtarë ata të cilët e kanë shqiptuar shehadetin.

1 - Muslimi, Ebu Maliku në Muvetta'në e vet, Ebu Davudi dhe Nesaiu transmetojnë hadithin e Mu'avi bin Hekam Es-Sulemit ku thotë se Resullull-llahu s.a.v.s. i ka thënë robëreshës, të cilën Mu'aviu kishte dashur ta lironte si keffaret (shpengim për mëkate): “Ku është All-llahu?” Ajo u përgjigj: “Në qiell.” Ai tha: “Kush jam unë?” Ajo tha: “Ti je i Dërguari i All-llahut.” Atëherë ai i tha Mu'aviut: “Liroje!”²⁸⁶

2 - Ebu Davudi dhe Nesaiu transmetojnë hadithin e Sherid bin Suvejd Eth-Thekafit ku qëndron se Resullull-llahu s.a.v.s. i ka thënë një robëreshë: “Kush është Zoti yt?” Ajo u përgjigj: “All-llahu.” Ai i tha: “E kush jam unë?” Ajo u përgjigj: “I Dërguari i All-llahut.” Atëherë ai tha: “Liroje atë, ajo është besimtare.”²⁸⁷

3 - Në sire thuhet se Ebu Bekri, me rastin e pranimit të Islamit, ka vajtur tek Resullull-llahu s.a.v.s. e i ka thënë: “A është e vërtetë ajo çka flasin kurejshitet, o Muhammed? Se ti i ke braktisur zotat tonë, se sjelljet tona i konsideron jonormale dhe se etërit tanë i konsideron jobesimtarë?” Resullull-llahu s.a.v.s. është përgjigjur: “Përkundrazi, unë jam i Dërguari i All-llahut dhe Lajmëtari

286 El-Muvetta', f. 485-486; Nejlul evtar, 7: 208.

287 Nejlul evtar, 7: 208.

i Tij. Më ka dërguar që ta dorëzoj porosinë e Tij. Unë të thërras, o Ebu Bekër, ta adhurosh vetëm All-llahun xh.sh., që mos t'i bësh ibadet askujt tjetër përveç Tij dhe të obligohesh me përlësi ndaj Tij.” Pastaj ia ka cituar disa fragmente nga Kur’ani. Atëherë Ebu Bekri e pranoi Islamit, e braktisi adhurimin e idhujve dhe zotave të tjerë të rrejtshëm dhe e kuptoj vërtetësinë e Islamit. Pastaj u kthye në shtëpinë e vet si besimtar.²⁸⁸ E ajo në çka e ka thirrë Resulull-llahu s.a.v.s. Ebu Bekrin, në realitet është thirrje në kelime shahadet.

4 - Në siren transmetohet se Halid bin Se’idi, me rastin e pranimit të Islamit, e ka takuar Resulull-llahun s.a.v.s. e i ka thënë: O i Dërguari i All-llahut, o Muhammed, në çka po thërret ti?” Ai është përgjigjur: “Të thërras ta besosh vetëm All-llahun dhe asnjë shok të mos ia përshkruash Atij, dhe të dëshmosh se Muhammedi është robi dhe i Dërguari Tij. Ta braktisish adhurimin e gurëve që nuk ndiejnë dhe nuk sjellin kurrfarë dobie, as që mund të shkaktojnë dëm, e as që e dinë se kush i adhuron e kush jo.” Atëherë Halidi tha: “Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se ti je i Dërguari i All-llahut.” Ndërsa Resulull-llahu s.a.v.s. iu gëzua Islamit të tij.²⁸⁹

5 - Transmetohet se Ebi Dherr El-Gaffari, me rastin e pranimit të Islamit, ka thënë: “Kam qenë i katërti në Islam. Para meje e kishin pranuar Islamit tre vetë, e unë isha i katërti. Erdha tek Resulull-llahu s.a.v.s. e i thash: “Es-selamu ‘alejke ja Resulull-llah. Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i All-llahut.” Atëherë pash gëzimin në fytyrën e Resulull-llahut s.a.v.s.²⁹⁰ Ky është versioni i shkurtër, ndërsa Buhariu e transmeton rastin

288 Es-Siretu nebevijje li ibni Kethir, 1: 433; Es-Siretul Helebijje, 1: 444.

289 Es-Siretu nebevijje li ibni Kethir, 1: 445.

290 Es-Siretu nebevijje li ibni Kethir, 1: 447.

e kalimit të Ebu Dherrit në tërësi, ku qëndron se Resulull-llahu s.a.v.s. i ka thënë Ebu Dherrit pasi që e pranoi Islam: “Shko tek populli yt dhe informoje për këtë, gjersa nuk të vjen urdhri tjetër prej meje.” Ai tha: “Pasha All-llahun, këto fjalë do t’i shqiptoj me zë të lartë para tyre.” Pastaj vajti para xhamisë dhe bërtiti me gjithë fuqinë që kishte: “Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i All-llahut.” Kur e dëgjuan këtë mushrikët, u ngritën dhe filluan ta rrahnin gjersa nuk e rrëzuan për toke.”²⁹¹

Nga ky rivajet shihet qartë se as’habët hynin në Islam duke deklamuar kelime shahadetin.

6 - Për shkakun e kalimit në Islam të Tufejl bin Amrit r.a., për të cilin në sire thuhet se ka qenë ndër të parët autoritativ, të cilin e respektonin të gjithë në fisin Devs, qëndron se ai ka ardhur në Mekë, e para tij janë tubuar paria kurejshite, ia kanë tërhequr vërejtjen për Resulull-llahun s.a.v.s. dhe ia kanë ndaluar të takohet me të ose ta dëgjoj ligjërimin e tij. Tufejli thotë: “Aq tepër ishin këmbëngulës, saqë vendosa të mos bisedoja me të e as mos ta dëgjoja atë. Madje edhe kur kaloja pranë mesxhidit, i mbyllja veshët me pambuk duke u frikësuar se do të dëgjoj diç nga biseda e tij dhe me të vërtetë nuk kisha dëshirë ta dëgjoj atë. Por një herë vajta në mesxhid dhe e pash Resulull-llahun s.a.v.s. duke u falur para Ka’bes. U ndala pranë tij, e All-llahu nuk më la të mos i dëgjoj disa nga fjalët e tij. Ligjërimi që e dëgjova ishte i këndshëm. Andaj, i thashë vetit: “Vaj halli për ty o Tufejl, se çdo të gjej! Pasha Zotin, unë jam poet i talentuar, mirë e dalloj ligjërimin e mirë nga i keqi, atëherë çka më pengon të dëgjoj ligjërimin e këtij njeriu? Nëse flet diçka mirë, do ta pranojë, e nëse jo, nuk do ta përfilli atë.” Ndeja aty gjersa ai nuk u nis për në shtëpi. E përcolla dhe kur hyri në shtëpi, hyra edhe unë pas tij. Pastaj i thash: “O Muhammed, populli yt më tha

291 Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 7: 139; Hajatus sahabe, 1: 290; Es-Siretul Helebije, 1: 451.

kështu e kështu (siç kishte dëgjuar edhe ai), pasha All-llahun vazhdimisht më frikësonin prej teje përderisa nuk i mbylla veshët e mi me pambuk. Por All-llahu ka dashur të kundërtën dhe unë dëgjova diç nga fjalët tuaja, të cilat i përjetova si fjalë të bukura, prandaj kërkoj prej teje që të më tregosh si qëndron puna me ty.” Ai ma prezantoi Islamin dhe këndoi nga Kur'ani. Pasha All-llahun, kurrë gjer atëherë nuk kisha dëgjuar diç më të bukur e as më të drejtë se Islami. Sa ligjërim i mrekullueshëm që ishte. Menjëherë pranova Islamin, e shqiptova shehadetin e të vërtetës dhe i thashë: “Mua më dëgjon populli im, andaj po kthehem në vendin tim dhe do t'i thërras në Islam, lute All-llahun të ma jap ndonjë shenjë.” Resulull-llahu a.s. u lut.”²⁹² E shehadeti i të së vërtetës është dëshmi se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguar i All-llahut, siç është shpjeguar në disa rivajete.

7 - Për shkakun e pranimit të Islamit nga ana e Halid bin Velidit r.a., në veprat e sirës transmetohet se ai ka vajtur tek Resulull-llahu s.a.v.s. në Medinë, pasi që i vëllai i kishte shkruar letër, me anë të cilës e thërriste në Islam. Halidi rrëfen: “Vëllai më priti me mirëseardhje dhe më tha: “Shpejto, Resulull-llahu tanimë është informuar (me anë të Shpalljes) për kalimin tënd në Islam dhe i është gëzuar ardhjes sate, dhe ai të pret. (Së bashku me të kanë qenë Amër bin A'si dhe Uthman bin Talha). Dhe shpejtua gjerja nuk e pashë. Derisa iu afroreshim, ai rrinte me buzë në gaz. Pastaj e përshëndeta si Pejgamberin. Ai me fytyrë të qeshur ma kthei selamin, e unë i thash: “Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se ti je i Dërguari i All-llahut.” Ai

292 Siretu Ibni Hisham, 1: 407-408.

më tha: “Afrohu”, e pastaj më tha: “Qoftë falënderuar All-llahu që të udhëzojë. Unë e kam par se ti ke mendje për të cilën kam shpresuar se do të të shpie gjer tek e vërteta.”²⁹³

Në këtë mënyrë e ka pranuar Islamin një numër i madh i as’habëve para dhe pas hixhretit.²⁹⁴

Të gjitha këto ngjarje dhe traditat gojore autentike tregojnë të njëjtën gjë, ku pjesëtarët e ehli Sunnetit pajtohen tërësisht, e kjo është se hyrja në fenë e All-llahut xh.sh. nuk mund të bëhet me asgjë tjetër, përpos me kelime shehadetin. Prandaj askush nuk është në gjendje, pas këtyre argumenteve, të konfirmojë se dikush ka hyrë në Islam e të mos e shqiptojë me gjuhë dhe të vertetojë me zemër kelime shehadetin. Gjithashtu askush nuk është në gjendje ta konsiderojë jobesimtar atë që e ka shqiptuar kelime shehadetin, nëse personi në fjalë nuk ka bërë diç që e anulon shehadetin e tij.

Për hyrje në Islam nuk mjafton vetëm një pjesë e kelime shehadetit, porse duhet të shqiptohen dhe të pranohen të dy pjesët e tij. Nëse dikush do të thoshte se nga disa hadithe të përmendura mund të kuptohet se është e mjaftueshme vetëm pjesa e parë e shehadetit (se nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut), atij do t’i thuhet se edhe në to mendohet në të dy pjesët e shehadetit, ngase kjo është sqaruar në hadithe të tjera.²⁹⁵

293 Es-Siretu nebevijje li ibni Kethir, 2: 520.

294 Shih për shembull: Rasti i kalimit në Islam i Ibnul ‘As bin Rebi’as në Siretu Ibni Hisham, 2: 303-304; rasti i kalimit në Islam i Umer bin Hattabit në ‘Ujnu Ether fi fununil megazi vesh-shemali ves-sijer li Ibni Sejjidin nas, dhe rasti i kalimit në Islam i Hamzës në Es-Siretul Helebije, 1: 477.

295 Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 1: 149, 219.

Ulemaja islame janë në pajtim se, shqiptimi i kelimeit shehadetit dhe vërtetimi i tij me zemër, nuk mjafton për hyrje në iman dhe në Islam, e as që me këtë arrihet shpëtimi nga zjarri i Xhehennemit, nëse personi në fjalë bën diç që e anulon atë, apo e anulon njëri nga dy pjesët e tij. Kështu, nuk do të pranohet Islami i njeriut i cili për shembull thotë: Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguar i All-llahut, por nuk e pranoj për të obligueshëm zekatin dhe haxhxhin, ose zinanë, kamatën, vrasjen dhe kështu me radhë nga regjistri i ndalesave që bazohet në Kur'an ose në Sunnetin e Resulull-llahut s.a.v.s. e që janë të njohura përgjithësisht. Ose të thotë: Unë e pranoj peygamberllëkun e Muhammedit a.s., por mendoj se ai i është dërguar një populli të caktuar, apo një kohë së caktuar, apo krahas me shqiptimin e shehadetit parashtron komentimin e vet personal me të cilin e mohon tevhidin e All-llahut xh.sh. duke mohuar ndonjë cilësi apo emër të Tij. Apo e shqipton shehadetin, por mohon diç nga Kur'ani, madje edhe një ajet, një fjalë apo një shkronjë të vetme. Të këtillit nuk i vlenë shehadeti i tij, ngase ai krahas këtij ka ardhur me diçka që i kundërvihet Kur'anit dhe Sunnetit të Resulull-llahut s.a.v.s.

Gjithashtu edhe për njeriun, i cili ka ndjekur ndonjë ideologji të caktuar që është në kundërshtim me shqiptimin e shehadetit, nuk është e mjaftueshme që vetëm ta deklamojë shehadetin, por është i obliguar që krahas shehadetit ta precizojë në mënyrë të qartë se heqë dorë nga bindja e mëparshme. E nëse bie fjala ndonjë njeri ka besuar në tevhid dhe se Muhammedi s.a.v.s. është i Dërguar i All-llahut, por vetëm për një popull të caktuar apo për një kohë të caktuar, shqiptimi i tij i shehadetit nuk do të jetë i mjaftueshëm për hyrje në Islam. Ngase pranimi i peygamberllëkut të Muhammedit a.s. nga ana e tij, nuk e mohon mendimin e tij të njohur se ai i përket popullit të caktuar ose kohës së caktuar. Prandaj, krahas shehadetit të tij, ai është i obliguar që në mënyrë të

qartë të vërtetojë se Muhammedi a.s. është Pejgamber për të gjithë njerëzit.²⁹⁶ Një pjesë e ulemasë, përkritazi me këtë çështje, përmend një rregull të përgjithshëm e cila është: Nuk mund të pranohet Islami i ndonjë njeriu përderisa nuk e pranon dhe nuk e shqipton shehadetin, nëse shehadeti është i mjaftueshëm për mohimin e të gjitha bindjeve të gabuara të mëparshme që kanë qenë të njohura tek ai. E nëse ky nuk është rast me shehadetin, atëherë është i obliguar që, krahas shehadetit të heqë dorë publikisht nga këto mendime dhe bindje, të cilat me shehadet nuk janë mohuar.²⁹⁷

Këtu do të përmendnim se fjalët (La ilahe il-Allah) mohojnë të gjitha besimet e gabuara lidhur me All-llahun xh.sh., me krijimin dhe sundimin e Tij mbi çdo gjë, dhe me Njësinë (Unitetin) e Tij. Sepse, nëse kemi kuptuar diç, ato (fjalë) kërkojnë veçimin e All-llahut xh.sh. në qenien e Tij, cilësitë e Tij, emrat e Tij veprat e Tij dhe i anulon të gjitha mendimet dhe bindjet e gabuara të mëparshme lidhur me Krijuesin, ndërsa me pjesën e dytë të shehadetit mohohen, në shumicën e rasteve, besimet e gabuara lidhur me Resulull-llahun s.a.v.s. Por, disa bindje, siç kemi përmendur, nuk i mohon. Prandaj, ai i cili ka pandehur se pejgamberllëku i Muhammedit a.s. i përket vetëm një populli, është i obliguar që publikisht të vërtetojë se pejgamberllëku i tij i përket tërë njerëzimit.

E tërë kjo që thamë gjer më tani, ka të bëjë me atë që ka qenë jobesimtar dhe përpara nuk ka qenë pjesëtar i fesë së All-llahut xh.sh. Kurse, për sa i përket renegatit nga feja, Islami i tij i sërishëm

296 Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 1: 149; Sherhus-sijere el-kebir, 1: 150; El-Mugni li Ibni Kudame, 9: 21; El-Muhedhdheb, 2: 223.

297 Sherhus-sijere el-kebir, 1: 150.

nuk do të pranohet, përderisa së pari nuk pranon atë që ka mohuar nga Islami, e pastaj ta shqiptoj shehadetin. E, nëse ka mohuar vahdanijetin apo pejgamberllëkun, atëherë për të është i mjaftueshëm vetëm shehadeti, por nëse është në pyetje diç tjetër, atëherë duhet ta shqiptojë shehadetin dhe të pranojë atë që më parë ka mohuar.²⁹⁸ Personi i cili ka mohuar, për shembull, zekatin apo ndalesën e zinasë apo kamatës, ai nuk mund të kthehet në Islam, përderisa nuk dëshmon se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i All-llahut, dhe përderisa nuk pranon domosdoshmërinë apo ndalesën e asaj që ka mohuar.

Gjithsesi është e dobishme që këtu ta përsërisim atë që kemi thënë edhe gjatë shpjegimit të esencës së imanit, se ulemaja islame është në pajtim me atë se shqiptimi i shehadetit është i mjaftueshëm që ai i cili e shqipton këtë, të konsiderohet për mysliman dhe mbi të që nga ai moment aplikohen të gjitha dispozitat ligjore, e të ngjashme. Porse vetë shqiptimi i shehadetit nuk është i mjaftueshëm për shpëtim nga qëndrimi i përhershëm në zjarr, përderisa nuk përcillet me bindshmëri të vërtetë në zemër. E, kush e shqipton kelimeit shehadetin me të gjitha kushtet e përmendura, ndaj tij duhet të kihet sjellje sikurse ndaj të gjithë myslimanëve në botë, edhe në qoftë se ai në realitet është munafik. Ngase ne jemi të obliguar t'i mbështesim gjykimet tona, në këtë botë, në bazë të dukurive të jashtme e të dukshme, ndërsa gjërat e brendshme e të fshehta duhet t'ia lëmë All-llahut xh.sh., ngase askush tjetër nuk i di ato përveç Tij. Tanimë e kemi përmendur rastin kur Resulull-llahu e ka qortuar Usame bin Zejdin, për shkak se nuk ka vepruar sipas asaj që ka parë, dhe e ka vrarë njeriun i cili ka shqiptuar: La ilahe il-llah, duke pandehur se ai nuk e ka bërë këtë sinqerisht.

298 El-Mugni li Ibni Kudame, 9: 21; Hashijetu Ibni 'Abidin, 3: 397.

PJESA E DYTË

KUR BESIMTARI BËHET JOBESIMTAR

Nga kapitulli i parë kuptove se si njerëzit hyjnë në fenë e All-llahut xh.sh., mirëpo ata që hyjnë në iman dallojnë mes veti.

Mes tyre ka edhe të tillë, të cilët All-llahu xh.sh. i përforcon në imanin e tyre, dhe ata mbeten në të gjer në vdekje dhe vdesin duke qenë të bindur se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij. Por mes tyre ka edhe të tillë, të cilët renegojnë për shkak të mohimit dhe kundërshtimit të tyre.

Në llojin e parë, përsëri, dallohen besimtarët: mes tyre ka muhsin (të cilët janë në shkallën më të lart të besimit), ka edhe muktesid (të cilët përkufizohen vetëm në obligime) dhe ka edhe të tillë që i bëjnë zullum vetvetes. Mes tyre ka të tillë që do të hyjnë në Xhennet pa dhënë llogari, dhe ka edhe të tillë që do të kalojnë lehtë me dhënien e llogarisë. Por ka edhe të tillë, të cilët do të ndëshkohen me zjarr, përderisa All-llahu xh.sh. nuk e shpreh mëshirën e Vet ndaj tyre, e i shpëton nga zjarri me mirësinë Vet tejet të madhe.

Për sa i përket shkaqeve që nxjerrin nga imani pasi që njëherë hyhet në të, në vend të parë do ta përmendim një rregull gjenerike, rreth së cilës janë në pajtim të gjithë pjesëtarët e ehli Sunnetit, e pastaj do ta sqarojmë hollësisht.

RREGULLA

Përkitazi me rregullën, sipas së cilës caktohet se cilat vepra, bindje apo fjalë shpiejnë në kufër, parashtrijmë definicionin e imam Tahaviut r.a., i cili në veprën e vet të njohur El-'Akidetut Tahavijje, thotë: “Ne të gjithë pjesëtarët e kiblës sonë i konsiderojmë si myslimanë, besimtarë, përderisa pranojnë atë me çka ka ardhur Pejgamberi s.a.v.s. ynë dhe e besojnë për të vërtetë tërë atë që ka thënë dhe për çka na ka informuar. Dhe ne nuk themi për asnjërin pjesëtarë të kiblës sonë se është jobesimtar për shkak të mëkatit që e ka bërë, nëse nuk e konsideron të lejueshëm. Dhe ne nuk do të themi: Njeriut me iman nuk i bën dëm kurrfarë mëkati të cilin e bën. Ndërsa njeriu nuk del prej imanit, pos nëse mohon atë me çka edhe ka hyrë në të”.²⁹⁹

SQARIMI I KËSAJ RREGULLE

Sheriati ka mbaruar një derë për hyrje në iman dhe në Islam, dhe vetëm përmes saj mund të hyhet në të. Kjo derë është, siç e ke kuptuar tanimë, shqiptimi dhe pranimi i kelimeit shehadetit. E, ai cili hyn në Islam nëpër këtë derë, ai më nuk del prej tij, pos nëse e nxitë diçka nga fjalët, veprat apo bindjet, që e anulojnë deklaratën dhe bindshmërinë e mëhershme. Siç kemi kuptuar gjer më tani, shehadeti - nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe Muhammedi është i Dërguari i Tij - do të thotë veçimin e All-llahut si të Vetmin lidhur me krijimin dhe sundimin me Gjithësinë, lidhur me emrat

299 El-'Akidetut-Tahavijje me'a sherhiha, f. 350, 352, 357.

dhe cilësitë e Tij, dhe lidhur me veprat e Tij. Gjithashtu e vëçojmë vetëm Atë lidhur me hyjni dhe çfarëdo lloji qoftë nga ibadetet ia drejtojmë vetëm Atij e askujt tjetër. Pastaj do të thotë pranimi dhe njohja për të vërtetë e tërë asaj me çka ka ardhur Muhammedi a.s. nga dispozitat, lajmet mbi fshehtësinë (gajbin) dhe se e tërë kjo është nga Zoti i tij dhe pranimi i të gjitha veçorive të pejgamberllëkut që i ka pasur ai, siç janë sinqeriteti, besnikëria, mendjemprehtësia, interpretimi besnik (i Shpalljes), pagabueshmëria etj.

Pas të gjitha këtyre na bëhet e qartë se, ai i cili bënë ndonjë vepër apo e shqipton ndonjë fjalë, me të cilën mohon çkadoqoftë nga gjërat e përmendura, me këtë akt, ai, e anulon deklaratën dhe pranimin e mëhershëm, dhe del nga feja e All-llahut xh.sh. E nëse fjala e tij, vepra apo akti, i përgjigjet nijetit dhe bindjes së tij të vërtetë, ai bëhet jobesimtar edhe në këtë botë edhe në botën tjetër. Ai do të trajtohet sikurse edhe jobesimtarët e tjerë në këtë botë dhe në të do të zbatohen ligjet e renegimit, prej të cilëve, më i rëndësishmi është kërkimi nga ai që të pendohet, e pastaj likuidimi nëse nuk pendohet. Dhe ai, nëse vdes në këtë gjendje, mbetet përgjithmonë në zjarrin e Xhehennemit.

Nëse besimtari bën ndonjë mëkat, shqipton ndonjë fjalë apo bën ndonjë vepër që, sipas Sheriatit konsiderohet si mëkat ndaj All-llahut xh.sh., vetë ky akt nuk mund të jetë argument i daljes së tij nga imani, edhe pse nuk pendohet për atë, por me kusht që ai akt nuk përmban diç që e anulon kelimeit shehadetin ose një pjesë të tij. Njeriu i tillë mbetet në vullnetin e All-llahut xh. sh, nëse don, do ta dënojë dhe do ta shpie në Xhehennem, e pastaj më në fund do të mbarojë në Xhennet. Ekziston një numër i madh hadithesh autentike të cilët flasin për atë se do të dalë nga Xhehennemi çdonjëri, që në zemrën e tij ka iman madje edhe sa një kokërr. E nëse All-llahu

dëshiron, do t'ia falë mëkatet dhe nuk do ta dënojë, por do ta shpie në Xhennet pa ndëshkim me zjarr. Sepse, All-llahu xh.sh. thotë:

“All-llahu, me të vërtetë, nuk e falë atë që i bën shok Atij, por ia falë tjerat mëkate kujt të dojë (përveç këtij).” (En-Nisa: 116).

LLOJET E GJËRAVE QË NXJERRIN NGA IMANI

Prej asaj që parashtruam më sipër, mund të konkludojmë se gjërat që nxjerrin nga feja e All-llahut xh.sh. ndahen në disa lloje, e të gjitha ato kthehen në rregullën gjenerike posa të përmendur. Në çdonjërin prej këtyre llojeve bëjnë pjesë aspekte dhe shembuj të ndryshëm, të cilët është tejet vështirë të përmbledhen dhe të sqarohen që të gjithë. Mirëpo, të gjithë këto lloje ekzistuese mund t'i reduktojmë në katër sish:

- 1 - Lloji i cili përmbanë gjërat me të cilat mohohet apo pjesërisht cenohet rububijeti i All-llahut xh.sh.
- 2 - Lloji i cili përfshinë gjërat me të cilat cenohet dinjiteti i emrave dhe cilësive të All-llahut xh.sh.
- 3 - Lloji i cili përmbanë gjërat me të cilat cenohet uluhijeti (hyjnia dhe adhurimi) i All-llahut xh.sh.
- 4 - Lloji i cili përfshinë gjërat me të cilat njolloset Shpallja dhe interpretuesi i saj s.a.v.s.

Këto janë katër llojet, e në çdonjërin prej tyre bënë pjesë një numër i madh shembujsh të llojllojshëm të fjalëve, bindjeve dhe veprave, të cilat që të gjitha ngërthejnë në vete diç me çka anulohet kelimei shehadeti, dhe bërësin e tyre e nxjerrin nga imani, e All-llahu xh.sh. na ruajt prej këtyre gjërave. Në faqet vijuese do të përpiqemi që më hollësisht t'i sqarojmë këto lloje, duke i mbështetur në shembuj adekuat.

LLOJI I PARË

Tanimë ke kuptuar se lloji i parë i tevhidit është tevhidur-rububijeti vel mulk, që do të thotë bindshmëria e fuqishme se All-llahu xh.sh. është Pronar dhe Sundues i çdo gjëje që ekziston, se të gjitha i ka krijuar Ai, se të gjitha krijesat i furnizon Ai, dhe se Ai është i Vetmi që qeverisë me Gjithësinë me vullnetin, me diturinë dhe me urtësinë e Vet. Prandaj çdo fjalë, vepër apo bindje me të cilën mohohet çkadoqoftë nga kjo, është kufër dhe renegim nga feja. Këtu bën pjesë mohimi i ekzistimit të Krijuesit, të konsideruarit se bota ekziston përgjithmonë dhe se nuk është krijuar, se materia është e përhershme, ose të konsideruarit se dikush tjetër, përveç All-llahut xh. ah., krijon dhe sundon me Gjithësinë, siç thuhet: rasti, natyra e të ngjashme, mohimi se All-llahu xh.sh. është Sundues i të gjitha krijesave, se dikush tjetër i furnizon ato, përveç All-llahut xh.sh., ose që këtë e bënë edhe dikush tjetër pranë All-llahut. Gjithashtu, të besuarit se All-llahu xh.sh. i ka krijuar krijesat e pastaj i ka lënë pas dore, se Ai assesi nuk ndikon në to, nuk kujdeset për to, se Ai nuk rregullon asgjë lidhur me to etj. që vie në kundërshtim me rububijetin.

Gjithashtu konsiderohet kufër dhe riddet (renegim) nëse dikush i përshkruan vetes cilëndo qoftë prej këtyre cilësive, që t'ia përshkruaj vetvetes rububijetin, siç ka bërë Faraoni kur ka thënë:

“Unë jam Zoti juaj më i lartë!” (En-Nazi’at: 24).

Ose së paku, të konfirmojë se vetë posedon në të vërtetë, dhe se ai vetë e jep nafakën (furnizon), se vetë cakton çka të dojë pa All-llahun xh.sh. Gjithashtu bën kufër edhe ai që i beson këtij.

LLOJI I DYTË:

Në llojin e dytë benë pjesë e tëra ajo që bie në kundërshtim me shkallën e dytë të tevhidit - me besimin se vetëm All-llahu xh.sh. posedon emrat e bukur dhe cilësitë e përsosmërisë.

Vetë All-llahu xh.sh. ia ka caktuar Vetes emrat dhe atributet, siç e ka bërë këtë edhe Pejgamberi i Tij s.a.v.s., ndërsa i ka mohuar cilësitë të cilat ia atribuojnë Atij, të cilat i ka mohuar edhe Pejgamberi i Tij. Prandaj, kush mohon apo njollosë çkado qoftë nga cilësitë të cilat All-llahu xh.sh. ia ka përshkruar Vetes apo ia ka përshkruar Resulull-llahu s.a.v.s., ai ka bërë kufër. E njëjta gjë është edhe me atë i cili i atribuon All-llahut xh.sh. atë që ka mohuar Resulull-llahu s.a.v.s. Pra, për sa i përket cilësive të All-llahut xh.sh. ekzistojnë dy lloj kufrash: kufri i mohimit dhe kufri i atribuimit.

Në pjesën e parë bën pjesë mohimi i cilësdo qoftë nga cilësitë e All-llahut xh. siç është për shembull mohimi i diturisë së Tij absolute, fuqisë së Tij, jetës së Tij, udhëheqjes së Tij me çdo gjë,

të dëgjuarit dhe të pamurit e tij, ngritjen e Tij mbi Arsh, të folurit e Tij, mëshirën e Tij, madhështinë dhe fuqinë e Tij apo cilëndo qoftë cilësi tjetër që përmendet në Kur'an dhe në Sunnet. Në këtë lloj bën pjesë edhe komentimi alegorik i emrave dhe i cilësive të Tij (te'vili) në mënyrë çfarë e zvogëlon vlerën e tyre. Siç është rasti me atë i cili pranon diturinë e All-llahut xh.sh., por konsideron se ajo është e përgjithshme dhe se All-llahu xh.sh. nuk i di të gjitha detajet dhe hollësitë. Apo nëse dikush i krahason cilësitë e All-llahut xh.sh. me të njerëzve, dhe konfirmon se All-llahu xh.sh. dëgjon ashtu siç dëgjojnë njerëzit, se sheh siç shohin njerëzit dhe të ngjashëm me këtë.

Ndërsa, në pjesën e dytë bën pjesë atribuimi i çfarëdo cilësie All-llahut xh.sh., që e ka mohuar All-llahu xh.sh. apo Pejgamberi i Tij., siç është përshkrimi djalë apo vajza, bashkëshorte, pafuqia, pagjumësia, gafleti apo vdekja, ose çfarëdo gjymtësie tjetër e që mund t'u ndodh njerëzve.

Gjithashtu jobesimtar bëhet gjithsesicili që i përshkruan vetes apo çfarëdo krijese tjetër cilëndo nga cilësitë e All-llahut xh.sh., kurse jobesimtar bëhet edhe ai që i beson këtij. Si për shembull sikur dikush të thoshte: “Unë di sikurse që di edhe All-llahu xh.sh., apo filan filani ka dituri sikurse edhe All-llahu xh.sh. Ai i cili i shqipton këto fjalë, bëhet jobesimtar, sikurse edhe ai që i beson këtij. Sepse, t'ia atribuosh All-llahut xh.sh. dikë të barabartë më Të është një trajtë e nënçmimit të All-llahut xh.sh., e çdo nënçmim i All-llahut xh.sh. apo cilëndo nga cilësitë e Tij, është kufër.

LLOJI I TRETË

Këtu bënë pjesë çdo fjalë, bindje apo vepër që vie në kundërshtim me llojin e tretë të tevhidit (tevhidul uluhijje) - me të besuarit se vetëm All-llahu xh.sh. meriton të adhurohet dhe se vetëm atij mund t'i bëhet ibadet. E, ai që e flet ndonjë fjalë, bën ndonjë vepër, beson në diç me çka mohohet kjo e vërtetë mbi All-llahun xh.sh., apo në çfarëdo mënyrë tjetër kjo zvogëlohet, duke ia përshekruar këtë dikujt tjetër apo bile edhe një pjesë të saj, ai ka bërë kufër dhe ka dalur nga feja e All-llahut xh.sh.

Rastet më të shpeshta të renegimit të njerëzve nga Islami dhe i mosbesimit të tyre, janë të lidhura me këtë lloj, edhe pse shumica e njerëzve, në kohët e kaluara, e edhe sot, pranojnë ekzistimin e All-llahut xh.sh. si Krijuesin, dhe shumica prej tyre ia përshekruajnë Atij atributet e rububijetit, siç është fuqia, qeverisja, furnizimi, ringjallja, marrja e jetës etj. All-llahu xh.sh. në Librin e Vet përmend se mushrikët, të cilëve All-llahu xh.sh. ua ka dërguar Pejgamberin e Vet s.a.v.s., kanë besuar se All-llahu xh.sh. i ka krijuar ata:

“E, nëse ti i pyet ata kush i ka krijuar, ata, me siguri, do të thonë: “All-llahu!” (Ez-Zuruf: 87).

“Nëse ti i pyet ata: “Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?” Ata me siguri do të thonë: “Ato i ka krijuar i Plotfuqishmi dhe i Gjithdijshmi!” (Ez-Zuhruf: 9).

Pra, kufri tek shumica e jobesimtarëve ka depërtuar për shkak mohimit të tyre se vetëm All-llahu xh.sh. meriton t'i bëhet ibadet. Është njësoj se a është ky mohim me zemër (me besim) apo me diç që e vërteton këtë nga fjalët dhe veprat. Apo për shkak të konfirmimit të tyre se, përveç All-llahut xh.sh. edhe dikush tjetër e meriton këtë, qoftë ky konfirmim me anë të bindshmërisë me

zemër, me vepër apo me fjalë. Ky lloj i kufrit, në realitet, i shpie njerëzit edhe në dy llojet e tjera paraprake, ngase, ai i cili pranon se All-llahu xh.sh. është Krijues i çdo gjëje që ekziston, se Ai qeverisë me të gjitha, se vetëm Ai meriton t'i përshkruhen emrat e bukur dhe cilësitë e përsosmërisë për të cilat është i denj Vetëm ai, ky pranim kërkon prej tij njohjen absolute të hyjnisë së All-llahut xh.sh. dhe të konsideron se askush nuk meriton t'i bëhet ibadet përveç All-llahut xh.sh. E nëse e mohon këtë dhe nëse adhuron dikë tjetër pos All-llahut xh.sh. ose krahas me All-llahun xh.sh. e adhuron edhe dikë tjetër, pranimi i tij i All-llahut si Krijues është i parregullt dhe nuk ka kurrfarë vlere.

Es-San'ani thotë: “Ai që pranon tevhidin e All-llahut xh.sh. në rububijet, është i obliguar që vetëm Atij t'i bëjë ibadet, e kush nuk vepron kështu, pranimi i tij i parë bëhet i pavlefshëm.”³⁰⁰

Prandaj tevhidi i All-llahut në ibadet është bazë e sprovimit të njerëzve në këtë botë. All-llahu xh.sh. thotë:

“Xhinnët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.” (Edh-Dharijat: 56).

Nga kjo shihet se, dëshminë “nuk ka zot tjetër përveç All-llahut”, e anulojnë dy gjëra:

E para: Mohimi i meritave dhe ibadeteve të All-llahut xh.sh., çfarëdo lloji qofshin ato; dhe

E dyta: Të konsideruarit se kushdo qoftë tjetër përveç All-llahut xh.sh. i meriton këto.

Prandaj, çdo vepër e cila në vete përmbanë njëren prej këtyre dy gjërave, e shpie bërësin në kufër dhe në renegim. Ndërsa ibadeti, të cilin nuk e meriton askush tjetër përveç All-llahut xh. ah.,

300 Tathirul i'tikad, f. 9.

është pendueshmëria, përulësia, ndëgjueshmëria dhe bindshmëria ndaj Tij. Këtu bënë pjesë edhe dashuria, të drojturit, të kërkuarit ndihmë, duaaja (lutja), tevakkuli, shpresa, ruku'a, sexhdeja, agjërimi, therja e kurbanit, tavafi etj.

Në bazë të gjitha këtyre, mund të konkludohet se, ai i cili me fjalë, me vepër apo me bindje i mohon meritat e All-llahut për këto domethënie, ai bëhet jobesimtar. Pra, jobesimtar bëhet ai i cili ose beson se nuk duhet të ketë drojë nga All-llahu xh.sh., se Atij nuk duhet t'i drejtohet lutja, se nuk duhet të kërkohet ndihmë prej Tij, se nuk duhet T'i bëhet ruku dhe sexhde, e as që duhet të shpresohet diç prej Tij; ose e përqeshë dhe e konsideron si jonormal dikë që e adhuron All-llahun xh.sh., që Atij ia drejton lutjen dhe nga Ai kërkon ndihmë, që i përkulet dhe i bënë sexhde, që agjëron për Të dhe Atij ia përkushton tavafin ose që bënë çfarëdo vepre qoftë që Sheriati e konsideron për ibadet. Sepse, përqeshja e tij dhe tallja e tij me këto gjëra, në mënyrë të pashmangshme tregon sheshit se ai nuk e sheh të udhës që këto ibadete i meriton All-llahu xh.sh. Gjithashtu jobesimtar bëhet edhe ai që i mohon meritat e All-llahut xh.sh. që me përkushtim të kryhen urdhrat e Tij dhe përmbajtja nga ndalesat e Tij. Sepse, All-llahu xh sh. në Librin e Vet ka caktuar Ligjin, të cilin ia ka shpallur Pejgamberit të Vet s.a.v.s., andaj kushdo që konfirmon se çkado qoftë nga ai Ligj nuk meriton të zbatohet ose që nuk i përgjigjet kësaj kohe dhe të ngjashme, bëhet jobesimtar. Sepse, një nga veçoritë e hyjnisë është urdhri, pushteti dhe Ligji. All-llahu xh.sh. thotë:

“... Vendimi (pushteti) i përket vetëm All-llahut.” (Jusuf: 40).

Domethënë nga veçoritë e nënshtrimit është kryerja e urdhrave dhe dëgjueshmëria.

Jobsimtar bëhet edhe secili që çkado qoftë nga ibadetet, ia përkushton dikujt tjetër pos All-llahut xh.sh. Jobsimtar bëhet edhe ai që konfirmon se ai është meritör t'i bëhet ibadet ose i urdhëron njerëzit që t'i bëjnë atij ibadet ose këtë ta bëjnë për shkak të tij. Gjithashtu jobsimtar bëhet edhe ai që i beson fjalëve të tij dhe kryen ndonjë prej ibadeteve që urdhëron ai. I njëjti rast është edhe me atë që ka dëshirë të adhurohet, edhe pse nuk u ka urdhëruar njerëzve ta bëjnë këtë. Siç është shembulli i atij që ka dëshirë, që dikush të frikësohet nga ai, që atij t'i drejtohet për ndihmë, që të mbështetet në të, të shpreson diç prej tij,³⁰¹ ose t'i bëhet sexhde dhe ruku, ose që njerëzit ndaj tij të kenë sjellje përuljeje dhe gjëra të tjera, që nuk guxon t'i kushtohen askujt tjetër përveç All-llahut xh.sh.

Jobsimtar bëhet edhe ai që konfirmon se ka të drejtë të ligjëson diç që është e ndaluar nga All-llahu xh.sh., për shkak se ai gjendet në pushtet dhe në pozitë të lartë. E, për shembull thotë se ai ka të drejtë të lejojë të ndaluarën dhe ta ndalojë të lejuarën. Shembulli për këtë është marrja dhe aplikimi i ligjit me të cilin lejohet zinaja dhe të veshurit e çoroditur (amoral), apo ndërrohet ndëshkimi të cilin All-llahu xh.sh. e ka caktuar në Kur'an ose Resulull-llahu s.a.v.s. në Sunnet për ndonjë kundërvajtje, ose ndërrimin e normave të Sheriatit lidhur me zekatin, me trashëgiminë, me

301 Me frikë, kërkim ndihme dhe shpresim nënkuptohen ato gjëra me të cilat nuk mund askush ta ndihmojë dikë përveç All-llahut xh.sh., siç është për shembull frikërespekti etj. E, për sa i përket atyre gjërave që janë në mundësinë e njerëzve, me këto gjëra njeriu nuk del prej imanit, siç është bie fjala frika nga sunduesi i cili i kanoset se do ta burgosë, ose kërkimi i ndihmës nga shoku për kryerjen e ndonjë pune ku ai me të vërtetë mund të ndihmojë, ose që njëri t'i thotë tjetrit: Unë të lus të më ndihmosh ta bëj këtë dhe këtë - prej gjërave që mund t'i kryejnë njerëzit. Të gjitha këto nuk bëjnë pjesë në kufër dhe nuk ka kurrfarë ndalesash përkitazi me këtë.

keffaretin (shpengimin), me disa ibadete dhe me gjëra të tjera, që janë caktuar me anë të Kur'anit dhe Sunnetit. Jobesimtar bëhet edhe ai që beson në këta tagutë dhe pranon diç nga cilësitë hyjnore, për të cilat ata konfirmojnë se kinse i posedojnë. All-llahu xh.sh. Thotë:

“Na çdo popull i kemi dërguar nga një Pejgamber. (Ata u thonin atyre): “Adhuroni vetëm All-llahun, e shmanguni nga djalli (taguti)!” (En-Nahël: 36).

“... Ai që mohon tagutin (djallin) dhe beson në All-llahun - ai ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë.” (El-Bekare: 256).

Lidhja më e fortë është shhadeti, se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, me të cilin ia mohon të gjitha llojet e ibadetit kujdo qoftë tjetër përveç All-llahut xh.sh. dhe ia kushton ato vetëm All-llahut xh.sh., i Cili nuk ka shok.³⁰²

Nga kjo shihet qartë se, sundimtari, i cili punon kundër të vërtetës duke caktuar ligje që janë në kundërshtim me Kur'anin dhe Sunnetin dhe lejon atë që ka ndaluar All-llahu xh.sh. ose ndalon atë që ka lejuar All-llahu xh.sh., bëhet jobesimtar dhe renegat nga feja e All-llahut xh.sh. Sepse, ai me këtë konsideron se mund të dalë nga suazat e Ligjit islam, duke caktuar ligje çfarë dëshiron vet, dhe e beson këtë, ai bëhet jobesimtar.³⁰³

302 Risaletu Muhammed bin Abdul Vehhab fi ma'na tagut el-Xhemi'ul Ferid, f. 266.

303 Nevakidul Islam li Muhammed bin Abdul Vehhab fi ma'na tagut el-Xhemi'ul Ferid, f. 278.

Mirëpo, kjo nuk ka të bëjë me atë që sjellë ligje për të cilat nuk flitet në Kur'an e në Sunnet, e as me ligjet të cilat mbështeten në ixhtihad dhe rreth të cilave ulemaja islame ka mendime të ndryshme.

E, kush cakton ndonjë ligj, me të cilin lejohet zinaja dhe kamata, apo çkado qoftë tjetër nga mëkatet për të cilat dihet se janë të ndaluara me Sheriat, ai bëhet jobesimtar, dhe jobesimtar bëhet çdonjëri që pranon me dëshirë të sjellet një ligj i tillë. Mirëpo, nuk bëhet jobesimtar ai i cili cakton ligjin me të cilin dëshirohet të rregullohet, të themi, komunikacioni, apo diç të ngjashëm, lidhur me çka Sheriati nuk ka folur, e as që e ka përmendur. Gjithashtu nuk bëhet jobesimtar ai i cili cakton ligjin duke dëshiruar që me të rregullohet çështja e çmimeve në treg dhe nuk mund të thuhet se caktimi i çmimeve është haram për shkak se këtë nuk e lejojnë disa alimë, sepse kjo është çështje e ixhtihadit, ndërsa disa fakihë e lejojnë këtë.

Më sa parashtruar më lart, duket qartë se jobesimtarë bëhen njerëzit, të cilët tagutëve ua pranojnë këto të drejta dhe janë të kënaqur me to, dhe në bazë të cilave gjykojnë edhe pse këto ligje janë në kundërshtim me Islamit dhe me parimet e gjithënjohura. All-llahu xh.sh. thotë:

“A nuk i ke parë ti (o Muhammed!) ata, që pohojnë se kanë besuar në atë, që të është shpallur ty dhe në atë që është shpallur para teje, dëshirojnë që t'i gjykojë djalli (taguti), e ata janë urdhëruar që ta mohojnë atë (të keqin). Djalli, madje, dëshiron që t'ua humbë atyre krejtësisht udhën e drejtë.” (En-Nisa': 60).

“Por ata kanë shokë tjerë (udhëheqës të keqij), të cilët atyre u kanë përcaktuar në fe aso dispozita, çfarë nuk ka lejuar All-llahu.” (Esh-Shura: 21).

LLOJI I KATËRT

Në këtë lloj bënë pjesë çdo fjalë, vepër apo bindje me të cilën njolloset Shpallja ose Resulull-llahu s.a.v.s., sepse me këtë anulohet shehadeti se Muhammedi është Pejgamber i All-llahut. Sepse, ky shehadet don të thotë të besuarit e vërtetësisë së tërë asaj që është interpretuar me besnikëri nga Pejgamberi i All-llahut, dhe se All-llahu xh.sh. e ka përgatitur Muhammedin a.s. për këtë detyrë dhe e ka pajisur me të gjitha cilësitë e duhura, në mënyrë që të jetë në gjendje t'ua kumtojë Shpalljen njerëzve në mënyrë më të mirë që është e mundshme. Prej këtu shihet se kjo pjesë e shehadetit anulohet në njërin nga dy mënyrat.

Mënyra e parë: Përçmimi i Muhammedit a.s., sido që të shfaqet ai.

Mënyra e dytë: Mohimi çkadoqoftë prej asaj me çka ka ardhur Muhammedi a.s., apo përçmimi i saj.

Në mënyrën e parë bën pjesë të atribuarit Pejgamberit të All-llahut çkado qoftë që bie në kundërshtim me dekorimin e tij nga ana e All-llahut xh.sh. në mënyrë që besnikërisht t'ua komunikojë njerëzve Udhëzimin e Tij. Prandaj, jobesimtar bëhet gjithsecili që mohon sinqeritetin, dëlirësinë, mendjemprehtësinë dhe virtytet e tjera të Resulull-llahut s.a.v.s. Jobesimtar bëhet edhe ai i cili e shanë Resulull-llahun s.a.v.s., apo tallet me të, apo me çfarëdo procedimi të tij, që besnikërisht është transmetuar gjer tek ne.

Ndërsa, në mënyrën e dytë bën pjesë mohimi i çkado qoftë prej asaj me çka ka ardhur ai, e që është e gjithënjohur si pjesë e fesë. Prandaj jobesimtar bëhet ai i cili mohon diç nga ajo që na është interpretuar nga Resulull-llahu s.a.v.s. përkitazi me çështjen e ringjalljes, llogarisë, peshimit

të veprave, urës Sirat, Xhennetin dhe Xhehennemin e gjërat e tjera që i takojnë gajbit. Jobesimtar bëhet edhe ai që mohon çkado qoftë prej Kur'anit,³⁰⁴ ngase Resulull-llahu s.a.v.s. na ka informuar se çdo ajet kur'anor është të folurit e All-llahut xh.sh., andaj nëse mohon çkado qoftë prej saj, ai konsideron se fjalët e Resulull-llahut s.a.v.s. janë të rrejshme. Jobesimtar është edhe ai që mohon cilindo nga dispozitat e Islamit, që janë të konstatuara me Kur'an apo me Sunnet. Prandaj jobesimtar bëhet secili që mohon obligueshmërinë e namazit apo zekatit, ndalesën e zinasë apo të kamatës dhe vjedhjes, ose ai që pandehë se cilit do namaz qoftë duhet t'i shtohet edhe një rekat ose është e lejueshme falja pa abdest etj.

Mirëpo, i falet atij që mohon diç që assesi nuk është e njohur në fe, që e di vetëm një rreth i vogël i ulemasë së lartë. Gjithashtu nuk bëhet jobesimtar edhe ai që mohon ndonjë dispozitë që bazohet në ixhtihad dhe për të ulemaja nuk ka mendim unik.

Imam Neveviu thotë: “Rasti i njëjtë është edhe me atë që mohon diç nga feja në çka pajtohet i tërë ummeti, nëse është e gjithënjohur, siç janë pesë namazet ditore, agjërimi i muajit Ramazan, larja pas xhunublëkut, ndalesa e zinallëkut, martesja me gra të cilat janë mehrem e të ngjashme. Përpos nëse njeriu është prej atyre të cilët posa e kanë pranuar Islamit, e mohon diç prej këtyre duke mos ditur se kjo është nga feja, me këtë ai nuk do të bëhet jobesimtar. E, për sa i përket gjërave për të cilat pajtueshmëria e ummetit është e njohur vetëm për një rreth më të ngushtë njerëzish, siç është për shembull ndalesa e martesës me një grua së bashku me tezën e saj, se ai i cili qëllimisht e mbytë dikë nuk gëzon të drejtën e trashëgimisë, se njërit i takon një e gjashta dhe

304 Sherh Mukka ‘All el-Kari ‘alel fikhil ekber, f. 167.

të ngjashëm me këtë, kush mohon diç prej këtyre nuk bëhet jobesimtar, po i falet për shkak se këtu ka të bëjë për dispozitat që nuk i kanë të njohura shumica e njerëzve.”³⁰⁵

Jobesimtar bëhet edhe ai që mohon madje edhe një ajet nga Kur’ani, apo mohon diç nga gajbi, apo konsideron si të rrejshëm lajmin mbi atë se çka ka ndodhë në të kaluarën, apo çka do të ndodhë në të ardhmen e që përmendet në Kur’anin fisnik.

Jobesimtar bëhet edhe ai që i mohon Pejgamberët para Muhammedit s.a.v.s., apo mohon diç nga ajo që interpretohen në Kur’an dhe në Sunnet, mbi rrëfimin për ta dhe për popujt e tyre. Apo kush mohon mënyrën e fillimit të krijimit që All-llahu xh.sh. na ka sqaruar në Kur’an, pastaj kush mohon xhinnët, shejtanët, Arshin e All-llahut, Lehvi Mahvudhin dhe pendën (kalemin). Rasti i njëjtë është edhe tek ai që mohon personalitetet historike që përmenden në Kur’an apo që mohon pejgamberllëkun e atij që Kur’ani ia atribuon, apo që dikë prej tyre e akuzon për diç që nuk është e denjë për zgjedhjen e tyre nga ana e All-llahut xh.sh., apo që mohon se All-llahu xh.sh. ka dërguar edhe Pejgamber të tjerë pos këtyre të cilët nuk i ka përmendur me emra, ngase përkritazi me këtë All-llahu xh.sh. na flet në mënyrë të qartë në shumë vende të Kur’anit. Jobesimtar bëhet edhe ai që mohon mbinatyrshtësinë e Kur’anit, sepse për këtë na flet vetë Kur’ani. Po ashtu edhe ai që pandehë se vet është pejgamber pas Muhammedit s.a.v.s. apo ai që i beson atij që pandehë kështu, ngase Kur’ani na ka informuar se Muhammedi a.s. është Pejgamberi i fundit.

305 Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 1: 205.

TË KËNAQURIT ME KUFËR DHE PAKËNAQËSIA ME ISLAM

Përsëri theksojmë se këta shembuj dhe detaje të mohimit të kelimeit shehadetit, janë përmendur ndër shumë shembuj që ekzistojnë në realitet.

Këtu posaçërisht tërheqim vërejtjen në një gjë, për të cilën dikush do të mendon se i takon gjërave të përmendura më parë, edhe pse kjo në esencën e vet e anulon kelimeit shehadetin dhe nënkupton mohimin e tevhidit dhe Shpalljes. Pra, këtu është fjalë për kënaqësinë me kufër dhe pakënaqësinë me Islam.³⁰⁶ Ai i cili për shembull thotë: “Konsideroj se e ka thënë të vërtetën ai i cili ka mohuar kelimeit shehadetin”, ose ai që thotë: “Konsideroj se nuk e ka thënë të vërtetën ai i cili e ka shqiptuar kelimeit shehadetin”. Askush nuk do të dyshojë në kufrin e tij, madje edhe nëse këtë e ka thënë që t’i hyjë në hatër dikujt (në rastin e parë). Ekzistojnë edhe shumë lloj aspektesh të deklarimeve, veprave dhe bindjeve, të cilat kanë peshë të barabartë me shembujt e përmendur dhe të cilat nxjerrin nga imani. Ja disa prej tyre:

Shembulli i parë: aspektet e kënaqësisë me kufër

306 Sherh Mukka ‘All el-Kari ‘alel fikhil ekber, f. 165.

1 - KONSIDERIMI SE JOBESIMTARËT - ATEISTËT, RENEGATËT DHE MUSHRIKËT - NUK JANË JOBESIMTARË, OSE DYSHIMI NË MOSBESIMIN E TYRE, OSE TË PRANUARIT PËR TË VËRTETË CILINDO DREJTIM TË TYRE JOBESIMTAR³⁰⁷

Ai i cili e di se personi i caktuar, organizata apo pjesëtarët e fesë së caktuar janë në kufër të qartë, e nuk i konsideron ata si jobesimtarë apo renegatë, e thotë se drejtimet e tyre janë korrekte - ai ka hyrë në kufër së bashku me ta dhe është bërë sikurse edhe ata.

Mirëpo, ky parim kërkon sqarim dhe kujdes të madh gjatë aplikimit të tij.

E kjo nga shkakun se konsiderohet që ai për të cilin pandehet se në këtë rast është bërë renegat, e ka ditur realitetin e atij të cilin e ka konsideruar si mysliman, e jo kafir. Mirëpo, nëse ai nuk e ka ditur saktësisht të vërtetën e bindjes së tij dhe se ai njëmend është në kufër, atëherë nuk është e lejuar që i tilli të konsiderohet renegat që në fillim, por do t'i shpjegohet në mënyrë të mirë ajo që i përshkruhet atij, kështu që këtu mos të mbetet aspak dyshim, e nëse edhe pas kësaj ai përsëri mohon kufrin e tij, atëherë do të konsiderohet renegat dhe kafir, sepse mohimi i kufrin të tyre, në realitet paraqet pranimin e bindjes së tyre dhe pranimin e korrektesisë së tyre. Me kusht që duhet të kihet parasysh se kufrin i disa sekteve është bërë e gjithënjohur mes njerëzve, siç janë hebrenjtë, të krishterët, mexhusijët etj. Andaj bëhet jobesimtar çdonjëri që mohon kufrin e tyre.

307 Nevakidul Islam li Muhammed bin Abdul Vehhab. Shih: El-Xhemî'ul Ferid, f. 277.

E, për sa i përket sekteve dhe drejtimeve dhe procedimeve të tyre jobesimtare, për të cilat dihet pak mes njerëzve, duhet të kihet kujdesë gjatë konsiderimit për jobesimtar atë që pjesëtarët e tyre nuk i konsideron si jobesimtarë, përderisa atij nuk i shpjegohen tërësisht detajet e atyre sekteve të cilat shpjen në kufër.³⁰⁸ Veçanërisht duke pasur parasysh se një pjesë e atyre sekteve e konsiderojnë veten pjesëtarë të Islamit dhe para njerëzve të thjshhtë tregohen dhe argumentojnë se ata nuk mohojnë asgjë nga Islami dhe fshehin prej tyre, bile në fillim, atë që do të shkaktonte ta ndërrojnë bindjen e tyre, ku shihet qartë mohimi i çkado qoftë nga bazat e Islamit.

Kushti që ky lloj njerëzish të konsiderohet jobesimtar është edhe ai që, pjesëtarët e sektit përkatës janë bërë jobesimtarë përkitazi me gjërat të rreth cilave ulemaja është në pajtim se ai që i mohon këto del nga imani. E nëse ka të bëjë me gjërat për të cilat ulemaja e pranuar nuk kanë mendim unanim, disa mendojnë se ato nxjerrin nga imani e disa se nuk nxjerrin, në këtë rast nuk është e lejuar që të konsiderohen jobesimtarë ata të cilët këta pjesëtarë nuk i konsiderojnë jobesimtarë. Siç është rasti i konsiderimit të havarixhëve për jobesimtarë dhe i disa sekteve të tjera rreth riddetit të të cilëve ulemaja nuk ka mendim unanim. Këtu bënë pjesë edhe ai që nuk e konsideron jobesimtar atë që qëllimisht nuk e kryen namazin, nëse nuk e ka mohuar obligueshmërinë e tij. Nëse plotësohen të gjitha këto kushte, e myslimani edhe përkundër tyre jobesimtarët nuk i konsideron për jobesimtarë dhe drejtimin e tyre e konsideron si drejtim të rregullt, në realitet, është sikurse edhe vetë të kishte shqiptuar atë që ata i ka shpie në kufër, me çka e ka anuluar shehadetin e vet të cilin e ka deklamuar para kësaj. E nga ana tjetër ai i mohon ajetet dhe hadithet

308 Mexhmu'atut-tevhid, f. 126.

të cilat të tillët i konsiderojnë për jobesimtarë, dhe me mohimin e këtyre argumenteve edhe vet bëhet jobesimtar.

2 - MIQËSIMI ME JOBESIMTARËT DHE SHPREHJA E PAJTUESHMËRISË ME BESIMIN E TYRE

Tanimë ke kuptuar se një nga domethëniet e shehadetit se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, mohon ekzistimin e çdo hyjnije tjetër që meriton t'i bëhet ibadet përveç All-llahut xh.sh., krahas asaj që ai udhëzon në pranimin se këtë të drejtë e gëzon vetëm All-llahu xh.sh. Këtë e vërtetojnë fjalët e All-llahut xh.sh.:

“Adhuroni vetëm All-llahun, e shmanguni nga djalli (taguti)!” (En-Nahël: 36).

Andaj, për realizimin e këtij shehadeti, nuk mjafton që njeriu ta besojë vetëm All-llahun xh.sh., por duhet të shmanget nga adhurimi i kujdo qoftë tjetër dhe të mohojë se kushdo qoftë tjetër meriton të adhurohet përveç All-llahut xh.sh. Përkitazi me këtë çështje ulemaja është në pajtim të plotë dhe rreth kësaj nuk ka diskutim. Gjithashtu, nuk është diskutabil fakti se një nga karakteristikat më të shquara të jobesimtarëve është se ata nuk e adhurojnë All-llahun në mënyrë të drejtë, ngase ata në ibadet i shoqërojnë edhe të tjerët, duke i shtuar kësaj se ata shpeshherë e mohojnë Shpalljen dhe e përçmojnë Resulull-llahun s.a.v.s., apo të ngjashëm me këtë, nga gjërat të cilat anulojnë kelimeit shehadetin. Edhe këtu është në pajtim e tërë ulemaja islame.

Në bazë të këtyre dy fakteve pakontestuese ne caktojmë qëndrimin ndaj armiqve të All-llahut xh.sh. dhe armiqve të fesë së Tij, i cili përputhet me kelimeit shehadetin. Në mënyrë të qartë e shohim kufirin të cilin myslimani nuk guxon ta kalojë assesi në marrëdhëniet dhe afarizmin e vet me jobesimtarët, në mënyrë që ta ruaj fenë e vet dhe besimin e vet. Ky kufi nuk mund të shquhet nga ana e atij që është i kënaqur me besimin e tyre dhe më kufrin e tyre. Prandaj, kur myslimani e kalon këtë kufi dhe u nënshtrohet jobesimtarëve duke konsideruar si të drejtë, besimin e tyre të padrejtë, u ndihmon atyre me mundin e vet dhe materialisht dhe shoqërohet me ta, ndërsa nuk shoqërohet më me myslimanët dhe këta i flijon për ata, ky person është bërë njëri prej tyre, ka reneguar nga feja e vet dhe është bërë jobesimtar dhe njëri prej armiqve më të mëdhenj të All-llahut xh.sh. dhe Pejgamberit të Tij. Këtu bën përjashtim vetëm ai që është nën pushtetin jobesimtar dhe është i detyruar të veprojë kështu. Atij i urdhërojnë që të jetë i dëgjueshëm në batillëkun e tij, i kërcënohen se do ta mbysin nëse nuk i dëgjon ata dhe fillojnë ta torturojnë. Në këtë situatë i lejohet që me fjalë ta shprehë pajtueshmërinë me ta, por zemra e tij duhet të mbetet e sigurt në iman. Edhe pse kjo nënkuptohet nga kelimeit shehadeti, shumë ajete kur'anore i urdhërojnë myslimanët që ta ndërpresin shoqërimin me jobesimtarët dhe i obligon që ndaj tyre të kenë qëndrim armiqësor përkitazi me fenë. Shumë prej këtyre ajeteve, tregojnë sheshit se ai që nuk vepron kështu gjendet në kufër dhe në riddet. Prandaj, nëse e merr në konsideratë domethënien që tregohet sheshit në këtë, kelimeit shehadeti dhe udhëzimet e qarta të ajeteve kur'anore, do të shohësh se ky është realiteti i cili nuk guxon të komentohet në mënyrë figurative. Këtu do t'i përmendim vetëm disa nga ato ajete, e assesi të gjitha, ngase ato janë të shumënumërta e këto i tejkalojnë vetëm ajetet që flasin për tevhidin dhe urdhrin për adhurimin e All-llahut xh.sh.:

a) “Besimtarët mos t’i marrin për miq kafirat (mohuesit), duke i lënë anash besimtarët. Ata që bëjnë këtë, nuk kanë çka të shpresojnë te All-llahu. Këtë mund ta bëni vetëm për t’u ruajtur nga ata - All-llahu u bën vërejtje për pezmin e Tij. Dhe të gjithë do të ktheheni te All-llahu.” (Ali Imran: 28).

Me këtë ajet All-llahu ua ndalon besimtarëve që t’i marrin për miq, shokë dhe as’habë jobesimtarët krahas besimtarëve, dhe na informon se ai i cili megjithatë e bënë këtë - ai nuk do të gjejë mbrojtje tek All-llahu xh.sh. Ibni Xheriri, duke komentuar këtë ajet, thotë: “Kjo do të thotë: “O besimtarë, mos i merrni jobesimtarët për ndihmës dhe mbështetje të juaj, duke ua miratuar fenë dhe duke u ndihmuar kundër myslimanëve, përpos besimtarëve me të cilët mund të shoqërohemi, duke ua treguar atyre dobësitë që i kanë, sepse, ai që vepron kështu nuk do të ketë kurrfarë ndihme nga All-llahu xh.sh. All-llahu xh.sh. ka heqë dorë prej tij dhe All-llahu nuk ka më asgjë me të, e as ai me All-llahun xh.sh., ngase me këtë ka hequr dorë nga feja e vet dhe ka hyrë në kufër.”³⁰⁹

E, për sa i përket fjalëve “vetëm për t’u ruajtur nga ata” kjo është sqaruar me ajetin “përpos atij që është i detyruar me forcë” (En-Nahël: 106), dhe kjo ka të bëjë me myslimanin që jeton mes tyre i pafuqishëm t’u kundërvihet, andaj sa për sy e faqe ua bënë me dije se është me ta, por zemra e tij është e mbushur me iman dhe me urrejtje ndaj kufrit dhe armiqtë e All-llahut xh.sh. Ibni Xheriri thotë: “Përpos që të ruheni prej tyre, por duke fshehur në vete armiqtësinë, e assesi

309 Tefsirut-Taberi, 6: 313.

duke marrë pjesë në kufirin e tyre dhe duke mos u ndihmuar në asnjë mënyrë kundër myslimanëve.”³¹⁰

Për kufijtë e dhunës që mirren parasysht në këtë rast, do të bëhet fjalë më vonë.

b) “O besimtarë! Mos i konsideroni për miq hebrenjtë dhe të krishterët! Ata janë miq të njëritjetrit. Kushdo që prej jush i konsideron ata për miq, ai është me ta. Me të vërtetë, All-llahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë zullumqarët. I sheh ti ata, zemrat e të cilëve lëngojnë (nga hipokrizia) se si vrapojnë për të lidhur miqësi me ta duke thënë” Druajmë se mos po na godetë ndonjë fatkeqësi”. E, All-llahu do t’i sjellë fitoren ose diçka tjetër nga ana e Tij, e prandaj, për atë që kanë fshehur në veten e tyre do të pendohen.” (El-Maide: 51-52).

Pra, All-llahu xh. sh na ndalon të miqësohemi me hebrenjtë dhe me të krishterët, dhe na tërheq vërejtjen se, ai i cili miqësohet me ta, bëhet njëri prej tyre. Andaj, kush miqësohet me hebrenjtë, ai është hebre, e kush miqësohet me të krishterët, ai është i krishter. Gjithashtu, kush miqësohet me cilindo kafir qoftë, ai së bashku me të është në kufër. Sepse, njeriu pranon prej atij me të cilin shoqërohet dhe është i kënaqur me atë ku gjendet miku i tij, andaj gjendet në kufër sikurse edhe ai. Ibni Hatimi transmeton nga Muhammed bin Sirini se ka thënë: “Abdull-llah bin Utbe ka thënë: “Çdonjëri prej jush le të ruhet që të mos bëhet hebre apo i krishter, e të mos jetë as i vetëdijshëm për këtë.” Andaj kuptuam se ai mendon në këtë ajet.”

Vetëm shikoje arsyetimin e atyre të cilët janë bërë jobesimtarë duke u miqësua me hebrenjtë dhe me të krishterët, arsyetimin të cilin All-llahu xh.sh. nuk ua ka pranuar - drojën e tyre nga ehli

310 Tefsirut-Taberi, 6: 313.

kitabët dhe pushtetit të tyre për pozitat dhe pasuritë e veta, për dynjallëkun e vet. Të menduarit për këtë të jep të kuptosh se, këtu ka të bëjë me dhunën e cila mund të mirret parasysh dhe me dhunën e cila nuk mirret parasysh, për çka tanimë kemi premtuar se do të flasim pas citimit të këtyre ajeteve.

c) “Ti i sheh shumicën nga ata që miqësohen me mohuesit. Me të vërtetë, e shëmtuar është ajo që i përgatisin ata vetes: që All-llahu të pezmatohet në ta dhe t’i dënojë përherë. Sikur t’i besonin ata All-llahut, Pejgamberit dhe asaj që i është shpallur atij, nuk do t’i merrnin ata (mohuesit) për miq. Por, shumica prej tyre janë mëkatarë”. (El-Maide: 80-81)

Nga këto ajete shihet se miqësimi i tyre me ta patjetër rezulton mosbesimin e tyre, ngase All-llahu xh.sh. ua ka premtuar atyre që miqësohen me ta hidhërimin e Vet dhe dënimin e përhershëm, dhe i ka informuar ata se besimtari nuk bën të miqësohet me ta, ngase jobesimtarët kanë sjellje armiqësore ndaj tyre, andaj nuk mund të miqësohet me ta.

Pastaj shiko se si All-llahu xh.sh. mosmiqësimin me jobesimtarët e ka nënrenditur si pjesë përbërëse të kelimeit shehadetit, për të cilën flet përmes imanit në All-llahun, Pejgamberin dhe asaj që i është shpallur atij.

d) “Lajmëroji (o Muhammed!) hipokritët për dënimin e mjerueshëm që i pret ata, të cilët miqësohen me mohuesit, e jo me besimtarët! A thua te ata kërkojnë fuqi, kur, me të vërtetë, e gjithë fuqia i përket vetëm All-llahut!” (En-Nisa’: 138-139).

Me këto ajete All-llahu xh.sh. miqësimin me jobesimtarë e konsideron si shenjë më të madhe të nifakut.

e) “Nuk gjen njerëz që besojnë në All-llahun dhe në Ditën e Kiametit, e të ushqejnë dashuri ndaj atyre të cilët kundërshtojnë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, madje qofshin ata (kundërshtarët) edhe etërit e tyre, ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre.” (El-Muxhadele: 22).

Me këtë ajet, All-llahu xh.sh. na informon se nuk ka besimtar që e do jobesimtarin dhe se ai që e do jobesimtarin nuk është besimtar. Nëse All-llahu xh.sh. i ka quajtur jobesimtarë ata të cilët i dojnë etërit e tyre, vëllezërit dhe farefisin që janë jobesimtarë, gjithsesi më parë do të jetë jobesimtar ai i cili miqësohet me besimtarë.

f) “Me të vërtetë, ata që janë kthyer prapa (në mohim), pasi u është treguar rruga e drejtë, djalli i ka shpie në mëkat dhe i ka ushqyer ata me shpresë të rrejshme. Kjo ngjet, ngase ata u thonin atyre, të cilët nuk e donin atë që e ka shpallur All-llahu: “Ne do t’ju përulemi juve në disa gjëra”, e All-llahu i di mirë fshehtësitë e tyre. E, (çka do të bëjnë) ata, kur engjëjt do t’ua marrin shpirtin atyre, duke i rrahur ata nëpër fytyrat dhe shpindët e tyre? Kjo është, ngase ata, pasuan atë që shkakton pezmin e All-llahut dhe që urrenin kënaqësinë (mënyrë e vdekjes) e Tij; e Ai, ua ka shkatërruar veprat e tyre.” (Muhammed: 25-28).

Me këto ajete All-llahu xh.sh. na shpjegon se shkaku i riddetit dhe i kufrit të tyre është ai që i thoshin jobesimtarëve: “Ne do t’ju përulemi juve në disa gjëra.” Prandaj nuk u ka sjellur kurrfarë dobie ajo që kanë ditur nga udhëzimi dhe e vërteta, pasi që u kanë thënë këto fjalë dhe u kanë premtuar armiqve të Islamit.

g) “Ai, juve, madje, ua ka shpallur në Libër (Kur’anin): kur të dëgjoni se mohohen argumentet e All-llahut dhe bëjnë tallje me to, atëherë mos rrinë me ata, përderisa të rrokin tjetër temë

(përndryshe nëse rrinë me ta), - ju atëherë jeni si ata. All-llahu do t'i tubojë në Xhehennem të gjithë hipokritët dhe mohuesit.” (En-Nisa’: 140).

All-llahu xh.sh. na tërheq vërejtjen se në Librin e Vet u ka shpallur besimtarëve që të mos rrinë në shoqëri me ata të cilët i mohojnë shenjat e All-llahut xh.sh. dhe tallen me to, përderisa nuk fillojnë ndonjë bisedë tjetër, dhe se ai që rrin me jobesimtarët gjersa ata tallen me shenjat e All-llahut xh.sh. dhe i mohojnë ato, është sikurse edhe ata. Kjo ka të bëjë me as’habët të cilët kanë qenë vetëm në një qytet të myslimanëve. Atëherë si qëndron puna me ata të cilët sot jetojnë në shtetin islam, ndërsa jobesimtarët që e përqeshin All-llahun dhe shenjat e Tij i thërrasin në shtetin e tyre dhe i marrin ata si miq, as’habë dhe këshilltarë duke dëgjuar kufrin e tyre dhe duke ua lejuar të gjitha këto? E në të njëjtën kohë i persekutojnë ulemanë islame nga atdheu i tyre!!! Kjo është njëra nga mënyrat e kënaqësisë me kufër, e cila vepruesin e vet e largon nga imani dhe e shpie në kufër. Sepse, të heshturit në vendin ku përmenden gjërat që paraqesin kufër, është argument i mjaftueshëm se ai, personi, është në pajtim me ta.

Prandaj, besimtari është i obliguar të ruhet prej kësaj, ashtu siç ruhet nga kufri dhe është i obliguar t’i ikë ndejave të tilla, në mënyrë që të shpëtojë nga ndëshkimi i All-llahut xh.sh. Në këtë nuk do të duhej ta pengonte frika se kështu ndoshta do ta humbaste pasurinë, pozitën, ose çkado qoftë tjetër në këtë botë, ngase më me rëndësi është të ketë frikë nga All-llahu xh.sh.

ÇKA DO TË THOTË MIQËSIMI ME JOBESIMTARËT?

Këto janë vetëm disa prej ajeteve që tregojnë qartë renegimin e atyre që miqësohen me jobesimtarët dhe me mushrikët, dhe nga të cilët shihet mospërputhja ndërmjet miqësisimit me ta dhe kelimeit shehadetit. Dhe askush nuk ka të drejtë të thotë se domethënia e miqësisimit me jobesimtarët nuk është caktuar (shpjeguar), për shkak se në të ngërthehen shumë gjëra dhe se nuk jemi në gjendje t'i përcaktojmë se, cilat prej tyre nxjerrin nga imani e cilat jo. Ngase, All-llahu xh.sh. nuk ndalon diç që nuk është definuar qartë dhe që nuk është e njohur, dhe nuk thotë se është jobesimtar ai që ka hyrë në diçka që është e paqartë dhe e pa definuar. Sepse në këtë rast urdhri dhe ndalesa e Tij nuk do të kishte kuptim dhe nuk do të ishte e mundur të aplikohet, e këtë ai që beson në All-llahun xh.sh. dhe në cilësitë e Tij të përsosmërisë nuk do ta thoshte kurrë.

E, nëse dikush pyet: “Çka do të thotë miqësimi (muvala)?”

Dije se kjo fjalë është derivat i fjalës afërsi, intimitet dhe vilajet (miqësim), e miqësim do me thënë të kundërtën e jomiqësisimit dhe mik të kundërtën e armikut. Besimtarët janë miq të All-llahut xh.sh. për shkak të afërsisë me All-llahun xh.sh. që arrihet me përlulje dhe me ibadet ndaj Tij, ndërsa armiqtë janë miq të tagutit dhe shejtanit për shkak të nënshtrimit të urdhrave të tij dhe për shkak largimit të tyre nga All-llahu xh.sh. duke mëkatuar dhe duke i kundërshtuar urdhrat e Tij. Nga kjo kuptohet se miqësimi me jobesimtarët do të thotë afërsia me ta dhe të shprehurit e dashurisë ndaj tyre me fjalë, me vepra dhe me nijet (qëllim). Ajetet kur'anore kanë nxjerrë sheshit shumë gjëra me të cilat njeriu hyn në miqësim me jobesimtarët, e disa prej tyre janë:

1 - Pasimi i qejfeve (epsheve) të tyre, e All-llahu xh.sh. e ka ndaluar të pasohen ato. All-llahu xh.sh. thotë:

“As hebrenjtë, as të krishterët nuk do të jenë të kënaqur me ty, përderisa të mos pranosh besimin e tyre. Thuaju: “Vetëm drejtimi i All-llahut është i drejtë!” E, në qoftë se pas asaj diturie që të ka zbritur ty, ti ndjek dëshirën e atyre, atëherë prej dënimit të All-llahut ti nuk do të kishe kurrfarë mbrojtësi as kurrfarë ndihmëtari.” (El-Bekare: 120).

2 - Nënshtrimi ndaj tyre në atë që urdhërojnë dhe që dëshirojnë ata. All-llahu xh.sh. thotë:

“O besimtarë, nëse u nënshtroheni atyre që nuk besojnë do t’ju kthejnë gjurmëve tuaja dhe do të jeni të humbur.” (Ali Imran: 149).

“... Dhe mos dëgjo atë - zemrën e të cilit ia kemi lënë të (shkujdesur ndaj Nesh).” (El-Kehf: 28).

“... Me të vërtetë, djajtë i nxisin miqtë e vet që të polemizojnë me ju. E nëse ju u përuleni atyre, atëherë edhe ju, me të vërtetë, jeni idhujtarë.” (El-En’am: 121).

3- Dashamirësia ndaj tyre. All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe, mos anoni kah ata që bëjnë zullum, meqë do t’ju përcëllojë zjarri. Ju nuk keni mbrojtës tjetër përveç All-llahut, dhe nuk do të jeni të ndihmuar.” (Hud: 113).

E animi kah ata do të thotë t’i simpatizosh ata dhe të jeshë i kënaqur me atë që bëjnë ata kundër myslimanëve.

4 - Lajkatimi, miklimi dhe intimiteti me ta në llogari të fesë. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ata dëshirojnë që ti të bësh lëshime, e të bëjnë (lëshime) edhe ata.” (El-Kalem: 9).

5 - Shprehja e dashurisë ndaj tyre. All-llahu xh.sh. thotë:

“Nuk gjen njerëz që besojnë në All-llahun dhe në Ditën e Kiametit, e të ushqejnë dashuri ndaj atyre të cilët kundërshtojnë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij.” (El-Muxhadele: 2).

6 - Gostitja e jobesimtarëve dhe afërsia me ta, veçanërisht me sundimtarët e tyre.

7 - Këshillimi me ta për gjërat e rëndësishme

8 - Marrja e jobesimtarit për mbrojtës, pranë besimtarit.

9 - T’u ndihmohet atyre në padrejtësi.

10 - Imitimi i jobesimtarëve në vepra, në adetet e tyre dhe në traditat e tyre.

11 - Nxitja e myslimanëve me metoda dhe me mjete të ndryshme që t’i imitojnë ata në mënyrën e jetës së tyre.

12 - Huazimi i ligjeve dhe metodologjisë së tyre nga pikëpamjet e shoqërisë dhe edukimit të të rinjve.

13 - Bashkëpunimi me ta në punët e tyre të këqija, në realizimin e planeve të tyre në praktikë, kyçja në organizatat dhe blloqet e tyre, spiunimi për interes të tyre, t’u zbulohen atyre dobësitë dhe mangësitë e myslimanëve dhe fshehtësitë e popujve myslimanë dhe të luftuarit në anën e tyre.

14 - Garantimi për sigurinë e tyre, përderisa e dimë se All-llahu xh.sh. i ka braktisur ata. Të besuarit e funksioneve të larta njerëzve të tyre, e veçanërisht në armatë dhe në institucione të rëndësishme shtetërore.

15 - Të konsideruarit se janë të drejta dhe të bukura idetë, drejtimet dhe konceptimet e jetës së tyre si dhe thirrja në to.

16 - Të konsideruarit se shkencëtarët e tyre janë më të dijshtëm dhe më të zellshëm se ulemaja islame.

Ai, tek i cili gjenden këto gjëra, apo ndonjëra prej tyre, dhe kjo bëhet gjë e njohur dhe e zakonshme tek ai, - ai vetë ka ardhur me argument se është i kënaqur me kufirin e jobesimtarëve, andaj bëhet i njëjtë sikurse ata ose bëhet njëri prej tyre, dhe asgjë nuk do të mund ta shpëtojë nga kufiri, përveçse imani i sërishëm dhe ndërprerja e miqësismit me ta.

ÇKA PRANOHET, E ÇKA NUK PRANOHET NGA ARSYETIMI NË KËTË SITUATË

Ndoshta dikush prej atyre që miqësohen me jobesimtarët do të arsyetohet me atë se frikohet për pozitën e vet, për pasurinë e vet etj. Mirëpo, kjo assesi nuk është arsye që e justifikon atë, ngase All-llahu xh.sh. nuk e pranon këtë arsyetim, e as që për shkak të tij do ta shfajësojë këtë person. Sepse, të gjitha këto janë shkaqe të cilat i ka sjellur shejtani duke i hijeshuar ato, e që shfaqin

lojalitetin ndaj kësaj bote dhe lakminë ndaj stolirave të saj. Sepse, All-llahu xh.sh. prej asnjërit nuk ka pranuar kurrfarë arsytimi për shoqërimin e tyre me jobesimtarët, përveçse një të vetmin, e kjo është - dhuna. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ai që mohon All-llahun, pasi që pat besuar - përpos atij që është i detyruar me forcë (që të mohojë), por zemra e tij është plotë besim, (për të nuk ka mëkat) - por për ata që e hapin zemrën për mohim, për ta ka zemrim nga All-llahu dhe për ta ka dënim të madh, sepse, ata e duan më shumë jetën e kësaj bote se jetën e botës tjetër, e All-llahu nuk i udhëzon në rrugë të dejtë mohuesit.” (En-Nahël: 106-107).

“Besimtarët mos t’i marrin për miq kafirat (mohuesit), duke i lënë anash besimtarët. Ata që bëjnë këtë, nuk kanë çka të shpresojnë te All-llahu. Këtë mund ta bëni vetëm për t’u ruajtur nga ata - All-llahu u bën vërejtje për pezmin e Tij. Dhe të gjithë do të ktheheni te All-llahu.” (Ali Imran: 28).

Me kusht që as dhunimi përkitazi me kënaqësinë e zemrës dhe lojalitetit të brendshëm ndaj jobesimtarëve nuk vlenë. Kjo assesi nuk është e lejuar. Sepse, All-llahu xh.sh. Thotë: “por zemra e tij është plotë besim”, ngase dhuna nuk ndikon në zemër, por arsytimi pranohet nëse është i lidhur me atë që mund të ndikojë, e kjo është të shqiptuarit me gjuhë dhe zbatimi me vepra. Andaj, ai që e bartë në zemër miqësinë dhe lojalitetin ndaj jobesimtarëve, ai gjithsesi është jobesimtar. E nëse këtë miqësim e shprehë haptazi me fjalë dhe me vepra, ndaj tij do të praktikohet sjellja si ndaj jobesimtarit dhe në Ahiret vendbanimi i tij i përhershëm do të jetë në zjarr. Por nëse këtë nuk e shprehë as me fjalë as me vepra dhe (publikisht) i përmbahet

dispozitave islame, atëherë ai e ka ruajtur pasurinë e vet dhe jetën e vet, por ky është munafik i cili do të jetë në fund të Xhehennemit.

KUFIJTË E DHUNËS QË MIRREN PARASYSH

Cilët janë kufijtë e dhunës për të cilët mendohet këtu?

Shejhul islam Ibni Tejmii r.a. thotë: “I kam studiuar mendimet përkitazi me dhunën dhe kam konstatuar, se ato dallojnë në pajtim me dallimin e gjërave të cilave u përkasin ato. Sepse, nuk është e njëjtë dhuna e cila pranohet me fjalë që nxjerrin nga imani dhe dhuna që pranohet me rastin e dhuratës. Imam Ahmedi në mënyrë të qartë ka konfirmuar në shumë vende se detyrimi në kufër nuk mund të jetë përpos me torturim përmes rrahjes dhe lidhjes, ndërsa kërcënimi vetëm me fjalë nuk është i mjaftueshëm. Gjithashtu ka thënë se gruaja e cila ia ka dhuruar mehrin burrit të vet, ka të drejtë ta ketë atë, me kusht që ajo në esencë nuk e dhuron mehrin e vet, përveçse nëse frikohet se do ta shkurorëzojnë, ose do të sillen keq ndaj saj. Edhe në këtë rast frika nga shkurorëzimi apo nga trajtimi i keq konsiderohet si dhunë. Mirëpo, ky rast dhe raste të tjera të ngjashme me këtë nuk mund të mirren parasysh kur është në pyetje kufri. Prandaj, nëse i robëruari frikohet se armiku nuk do ta lejojë të martohet ose se do ta ndajnë nga gruaja, në këtë rast nuk ka të drejtë t’i shqiptojë fjalët e kufrit.”³¹¹

311 Mexhmu’atut-tevhid.

Pra, imam Ahmed bin Hanbeli konsideron se, e me këtë është në pajtim edhe Ibni Tejmju, detyrimi përkitazi me paraqitjen si jobesimtar, qoftë me fjalë qoftë me miqësim me jobesimtarët, nuk mirret si i vlefshëm përderisa nuk arrinë shkallën e torturimit me goditje apo me tentimin e vrasjes etj. E, për sa i përket gjërave të tjera, siç është gjasa për pushtet, për pozitë që do ta caktojne jobesimtarët ose frika për pasurinë, familjen, atdheun etj., të tëra këto nuk janë të lejuara dhe nuk do të trajtohen si arsytim. Këtë mendim të tyre e mbështesin në ajetet, të cilat tanimë i kemi cituar, e të cilat ua ndalojnë besimtarëve miqësimin me jobesimtarët dhe këtë e konsiderojnë si shkas për renegim dhe mosbesim. Në ajetin i cili pason, All-llahu xh.sh. nënvizon se dashuria ndaj jetës së kësaj bote dhe sakrifikimi për të, nuk do të jetë arsytim para All-llahut xh.sh., po qe se ai shqipton diç nga fjalët apo punon diç me çka bëhet jobesimtar. All-llahu xh.sh. thotë:

“Sepse, ata e duan më shumë jetën e kësaj bote se jetën e botës tjetër, e All-llahu nuk i udhëzon në rrugë të dejtë mohuesit.” (En-Nahël: 107).

Në një ajet tjetër All-llahu xh.sh. i kërcënohet me ndëshkim atij që për mbrojtës të vet merr babain apo të vëllain e vet jobesimtar, e thotë:

“O besimtarë! Mos e bëni mik babanë tuaj dhe vëllezërit tuaj, nëse ata më tepër e duan mohimin se sa besimin. Kushdo prej jush që i bënë ata miq, është zullumqar.” (Et-Tevbe: 23).

Shih se si All-llahu xh.sh. nuk pranon që madje edhe farefisi më i afërt të jetë arsytim për miqësim me jobesimtarët. E, nëse dashuria ndaj fëmijës nuk është arsytim i mjaftueshëm për miqësim me armikun, atëherë si mund të jetë kjo dashuri ndaj pozitës, pasurisë dhe stolive të kësaj bote? All-llahu xh.sh. ka refuzuar arsyetimin me ato pretekste me të cilat njerëzit shpeshherë

arsyetohen për shkak të lënies pas dore atë që All-llahu xh.sh. dhe i dërguari i Tij kërkojnë prej tyre.

“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj, që e keni fituar, tregtia - për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë - dhe shtëpitë në të cilat e ndieni veten rehat, u janë më të dashura se All-llahu, se i Dërguari i Tij dhe se lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa ta sjellë vendimin All-llahu. E, All-llahu nuk don ta udhëzojë në rrugën e drejtë popullin e korruptuar.” (Et-Tevbe: 24)

Nuk ka dyshim se me miqësimin me jobesimtarët shprehet dashuria dhe simpatia ndaj tyre dhe se atyre u jipet përparësi kundruall dashurisë ndaj All-llahut xh.sh., të Dërguarit të Tij dhe luftës në rrugën e Tij. Ngjashëm me këtë përmendet edhe në këtë ajet:

“Nuk gjen njerëz që besojnë në All-llahun dhe në Ditën e Kiametit, e të ushqejnë dashuri ndaj atyre të cilët kundërshtojnë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, madje qofshin ata (kundërshtarët) edhe etërit e tyre, ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre.” (El-Muxhadele: 22).

Pra, njeriu nuk ka arsytim me jobesimtarët, nëse frikohet për pasurinë e vet, për fëmijët e vet, për gruan e vet, për familjen e vet etj., me çka arsyetohen shumica e njerëzve.

Shih se si All-llahu xh.sh. ka refuzuar arsyetimin e atyre që janë miqësuar me hebrenjtë dhe me të krishterët kur patën thënë: “Druajmë se mos po na godetë ndonjë fatkeqësi.” All-llahu xh.sh. ka thënë:

“O besimtarë! Mos i konsideroni për miq hebrenjtë dhe të krishterët! Ata janë miq të njëri-tjetrit. Kushdo që prej jush i konsideron ata për miq, ai është me ta. Me të vërtetë, All-llahu nuk i

udhëzon në rrugë të drejtë zullumqarët. I sheh ti ata, zemrat e të cilëve lëngojnë (nga hipokrizia) se si vrapojnë për të lidhur miqësi me ta duke thënë: “Druajmë se mos po na godetë ndonjë fatkeqësi”. E, All-llahu do t’i sjellë fitoren ose diçka tjetër nga ana e Tij, e prandaj, për atë që kanë fshehur në veten e tyre do të pendohen.” (El-Maide: 51-52).

Në situatë të tillë edhe sot gjenden shumë renegatë. Sesa janë të ngjashme arsyetimet e jobesimtarëve të mëhershëm me arsyetimet e jobesimtarëve të sotëm! Do t’i gleshë këta duke u arsyetuar njësoj si edhe të parët e tyre se iu frikësohen fatkeqësive. Ata thonë: “Si të mos miqësohemi me jobesimtarët apo të mos kemi marrëdhënie të mira me këtë dhe më këtë njeri apo me këtë e këtë parti, madje edhe në llogari të fesë, duke qenë se ajo ka mbështetje dhe mbrojtje nga fuqitë e mëdha, e ne nuk jemi në gjendje t’u kundërvihemi atyre.” Ose thonë: “Si mos ta përfillim dëshirën e asaj dhe asaj fuqie, ndonëse dëshira e tyre është që t’i mbysin myslimanët, t’ua prishin moralin, t’i largojnë ata nga feja e tyre, dhe mospranimin e atdheut të tyre, si mund të bëjmë këtë?! Edhe vetë e dini se nuk jemi në gjendje të ekzistojmë asnjë moment në vendin ku gjendemi nëse nuk u nënshtrohemi dëshirave të tyre, ngase ne nuk jemi në gjendje t’i sakrifikojmë pozitat tona dhe privilegjet që i gëzojmë!!!”

E kjo, pasha All-llahun, është frikë e cila assesi nuk është e lejuar, ngase frikë duhet të kihet vetëm atëherë kur është në pyetje All-llahu xh.sh. dhe feja e Tij. E, tanimë ke kuptuar se në kufër hyn ai i cili e miraton këtë për shkak të dikujt tjetër përveç All-llahut xh.sh. Njerëzit e tillë bëjnë kufër të dyfishtë, duke u miqësua me jobesimtarët dhe duke u bërë ibadet (shprehje frike) atyre, që nuk është e lejuar t’i bëhet askujt tjetër përveç All-llahut xh.sh.

Këto ajete dhe të ngjashme me to, janë argument i qartë se All-llahu xh.sh. askujt nuk do t'ia arsyetojë miqësimin me jobesimtarët, përveç atij i cili do të gjendet në ndonjë situatë çfarë ka qenë Ammar bin Jasiri, për shkak të cilit All-llahu xh.sh. ka shpallur ajetin ku thuhet: “përpos atij që është i detyruar me forcë (që të mohojë), por zemra e tij është plotë besim, (për të nuk ka mëkat).” Pra, me këtë kërkohet që, ai mbi të cilin ushtrohet dhuna, të jetë nën pushtetin e jobesimtarëve, të cilët janë në gjendje edhe ta mbysin, ndërsa lehtësimet për mëkate vlejné vetëm gjatë kohës së zgjatjes së këtyre dhunave. Dhe nuk është e lejuar që kjo të shfrytëzohet pas ndërprerjes së torturimit. E, nëse përsëri fillojnë ta torturojnë, ai prap do ta përdorë këtë lehtësim. Transmetohet se Resulull-llahu s.a.v.s., pasi që kishte kuptuar se në çfarë situatë gjendet Ammari, i ka thënë: “E, nëse kthehet, edhe ti kthehu.”

Ibni Kudame thotë: “E nëse konstatohet se ai i cili ka qenë nën dhunë nuk ka bërë kufër, menjëherë pas ndërprerjes së saj prej tij do të kërkohet që publikisht ta rrëfejë Islamin, e nëse e bënë këtë - ai mbetet në Islamin e vet. E nëse me atë rast shfaqë kufrin - ai do të konsiderohet për jobesimtar që nga momenti kur i ka shqiptuar fjalët e kufrit. Ngase me këtë është konstatuar se ai është i kënaqur me kufër që nga momenti kur e ka shprehur këtë me dëshirën e vetë dhe pa kurrfarë dhune.”³¹²

Por, ai që është i shtyrë të bëjë kufër apo të miqësohet me jobesimtarë, gjithsesi është më mirë të durohet dhe të mos e bëjë këtë, madje edhe nëse kjo shkakton vdekjen e tij. Sepse, transmetohet nga Ebu Abdull-llah Habbab ibën el-Eret'i r.a. që thotë: “Tu ankuam të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. (për persekutimet nga mushrikët) derisa ai ishte i mbështetur nën hije të Ka'bës në burdën

312 El-Mugni, 9: 24.

e tij që e kishte bërë jastëk, e ne i thamë: “A nuk do të na ndihmosh, a nuk do të na bësh lutje (dua)?” Ai na tha: “Më parë (para jush), për shkak të fesë e merrnin njeriun, ia hapnin një gropë, e vendosnin në të, e pastaj e merrnin sharrën dhe ia vendosnin në kokë dhe e përgjysmonin, pastaj ia rrjepnin mishin dhe lëkurën me krehër hekuri, por as kjo nuk e largonte nga feja e tij. Pasha All-llahun, All-llahu do ta plotësojë këtë fe ashtu që kalorësi do të shkojë prej Sana-së deri në Hadramevt e nuk do të frikësohet prej askujt tjetër përveç prej All-llahut, dhe prej ujkut për kopenë e vet, mirëpo ju po nguteni-(nuk jeni durimtarë)”³¹³.

Këtë e vërteton edhe ngjarja me njerëzit e Uhdudit, e cila transmetohet nga Buhariu, e ku përmendet se çka kanë bërë ata me besimtarët, porse ata kanë duruar dhe kanë qëndruar fuqishëm në rrugën e All-llahut xh.sh. Ata nuk i ka penguar hendeuku i mbushur përplotë me zjarr të flakëruar që ta ndjekin fenë e tyre, por kanë mbetur fuqimisht në të, duke i sakrifikuar edhe jetët e tyre në këtë rrugë. Kjo që thamë është sqarim i fjalëve të All-llahut xh.sh.:

“Mallkuar qofshin ata që kanë hapur hendeqe, dhe që i mbushën me zjarr, me gjithfarë lëndë djegëse, (mallkuar qofshin ata) kur u ulën pranë tij, dhe ishin prezent të asaj (që u bënë besimtarëve)!” (El-Buruxh: 4-7).

Imam Kurtubi r.a. thotë se ulemaja islame është në pajtim me atë se, nëse dikush është i shtyrë të bëjë kufër, e në vend të tij e zgjedhë vdekjen, do të jetë më tepër i shpërblyer nga All-llahu xh.sh. se ai që e ka zgjedhur lehtësimin.”

313 Transmeton Buhariu. Shih: Radijus Salihin, f. 32.

DISA SHEMBUJ TË MOSKËNAQËSISË ME ISLAM

Do t'i përmendim vetëm dy shembuj të urrejtjes ndaj Islamit, bërësit e të cilëve hudhen në renegim dhe në kufër, përkundër asaj se ata e kanë shqiptuar kelimeit shahadetin dhe se veten e konsiderojnë si myslimanë.

Shembulli i parë: të tallurit me çkado qoftë që është e gjithënjohur si pjesë e fesë islame. Këtu bënë pjesë të tallurit me All-llahun xh.sh., me Pejgamberin e Tij, me Librin e Tij, apo të tallurit me besimtarët për shkak të besimit të tyre etj. Kjo bazohet në fjalët e All-llahut xh.sh.:

“E, nëse i pyet ata (përse tallen), do të përgjigjen: “Ne vetëm biseduam dhe u argëtuam”. Thuaj: “A mos vallë me All-llahun, me Librin e Tij e me Pejgamberin e Tij po talleni?” Mos u arsyetoni! Se, ju, mohuat fenë, pasi që patët besuar. Nëse Ne e falim një grup tuajin, do ta ndëshkojmë grupin tjetër, ngase ishin mëkatarë.” (Et-Tevbe: 65-66).

Këto ajete u shpallën pasi që dikush gjatë ekspeditës në Tebuk pat thënë: “Nuk kemi parë njerëz më lakmitarë për ushqim, gënjeshtarë më të mëdhenj në rrëfime, dhe frikacakë më të mëdhenj me rast ballafaqimi me armikun, se sa mësuesit tanë”, duke menduar për Resulull-llahun s.a.v.s. dhe as’habët e tij mësuesit (karije) e Kur’anit. E, Malik bin Avfi është përgjigjur: “Gënjen, ti je munafik. Unë për këtë do ta informojë Resulull-llahun s.a.v.s.” Avfi vajti tek Resulull-llahu s.a.v.s. por e pa se Shpallja kishte qenë më e shpejt se ai. Njeriu, i cili i kishte thënë këto fjalë, vajti tek Resulull-llahu s.a.v.s. kalëruar në devenë e vet, e tha: “O i Dërguari i All-llahut, ne vetëm luanim dhe mahiteshim duke biseduar çkado qoftë vetëm për të na kaluar koha.” Ibni Umeri thotë: “Më bëhet se edhe tani e shoh se si e mbante për freri devenë e Resulull-llahut s.a.v.s., derisa gurtë ia

shtypnin këmbët e tij, e thoshte: “Ne vetëm biseduam dhe u argëtuam.” Ndërsa Resulull-llahu s.a.v.s. iu përgjigj: “A mos vallë, po talleni me All-llahun, me fjalët e Tij dhe me Pejgamberin e Tij?”, dhe assesi nuk u kthye kah ai e as që shtoi diç tjetër.³¹⁴

Format e shpotitjeve janë të shumënumërta dhe nuk mund të numërohen që të gjitha, por elementi i përbashkët për të gjitha ato është se tregojnë sheshit përçmimin e fesë dhe pakënaqësinë me të apo çkado qoftë në të. Kjo mund të ndodhë me fjalë, me vepra apo me isharet, siç është isharetit me sy (mbyllja e syrit), nxjerrja e gjuhës, të fryrët e buzëve, të bërët shenjë me dorë gjatë dëgjimit të Kur’anit dhe hadithit të Resulull-llahut s.a.v.s., apo gjatë përmendjes së akaidës islame, apo diç nga parimet e njohura të saj, dhe të ngjashme me këtë.

Shembulli i dytë: shprehja e urrejtjes dhe pezmit gjatë përmendjes së All-llahut xh.sh., Pejgamberit të Tij, dëgjimit të Kur’anit, përmendjes çkadoqoftë nga parimet e gjithënjohura të Islamit apo gjatë thirrjes në të. Sepse, All-llahu xh.sh. thotë:

“E kur t’ju lexohen atyre ajetet Tona të qarta, ti, do të vërejsh në fytyrat e atyre që nuk besojnë - pakënaqësinë e madhe; ata duan t’u vërsulen atyre, që i lexojnë ajetet Tona. Thuaj: “A doni t’ju tregoj juve se çka është më e keqe se kjo? - Zjarri! All-llahu ua ka premtuar atyre që nuk besojnë. E, sa vendbanim i shëmtuar që është ai!” (El-Haxh: 72).

“Kjo është, ngase ata e urrejnë atë që e ka shpallë All-llahu, andaj Ai ua ka shkatërruar veprat e tyre.” (Muhammed: 9).

314 Tefsir Ibni Kethir, 2: 367.

FJALËT E DISA ALIMËVE PËRKITAZI ME ATË SE ÇKA SHKAKTON RENEGIMIN NGA FEJA

Mendojmë se është e dobishme që në fund të kësaj kaptine t'i përmendim disa alimë, të cilët në mënyrë të përpiktë i kanë kualifikuar veprat, fjalët dhe bindjet të cilat e nxjerrin njeriun nga feja islame, në mënyrë që lexuesit të kenë njohuri më të qartë mbi këtë, e që të mos futen edhe vetë në to dhe të jenë në gjendje t'ua tërheqin vërejtjen vëllezërve të tyre e t'i pengojnë ata që të bëjnë diç nga këto. Sepse, shumë gjëra që i kanë përmendur këta alimë, ulemaja islame janë në pajtim, ndërsa ajo rreth së cilës nuk janë të një mendimi, në raste më të shumta i takojnë fushës së mëkateve të mëdha.

1 - Imam Ibni Haxher El-Hajteme, në librin e tij të njohur “Ez-Zevaxhir ‘an iktirafil kebair”, thotë: “Në kufër bënë pjesë edhe ajo që njeriu kurdoherë që vendos të bëhet jobesimtar ose për vete thotë se do të bëhet jobesimtar, nëse ndodhë kjo dhe kjo, madje edhe në qoftë se kjo është e pamundur të ndodhë. Që nga ai çast, ai bëhet jobesimtar. Gjithashtu, nëse beson diç që shpie në kufër, ose bënë ndonjë vepër që nxjerrë nga imani, ose shprehë fjalë që tregojnë në kufër, qofshin ato nga bindja e tij, inati apo në tallje e sipër. Si për shembull të besojë në atë se kjo botë nuk është krijuar porse ekziston gjithmonë. Apo, nëse mohon diç nga All-llahu që është e gjithënjohur në Islam për Atë. Si për shembull të mohojë diturinë e All-llahut xh.sh., ose gjithëfuqinë e Tij, ose që All-llahu xh.sh. i di të gjitha hollësitë, ose t'i atribuojë All-llahut diç që nuk mund t'i përshkruhet Atij, siç është për shembull - ngjyra.”

Pastaj, ai kalon në sqarimin detaj të këtij rregulli, e thotë: “Këtu bënë pjesë gjithsecili që bënë ndonjë vepër, për të cilën të gjithë myslimanët konfirmojnë se nuk mund të rezultojë nga besimtari, veçse nga jobesimtari. Siç është shkuarja në kishë me të krishterët në rrobat e tyre ceremoniale. Të hedhë në pleh letra, në të cilat ka diç të shkruar nga Kur’ani ose emri i All-llahut xh.sh. Të dyshojë në shpalljen e cilitdo Libër të All-llahut xh.sh., siç është Tevrati, Inxhili, Zeburi i Davudit a.s. dhe Fletushkat e Ibrahimit a.s. Të dyshojë në ndonjë ajet kur’anor. Të dyshojë në kufër të atij që shqipton diç me çka dëshiron që ummeti islam të shpihet në lajthitje, apo ndonjërin prej as’habëve ta shpallë jobesimtar, apo ta njollojë Mekën dhe Tempullin e Shenjtë, apo dëshiron që t’a ndryshojnë mënyrën e kryerjes së haxhxit, agjërimit dhe namazit, ose me të dëshirohet të lejohet diç që është haram, siç është namazi pa abdest, ose më atë lejohet ofendimi i myslimanëve apo jobesimtarët zimmije pa shkaqe të arsyetuara me Sheriat, ose me çka ndalohet e lejuara, siç është tregtia dhe martesja, ose të thotë se Pejgamberi ynë ka qenë zezak (duke e poshtëruar), ose që ka vdekur para se t’i rritet mjekra, se nuk është kurejshit, se nuk është arab, ngase t’i përshkruhet diç Resulull-llahun s.a.v.s., që nuk është e vërtetë, paraqet një formë të gënjeshtres për të. Gjithashtu është kufër edhe mohimi i cilësdo cilësi e cila me siguri i përshkruhet Resulull-llahut s.a.v.s., siç është bie fjala mundësia të vijë ndonjë pejgamber tjetër pas Resulull-llahut s.a.v.s., ose të thotë: “Nuk e di se a është ai, i cili ka lindur në Mekë, e ka vdekur në Medinë, apo është dikush tjetër.” Ose të thotë se, pejgamberllëku përfitohet (arrihet), ose të thotë se shkalla e tij arrihet me pastërtinë e zemrës, ose të thotë: “Evlija është më i mirë se pejgamberi”, ose të thotë për vete se është duke i zbritur shpallja edhe pse nuk është pejgamber, të konfirmojë për vete dhe për dikë tjetër se do të hyjë në Xhennet para se të vdes, ose në çfarëdo mënyre qoftë e përçmon Pejgamberin tanë apo cilindo nga as’habët e tij apo nga engjëjt. Ose ta shajë e ta mallkojë, ta përçmojë dhe ta përqeshë atë, t’ia përshkruajë ndonjë të metë atij, origjinës

së tij, fesë së tij, veprave të tij apo aludon në të, e përçmon me atë që ia zvogëlon vlerën atij, ose dëshironë t'ia gjejë ndonjë mangësi apo i përshkruan diç në kontekst negativ që nuk i përket dinjitetit të tij. Ose që në llogari të tij të bëjë shaka apo shpoti. Apo ta përçmojë për shkak të cilitdo sprovim që i ka ndodhur gjatë jetës së tij, apo e përçmon me gjërat që i kanë ndodhur e që mund t'i ndodhë çdo njeriu në këtë botë. E tërë ulemaja islame është në pajtim se ai i cili bënë çkado qoftë prej këtyre - ai del nga imani dhe bëhet jobesimtar. Dhe ai duhet të likuidohet dhe pendimi i tij nuk pranohet tek shumica e ulemasë. Halid bin Velidi e ka mbytur një njeri i cili i ka thënë: “Tek ai kolegu i juaj.”, ngase këtë shprehje e ka konsideruar si poshtëronjëse për Resulull-lahun s.a.v.s.”

Pastaj Ibni Haxheri thotë: “Ose bëhet i kënaqur me kufër, madje qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, si për shembull nëse në ndonjë mënyrë ia bënë me dije jobesimtarit se nuk duhet ta pranojë Islamin, edhe pse ky as që e ka pyetur për këtë. Ose ia dëshiron kufirin tjetërkujt. Ose t'i thotë myslimanit: “O kafir”, pa kurrfarë shkasi të qartë për këtë, sepse me këtë ai e ka quajtur Islamin kafir. Ose të tallet me ndonjë urdhër të All-llahut xh.sh., me Pejgamberin e Tij ose me kërcënimet dhe premtimet e Tij. Për shembull të thotë: “Sikur të më urdhëronte këtë dhe këtë, unë nuk do ta bëja”, ose: “Sikur ta kishte bërë kiblën në këtë anë, unë nuk do të falesha”, ose: “Edhe sikur të ma jipte Xhennetin, unë ne të nuk do të hyja (prej inati apo përçmimi), ose të thotë: “Nëse më ndëshkon për shkak se nuk jam duke u falur, edhe pranë sëmundjes sime kaq të madhe dhe vuajtjeve të mia, atëherë më ka bërë të padrejtë.” Ose sikur dhunuesi t'i thoshte atij që i bënë dhunë, pasi që ky i ka thënë se edhe kjo dhunë është sipas përcaktimit të All-llahut xh.sh. Ose dikush të thotë: “Edhe sikur këtë ta dëshmonte Pejgamberi apo ndonjë engjëll, unë këtë nuk do ta besoja.” Ose thotë: “Sikurse filani të ishte pejgamber, unë nuk do ta pasoja.” Ose të thotë:

“Nëse është e vërtetë ajo që thotë Pejgamberi, atëherë jemi të shpëtuar.” Ose, atij që i thuhet se duhet t’i prejë thonjtë, ngase ky është sunnet, e ai thotë se nuk do ta bëjë këtë edhe se është sunnet, duke e përqeshur këtë. Ose të thotë: “Fjalët “La havle ve la kuvete il-la bil-lah” nuk kanë kurrfarë dobie.” E njëjta gjë është edhe me duatë e tjera, të cilat i transmeton Resulull-llahu s.a.v.s. Ose të thotë: “Muezini gënjen”, ose zërin e tij e krahason me zërin e kambanave të krishterëve, apo në çfarëdo mënyre tjetër tallet me ezan. Ose nga qesendia e thotë bismelen gjatë fillimit të ndonjë pune haram. Apo duke u tallur thotë: “unë nuk i frikohem Ditës së Kiametit.” Ose për All-llahun thotë se Ai nuk është në gjendje ta gjejë vjedhësin. Ose All-llahut xh.sh. ia atribuon padrejtësinë në dispozitat e Tij. Ose i vesh rrobat me të cilat shquhen jobesimtarët, duke e shprehur me këtë simpatinë ndaj tyre dhe ndaj fesë së tyre. Ose të thotë: “Hebrenjtë janë më të mirë se myslimanët”. Ose, kur të pyetet se ç’është imani të thotë: “Nuk e di” duke u tallur me të. Ose ta mohon suhbetin e Ebu Bekrit r.a., ose ta njollosë Aishen r.a., ngase me këtë ai gënjen për Kur’anin, që nuk është rasti me as’habët e tjerë. Ose për vete të thotë se është All-llah, madje edhe në mahi e sipër, ose të thotë se nuk i pranon të drejtat e All-llahut ndaj nesh, duke iu shmangur obligimeve. Ose të thotë duke u tallur: “Mjaft më me Kur’an, me namaz apo me dhikër” dhe të ngjashme me këtë. Ose të thotë: “ç’është Xhehennemi ose Mahsheri?” Ose të thotë: “Mallkimi i All-llahut qoftë mbi të gjithë alimët”, ngase këtu hyjnë edhe Pejgamberët dhe engjëjt. Ose duke u tallur thotë: “Ç’është me këtë Sheriat?” Ose të thotë: “Nëse përnjëmend realizohet rububijeti, atëherë bie poshtë ubudijjeti”, duke menduar në lirim nga dispozitat e Sheriatit. Ose të pandehë se ai ka kaluar nga cilësitë njerëzore në cilësi hyjnore. Ose të pandehë se haptazi është duke e parë All-llahun xh.sh. në dynjallëk. Ose të thotë se All-llahu xh.sh. i shfaqet atij në figurë të bukur. Ose të pandehë se është i liruar nga obligimet e Sheriatit. Ose pandehë se njeriu mund të arrijë tek All-llahu xh.sh. përmes ndonjë rruge tjetër, përpos rrugës së ubudijetit.

Ose të thotë: “Shpirti është nga nuri i All-llahut xh.sh., e kur të takohet nuri me nurin, ata bashkohen.”³¹⁵

2 - Këtu po i transmetojmë fjalët e Ibni Tejmiut r.a. përkritazi me domethënien e fjalëve të All-llahut xh.sh.:

“E, ata që nuk gjykojnë sipas asaj që ka shpallur All-llahu, ata janë mohues të vërtetë.” (El-Maide: 44).

“S’ka dyshim se është jobesimtar ai i cili konsideron se nuk qëndron obligimi tek mu’mini të qeveriset sipas ligjeve të All-llahut xh.sh., të cilat ia ka shpallur Pejgamberit të Tij. Sepse, nuk ekziston kurrnjë popull i cili nuk dëshiron qeverisje të drejtë, e drejtësia tek ata mund të jetë ajo që parasheh drejtimi i tyre. Madje edhe shumë njerëz të cilët konsiderohen si myslimanë gjykojnë sipas zakoneve të tyre të cilat nuk kanë kurrfarë bazash në Librin e All-llahut xh.sh., siç është rasti me disa doke të beduinëve. Ata konsiderojnë se ky është ligj sipas të cilit duhet të gjykojnë, përpos Kur’anit dhe Sunnetit, e kjo gjithsesi është kufër. Sepse, shumë njerëz kanë pranuar Islamin, por gjykojnë sipas dokeve të ngulitura të cilat i urdhërojnë paritë e tyre. Ata, nëse kuptojnë se nuk u është lejuar të gjykojnë ndryshe pos me Kur’an, e edhe më tej mbeten në të, me këtë ata konsiderojnë se kjo është e lejuar dhe bëhen jobesimtarë.”³¹⁶

315 Kitabuz-zevaxhir an iktirafilkebair li Ibni Haxher el-Mekki, 1: 28-30. Shih edhe tekstin të ngjashëm me këtë edhe në Mugnil muhtaxh, 4: 135-136; Hashijetul Buxhuri, 2: 257.

316 Min menahixhis-sunne en-Nebevijje. Shih: Mexhmuatut-tevhid, f. 193.

Përkitazi me këtë temë komentuesi i Tahaviut thotë: “Këtu duhet të theksohet një gjë, e kjo është se gjykimi dhe qeverisja sipas ligjeve të cilat nuk i ka shpallur All-llahu xh.sh., mund të jetë kufër i cili nxjerrë nga imani, që varet nga situata në të cilën gjendet sundimtari. Nëse ai konsideron se gjykimi sipas ligjeve të cilat i ka shpallur All-llahu xh.sh. nuk është vaxhib dhe se ai mundet, e nuk është i obliguar, të gjykojë sipas tyre apo t’i përçmojë ato, edhe pse e di se janë nga All-llahu xh.sh., atëherë e tërë kjo është kufër i madh (i cili nxjerrë nga imani).”³¹⁷

Hafëz Ibni Kethiri, duke komentuar ajetin:

“A mos kërkojnë ata gjykimin e kohës së paganizmit?!” (El-Maide: 50), thotë:

“All-llahu xh.sh. e qorton atë që e le Ligjin e drejtë dhe të përsosur të All-llahut xh.sh., i cili në vete përmbanë çdo të mirë dhe pengon nga çdo e keqe, dhe merrë çkado qoftë tjetër nga mendimet, pasionet dhe terminet të cilat i kanë vënë njerëzit, pa u bazuar në ligjin e All-llahut xh.sh., ashtu siç kanë bërë edhe banorët e kohës së xhahilijetit (injurancës), të cilët gjykonin me llojlloj lajthitjesh dhe me mosdije, që i kanë trilluar vet, duke iu nënshtruar pasioneve të veta. Apo siç veprojnë tatarët me udhëheqjen e tyre mbretërore, të cilën e kanë marrë nga sundimtari i famshëm Çingiz-hani, i cili ka shkruar El-Jasikun - librin ku ka përmbledhur një numër të caktuar ligjesh dhe dispozitash të marrura nga ligjet e mëhershme të hebrenjve, të krishterëve, të Islamit etj. Shumicën e këtyre ligjive i ka përpiluar vetë ai sipas mendimit dhe tekeve të veta. Këto dispozita janë bërë ligj, me të cilin qeverisin pasardhësit e tij dhe të cilit i japin përparësi kundruall ligjit të Kur’anit dhe Sunnetit, andaj, kush nga mesi i tyre, e bënë këtë, gjithsesi bëhet kafir,

317 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 363-364.

kundër të cilit duhet të luftohet përderisa nuk i kthehet ligjit të All-llahut xh.sh. dhe të Pejgamberit të Tij, dhe përderisa nuk e aplikon atë në të gjitha sferat e jetës, si në ato të mëdhatë ashtu edhe në të imëtat.”³¹⁸

Sheh Ahmed Shakiri, në shënimin e vet përkitazi me fjalët e Ibni Kethirit thotë: “A mos vallë, edhe pranë kësaj, në Islam është e lejuar që myslimanët në shtetin e vet të gjykojnë sipas ligjeve të cilat janë marrë nga ligjet evropiane pagane ateiste? Nga ligjet ku ngërthehen ide dhe pasione të llojllojshme të cilat janë të pabaza, dhe ku, kurdoherë që dëshirojnë t’i ndryshojnë, e bëjnë këtë pa pasur kujdes a i përgjigjen ato dispozitave islame apo jo?

Myslimanët, në tërë historinë e tyre nuk kanë qenë të sprovuar me këtë lloj sprove, përderisa nuk patën ardhur tatarët, periudha e të cilëve ka qenë periudha më e errët dhe më e vështirë në historinë e myslimanëve, mirëpo edhe atëherë nuk iu kanë nënshtruar këtyre ligjeve. Porse Islami i mposhti tatarët dhe në fund i ngërtheu në ligjet e veta, kur edhe zhduket ajo që ata kishin sjellur me vete. E tërë kjo është arritur me qëndrueshmërinë e myslimanëve në fenë e tyre dhe në ligjet saj. Ky ligj i padrejtë ka qenë i imponuar nga pushteti i atëhershëm, mirëpo kurrnjë mysliman nuk është pajtuar me të, nuk e ka mësuar atë e as që ua ka mësuar fëmijëve atë, andaj për një kohë të shkurtër është zhdukur ndikimi i tij.

Shikoni vetëm këtë kritikë të ashpër të Ibni Kethirit - në shekullin e tetë - për këtë ligj joislam të cilin e ka futur armiku i All-llahu Çingiz-hani! A nuk po e shihni se kjo kritikë tërësisht i përket gjendjes së sotme të myslimanëve - në shekullin katëmbëdhjetë? Përpos një shekulli, që e

318 Tefsir Ibni Kethir, 2: 67.

përmendëm më herët dhe thamë se ai ka qen lidhur me një shtresë të caktuar njerëzish në atë pushtet që ishte paraqitur, e i cili për një kohë të shkurtër është ngërthyer në ummetin mysliman dhe së shpejti nuk ka mbetur kurrnjë gjurmë nga ajo që kishin bërë ata.

Pastaj, myslimanët e sotëm gjenden në situatë edhe më të vështirë, në fatkeqësi dhe në errësirë edhe më të madhe se ata të atëhershmit, ngase shumica e myslimanëve në botë gati sa nuk janë përmbytur tërësisht dhe i kanë pranuar ato ligje joislame, të cilat janë thuajse identike me atë të Jasikut - të cilin e pat përpiluar njeriu jobesimtar, kufri i të cilit ka qenë tërësisht i qartë. Këto ligje sot i përpilojnë dhe i ndërtojnë njerëzit, të cilët veten e konsiderojnë për myslimanë dhe të cilët sot i mësojnë fëmijët myslimanë, me çka mburren prindërit e tyre, dhe në fund edhe ata e pranojnë tërësisht këtë Jasik bashkëkohor duke i përqeshur ata të cilët nuk e pranojnë këtë, ndërsa ata që i thërrasin që t'i mbahen fesë së tyre dhe ligjit të saj, i quajnë të prapambetur, të pakulturuar dhe me shprehje të tjera negative të ngjashme me këto. Madje, edhe më tepër se kjo, ata i përziejnë duart e tyre dhe në atë që pak ka mbetur nga ligjet e Sheriatit dhe dëshirojnë që edhe këto t'ia përshtatin Jasikut të tyre të ri, ngandonjëherë gradualisht dhe ngadalë e ngandonjëherë në mënyrë të poshtër dhe perfide, e shpeshherë me dhunë të cilën ua lejon pushteti i tyre. Dhe haptas, pa kurrfarë turpi thonë se po e ndajnë fenë nga shteti!

A mos vallë, pas kësaj cilido mysliman e ka të lejuar ta pranojë këtë fe të re të tyre - këtë ligj të ri?!

A mos vallë, është e lejuar që njeriu mysliman ta pranojë këtë gjyqtari nën hijen e “Jasikut bashkëkohor” dhe të sjellet sipas tij, duke e braktisur Sheriatin e vet të qartë e të drejtë?

Mendoj se nuk ekziston kurrnjë mysliman, i cili e njeh fenë e vet dhe i beson asaj me të gjitha hollësitë e saj, i cili beson se këtë Kur'an All-llahu xh.sh. ia ka shpallur Pejgamberit të Tij dhe se

është i ruajtur në tërësi nga çfarëdo gabimi, se ndëgjesa ndaj Tij dhe ndaj Pejgamberit i cili ka ardhur me të është obligim i rreptë në çdo situatë, mendoj se ky mysliman nuk do të mundet, e që lirisht mos të konkludojë, pa kurrfarë hamendje, se shërbimi në këtë rast konsiderohet i parregullt dhe i pavlefshëm dhe ai assesi nuk mund të pasohet e as të lejohet.

Çështja rreth këtyre ligjeve njerëzore (joislam) është tërësisht e qartë - ato shpiejnë në kufër të hapët në të cilin nuk ka aspak dyshim. Dhe askush, që i thotë vetes se i takon Islamit, kushdo që të jetë ai, nuk ka arsytim nëse vepron sipas tyre, i nënshtrohet atyre dhe sjellet sipas tyre. Dhe çdonjëri le të ruhet nga kjo, ngase çdonjëri do të përgjigjet për veprat e veta.”³¹⁹

3 - Sheh Ahmed Shekiri gjithashtu, përkitazi me ata që mohojnë dënimin sheriatik për vjedhje, thotë: “Kjo është dispozitë e All-llahut xh.sh. për vjedhje dhe nuk ka aspak dyshim në autenticitetin dhe domethënien e tij. Ndërsa Resulull-llahu s.a.v.s. e ka vërtetuar këtë dispozitë duke e zbatuar në praktikë dhe duke iu nënshtruar kështu All-llahut xh.sh. dhe urdhrit të Tij. Vjedhësit, qoftë ai mashkull apo femër, i prehet dora, dhe këtu nuk ka aspak dyshim, ngase Muhammedi a.s. ka thënë: “Beto hem me All-llahun që sikur të vidhte Fatimja, e bija e Muhammedit, unë sigurisht do t’ia preja dorën”.

Shih vetëm se çka kanë bërë prej nesh armiqtë tanë, misionarët të krishterë dhe kolonizatorët! Kanë bërë tallje me fenë tonë - neve na kanë imponuar ligjet e veta pagane me të cilat e kanë abroguar ligjin e All-llahut xh.sh. dhe të Pejgamberit të Tij, e pastaj i kanë arsimuar disa njerëz

319 Umdetut-tefsir - ihtijar ve tahkik Ahmed Muhammed Shakir, tab’atu daril me’arif senete 1377/1957, 2: 171-172.

prej nesh, të cilët ende konsiderohen të tanët, dhe zemrat e tyre i kanë mbushur me urrejtje ndaj këtij ligji dhe në gjuhën e tyre e kanë vënë fjalën kufër: ky ligj është tejet i ashpër dhe nuk i përgjigjet kohës sonë bashkëkohore, kohës së civilizimit të shfrenuar. Ata këtë dispozitë islame e kanë marrë si lëndë talljeje dhe poshtërimi, që ka rezultuar me atë që me qindramija vjedhës t'i mbushin burgjet, vetëm në shtetin tonë, për shkak të ligjeve të tyre të cilat i kanë caktuar përkitazi me vjedhje, e të cilat assesi nuk e pengojnë këtë e as që do të arrijnë ta pengojnë ndonjëherë, e as që do të bëhet ilaç për këtë sëmundje të përhapur anembanë.

Pastaj në trurët e shtresës së njerëzve të arsimuar, e posaçërisht të atyre që janë përgjegjës për këto ligje pagane, kanë futur, si e quajnë ata - psikologjinë, e cila nuk është kurrfarë shkence e as që i përngjanë asaj, porse përmbahet nga epshet dhe rrebet kontradiktore. Çdo kryetar, nga kryetarët e kufrit në këtë fushë posedon mendimin e vet me të cilin e rrëzon mendimin e kundërshtarëve të tij. Pastaj gjatë aplikimit të ligjit në psikologji, kërkojnë arsyetim për çdo vjedhës siç u konvenon atyre. Pastaj çështja është keqësuar edhe më, e kanë filluar që vetë vjedhësit të shkruajnë libra me të cilat përpiqen t'i arsyetojnë krimet e veta, ndërsa të tjerët kanë filluar t'i mbrojnë ata, duke marrë kështu qëndrim i cili do t'i shpie në zjarr të përherëshëm. Ata e dinë se krimi është bërë, megjithatë as që orvaten ta kritikojnë dhe ta dënojnë këtë vepër, por përpiqen që ta zbusin duke studiuar gjendjen psikike të kriminelit dhe rrethanat nën të cilat e ka bërë këtë!!

Kam polemizuar me shumë madhorë të tyre dhe kam ardhur në përfundim se ata nuk kanë kurrfarë arsytimi, përveç asaj që thonë se dispozita kur'anore përkitazi me këtë çështje nuk i përgjigjet kohës së sotme!!! Dhe thonë se vjedhësi është njeri i sëmur të cilin duhet shëruar, e jo ndëshkuar, duke i harruar fjalët e All-llahut xh.sh. përkitazi me këtë dispozitë:

“Vjedhësit dhe vjedhëses këputjuani duart e tyre, për ndëshkim të asaj që kanë punuar - (kjo masë është) dënim nga All-llahu.” (El-Maide: 38).

All-llahu xh.sh. është Krijues i të gjitha krijesave dhe Ai më së miri i njeh ato. Ai është i Fuqishëm dhe i Urtë, andaj këtë ndëshkim e jep si vërejtje dhe masë për ta frenuar vjedhjen. Ky është tekst i qartë kur’anor, e si mund të veprojnë ndryshe nga kjo? Kjo çështje, tek ne myslimanët, bën pjesë në thelbin e akaidës dhe të imanit. Ndërsa ata, që konsiderohen myslimanë dhe mohojnë ndëshkimin që vjedhësit t’i prehet dora, do t’i pyetnim: “A besoni ju në All-llahun xh.sh. dhe se Ai ka krijuar çdo gjë që ekziston?” Ata do të përgjigjen: “Po!” “A besoni ju se Ai e di se çka ka ndodhur përpara dhe çka do të ndodhë në të ardhmen, se Ai di më tepër për krijesat sesa ato për veten e tyre dhe e din se çka është e dobishme për ta e çka e dëmshme?” Ata do të përgjigjen: Po!” “A besoni ju se Ai e ka dërguar Pejgamberin e Tij Muhammedin a.s. me Udhëzim dhe me Fe të vërtetë dhe se atij ia ka shpallur Kur’anin si udhëzim dhe udhërrëfyes për njerëzit, se si ta rregullojnë jetën e tyre edhe në fe edhe në dynjallëk?” Do të thonë: “Po!” “A besoni se ky ajet: “Vjedhësit dhe vjedhëses këputjuani duart e tyre” (El-Maide: 38), është pjesë e Kur’anit?” Do të thonë: “Po!” E, përse atëherë ktheheni nga ky. Cilit ligj ju i përmbaheni kështu?!”

E, për sa u përket atyre që veten e konsiderojnë mysliman, e në cilëndo prej këtyre pyetjeve përgjigjen negativisht, me ta kemi mbaruar dhe e dimë se çfarë përfundimi do të kenë ata. Sepse, çdo mysliman, qoftë i arsimuar ai apo jo, është i vetëdijshëm se, ai i cili përgjigjet negativisht në cilëndo nga këto pyetje, ka dalur nga Islami dhe ka ra në ambiset e renegimit nga feja. Ndërsa, me ata që nuk janë myslimanë dhe të cilët nuk e konsiderojnë veten myslimanë, me ta nuk do të hyjmë në polemikë përkitazi me këtë çështje dhe nuk do të japemi pas përrallave të tyre, ngase ata

nuk e besojnë atë që besojmë ne, dhe ata nuk do të jenë të kënaqur me ne përderisa nuk fillojmë të flasim njësoj sikurse ata. E lusim All-llahun xh.sh. që të na mbrojë nga kjo!

E, sikur ata, që konsiderohen myslimanë, të kishin pak mendje, do ta kuptonin se disa duar të prerë të vjedhësve për çdo vit, do të ishte shpëtim për tërë shtetin nga invadimi i hajnisë. Dhe gjatë një viti do të ndodhnin vetëm disa vjedhje, që do të paraqiste rrallësi të madhe, ndërsa burgjet do të zbrazeshin nga qindamija njerëzish, të cilët këto vende i kanë shndërruar në shkolla juridike për specializim në të gjitha llojet e krimeve. Sikur ta kuptonin këtë, ata edhe do ta pranonin këtë dhe do ta zbatonin në praktikë, por, ata mbeten të mënjanuar në batillëkun e tyre, në mënyrë që me ta të jenë të kënaqur zotërinjtë dhe mësuesit e tyre. Mirëpo ata, megjithatë, kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ta.³²⁰

4 - Një nga fetvatë e rëndësishme përkitazi me çështjet e sekteve, të cilat kanë reneguar nga feja islame, është fetvaja e Ibni Tejmijut r.a. me të cilën është përgjigjur në pyetjen mbi nusajrijët, që thotë: “Qoftë falënderuar All-llahu, Sunduesi i të gjithë botëve! Sekti, pjesëtarët e të cilës quhen nusajrijë dhe grupet e tjera të karamitëve batinijë, janë në kufër më të madh sesa hebrejët dhe të krishterët, madje edhe se shumica e mushrikëve. Dëmi i tyre për ummetin e Muhammedit a.s. është shumë më i madh sesa dëmi që shkaktojnë jobesimtarët, armiqtë tanë të hapët, siç janë kafirat nga mesi i tatarëve, evropianëve etj. Ngase, këta para myslimanëve të rëndomtë prezentohen si adhurues të mëdhenj të ehli Bejtit, e ata aspak nuk e besojnë All-llahun xh.sh., as Pejgamberin e Tij, as Librin e Tij, e as që i besojnë ndonjë urdhri apo ndalesë të All-llahut xh.sh., as ndëshkimit dhe shpërblimit, as Xhennetit dhe Xhehennemit, as Pejgamberët para

320 ‘Umudetut-tefsir, 4: 164-167.

Muhammedit a.s., e as ndonjë fe të përparshme. Ata i marrin fjalët e All-llahut xh.sh. dhe të Pejgamberit të Tij, të cilat u janë të njohura të gjithë myslimanëve, e pastaj i komentojnë ato në mënyrën e vetë arbitrare, duke tentuar të argumentojnë korrektësinë e gjërave të cilat i trillojnë ata dhe konfirmojnë se ato janë nga ‘ilmul batini - nga gjërat esenciale. Ata, assesi nuk kanë kufij në kufër të cilin e favorizojnë përkitazi me cilësitë e All-llahut xh.sh. dhe me ajetet e Tij, duke i shtrembëruar fjalët e All-llahut xh.sh. dhe të Pejgamberit të Tij.” E pastaj ka thënë: “ E kemi të njohur se viset bregdetare të Shamit i kanë pushtuar të krishterët, të cilët janë gjithnjë të bashkuar me çdokend që është armik i myslimanëve, dhe e dimë se nusajrijët i ndihmojnë ata kundër myslimanëve. Dhe e dimë se një prej anktheve më të mëdha për ta është fitorja e myslimanëve kundër tatarëve, ndërsa ndër festat më të mëdha të tyre janë ditët kur të krishterët pushtojnë ndonjë qytet kufitar të myslimanëve. Këta armiq të All-llahut xh.sh. dhe të Pejgamberit të Tij janë shumuar në viset bregdetare, të cilat, menjëherë pas kësaj, i pushtuan armiqtë, e pastaj me sebebin e tyre e pushtuan Kudsi sherifin dhe qytet e tjera. Është e njohur se ata kanë qenë shkaktarët kryesor për tërë këtë. Pastaj All-llahu xh.sh. i dhurojë ummetit të Vet muxhahidë siç janë shehidët Nuruddini dhe Salahuddini dhe pasuesit e tyre, të cilët i çliruan këto vise bregdetare nga të krishterët dhe nga nusajrijët të cilët ishin me ta. Pastaj e çliruan Egjiptin, pasi që ata (nusajrijët) sunduan me të rreth 200 vjet në bashkëpunim të ngushtë me të krishterët, e myslimanët ndërmorrën xhihad kundër tyre dhe i mposhtën ata.

Gjithashtu është e njohur se tatarët kanë hyrë në Bagdad dhe e kanë mbytur kalifin dhe udhëheqësit e tjerë myslimanë, më së tepërmi duke i falënderuar ndihmës dhe mbështetjes së tyre.

Ata emërtohen me ofiqe të njohura tek myslimanët. Ndonjëherë i quajnë “melahidë” - ateistë, ndonjëherë karamitë, ndonjëherë batinijë, ndonjëherë isma’ilijë, ndonjëherë el-huremijë, e

ndonjëherë el-muhammere. Disa prej këtyre ofiqeve i përkasin të gjithë atyre, e disa i përkasin vetëm ndonjërit prej sektit të tyre. Dhe nuk ka dyshim se ndërmarrja e xhihadit ndaj tyre dhe aplikimi i Ligjit të All-llahut ndaj tyre, është një ndër veprat më të dashura për All-llahun xh.sh. dhe një nga obligimet më të mëdha të çdo myslimani. Ky xhihad është më i mirë se xhihadi kundër mushrikëve dhe kitabijëve, të cilët nuk luftojnë kundër myslimanëve. Sepse, xhihadi kundër tyre është një lloj i xhihadit kundër renegatëve të fesë. Ndërsa, Ebu Bekri r.a. dhe të tjerët kanë ndërmarrë xhihadin kundër renegatëve para xhihadit kundër jobesimtarëve nga kitabijët, ndërsa dëmi prej këtyre për myslimanët është shumë më i madh sesa dëmi nga të tjerët. Çdo mysliman është i obliguar të ndërmerre çkado që të mundet në këtë fushë. Askush nuk e ka të lejuar të fshehtë diç që kupton për ta, por është i obliguar që këtë t'ua tregojë myslimanëve të tjerë, në mënyrë që të gjithë ta dinë të vërtetën e pastër për ta. Dhe askujt nuk i është lejuar të hesht nëse askush nuk lufton kundër tyre. E, ai që ndihmon në luftë kundër të keqës së tyre ose për udhëzimin e tyre, do të ketë shpërblim tek All-llahu xh.sh. çfarë nuk e di askush përveç All-llahut xh.sh.³²¹

KUJDESI PËRKITAZI ME SHPALLJEN E DISA PERSONAVE PËR KAFIR

Komentuesi i akaidës së Tahaviut thotë:

321 Mexhmu'u fetava Ibni Tejmijje, 25: 149 e tutje.

“Përkitazi me fjalët e trilluara, të parregullta dhe të shtrembëruara, të cilat në vete permbajnë mohimin e asaj që ka pohuar All-llahu xh.sh. ose Pejgamberi i Tij, apo konfirmimin e asaj që ata kanë mohuar, urdhërimi i asaj që është e ndaluar, apo ndalimi i asaj që është urdhëruar - përkitazi me këto gjëra duhet të thuhet e vërteta dhe të afirmohet kërcënimi i cili vihet në pah nga Kur’ani ose Sunneti. Duhet të sqarohet se ato janë kufër e të ngjashme. E, për sa i përket njeriut të caktuar, nëse bëhet pyetja se a është ai të cilit i përket ky kërcënim dhe se a është ai kafir, ne për të nuk mund të themi asgjë që është në kundërshtim me kelimeit shehadetin. Sepse, një prej mëkateve më të mëdha është të pohohet për një person të caktuar duke e emërtuar atë se All-llahu xh.sh. nuk do ta falë dhe nuk do ta mëshirojë atë, porse do të qëndrojë përgjithmonë në zjarr, ngase ky është gjykim i cili vlenë për jobesimtarët pas vdekjes së tyre.³²² Sepse personi në fjalë mund të bëhet muxhtehid që ka gabuar, por All-llahu xh.sh. ia ka falur. Mund të jetë njeri gjer tek i cili nuk kanë arritur argumentet përkatëse, e mund të jetë edhe njeri me iman të fortë dhe i cili ka bërë mjaftë vepra të mira, për të cilat All-llahu xh.sh. do t’ia falë, siç ia ka falur atij që ka thënë: “Kur të vdes, ju ma thërrmoni kufomën time dhe shkapërderdhne atë!”, e All-llahu xh.sh. ia ka falur për shkak të frikës së tij nga ndëshkimi.³²³

Mirëpo, ky kujdes i ynë përkitazi me statusin e tij në Ahiret, nuk na pengon ta ndëshkojmë atë në këtë botë, në mënyrë që të pengohet risia (bid'ati) i tij me të cilin ka ardhur, dhe të kërkojmë prej tij pendesë, e nëse nuk dëshiron ta bëjë këtë, atëherë duhet ta mbysim. E, nëse fjalët që i ka

322 Don të thotë se kjo është çështje të cilën e njih vetëm All-llahu xh.sh., e jo edhe njerëzit.

323 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 17: 72.

shqiptuar, vetvetiu paraqesin kufër, për to do të themi se janë kufër dhe se ai i cili i shqipton këto bëhet kafir nën kushtet e caktuara - nëse për ato nuk ka arsyetim.”³²⁴

Prej këtu, shihet qartë se duhet të jemi të kujdesshëm në shpalljen për jobesmtar një person të caktuar. Këtu ekzistojnë disa gjëra të rëndësishme të cilat duhet të mirren parasysh gjatë bisedës mbi gjërat të cilat nxjerrin nga imani:

1 - Ekzistojnë shumë gjëra që janë në kundërshti me kelimeit shehadetin, për arsye se ato janë të përkundërta me imanin në All-llahun xh.sh. ose janë të përkundërta me besimin në Resulull-llahun s.a.v.s. dhe me atë me çka ka ardhur ai. Çdo mysliman i cili kupton diç përkritazi me këto gjëra, është i obliguar të tërheqë vërejtjen për këto dhe të thirret në argumentet e Kur’anit dhe të Hadithit duke i shpjeguar rregullat dhe obligimet lidhur me gjësendin e caktuar, kuptohet në kufijtë e dijenisë së tij dhe të aftësive të tij. Sepse, kjo bënë pjesë në interpretimin dhe sqarimin e fesë, dhe në urdhërin në vepra të mira dhe ndalimin nga të këqijat, e kush e bënë këtë, do të ketë shpërblim të madh tek All-llahu xh.sh., po qe se e ka njetin e pastër.

2 - Gjërat të cilat nxjerrin nga imani dallohen sipas fuqisë së tyre që tregojnë në kufër. Disa prej tyre tregojnë drejtpërdrejt në kufër e disa tërthorazi, që jipet të kuptohet nga vetë fjalët. Lloji i dytë përfshinë gjërat të cilat vërehen shumë lehtë dhe ato të cilat kërkojnë kujdesë dhe shqyrtim më të madh. Ai i cili bën diç nga grupi i parë, për të mund të thuhet se është kafir dhe për këtë nuk ka arsyetim, përpos në rast dhune, të cilën tanimë e kemi sqaruar, dhe me kusht që kjo të kufizohet vetëm në shqiptim me gjuhë, e assesi edhe me zemër. Rasti i njëjtë është edhe me ato

324 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 357-358.

gjëra të cilat janë më afër llojit të dytë, siç është bie fjala që dikush të konfirmojë për vete se është zot, ngase kjo do të thotë se ai i përshkruan shok All-llahut xh.sh., edhe pse nuk e ka mohuar hyjninë e All-llahut xh.sh. Rasti i njëjtë është edhe me atë që vetit i përshkruan ndonjë cilësi të All-llahut xh.sh., si për shembull dikush tua ndalojë apo tua lejojë diç njerëzve (legjisllacioni), ose dikush të konsiderojë se materia është e përherëshme (pa fillim e mbarim), prej çka rezulton se All-llahu xh.sh. nuk e ka krijuar atë, ngase kjo assesi nuk mund të kuptohet ndryshe. Edhe kjo është, sipas fuqisë së vet, e barabartë me kufrin e hapur. Siç është bie fjala rasti i atij që i thotë dikujt i cili mohon ekzistimin e All-llahut xh.sh.: “e ke thënë të vërtetën”, ose “kjo është e vërtetë”, ngase ky pajtim tregon në kufër njësoj sikurse fjalët e mohuesit. Treguesi i fuqisë së të treguarit në kufër mund të jetë edhe dukuria e veprave dhe fjalëve që përsëriten shpeshherë nga anë e një personi të caktuar, të cilat nxjerrin nga imani për shkak të ngulmimit në to. Këtu bënë pjesë edhe ngulmimi i njeriut në miqësimin me jobesimtarët dhe shpeshësia e veprave nga ana e tij të cilat tregojnë sheshit këtë. Është e gjithënjohur se është e pamundur të gjendet arsyetimi për njeriun i cili gjatë tërë jetës së vet bënë vepra dhe shqipton fjalë të cilat shpiejnë në kufër apo tregojnë se është i kënaqur me të.

E, për sa i përket atij i cili hynë në kufër me diç që nënkuptohet nga fjalët apo nga veprat e tij, apo bën diç që rezulton kufrin, në këtë rast duhet pasur kujdes, duke qenë se ato i përkasin njeriut të caktuar. Kujdesi duhet të jetë gjithnjë e më i madh varësisht nga domosdoshmëria e kufrin që rezulton nga gjërat e bëra apo të thëna, të cilat e zvoglojnë kufrin apo largojnë nga kufri.

Në këto raste do të mirren parasysh të gjitha rrethanat e lidhura ngusht me rastin përkatës.³²⁵ Këto raste mund t'i shqyrtojnë vetëm ata që janë përgjegjës për gjyqtari dhe pushtet në shtetet islame. Të japim një shembull përkitazi me këtë:

Nëse dikush gjuan në pleh (nexaset) çkadoqoftë nga Kur'ani, ky veprim i tij, pa marrë parasysh se kush e ka bërë këtë, sipas mendimit të tërë ulemasë, personin e shpien në kufër. Ngase nga ky akt domosdo rezulton se ky njeri i ka përçmuar fjalët e All-llahut xh.sh. Dhe ai që e sheh këtë ka të drejtë të thotë se kjo është vepër e kufrit, porse ai nuk guxon ta shpall njeriun për kafir, përderisa nuk i kupton dy gjëra: a e ka ditur ai, se ajo që e ka gjuajtur është pjesë e Kur'anit dhe a e ka ditur se atë e ka gjuajtur në nexaset? E nëse e kupton këtë, kështu që bie fjala, personi në fjalë pohon se i di të gjitha, vetëm atëherë mund ta konsiderojë atë për kafir. Por mund të ndodhë që ai njeri të jetë analfabet dhe se nuk e ka ditur se çka ka gjuajtur dhe se nuk është i vetëdijsëm se në çfarë vendi e ka gjuajtur atë. Në këtë rast, ky do të ishte tregues i hapët se ky njeri nuk ka pasur për qëllim ta poshtëron Kur'anin, andaj këtij i falet ky mëkat.

Prandaj është nevoja të kihet kujdes gjatë shpalljes të ndonjë personi të caktuar për kafir, përpos nëse bën diç që është kufër i hapët e që assesi nuk mund të komentohet ndryshe, porse qëndron obligimi që t'i tërhiqet vërejtja për të gjitha fjalët dhe veprat që bëhen pa ndonjë arsye të pranueshme e që shpiejnë në kufër.

3 - Ekzistojnë dy rregulla të rëndësishme, të cilat kanë të bëjnë me atë që bën kufër. Rregulli i parë i përket dynjallëkut: të aplikohen të gjitha dispozitat e ligjeve të Sheriatit përkitazi me

325 Ibni Haxher El-Hejtemi: Ez-Zevaxhir 'an iktirafil kebair, 1: 28.

çështjen e personit në fjalë, të cilat bazohen në atë që duket qartë nga veprat e personit gjegjës, pa hulumentimin e asaj se çka fshihet në zemrën e tij. Siç është ekzekutimi i renegatit, nëse nuk pendohet, shkurorëzimi mes tij dhe gruas së tij, ndalimi i ngrënies së mishit nga kafsha që e thërë ai, ndalese të martohet ndonjë grua më të etj. Të gjitha këto janë të lidhura me rregullat njerëzore në këtë botë dhe këto aplikohen ndaj personit të caktuar. Disa prej këtyre rregullave bien nën kompetencën e imamëve (sundimtarëve islam), siç është kërkimi i pendesës dhe ekzekutimi. Rregulli i dytë i përket Ahiretit: renegati nga feja meriton vuajtjen e përhershme në zjarrin e Xhehennemit. Kësi vendimi dhe zbatimin e tij ndaj personit që e meriton këtë, mund të marrë dhe të lejojë vetëm All-llahu xh.sh. E, në këtë nuk mund ta dimë në këtë botë, ngase kjo assesi nuk është në kompetencë të njerëzve. Prandaj askush në botë nuk mund të konfirmojë se dikush e ka vendin në Xhennet apo në Xhehennem. Përveç atyre (Pejgamberëve), të cilëve All-llahu xh.sh. ua ka zbuluar diç nga kjo, siç është rasti i Resulull-llahut s.a.v.s. që dhjetë vetë nga as'habët e tij i ka përgëzuar me Xhennet. Apo siç janë ata për të cilët flet Kur'ani se janë banorë të Xhehennemit, dhe për të cilët ka thënë Resulull-llahu s.a.v.s. Shembulli për këtë është Ebu Lehebi, për të cilin flet edhe Kur'ani.

Në kemi të drejtë të themi përgjithësisht: kush e mohon All-llahun, ose renegon nga feja e tij, ai do të qëndrojë përgjithmonë në zjarr dhe atij i është ndaluar Xhenneti. Këtu duhet të ndalet myslimani dhe nuk guxon të shkojë më tutje, ngase në të kundërtën do të kalojë kufirin dhe do të bëhet i padrejtë dhe zullumqar. Tanimë kemi përmendur se çka thotë përkitazi me këtë

komentuesi i akaidës së Tahaviut, e vetë Tahaviu r.a. ka thënë: “Dhe për asnjërin prej tyre nuk themi se do të hyjë në Xhennet apo në Xhehennem.”³²⁶

FJALA PËRFUNDIMTARE QËNDRIMI ISLAM NDAJ MËKATARËVE VETË MËKATI NUK NXJERRË NGA FEJA E ALL-LLAHUT XH.SH.

Tanimë i kemi cituar fjalët e Tahaviut r.a.: “Dhe ne nuk themi për asnjërin pjesëtarë të kiblës sonë se është jobesimtar për shkak të mëkatit që e ka bërë, nëse nuk e konsideron të lejuar. Dhe ne nuk do të themi: Njeriut me iman nuk i bën dëm kurrfarë mëkati.”

Imam Neveviu r.a. thotë: “Dije mirë se qëndrimi i ehli Sunnetit dhe i dashamirëve të së vërtetës nga gjeneratat e mëparshme dhe e tanishme është se, ata që vdesin duke besuar All-llahun xh.sh. dhe duke mos i përshkruar Atij shok, me siguri dhe në çdo rast do të hyjë në Xhennet. E, nëse është i pastër nga mëkatet, siç është i mituri, i çmenduri i cili është çmendur para moshës madhore, pendestari me tevbe të sinqertë nga shirku dhe mëkatet e tjera, nëse nuk bënë më mëkate pas tevbës së vet dhe ai të cilin All-llahu xh.sh. e ka dhuruar që assesi të mos bëjë mëkate - të gjithë këta do të hyjnë në Xhennet pa e shijuar Xhehennemin, me kusht që edhe ata do të kalojnë përmbi të, krahas mospajtimeve përkitazi me këtë çështje. Ndërsa, mendimi më i saktë

326 El-Akidetut-Tahavijje me’a sherhiha, f. 466.

është ai që parasheh, se ky kalim do të bëhet përmes urës e cila do të vihet përmbi Xhehennem, e All-llahun xh.sh. e lusim që të na mbrojë prej tij dhe prej mynxyrave të tjera. Ndërsa, për sa i përket atyre që kanë mëkate e vdesin para se të pendohen, ata do të jenë në mëshirën e All-llahut xh.sh. - nëse dëshiron do t'ua falë dhe menjëherë do t'i shpie në Xhennet sikurse edhe ata të parët, e nëse dëshiron, do t'i ndëshkojë aq sa don Ai Vet, në pajtim me mëkatet e tyre, dhe pastaj do T'i shpie në Xhennet. Pra, askush prej atyre që vdesin me tevhid nuk do të qëndrojë përgjithmonë në Xhehennem, sado që të jenë mëkatet e tyre. Sikurse edhe që nuk do të hyjë në Xhennet ai i cili vdes si jobesimtar, sado që të ketë vepra të mira. Ky është shkurtimisht qëndrimi i dashamirëve të së vërtetës përkitazi me këtë çështje. Ekzistojnë shumë argumente nga Kur'ani dhe Sunneti dhe nga koncenzusi (harmonizimi) i ulemasë islame që konfirmojnë vërtetësinë e këtij parimi. Këto argumente të shumta nga Kur'ani dhe Sunneti të cilat janë transmetuar me tevaturo, janë burime të njohurisë pakontestuese përkitazi me këtë çështje. Duke qenë se tashmë konfirmuam këtë parim, atëherë do ta marrim secilin hadith që ka të bëjë me këtë çështje si vërtetim të kësaj.³²⁷ E, nëse hasim në ndonjë hadith, i cili në shikim të parë do t'i kundërvihet këtij parimi, jemi të obliguar ta komentojmë në harmoni me këtë, në mënyrë që kështu t'i harmonizojmë argumentet shariatike.”³²⁸

327 Kësaj teme Neveviu i përkushton një kapitull të tërë me titull Bab: Ed-dellil ‘ala enne men mate ‘alet tevhidi dehalel xhennete kat’an.

328 Shih: Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 1: 217-220; Gjithashtu edhe fjalët të ngjashme me këto në: Lish shejh Ibni Tejmijje fil Furkan min mexhmu’atit tevhid, f. 506-507.

Pra, ai cili vdes me iman, pasi që me zemër të sinqertë ta ketë shqiptuar shehadetin, me siguri do të hyjë në Xhennet, e në zjarr nuk do të qëndrojë përgjithmonë, pa marrë parasysh se sa kanë qenë mëkatet e tij, nëse ato nuk i konsideron të lejuara, apo nëse nuk mohon diç nga gjërat e gjithënjohura, apo nëse nuk bënë diç që e anulon kelimeit shehadetin, për çka do të flasim hollësisht. Pra, vetë gabimi nuk është argument i anulimit të kelimeit shehadetit dhe nuk është shkak për qëndrimin e përhershëm në zjarrin e Xhehennemit.

Në këtë parim, na udhëzojnë shumë hadithe të cilat flasin për atë se Xhenneti është vendbanimi përfundimtar i të gjithë atyre që me zemër të sinqertë deklamojnë kelimeit shehadetin, ngase me këtë ata tregojnë se kanë pranuar tevhidin dhe Resulull-llahun s.a.v.s. me tërë atë me çka ka ardhur ai. Disa prej këtyre haditheve tregojnë qartë se edhe mëkatet e mëdha vetvetiu nuk janë shkas për moshyrje në Xhennet në fund, edhe nëse besimtari ndëshkohet për këtë.

Ja disa hadithe përkitazi me këtë:

1 - Transmetohet nga Uthmani r.a. se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Kush vdes duke besuar se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, do të hyjë në Xhennet.”³²⁹

2 - Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se unë jam i Dërguari i All-llahut, janë fjalë të cilat çdonjërin do ta shpiejnë në Xhennet, nëse me to takohet me All-llahun xh.sh. duke mos dyshuar aspak në to.”³³⁰

329 Sahih Muslim me’a sherhin Nevevi, 1: 218.

330 Sahih Muslim me’a sherhin Nevevi, 1: 224.

3 - Transmetohet nga Ubade b. Samiti se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Kush thotë: “Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, i Vetmi që nuk ka shok, dhe se Muhammedi është rob dhe i Dërguar i Tij, se Isai është rob, i biri i robëreshës së Tij dhe se është Fjala e Tij që ia dërgoi Merjemës, dhe i frymëzoi jetën, dhe se Xhenneti dhe Xhehennemi janë të vërtetë, All-llahu do ta fusë në Xhennet, përmes cilës derë dëshiron vetë prej tetë dyerve të tij” Në një rivajet tjetër qëndron: “Do ta futë në Xhennet sado që të jenë të vogla veprat e tij.”³³¹

4 - Transmetohet nga El-Abbas b. Abdul-Muttalibi r.a. se e ka dëgjuar Resulull-llahun s.a.v.s. duke thënë: “Ëmbëlsinë e imanit e ka shijuar ai i cili është i kënaqur me All-llahun si me Zot të vet, me Islamin si me fe të vet dhe me Muhammedin si me Pejgamber të vet.”³³²

5 - Banorët e Xhennetit do të hyjnë në Xhennet, e banorët e Xhehennemit do të hyjnë në Xhehennem, pastaj All-llahu xh.sh. do të thotë: “Nxirrne prej aty çdonjërin në zemrën e të cilin ka iman madje edhe sa një kokërr sinapi (bimë barishtore që bën fara të vogla)”³³³

6 - Transmetohet nga Ma'rur b. Suvejdi se ka thënë: E kam dëgjuar Ebu Dherrin duke transmetuar se e ka dëgjuar Resulull-llahun që ka thënë: “Më erdhi Xhibrili dhe më sjelli një lajm të gëzuar duke thënë se, kush vdes prej ummetit tënd duke mos i shoqëruar All-llahut asgjë, do të hyjë në Xhennet”. E unë i thashë: “A edhe nëse ka bërë prostitucion (zina) dhe nëse ka vjedhë?” Ai u përgjigj: “Edhe nëse ka bërë prostitucion dhe ka vjedhë.”³³⁴

331 Sahih Muslim me'a sherhin Nevevi, 1: 227. E transmeton edhe Buhariu në kaptinën mbi Pejgamberët.

332 Sahih Muslim me'a sherhin Nevevi, 2: 2.

333 Mutfekun alejhi, vel lafzu lil Buhari. Sahihu-l-Buhari, 1: 61; Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 3: 36.

334 Mutfekun alejhi, vel lafzu lil Muslim, 2: 94; Sahihu-l-Buhari, kaptina mbi xhenazen.

Imam Neveviu duke komentuar këtë hadith thotë: “Për sa i përket sentencës së Resulull-llahut s.a.v.s. se ai që vdes në shirk do të hyjë në Xhehennem, e ai që vdes duke mos bërë shirk do të hyjë në Xhennet, me këtë janë në pajtim të gjithë myslimanët. Për sa i përket hyrjes së mushrikëve në Xhehennem, kjo ka të bëjë me të gjithë mushrikët përgjithësisht - ata do të hyjnë në të ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Dhe këtu nuk ka dallim mes kitabijëve, hebrenjve apo të krishterëve dhe mes idhujtarëve dhe jobesimtarëve të tjerë. Dhe sipas dashamirëve të së vërtetës nuk ka dallim mes atij që beson nga inati dhe të tjerëve, e as ndërmjet atyre që janë në drejtim të kundërt të myslimenëve dhe atyre që i përshkruhen Islamit, porse është konstatuar se ata kanë bërë kufër në çfarëdo mënyre qoftë. E për sa i përket hyrjes në Xhennet të atij që nuk ka bërë shirk, kjo është po ashtu gjë e paprekshme. Mirëpo, nëse ka bërë mëkate të mëdha dhe nuk ka vdekur me to pa kërkim ndjese, do të hyjë në Xhennet menjëherë, e nëse ka bërë mëkate të mëdha dhe ka vdekur me to para se të pendohet, ai do të jetë në mëshirën e All-llahut xh.sh. - nëse ia falë, do të hyjë në Xhennet, e nëse jo, do të jetë i ndëshkuar me zjarr, e pastaj do të nxjerret nga ai e do të hyjë në Xhennet ku do të qëndrojë përgjithmonë. E për sa i përket fjalëve të Resulull-llahut s.a.v.s.: “Edhe nëse ka bërë prostitucion dhe ka vjedhë.” Këto janë argument për qëndrimin e ehli Sunnetit se nuk mund të konfirmohet se mëkatarët doemos do të hyjnë në Xhehennem dhe se ata edhe nëse hynë, do të dalin prej aty dhe do të përfundojnë në Xhennet përgjithmonë.”³³⁵

E, për sa i përket haditheve për të cilat Neveviu ka thënë: “Nëse dëgjojmë ndonjë hadith që është në kundërshtim me parimin e përmendur, jemi të obliguar ta kumntojmë në dritën e atij parimi në mënyrë që t’i harmonizojmë argumentet shariatike”, ato mund të klasifikohen në disa lloj. Një

335 Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 2: 97.

numër prej tyre sipas domethënies origjinare tregojnë sheshit se njeriu i cili bën disa nga mëkatet e mëdha të caktuara del nga imani. Grupi tjetër i haditheve përmbanë heqjen dorë të Pejgamberit të All-llahut nga ai i cili bënë diç nga mëkatet e mëdha të caktuara dhe grupi i tretë i haditheve përmbanë disa mëkate që quhen kufër dhe shirk.³³⁶ Po i përmendim disa prej këtyre haditheve:

1 -"Sharja e myslimanit është fisk (mëkat), e lufta kundër tij është kufër."³³⁷

2 -"Pas meje mos u ktheni në kufër, duke mbytur njëri-tjetrin!"³³⁸

3 -"Kush betohet në diç tjetër përveç All-llahut ka bërë shirk."³³⁹

4 -"Dy gjëra, nëse gjenden tek njerëzit, do t'i shpiejnë në kufër (mosbesim): Përbuzja e dikujt për shkak të prejardhjes (origjinës) së tij dhe vajtimi për të vdekurin".³⁴⁰

5 -"Kur njeriu bën zinallëk nuk është besimtarë përderisa gjendet në atë akt, kur vjedhë nuk është besimtarë përderisa gjendet në vjedhje, kur pinë alkool nuk është besimtarë përderisa është duke pirë, e pastaj mund të pendohet."³⁴¹

336 Risaletul iman li Ebu Ubejd el-Kasim bin Selam, metbu'atun me'a resaile uhra, f. 84.

337 Mutfekun alejhi. Shih: Sahihu-l-Buhari me'a Fet'hul Bari, 1: 96; Sahih Muslim me'a sherhin Nevevi, 2: 54.

338 Mutfekun alejhi. Shih: Sahihu-l-Buhari me'a Fet'hul Bari, 1: 175; Sahih Muslim me'a sherhin Nevevi, 2: 55.

339 Transmeton Ahmedî, Tirmidhiu dhe Hakimi në Mustedreku Ibni Umer. Shih: El Fet'hur rabbani, 14: 164; Sahihut-Tirmidhi bi sherh Ibnil 'Arebi, 3: 18; El-Mustedrek, 1: 18.

340 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 1: 18.

6 -"Kush ngritë armën kundër nesh - nuk është prej nesh, kush na mashtron - nuk është prej nesh."³⁴²

7 -"Nuk është prej nesh ai i cili rrahet fytyrës (duke vajtuar për të vdekurin), i shkyen rrobat dhe thërret në çkado qoftë nga xhahilijeti."³⁴³

Ekzistojnë edhe shumë hadithe të ngjashme me këto, dhe këto askush nuk i ka kuptuar bukvalisht përpos harixhijëve, të cilët bërësin e ndonjë mëkati të madh e konsiderojnë jobesimtar. Kurse, ehli Sunneti merr qëndrim se të gjitha këto hadithe duhet të komentohen në pajtim me parimin e përmendur.

Në këtë masë është në pajtim ulemaja e ehli Sunnetit, por ata ndahen në mendime përkitazi me komentimin e këtyre haditheve: disa prej tyre mendojnë se me kufër në këto hadithe mendohet në kufrin ni'me (mohimi i dhuntisë së All-llahut xh.sh.), e jo kufër i cili nxjerrë nga dini. Disa prej tyre mendojnë se me këto hadithe dëshirohet vetëm të tërhiqet vërejtja në madhësinë dhe rrezikun e mëkateve të përmendura, e disa të tjerë konsiderojnë se kufri në hadithet e përmendura ka të bëjë me ata të cilët këto mëkate i konsideron të lejuara. E, kush lejon çkado qoftë prej tyre, bëhet renegat. Kurse në mesin e tyre ka edhe sish të cilët shikojnë ndryshe dhe çdo hadith të përmendur e komentojnë në pajtim me parimin e përmendur tek ehli Sunneti (se bërësit e

341 Mutfekun alejhi, vel lafzu lil Muslim, 2: 45; Sahihu-l-Buhari, kaptina mbi pijet; Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 2: 45.

342 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 2: 108.

343 Mutfekun alejhi, vel lafzu lil Muslim, 2: 45; Sahihu-l-Buhari fi kitabil xhenaiz; Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 2: 109.

mëkateve të mëdha nuk do të qëndrojnë përgjithmonë në Xhehennem), dhe ata nuk i përmbahen një komentimi të përgjithshëm që do të vlente njësoj për të gjitha hadithet. E disa prej tyre konsiderojnë se me këto hadithe dëshirohet të theksohen veprat dhe fjalët të cilat janë rezultat të kufrit, e jo të imanit, dhe se imani nuk i dëshiron ato, por përkundrazi kërkon largim prej tyre.³⁴⁴

Imam Ebu Ubejd el-Kasim bin Selami r.a., pasi që i ka përmendur disa nga komentimet e përmendura dhe dobësinë e tyre, thotë: “Ajo që ne konsiderojmë përkitazi me këtë çështje është se: mëkatet nuk e fshijnë imanin dhe nuk shpiejnë në kufër, por ato mohojnë rregullsinë dhe sinqeritetin e imanit çfarë duhet pasur mu’minët dhe këtë ua kushtëzon në shumë vende në Kur’an. All-llahu xh.sh. thotë:

“All-llahu, me të vërtetë, ka blerë nga besimtarët e Vet trupin dhe pasuritë e tyre, për t’iu dhuruar Xhennetin atyre. Ata luftojnë në rrugën e All-llahut, vrasin dhe vriten. (Ky është) premtim i Tij i vërtetë në Tevrat, në Inxhil edhe në Kur’an. E, kush është më i plotë (më konsekuent) se All-llahu në premtim? Andaj gëzojuni kësaj shitjeje të juaj, që e keni kontraktuar me Të, dhe kjo është fitore e madhe. (Këta janë ata) që pendohen (për mëkatet e tyre), që e adhurojnë (All-llahun), dhe e falenderojnë Atë, dhe agjërojnë, dhe bëjnë ruku dhe sexhde (falin namazin), urdhërojnë me vepra të mira, e pengojnë prej të këqijave dhe të cilët ruajnë dispozitat e All-llahut. E sihariqoj besimtarët!” (Et-Tevbe: 111-112).

344 Sqarimin më të hollësishëm të këtyre komentimeve shih: Risaletul iman li Ebu Ubejd el-Kasim bin Selam, metbu’atun me’a resaile uhra, f. 84 ve ma ba’deha.

“Me të vërtetë, shpëtuan besimtarët, të cilët, në namazin e tyre janë të përlshëm, dhe të cilët shmangen nga kotësitë, dhe të cilët japin zekatin, dhe të cilët i ruajnë organet e veta gjinitale, përpos (në martesë) me gratë e tyre ose me robëreshat e tyre, (për këto) ata nuk janë të qortuar. E, kush kërkon (kënaqësi) përpos këtyre, të atillët - me të vërtetë, janë kundërvajtës. (Të shpëtuar janë) edhe ata, që i ruajnë amanetet dhe obligimet (e marra përsipër), dhe ata që ruajnë namazin e tyre (prej mungesave), ata janë trashëgimtarë të denjë, të cilët, do ta trashëgojnë (Xhennetin) Firdevsin. Ata, do të banojnë përherë në të.” (El-Mu’minun: 1-11).

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet All-llahu, vërgëllojnë (nga frika dhe përlja), e kur t’u lexohen argumentet e Tij, iu shtohet thellimi në besim dhe mbështeten vetëm te Zoti i tyre, ata që kryejnë namazin dhe japin nga pjesa e saj që ua kemi dhënë Ne. Ata, pa dyshim, janë besimtarë të vërtetë. Për ata ka pozita te Zoti i tyre, falje dhe dhunti fisnike” (El-Enfal: 2-4).

Ebu Ubejde thotë: “Këto ajete shpjegojnë dhe hollësisht i sqarojnë cilësitë e imanit i cili kërkohet prej besimtarëve, dhe mohojnë mëkatet lidhur me iman. Pastaj hadithet që flasin për virtytet e besimtarit edhe më tepër i sqarojnë këto ajete. Duke qenë se mëkatet janë të përziera me iman të cilat ndërlidhen me gjëra të tjera, e jo për të, atëherë mund të thuhet se këto nuk janë kushtet që ua ka vënë All-llahu xh.sh. besimtarëve e as që janë shenja të cilat i karakterizojnë besimtarët, prandaj, prej tyre mohohet imani i vërtetë (tërësisht i pastër), por nuk mohohet emri. E, nëse dikush pyet: “Si është e mundur të themi për dikë se nuk është besimtar, porse emri iman të mbetet me të?” Do t’i përgjigjemi se kjo është e njohur në gjuhën arabe dhe, nuk është kurrfarë çudie të mohohet puna e atij që e ka mbaruar atë, nëse ajo punë nuk është si duhet të jetë. A mos ke dëgjuar se ata i thonë dikujt i cili e ka bërë një punë dobët dhe jo në mënyrë profesionale: ti

nuk ke punuar asgjë, e as që ke bërë diç. Pra, në këtë rast mohohet kualiteti i punës, e jo edhe vetë puna. Pra, ky person tek ata është vetëm punëtor formal (sipas emrit), e jo punëtor sipas kualitetit. Arabët e kanë zakon të thonë edhe më tepër se kjo, siç është rasti me atë që është i padëgjueshëm ndaj prindërve të tij dhe të cilët madje edhe i bëjnë ezijet, ata për të thonë se assesi nuk është fëmijë (i prindërve të tyre), edhe pse e dinë se ai është i tyre. Gjithashtu thonë edhe për vëllain dhe gruan.” Pastaj Ebu Ubejde thotë: “Rasti i njëjtë është edhe me hadithe në të cilat Resulull-llahu heq dorë nga disa mëkatat të caktuar. Ata janë sikurse fjalët e atij që thotë: “Kush bën këtë dhe këtë, nuk është prej nesh.” Dhe konsiderojmë se nuk ekziston kurrnjë mëkat që do të ishte shkas për të hequrit dorë nga Resulull-llahu s.a.v.s. dhe nga ummeti i tij. Por, kjo, tek ne, do të thotë se personi (mëkatari) përkatës nuk është i bindur ndaj nesh, as që merr shembull prej nesh, e as që i respekton ligjet tona.

E, për sa i përket haditheve ku përmenden shirku dhe kufri dhe mëkatet që shpiejnë në to, ato, tek ne, nuk kanë domethënie se këto mëkate nuk rezultojnë me kufër dhe me shirk të cilët e anulojnë imanin e njeriut, porse me këtë do të thotë se mëkatet e përmendura janë karakteristikë dhe veti të jobesimtarëve dhe mushrikëve.”³⁴⁵

Ekzistojnë edhe disa argumente pakontestuese dhe indicione të Sheriatit të cilat na udhëzojnë në atë se është nevoja për komentimin alegorik të këtyre haditheve:

Nën një: Ekzistojnë shumë hadithe të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë tregojnë se mëkatat nuk do të mbeten përherë në Xhehennem, porse fundi i tyre do të jetë në Xhennet, qoftë pas ndonjë

345 Risaletul iman li Ebu Ubejd el-Kasim bin Selam, metbu’atun me’a resaile uhra, f. 89 ve ma ba’deha.

vuajtjeje të përkohshme, qoftë pas faljes nga ana e të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, e disa prej këtyre haditheve i kemi përmendur. Në disa të tjera përmenden mëkatet të cilat sipas realitetit të tyre janë më të mëdha sesa veprat që në disa hadithe të tjera quhen kufër. Zinjaja dhe vjedhja janë mëkate më të mëdha sesa sharja e besimtarit, apo hudhja e fallit, apo vajtimi për të vdekurin, që gjithashtu quhen kufër.

Nën dy: Po qe se ato gjëra të cilat përmenden në këto hadithe do të ishin kufër dhe shkase për renegim, atëherë ndaj vepruesëve të tyre do të aplikoheshin dispozitat me të cilën janë në pajtim të gjithë myslimanët, e për të cilët Resulull-llahu s.a.v.s. në një hadith sahih ka thënë: “Kush e ndërron fenë e vetë, mbyteni atë!”³⁴⁶ Gjithashtu, gjejmë se All-llahu xh.sh. ka paraparë prerjen e dorës vjedhësit, ndërsa për lavirin apo laviren dhe për atë që shpifë për myslimanin apo myslimanen se ka bërë kurvëri - rrahje me kamxhik, e sikur vepruesit e veprave të përmendura do të bëheshin jobesimtarë, atëherë për ta nuk do të kishte ndëshkim tjetër veçse të likuidoheshin dhe nuk do të pranohet falja e vrasësit nga familja e të vrarit, ngase përkitazi me çështjen e renegatit nuk pranohet falja prej askujt në këtë botë. Ndërsa argumentet nga Kur’ani, Sunneti dhe koncenzusi i ulemasë islame tregojnë se laviri - lavirja, hajni dhe ai që ka shpifur për dikë - nuk mbyten, por ndaj tyre aplikohen dispozitat e përmendura shariatike, që tregon se ata nuk kanë reneguar nga feja.³⁴⁷

346 Transmeton Buhariu nga Ibni Abbasi në kaptinën mbi xhihadin.

347 Risaletul iman li Ebu Ubejd el-Kasim bin Selam, metbu’atun me’a resaile uhra, f. 89; Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 361.

Së treti: Në Kur'an gjejmë ajete, në të cilat All-llahu xh.sh. bërësit e mëkateve të mëdha i klasifikon në besimtarë dhe ua përshkruan cilësitë e imanit dhe vëllezërisë sipas emrit.³⁴⁸

“O besimtarë! Është bërë obligim për ju ndëshkimi për vrasje: i liri për të lirin, robi për robin, femra për femrën; e atij që ia falë diçka nga vallai i vet, duhet të sillet njerëzishëm (me mirësi për dëmshpërblim) dhe le të zbatohet dëmshpërblimi me të mirë. Kjo (falje) është një lehtësi dhe mëshirë nga ana e Zotit. E kushdo që pas kësaj (faljes) e kapërcen kufirin, për atë ka dënim të rreptë.” (El-Bekare: 178).

Pra, All-llahu xh.sh. me këtë ajet nuk e konsideron vrasësin jashtë grupit të besimtarëve dhe e bënë vëlla të farefisit të të vrarit, e padyshim se këtu mendohet për vëllezërim për nga feja.³⁴⁹

Gjithashtu All-llahu xh.sh. thotë:

“Nëse dy grupe myslimanësh luftojnë ndërmjet veti, pajtoni ata, e nëse njëra prej tyre sulmon atë tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit, përderisa të mos kthehet në dispozitat e All-llahut. E nëse kthehet, atëherë pajtoni ata mes tyre, me të drejtë dhe bëhuni të drejtë. All-llahu njëmend i do të drejtët. Me të vërtetë, myslimanët janë vëllezër, andaj pajtoni vëllezërit tuaj ndërmjet veti dhe druajuni All-llahut, për t’u mëshiruar ju.” (El Huxhurat: 9-10)

348 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 361; Sherhun ‘akidetil vasitijje li Muhammed Halil Herras, f. 138-139.

349 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 361.

PJESËTARËT E EHLI SUNNETIT PRANOJNË NDËSHKIMET QË JANË PËRMENDUR PËR MËKATE TË CAKTUARA

Edhe pse pjesëtarë e ehli Sunnetit konsiderojnë se mëkatet e mëdha nuk e shpiejnë bërësin në kufër, nëse nuk janë të përcjella me ndonjë nga shkaqet e tyre të vërteta, ata, në të njëjtën kohë, nuk thonë se këto nuk i bëjnë dëm imanit, siç konfirmon sekti murxhijë. Këta konsiderojnë se mëkati assesi nuk i bën dëm bërësit të tij nëse është besimtar. Ky qëndrim është në kundërshtim me Kur'anin dhe Sunnetin e Resulull-llahut s.a.v.s., ngase All-llahu xh.sh. na ka informuar për ndëshkimet në këtë botë për shumë mëkate dhe vepra të ndaluara.

Pjesëtarët e ehli Sunnetit konsiderojnë se mëkatet shkaktojnë ndëshkimin dhe vuajtjen me të cilën All-llahu xh.sh. në Kur'an dhe përmes Pejgamberit të Tij i kërcënohet bërësit. Dhe se ndikojnë në iman, në forcimin apo në dobësimin e tij, e jo në ekzistimin apo shuarjen e tij, e mund të ndodh që njeriu i cili gabon vazhdimisht, këto mëkate ta shpiejnë në kufër dhe në riddet, nëse personi në fjalë mohon çkado qoftë nga ajo me çka ka ardhur Resulull-llahu s.a.v.s. në mënyrë që t'i arsyetojë lakmitë dhe pasionet e veta. E edhe për shkak se pasimi i epsheve dhe mëkatimi i vijueshëm në masë të madhe e molisë zemrën, gjersa nuk e sjell deri te konsiderimi se mëkatet janë të lejuara dhe në këtë mënyrë e shpien në kufër, e All-llahu xh.sh. na mbrojtë prej kësaj.

Murxhijet, përkritazi me këtë çështje, mbështeten në hadithet e përmendura në të cilat thuhet se ai i cili vdes me tevhid do të hyjë në Xhennet, siç është hadithi: “Kush vdes e e di se nuk ka zot

tjetër përveç All-llahut do të hyjë në Xhennet.”³⁵⁰, në bazë të cilit kanë konkluduar se hyrja e tij në Xhennet do të thotë se nuk do të jetë i ndëshkuar. Mirëpo, këto dy gjëra nuk varen prej njëra-tjetrës, ngase All-llahu xh.sh. mund ta ndëshkojë besimtarin aq sa dëshiron ta ndëshkojë, e pastaj ta shpie në Xhennet.³⁵¹

E ndoshta edhe mbështeten në fjalët e All-llahut xh.sh.:

“S’ka mëkat për ata besimtarë që bëjnë punë të mira (në atë) që kanë ngrënë (para ndalimit), kur ata të jenë të ruajtur (nga ndalimet), të kenë besuar e të kenë bërë vepra të mira; të ruhen e të besojnë; dhe të ruhen e të bëjnë vepra të mira (vijimisht). E, All-llahu i do bamirësit” (El-Maide: 93).

Ndërsa, dihet se ky ajet është shpallur përkritazi me as’habët që kanë vdekur para ndalimit të alkoolit, që është transmetuar për shkakun e shpalljes së këtij ajeti. Transmetohet se Abdull-llah bin Kudame dhe disa të tjerë kanë pirë alkool edhe pas ndalimit të tij, duke u arsyetuar me këtë ajet. Kur e kuptoj këtë Umeri r.a., ai u pajtua me mendimin e Aliut r.a. dhe të as’habëve të tjerë, që ata, po qe se pranojnë se alkooli është i ndaluar, të rrahen me kamxhik, e nëse jo, të mbyten. Andaj Umeri i tha Kudames: “Sikur të besoje përnjëmend, të ruhesh nga mëkatet dhe të punoje vepra të mira, nuk do të pije alkool. Ngase ky ajet është shpallur pasi që ata nga as’habët, pas Betejës së Uhudit dhe ndalimit të alkoolit, kanë pyetur: çka do të bëhet me shokët tanë të cilët kanë vdekur e kanë pirë alkool? E, All-llahu xh.sh. shpalli këtë ajet me të cilin na informon se ata

350 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 1: 218.

351 Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 1: 219.

që kanë bërë diç nga veprat e ndaluara, para ndalesës së tyre nuk do të jenë të ndëshkuar nëse kanë qenë besimtarë muttekijë, që bëjnë vepra të mira.³⁵²

MËKATET E MËDHA

Ky është qëndrimi islam ndaj mëkateve, të vogla apo të mëdha qofshin ato: All-llahu xh.sh. dhe Pejgamberi i tij na tërheqin vërejtjen që të ruhemi prej tyre, ngase besimtari është i obliguar që gjithnjë ta forcojnë takvallëkun e vet dhe sa ma shumë ta ndërtojë atë, në mënyrë që t'u shmanget gjërave që ka ndaluar All-llahu xh.sh. dhe që të mos shkujdeset përkitazi me këtë çështje duke thënë: imtësi. All-llahu xh.sh. thotë:

“Puna nuk qëndron ashtu, as sipas dëshirës suaj e as sipas dëshirës së ithtarëve të Librit. Por është, se kushdo që të bëjë një të keqe, do të ndëshkohet për atë dhe nuk do të gjejë as mbrojtës as ndihmës përveç All-llahut.” (En-Nisa’: 123).

Ndërsa Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Kur mëkatari bën ndonjë mëkat, ia lë në zemër një pikë të zezë, e nëse pendohet dhe kërkon ndjesë zemra e tij pastrohet, e nëse nuk pendohet ajo rritet

352 Tefsirul Kurtubi, 6: 293; Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 364-365.

gjersa nuk ia mbulon zemrën tërësisht.”³⁵³ Kjo pikë e zezë e mbulon dhe e mbyllë të tërën dhe kjo është shtresë (sediment) për të cilën flet All-llahu xh.sh. në Kur’an kur thotë:

“E, Nuk është ashtu! Por, veprat e tyre (të këqija) i kanë mbuluar zemrat e tyre (i kanë nxirë).” (El-Mutaffifin: 14).

Dikush prej ulemasë ka thënë: “Mos shiko në parëndësinë e mëkatit, por shiko ndaj kujt bën mëkat!” Hasan Basriu ka thënë: “Shmangia nga mëkatet është më e lehtë sesa të kërkosh ndjesë.”³⁵⁴ Këtë e vërtetojnë edhe fjalët e Resulull-llahut s.a.v.s. në një hadith sahih: “Kur t’ju ndaloj prej diçkasë, largohuni prej saj, ndërsa kur t’ju urdhëroj për diçka, atë përmbusheni sa të keni mundësi”.³⁵⁵ Shiko se si Resulull-llahu s.a.v.s. kryerjen e urdhrit e kushtëzon me mundësi, që nuk është rast me ndalesat duke treguar se ato fshehin në vete rreziqe të mëdha dhe padenjësinë e atij që i bënë këto, dhe se duhet të bëhen përpjekje të shumta në mënyrë që t’u shmangemi atyre. Fudajl bin Ijadi thotë: “Në masë të njëjtë sa të duket ty ndonjë mëkat i parëndësishëm ai bëhet i madh tek All-llahu xh.sh., e nëse te ti rritet vetëdija për rrezikun e tij që mbanë ne vete, në masë të njëjtë ai zvogëlohet tek All-llahu xh.sh.” As’habët kishin zakon të thoshin: “Mëkatet janë postë e kufrit”.³⁵⁶ Ngase shumë mëkate e ashpërsojnë zemrën dhe nxjerrin nga ajo çdo të mirë që kanë

353 Transmeton Ibni Xheriri, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibni Maxhe. Shih Sahihut-Tirmidhi bi sherhi Ibnil ‘Arebi, 12: 234. Tirmidhiu thotë se ky hadith është hasen sahih; Sunen Ibni Maxhe, 2: 1418.

354 Ez-Zevaxhir ‘an iktirafil kebair, 1: 12.

355 Shënon Buhariu dhe Muslimi: Fet’hul Bari, 17: 21; matbe’atul Halebi ve Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 5: 19.

356 Ez-Zevaxhir ‘an iktirafil kebair, 1: 12.

pasur ato, kështu që njeriu atëherë bënë çka të dëshirojë dhe çka t'i bie në mend, e shejtanin e merr për mik përpos All-llahut xh.sh., i cili e mashtron dhe e shpien në të keqe ndërsa e pengon nga e mira dhe nuk do të jetë i kënaqur me të përderisa nuk e shpien në kufër, nëse është në gjendje ta bëjë këtë.

All-llahu xh.sh. posaçërisht na ka tërhequr vërejtjen për rrezikun e disa mëkateve dhe iu është kërcënuar me ndëshkim më të madh atyre të cilët i bëjnë këto. Gjithashtu edhe Pejgamberi s.a.v.s. na ka informuar për disa mëkate të cilat bëjnë pjesë në mubikat - mëkate të mëdha të cilat shpiejnë në shkatërrim, e që i ka përmendur në disa hadithe sahih, duke i quajtur ato mëkate të mëdha. Ja disa prej tyre:

1 - Transmetohet nga Ebu Bekrete Nufejl ibën el-Harithi r.a. se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: “A doni t’ju njoftoj për mëkatet më të mëdha?” - tri herë - Ne i thamë: “Gjithsesi, o i Dërguari i All-llahut!” Tha: “All-llahut nëse i përshkruhet shok (shirk) dhe mosdëgjimi i prindërve”. Ishte (ulur) i mbështetur, pastaj u drejtua e tha: “Veni re, edhe dëshmia e rrejshme, edhe dëshmia e rrejshme”, dhe vazhdimisht e përsëriste këtë saqë thamë: “Ah, sikur të heshtte!”³⁵⁷

2 - Nga Ebu Hurejre r.a. transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Ruajuni nga shtatë të këqija të mëdha!” (As’habët) kanë thënë: “O i Dërguari All-llahut, cilat janë ato mëkate?” Ka thënë: “Të shoqëruarit e All-llahut, sehiri, mbytja e dikujt, që All-llahu e ka ndaluar, përveç me të

357 Sahih Muslim me’a sherhin Nevevi, 2: 81-82; Ahrexhel Buhari nahvehu ab Enes fi kitabid dijat.

drejtë, ngrënia e kamatës, pasurisë së bonjakut, ikja nga fushëbeteja dhe shpifja për amoral të besimtares së devotshme dhe të ndershme”.³⁵⁸

3 - Nga Abdull-llah bin Amër bin A's r.a. transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s.: “Në mëkatet e mëdha bënë pjesë edhe sharja e prindërve të tu.” Dikush pyeti: “O i Dërguari All-llahut, a mos vallë ekziston dikush që i shanë prindërit e vet?” Ai u përgjigj: “Po. Nëse dikush ia shanë dikujt babën, e ai ia shanë këtij, dhe nëse dikujt ia shanë nënën, e ai ia shanë këtij.”³⁵⁹

Edhe në shumë hadithe të tjera përmenden mëkatet të cilat kategorizohen në mëkate të mëdha. Mirëpo, me të gjitha këto hadithe nuk dëshirohet që numri i tyre të shpihet në numrin e përmendur.³⁶⁰ Dhe arsyeja që numri i tyre nuk caktohet saktësisht me siguri është se njerëzit duhen të ruhen dhe të shmangen nga të gjitha mëkatet, duke u frikësuar se ndoshta ndonjëri prej tyre bënë pjesë në mëkate të mëdha. Por, shumica e ulemasë së mëhershme dhe të tanishme bënë dallim mes mëkateve të vogla dhe të mëdha, pa pasur dyshim se çdo mëkat është në kundërshtim me urdhrin e All-llahut xh.sh. apo me ndalesën e Tij. Ndërsa, të punohet kundër urdhrin të All-llahut xh.sh. është gjë tejet e shëmtuar duke pasur parasysh madhërinë e Tij, por disa mëkate janë më të mëdha se të tjerat.

358 Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 2: 82-83; Buhari fi kitabul vesaja.

359 Mutfekun alejhi, vel lafzu li Muslim. Shih: Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 2: 82-83.

360 Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 2: 84.

DEFINICIONI I MĒKATIT TË MADH DHE KRITERI I TIJ

Ulemaja ndahet në mendim rreth definicionit të mëkatit të madh dhe mënyrës së dallimit të tij nga mëkati i vogël.³⁶¹ Mirëpo, shumica prej tyre i jep përparësi qëndrimit se, mëkat i madh është çdo mëkat i cili shkakton ndëshkimin shariatik, ose kërcënimin me zjarr, apo mallkimin dhe hidhërimin. Ky mendim transmetohet nga Ibni Abbasi r.a. dhe Hasan El-Basriu r.a.³⁶² Ndërsa Ebu Hamid El-Gazaliu r.a. thotë: “Çdo mëkat, që e bënë njeriu pa ndijim frike, të brejturit e ndërgjegjës dhe kërkim ndjese, siç është ai që këtë e bënë me lehtësi dhe të cilit mëkatet u janë bërë shprehi, e tërë ajo që bëhet nga mëkatet me lehtësi dhe pa brejtje të ndërgjegjës është mëkat i madh. Ndërsa, ajo që ka të bëjë me gabimin në shprehje gjatë sjelljes në momentet e dobësisë së ndjenjave të takvallëkut, por e përcjellur me pendim i cili e zvogëlon ëmbëlsinë e mëkatit, në këtë rast kjo nuk e trazon nderin e njeriut dhe nuk bën pjesë në mëkatet e mëdha.”³⁶³

Konsiderojmë si të udhës se lexuesit duhet t’ia transmetojmë fjalët e bukura dhe të kuptuara rreth çështjes së mëkateve të vogla dhe të mëdha, të imamit të famshëm El-Izz bin Abdus Sela’mit nga libri i tij “El-Kuva’id”, ku thotë:

“Nëse dëshiron ta kuptosh dallimin mes mëkateve të vogla dhe të mëdha, atëherë krahasojë pasojat e mëkatit të bërë me mëkatet të cilat janë klasifikuar në mëkate të mëdha, e nëse pasoja

361 Shih këto definicione në: Ez-Zevaxhir ‘an iktirafil kebair, 1: 4 e tutje; Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 2: 85 e tutje.

362 Sherhul ‘akidetit-Tahavijje, f. 418; Sherhun Nevevi ‘ala Sahih Muslim, 2: 85.

363 Këtë transmeton En-Neveviu nga Gazaliu në komentarin e vet të Sahih Muslimit. 2: 85.

është më e vogël se mëkati më i vogël i kësaj kategorie, atëherë ai bën pjesë në mëkatet e vogla, e nëse barazohen me pasojat e mëkatisë më të voglën të kategorisë së të mëdhave, apo është më e madhe se ai, atëherë mëkati i bërë bën pjesë në mëkatet e mëdha. Andaj, kush e shanë All-llahun ose Pejgamberin, ose i përçmon Pejgamberët, ose mohon cilindo prej tyre, ose e hedh musafin në pleh, kjo bënë pjesë në mëkatet e mëdha, edhe pse Sheriati nuk i ka përmendur në mënyrë të hapët këto raste. Rasti i njëjtë është sikur, bie fjala, dikush ta mbyllte gruan myslimane dhe t'ia mundësonte dikujt që me të bëjë zina, ose ta mbyllte myslimanin e t'ia mundësonte dikujt që ta mbysë atë, ngase s'ka dyshim se pasojat në këto raste do të ishin shumë më të mëdha sesa pasojat lidhur me shpenzimin e pasurisë së bonjakut, që është numërtuar në mëkatet e mëdha. Rasti i njëjtë është, nëse dikush ia zbulon jobesimtarëve dobësitë e myslimanëve, duke e ditur se do t'i mbysin ata pas kësaj, do t'ua plaçkisnin pasurinë dhe do t'ua rrënojnë shtëpitë. Pasojat e të gjitha këtyre janë shumë më të mëdha sesa pasojat që do të rezultojnë nga ikja e tij prej fushëbetejës, edhe pse ky është vërtet mëkat i madh. Dëshminë e rrejshme dhe shpenzimin e pasurisë së bonjakut, Sheriati i klasifikon në mëkate të mëdha. Nëse është ky rast me sasi të madhe, kjo është e qartë. Mirëpo, nëse ka të bëjë me sasi të parëndësishme, përsëri ky mund të konsiderohet si mëkat i madh, në mënyrë që të pengohen këto lloje mëkatesh. Nëse është haram të pihet alkooli, atëherë është haram të pihet madje edhe një pikë prej tij, edhe pse kjo pikë nuk do të shkaktonte kurrfarë dëmi. Ndërsa krahasimi mes fesadit që shkaktojnë mëkatet, është gjë delikate dhe këtë mund ta bëjë vetëm ai që e ka ndihmën e All-llahut xh.sh. Ndërsa të konstatohet barazia është shumë më vështirë sesa të konstatohet dallimi, dhe kjo mund të caktohet vetëm përafërsisht.”³⁶⁴ Pastaj thotë: “Një pjesë e ulemasë mëkatin e madh e definojnë në këtë mënyrë: çdo mëkat që është i përcjellur

364 Kava'idul Ahkam, 1: 23-24.

me kërcënim (të All-llahut xh.sh.) ose me ndëshkim të caktuar, ose me mallkim, bënë pjesë në mëkatet e mëdha. Andaj vrasja e besimtarit është mëkat i madh, ngase është përcjellur me kërcënim dhe me mallkim. Sulmimi i udhëtarit, zinaja, vjedhja dhe shpifja janë mëkate të mëdha, ngase këto shkaktojnë ndëshkimin e caktuar me Sheriat. Gjithashtu, çdo mëkat dëmi i të cilit i përgjigjet mëkatit të madh e që është i përcjellur më kërcënim, me mallkim apo me ndëshkim të caktuar, apo e tejkalon këtë, konsiderohet mëkat i madh.”³⁶⁵

DISA SHEMBUJ TË MËKATEVE TË MËDHA

Lexues i dashur! Me sa u tha gjer më tani, po e sheh se kriteret me ndihmën e të cilëve i dallojmë mëkatet e mëdha dhe të vogla janë vetëm të përafërsishme, dhe se në ajetet kur’anore dhe në hadithe përmenden disa mëkate të mëdha e disa të vogla. Mirëpo ekzistojnë edhe shumë mëkate të mëdha e të vogla prej të cilave duhet të shmangemi, e posaçërisht duhet të bëjmë përpjekje të mëdha që t’u shmangemi atyre të cilat në Sheriat janë definuar në mënyrë të qartë si mëkate të mëdha. Dhe, assesi mos e konsidero ndonjë mëkat si të parëndësishëm dhe mos ngulmo në mëkat sado që i vogël duket ai, ngase ulemaja islame ka thënë në mënyrë të prerë se ngulmimi në mëkate të vogla i përgjigjet mëkatit të madh. Sepse, ngulmimi në mëkate të vogla nxjerr sheshit kuptimin e papërgjegjshëm të fesë dhe thyerjen e papërfilltë të urdhrave të All-llahut xh.sh.

365 Kava’idul Ahkam, 1: 23-24.

Këtu do t'i përmendim disa nga mëkatet e mëdha të cilat i numëron Ibni Haxher El-Hutejme në veprën e vet të vlefshme Ez-Zevaxhir 'an iktirafil kebair:

Shirku i madh, All-llahu na ruajt nga ai, shirku i vogël - hipokrazia, pezmatimi për shkak të batilit, urrejtja dhe zilia, kibri, të shtirurit, mendjemadhësia, mashtrimi, nifaku, largimi nga njerëzit për shkak të mendjemadhësisë dhe nënçmimit ndaj tyre, lakmia, hidhërimi në përcaktimet e All-llahut xh.sh., imitimi i të pasurve dhe madhërimi i tyre për shkak të pasurisë së tyre, përqeshja e të varfërve për shkak të varfërisë së tyre, garimi në fitimin e pasurisë së kësaj bote dhe mburrja me të, stolisja e krijesave me atë që nuk është e lejuar të stolisen, lajkatimi, kënaqësia në lavdërim për atë që nuk e ka bërë, hidhërimi për shkak të gjërave tjera pos për fenë e All-llahut xh.sh., papërgjegjësia ndaj obligimeve të All-llahut xh.sh. dhe ndaj urdhrave të Tij, pasimi i epsheve dhe shmangia nga e vërteta, dyshimet e këqija ndaj myslimanëve, mospranimi i së vërtetës edhe nëse vie me diç që nuk i përgjigjet dëshirave dhe aspiratave njerëzore, apo sjell diç që ai nuk e do, gëzimi gjatë kryerjes së ndonjë mëkati dhe ngulmimi në të, harresa në All-llahun xh.sh. dhe në botën e ardhshme, ndierja e sigurisë nga ndëshkimi i All-llahut xh.sh., të zhyturit në mëkate, mendimi i keq ndaj All-llahut xh.sh., humbja e shpresës në mëshirën e Tij, fitimi i diturisë për shkak të dobive të kësaj bote, fshehja e diturisë, mosveprimi sipas dijenisë, gënjimi me qëllim për All-llahun xh.sh. ose për Pejgamberin e Tij, futja e zakoneve të këqija mes njerëzve, mospërfillja e Sunnetit të Resulull-llahut s.a.v.s., mosplotësimi i premtimit, dashuria dhe simpatia ndaj zullumqarëve dhe mëkatarëve, urrejtja e njerëzve të mirë dhe shqetësimi i tyre, shqiptimi dhe përhapja e fjalëve që shkaktojnë fesad dhe dëm e që e hidhërojnë All-llahun xh.sh., kënaqësia me mëkat të madh dhe ndihmesa në kryerjen e tij, kryerja e veprave të këqija dhe të prishura në mënyrë që t'i frikësohen njerëzit, harresa e Kur'anit (nga ai që e ka ditur përmedsh) zënka dhe

grindja, tentimi të ngadhënjëhet Kur'ani dhe feja, mospastrimi (tahreti) pas nevojës së vogël dhe mosmënjanimi i urinës nga trupi dhe nga rrobat, shpluarja e organeve të turpshme të trupit, përveç gjatë nevojës, marrëdhënia me grua kur është në hajd, lënia e namazit me qëllim, shtyerja e vetëdijshme e namazit pas kohës së tij të vërtetë apo kryerja e tij para se të hyjë koha pa ndonjë shkak të arsyeshëm, siç është udhëtimi dhe sëmundja, ta udhëheqish xhematin e njerëzve për të cilët e din se nuk të duan, ndarja e saffit në namaz dhe mosdrejtimi i tij, të jeshë më i shpejtë se imami në namaz, falja në varre, ndezja e qirinjve mbi ta dhe prekja e tyre, udhëtimi i gruas pa mehrem, shtyerja e udhëtimit apo e kthimit nga udhëtimi për shkak të fallit, lënia e xhuma namazit pa shkaqe të arsyeshme sipas Sheriatit, shtyerja përmes saffave në xhami gjatë kohës së xhumasë, bartja e mëndafshit për meshkuj pa ndonjë arsye dhe stolisja me ari, apo me argjend pos unazës, imitimi i grave me atë që është karakteristike për gra, qoftë në të folur, në të veshur, në ecje dhe në kundërta, ecja krenare, e rrëmbyeshme, rrahja nëpër fytyrë (për të vdekurin)), shkyerja e rrobave dhe vajtimi, mallkimi, ankimi gjatë fatkeqësive, mosdhënia e zekatit ose shtyerja e tij pasi që ka arritur obligimi pa shkaqe të arsyeshme nga Sheriati, sjellja koprrace ndaj borxhliut edhe pse e di se është në situatë të keqe materiale, përmendja e vijueshme për sadakanë e dhënë, ndalimi i ujit të tepruar atij që ka nevojë për të dhe është në mbek (shtrëngesë), lënia e agjërimit në cilëndo ditë të Ramazanit, prishjen e agjërimit të Ramazanit pa shkaqe të arsyeshme nga Sheriati, siç është udhëtimi dhe sëmundja, agjërimi gjatë kohës së dy bajramave dhe tre ditë pas Arafatit, moskryerja e haxhshit edhe pse ekzistojnë kushtet, pirja apo ngrënia e asaj që dehë, e alkoolit, hashashit, opiumit e të ngjashme, ngrënia e mishit të dërrit dhe të ngordhësirave, marrja apo dhënia e kamatës apo pjesëmarrja në të në çfarëdo mënyre qoftë (shkruatjen e saj, të dëshmuarit për të, të ndihmuarit për të etj.), fitimi i pasurisë me tregti të palejuar dhe aspektet e tjera të fitimit të palejuar, deponimi i mallrave në sasira të mëdha në mënyrë që t'u rritet çmimi,

mashtrimi gjatë shitjes, shpërndarja (shitja) e mallit me betim të rrejshëm, pakësimi në peshore e të ngjashme, shtyerja e paarsyeshme e borxhit nga ana e atij që është në gjendje ta kthejë atë, shpenzimi i pasurisë në gjërat që janë haram, ndërtimi i panevojshëm - vetëm për shkak të sederit dhe kryelartësisë, mashtrimi i partnerit në punë dhe zëvendësimin e vet, rrëmbimi i padrejtë i pasurisë së huaj, vonimi i pagesës së rrogave punëtorëve, apo refuzimi i pagesës pas punës së kryer e të kontraktuar, përvetësimi i pasurisë së përbashkët dhe ndalesa që me të të shfrytëzohen udhëtarët mysafirë, mohimi i amaneteve që janë dhënë në ruajtje apo në shërbim me qira etj.

Ibni Hishami ka përmendur edhe shumë gjëra të tjera, andaj të preferojmë ta lexosh librin e tij.³⁶⁶

SHKAQET E LIRIMIT NGA NDËSHKIMI PËR MËKATE

Nëse njeriu besimtar bie në mëkat, All-llahu xh.sh. ia ka hapur atij dyert e mëshirës së Vet, në mënyrë që të shpëtoi nga këto mëkate, nëse sinqerisht pendohet dhe i frikësohet All-llahut xh.sh.

Disa alimë i kanë mbledhur të gjitha ajetet dhe hadithet në të cilat flitet për mënyrën e lirimit nga ndëshkimi për mëkate, e ne këtu shkurtimisht do t'i përmendim rezultatet e kësaj tek komentuesi

366 Ez-Zevaxhir ‘an iktirafil kebair elxhduz’ul evvel ves-sani. Përkitazi me këtë temë ka shkruar dhe i ka numruar llojet e mëkateve të mëdha dhe argumentet për to edhe imam Zehehi në veprën e vet ‘El-Kebair’, si dhe Muhammed bin Abdul Vehhabi gjithashtu në veprën ‘El-Kebair’.

i Akaidës së Tahaviut, i cili thotë: “Bërësi i mëkateve në afro dhjetë raste lirohet nga ndëshkimi i Xhehennemit, të cilat i kemi kuptuar nga Kur’ani dhe Sunneti.” Pastaj i përmend:

Shkaku i parë: pendimi, ngase All-llahu xh.sh. ka thënë:

“E, pas tyre, erdhën breznitë (e shëmtuara), të cilët braktisën namazin dhe ndoqën epsheet e veta. Ata do të hasin në të keqe (në humnerën e skëterrës), përpos atyre që pendohen, që besojnë dhe bëjnë (vepër) të mirë! Këta do të hyjnë në Xhennet dhe nuk do t’u bëhet kurrfarë dëmi.” (Merjem: 59-60).

“E nuk mallkohen vetëm ata që pendohen dhe përmirësohen dhe haptazi e shfaqin këtë, se Unë jam pranues i pendimeve dhe mëshirues.” (El-Bekare; 160).

Tevbeja që i fshinë mëkatet, është tevbe e sinqertë e cila buron nga zemra, e jo tevbe e cila vetëm shqiptohet me gjuhë. Dhe atë e përcjellë pendesa e thellë për mëkatet e bëra, dhe vendimi i fuqishëm që të mos kthehet më në të krahas kryerjes së veprave të mira.

I tërë ummeti mysliman është në pajtim se pendesa është shkak për falje dhe për fshirjen e ndëshkimit, dhe se asgjë tjetër nuk mund të jetë shkak për faljen e të gjitha mëkateve përpos tevbeja (pendimi). All-llahu xh.sh. thotë:

“O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetvetes, mos e humbni shpresën në mëshirën e All-llahut! All-llahu, me siguri, i falë të gjitha mëkatet. Ai, me të vërtetë, është falës dhe përdëllimtar.” (Ez-Zumer: 53).

Shkaku i dytë: kërkimi i faljes (istigfari), ngase All-llahu xh.sh. thotë:

“All-llahu ata nuk i dënonte, sepse ishte ti në mesin e tyre, dhe ata All-llahu nuk i dënon derisa luten për falje”. (El-Enfal: 33).

Istigfari, në realitet, hyn në rëndësinë e tevbes, ngase istigfari është kërkim faljeje për mëkatet që i ka bërë njeriu, që hyn në pendesë të asaj që ka bërë ai, ngase kërkimi i faljes është argumenti më i madh i pendesës së tij. Porse, tevbeja ka rëndësi më të madhe se istigfari ngase në vete përmbanë edhe vendimin e fuqishëm për mosmëkatim në të ardhmen.

Shkaku i tretë: kryerja e veprave të mira, ngase All-llahu xh.sh. thotë:

“... S’ka dyshim se veprat e mira i shlyejnë ato të këqijat.” (Hud: 114)

Shkaku i katërt: mynxyrat e dynjallëkut që e godasin njeriun, ngase Resulull-llahu s.a.v.s.. ka thënë: “Çkado që e godet myslimanin, qoftë lodhja, pikëllimi, brenga, hidhërimi, mundimi nga sëmundja a fatkeqësia, madje edhe të shpuarit e ferrës - me secilën prej këtyre All-llahu ia shlyen mëkatet atij”.³⁶⁷

Ta dishë se falja e mëkatit ndodhë për shkak të vetë sprovimit me ndonjë mynxyrë, e nëse njeriu është i durueshëm gjatë këtyre mynxyrave, do të arrijë edhe shpërblime të tjera pos faljes së mëkateve, e nëse pezmatohet do të fitojë mëkat të ri, porse mbetet falja e mëkatit për shkak mynxyrës që e ka goditur.

Shkaku i pestë: vuajtja në kabur.

Shkaku i gjashtë: tmerret dhe vështirësitë e Ditës së Kiametit.

367 Muteffekun ‘alejhi - shih: Radijus Salihin f. 31 (në shqip f.

Shkaku i shtatë: Ndërmjetësimi i atyre që All-llahu xh.sh. do t'u lejojë të ndërmjetësojnë Ditën e Kiametit.

Shkaku i tetë: falja e të Gjithëmëshirshmit pa ndërmjetësimin e askujt. All-llahu xh.sh. thotë:

“... por ia falë të tjerat mëkate kujt të dojë.” (En-Nisa’: 48 dhe 116).

Shkaku i nëntë: duaja e besimtarit dhe kërkimi i faljes derisa është gjallë dhe pasi që të vdes.

Shkaku i dhjetë: sevabet e sadakasë, leximi i Kur’anit, haxhxi e të ngjashme, që i dhurohen të vdekurit, ngase pjesëtarët e ehli Sunnetit janë në pajtim se të vdekurit kanë dobi nga veprat e të gjallëve në dy raste:

Rasti i parë është nëse njeriu lë pas vetes diçka që prej saj ka dobi edhe pas vdekjes së tij, ngase në një hadith sahih thuhet: “Kur vdes njeriu, sevabet i pushojnë t’i arrijnë, përveç në tri raste: sadakasë së përhershme, shkencës prej të cilës ka dobi njerëzia dhe fëmijës së mirë i cili lutet për të”.³⁶⁸

Rasti i dytë është duaja e besimtarit dhe kërkimi i faljes për të, sadakaja dhe haxhxi. Ndërsa ndahen në mendime për sa i përket ibadeteve trupore, siç janë agjërimi, leximi i Kur’anit dhe dhikri.

Ebu Hanife, Ahmedi dhe shumica e selefëve konsiderojnë se edhe sevabet prej tyre arrijnë gjer tek i vdekuri, ndërsa Shafiu dhe Maliku konsiderojnë se nuk arrijnë.

368 Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejre në Sahihun e vet dhe Buhariu në Edeb.

Kurse, argument se të vdekurit kanë dobi nga veprat që nuk i ka bërë ai janë fjalët e All-llahut xh.sh.:

“Edhe ata që vijnë pas tyre - thonë: “O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh.” El-Hashër: 10).

Me këtë ajet All-llahu xh.sh. i lavdëron besimtarët të cilët kërkojnë falje për besimtarët që kanë qenë para tyre, që është argument se ata (të vdekurit) kanë dobi nga istigfari i të gjallëve.

Argument se të vdekurit kanë dobi nga duatë e të gjallëve është edhe ajo se i tërë ummeti është i një mendimi përkitazi me Kunut-duanë të vdekurve në namazet e përbashkëta, kurse duatë që transmetohen në hadithe për të vdekurin, gjithashtu janë të njohura për të gjithë, si dhe duaja për të vdekurin pas varrimit të tij. Ndërsa Resulull-llahu s.a.v.s. i mësonte as’habët që kur t’i vizitojnë varrezat të thonë: “Es-selamu alejkum ehled dijari minel mu’mnine vel muslimine, ve inna in shaellahu bikum lahukun, nes’elullahe lena ve lekumul ‘afije.” -”Es-selamu alejkum banorëve të këtyre varreve, mu’minëve dhe myslimanëve, e edhe ne, dhashtë All-llahu, do t’ju bashkangjitemi juve, e lusim All-llahun xh.sh. të na shpëtojë edhe juve edhe neve!”³⁶⁹

Argument se, shpërblimi i sadakasë, e cila është ndarë në emër të të vdekurit, i arrinë edhe atij është hadithi që e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Aishja r.a. e cila tregon se një njeri i ka thënë Pejgamberit s.a.v.s.: “Vërtet, nëna ime ka ndërruar jetë, dhe kam parë se sikurse të mund të

369 Transmeton Muslimi. Shih: Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 7: 89.

fliste do të më urdhëronte të jap sadaka (lëmoshë) për të. A do të ketë ajo dobi nëse unë jap sadaka për të?” Pejgamberi s.a.v.s. u përgjigj: “Po!”³⁷⁰

Përkitazi me këtë temë flasin edhe disa hadithe të tjera.

Se shpërblimi për agjërim, gjithashtu, i arrinë të vdekurve, argument është hadithi që e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Aishja r.a. e cila thotë se Resulull-llahu s.a.v.s. ka thënë: “Kush vdes e ka mbetur borxh diç nga agjërimi, për të do të agjërojë trashëguesi i tij.”³⁷¹

Ndërsa argument se, shpërblimi i haxhxhit i cili bëhet në emër të të vdekurit arrinë gjer tek ai, është hadithi që e transmeton Buhariu nga Ibni Abbasi r.a. i cili thotë se një grua nga fisi Xhuhejne ka ardhur tek Resulull-llahu s.a.v.s. dhe ka thënë: “Nëna ime është betuar se do ta kryejë haxhxhin, porse ka vdekur para se ta bënte këtë. A do ta kryej haxhxhin për të?” Ai u përgjigj: “Kryeje haxhxhin për të, a mos vallë, nuk do ta paguajshe borxhin e nënës sate sikur ta linte pas vetes? Andaj kthejani borxhin All-llahut, ngase All-llahu është më i pashmangshmi që të realizohen premtimet e dhëna Atij.”³⁷²

Kjo nuk bie në kundërshti me fjalët e All-llahut xh.sh.:

“Dhe që njeriu do të ketë vetëm atë që është marrë me te (punuar atë).” (En-Nexhm: 39).

370 Muttefekun alejhi, vel lafzu li Muslim. Shih: Sahih Muslim bi sherhin Nevevi, 7: 89.

371 Muttefekun alejhi. Shih: Sahihu-l-Buhar - kaptina mbi agjërimin (kush vdes e ka mbetur borxh diç nga agjërimi).

372 Transmeton Buhariu. Shih: Sahihu-l-Buhari me’a Fet’hul Bari, 4: 52.

“... Në dobi të tij është e mira që bënë.” (El-Bekare: 286).

“... Dhe ju do të shpërbleheni vetëm për atë që keni punuar.” (Ja Sin: 54).

Sepse, njeriu me pranimin e Islamit hynë në lidhje vëllazërore islame me vëllezërit e vet myslimanë, andaj sjellja e pëlqyeshme e tij ndaj tyre, udhëzimi i tij në të mirë dhe të shprehurit e dashurisë ndaj tyre, bëhen shkak që ata të luten për të edhe pas vdekjes së tij, të kërkojnë falje për mëkatet e tij dhe t’ia falin sevabet e disa ibadeteve që i bëjnë për të. Andaj edhe kjo nënkupton një pjesë të angazhimit të tij. Pra, të konsideruarit se i vdekuri ka dobi nga ajo që ia dhurojnë të gjallët nuk është në kundërshtim me këto ajete kur’anore, ngase këto janë ajete të qarta të cilat shquajnë drejtësinë e All-llahut xh.sh. dhe se Ai nuk do ta ndëshkojë askë për shkak të mëkateve të tjetërkujt, e as që do ta bartë përgjegjësinë për mëkatet e tjetrit, siç bëjnë sunduesit në këtë botë. Dhe nënkuptohet se askush nuk do të jetë i shpëtuar pos me veprat e veta, në mënyrë që të ndërpritet çdo shpresë e atij që mbështetet në veprat e paraardhësve të tij, prindërve të tij dhe shehlerëve.

Mirëpo, këtu duhet të theksohet se janë paraqitur dhe janë përhapur shumë risi (bid'ate) të cilat assesi nuk bëjnë pjesë në këtë që thamë ne, dhe assesi nuk ekzistojnë argumente shariatike për to e as i ka lejuar ato cilido qoftë nga ulemaja e pranuar. Siç është bie fjala pagesa dikujt që të lexojë Kur’an për të vdekurin, pagesa atyre të cilët falin namaz dhe agjërojnë, e këtë ia falin të vdekurve etj. Nuk ka dyshim se kjo nuk është e lejuar. Ajo që i takon asaj që thamë gjer më tani është se leximi i Kur’anit dhe dhurimi i sevabit të këtij leximi të vdekurve duhet të bëhet vullnetarisht dhe pa kurrfarë kompensimi.

Lutja e jonë e fundit është:

Falënderimi i përket All-llahut, Zotit të botëve!³⁷³

SHËNIM PËR AUTORIN

Emri i plotë i autorit është Muhammed Naim Abdus-Selam Jasin. U lind në Jordan më 11 6 1943. Fakultetin e Sheriatit e kreu në Universitetin e Damaskut, ndërsa në vitin 1965 e kreu Fakultetin e Drejtësisë në të njëjtin universitet. Punën e magistraturës në fikhun komparativ e kreu në vitin 1968 në El-Azhar. Në të njëjtin vit e kreu magistraturën nga drejtësia në Universitetin e Kajros. Doktoratin e përfundon në El-Azhar në vitin 1972 po ashtu nga fusha e fikhut komparativ. Në vitin 1972 emërohet mësime dhënës në Universitetin e Jordanisë, ndërsa nga viti 1978 gjer në vitin 1992 ligjëron edhe në Universitetin e Kuvajtit. Nga viti 1992 gjer më sot ligjëron vetëm në Universitetin e Jordanisë. Një kohë ligjëroi vetëm në Universitetin e Jordanisë. Një kohë ka udhëhequr katedrën e fikhut komparativ në Universitetin e Kuvajtit dhe është njëri nga themeluesit e Fakultetit të Sheriatit në këtë universitet. Ka qenë anëtar i komisionit shkencëtar për enciklopedinë kuvajte të fikhut. Ka marrë pjesë aktivisht në përpilimin e programit të fikhut në fakultet, dhe mbetet për një kohë të gjatë anëtar i komisionit profesional për fetva në Jordan.

373 Autori në origjinal i numëron 95 vepra më eminente nga lëmi i akaidës dhe lëmenjve të tjerë që i kanë shërbyer si burim për këtë punë të tij. Por, ne, për shkak të gjatësisë së tekstit dhe mosnjohjes së gjuhës arabe nga ana e lexuesve tanë, nuk do t'i numërojmë. Ai që dëshiron të njoftohet me to mund t'i gjejë në veprën origjinale në gjuhën arabe (sh. p.).

Merr pjesë në komisionet për përpilimin e ekonominë bashkëkohore islamike. Është bërë anëtar i kolegiumit redaktues për botimin e punimeve shkencore të Univerzitetit të Jordanisë, në të cilin vepron edhe sot. Boton një numër të madh punimesh shkencore nga fikhu dhe më gjerë. Gjer më tani i ka botuar dhjetë libra, prej të cilave dy janë nga fusha e fikhut e tri mbi xhihadin. Këto shënime i kemi marrë prej dosieut të tij në Universitetin e Jordanisë, dhe ka shprehur gëzim dhe kënaqësi të madhe, kur kuptoi se kjo vepër e tij do të botohet edhe në gjuhën shqipe.